


RESHAT T. NEPRAVISHTA

BIBLIOTEKA

854-31
N 44

PELIKANËT NDROJNË FOLE



RESHAT T. NEPRAVISHTA

BIBLIOTEKA I SHTETIT
GJYRTHJASIFER

56

32473

PELIKANËT NDROJNË FOLE

(Roman)



Titulli: 3000 Format: 30x100 cm

N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHERI»
TIRANE, 1962

RESUME OF THE PREPARATION

PETIKANET INDONESIE FOLIE

(Digitized by Google)



Redaktor: Moisi Zaloshnja
Korektor letrar: Ali Hashorva
Redaktor teknik: Adem Lita
Kopertina: Dolli Gjinali

Tirazhi: 3000

Format 70x100/32

Stash: 220455

Shtyp. N.I.Sh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tirana
MSH BOTTRELLA «MIHAL DURI»
TIRANA 1985

sheshi i tijë që i mbledhur gjithë fshatit. Dielli i që
ngjitur katër-pesë hostene rimbë, kodrat kurardhi
kryetari i këshillits Riza Drënja. Ai u përhëndet me
disa burra e dhet përdrejtua përmes pleqit, që i bënë
vënd në krye. Në kurrë shkoi i lindjeve i tij, që
pas Rizait erdhë e bija, Selvija. Vajza kish vë-
shur një fustan bojë kërmezi, pat ngjeshur përparrë
një futë të punuar në tezgjah dhe mbante nën sqe-
tull dikë të mbështellë në letër. Ajo hyri midis shor-

PJESA E PARË

Atë mëngjes rrëzeti e diellit ndrisnin plot buku-
ri. Një tufë me viqes çante ajrin e pastër, fluturon-
te me shpejtësi, lëshohej me vrik sa s'puqte me gat-
titë, loste e zbabitej dhe pastaj qëndronte të rrapi i

Shahinajve. Zogjtë ciceronin, shpupur ispin pendët,
guforeshin dhe ngroheshin si stë kishin tënë në
gjumë. Medant që shpejtësi e përfundon, i
mbushët Jashar Shahini, u kënaq duke i parë dhe, jetëm-
kur ata, të trembur nga një-qifte, fluturuan në ha-
pësirat e kaltra, u ngrit e doli nga oborri. Ngadale
e i qetë shkoi te sheshi i festës, e toku me disa pleq
dhe u ul këmbëkayq në barin që kish nisur të tha-
hej. Një vërsnik i tij i dha kutinë dhe ai mori të

mbushte çibukun. Te sheshi që imblodhur gjithë fshatit. Dielli i që
ngjitur katër-pesë hostene rimbë, kodrat kurardhi
kryetari i këshillits Riza Drënja. Ai u përhëndet me
disa burra e dhet përdrejtua përmes pleqit, që i bënë
vënd në krye.

Pas Rizait erdhë e bija, Selvija. Vajza kish vë-
shur një fustan bojë kërmezi, pat ngjeshur përparrë
një futë të punuar në tezgjah dhe mbante nën sqe-
tull dikë të mbështellë në letër. Ajo hyri midis shor-

qeve, që ishin veshur me petka të reja edhe ato, e u qafua me Minirenë, të mbesën e Jasharit.

Në shesh kishte gjallëri të madhe: biseda, të qeshura e ç'nuk të zinte veshi. Aty nga ora dhjetë shumë burra sollën disa krahë me dru dhe përgatitën vëndin e pjekjes së peshkut. Çdo gjë u bë gati, Tani prisnin kush do të delte i pari.

Midis zhurmës, përtëj te skela e Pendëkuqit, u dëgjua një gérnetë, pastaj defi. Kjo donte të thosh se një nga peshkatarët kish sjellë gjahun e tij. Kur u dha sihariqi që do të kish festë, të gjithëve sa ishin mbledhur iu çeli fytyra. Gérneta buçiti përsëri, po akoma s'pat vajtur ora që të dorëzohej peshqeshi.

Të gjithë ishin bërë kureshtarë. Donin që vëndin e nderit ta zinte ndonjë i afërt i tij.

Selvija që edhe e gjuar edhe e trondititur. Përgjak kish dalë djali i zémrës së saj, Hekurani, ndaj donte që ai t'uá kalonte të tjerëve.

Nekija, e ëma e Hekuranit dhe Jashari, gjyshi i tij, luteshin që biri i tyre të dilte fitonjës, se do ta mbanin në gojë përmirë.

Me njerëzit, në festë, sikur merrte pjesë edhe natyra. Një tufë me pullumbë fluturonin si të ndjekur nga sqyfteri, zhdukeshin në horizont, ngjiteshin përpjetë, lëshoheshin me vërtik mbi kokë të njerëzve dhe kalonin mbi kashtoren; pastaj delnin në Tërbuf dhe përsëri kthëheshin. Një herë, tufa, duke flutruar ulët sipër presjes, në hürdhjet e fshehta, u trembojnë një njeri që doli si papritur.

Ky ish Hekuran Shahini, i cili, me të lindur dielli, i pat hipur barkës. Në hürdhën e parë pat zë-në një peshk, po ky s'ja kishte mbushur synë. Në hürdhën e dytë nuk shtiri, së atjé peshqit ishin të vegjël. Voziti dhe shkoi në priten që kish caktuar që më parë. Vëndio që i frëskët, i rrëthuar nga penia.

Dielli nuk e zinte as atëhere kur arrinte kupën e qiellit. Para djalit shkuan mjaft kafshë uji; më në fund i tërroqi vëmëndjen një peshk që rrëshqiti i tronditur. Pas tij shkuan vetëtimthi dhe dy të tjere. Djali e kuptoi se po lëviznin llovushkat, caktoi edhe një herë shënjën përpara dhe u gatit për sulm. Nuk shkoi shumë dhe pa një peshk që çante ujin i trëmbur. Më në fund, nga shtegu doli me zhurmë peshku i madh. Sa arriti në pikën e caktuar, Hekurani vërviti fushqanën, pastaj ngau lundrën dhe kapi gjahun. Si e ngriti dhe e hodhi në strepën e mezit të varkës, e la sa u qetësua, pastaj e mati, i pa fletët, bishtin dhe u kënaq, se pat zënë gjah të madh e të lashtë.

Voziti dhe pas pak arriti të skela e Pëndëktiqit. Atje e priten me gënetë, dhe kur panë atë alamet peshkù që kish kapur, sazet ja morën tri herë me radhë.

Në kohën kur dielli qe ngiritur në kupën e qiellit, peshkun e stolissen me lëpushka e gjineshtra Hekurani, duke mbajtur gjahun në dorë, bëri për të sheshi:

Midis turmës doli plaku i festës. Djali iu drejtua me hap të shpejtë, i puthi dorën dhe i dha peshkun. Plaku e puthi në ballë, pa gjahun dhe tha:

— Të më rrosh, djalë, zoti të bëftë si të dashtë zemra! Ti sot gëzove fshatin, ke zënë peshk që unë në jetën time rrallë e kam parë. — Hekurani buzëqeshi, kurse përtëj Jashari, përdrodhi mustaqet. Plaku i festës e uli pakëz zënë e i tha Hekuranit në vesh: — «Peshkun do t'ja jap cucës më të bukur». — Shkoi serbes te vajzat, që ishin vënë si në radhë dhe, kur u kthyte, qëndroi përpara Selvijes.

— Mëfre, çupez, pastroje, laje dhe na e piq për meze. Paç dorën e mbarë.

Vajza i puthi dorën, mori peshkun, hoqi nga sqetulla letrën, e hapi dhe i dha plakut një dyshe të qëndisur anës me hoja.

Selvija, e yuri gjahun, në një dërrasë të gdhen+ dur, dhe nisi ta qërojë me një thikë, të mprehtë. Duart i lëviznin, me shpejtësi të madhe, se donte të mos e turpéronte plakun. Vajza e ndjente yeten, të lumtur, sadoq i vinte dhe cazë turp. Fytyra e saj, e skuqur, flokët e dredhur që i bënin ballit, sytë e qe- shur, buzët, si qershia dhe ai nishan, sa një kokërr hinxe sipër mollëzës, së faqes së djathët, e shushatë. Hekuranin.

«Selvija, është kjo?! Shiko! sa qënka rritur; sa qënka zbuluar gjatë këtyre dy vjetëve që kam qenë, në ushtrit!» – mendoi ai dhe mori frymë thellë.

Në atë çast që vajza nisi të hapë barkun e peshkut, plaku i festës kapi Hekuranin për dore dhe, në tingujt e sazeve, zuri të heqë vallen. Gjithë fshati hyri të kërcente. Selvija pastronte peshkun, dhe kur e kur ngrinte kokën dhe ngulte vështrimin si shigjetë, të një fytyrën e Hekuranit. Kur vajza i futi peshkut hellin e hekurt dhe e la të kullojë, vallja mbaroi dhe filloj sërishimi.

Sipas zakonit, me t'u vënë gjahu në zjarr, peshkatari që mbante vëndin e nderit udhëhiqte vallen e madhe. Të gjithë qenë bërë gati. Ashtu pa dashur, djalë e vajzë u shikuani sy ndër sy dhe kur vuri Selvija peshkun në zjarr, Hekurani ja filloi valles.

Sheshi buçiste nga kënga. Perbri Selvijes edhe vajza, të tjera piqnin, peshq më të vegjël. Tymi ngrish, në qancell, era e mirë, përhapej, kudo dhe u ngacmonte oreksin, njerëzve.

Djali kërcente dhe kundronte Selyjen. Vështrimet e tyre të ëmbëla takoheshin dendur dhe mbaronin me një buzëqeshje të fshehtë,

Jashari vrente të nipin dhe krenohej; kurse Ne-kija qe shumë e gëzuar, shikonte të birin dhe i bë-hej zemra mal. Vështrimet e djalit të saj dhe të vajzës së Rizait i ngrohnin zemrën.

«Eshtë e bukur si xhind, dhe punëtore si melin-gonë. Sikur ta kesh në shtëpi, ta bën natën ditë; të gëzon konakun, të lezeton prakun...»

Selvija pikte peshkun. Në vallen e tretë ajo mbaroi punën dhe, në të katërtën, udhëhoqi kërcimtarët.

Trupi i saj përdridhej lezecëm dhe duke vallë-zuar dukej sikur fluturonte. Ajo dinte ta tregonte bukurinë me buzëqeshjen e embël, nazet e holla e me krahët e mbushura topolake që tundnin shami-në tërë ojna. Të gjithë i bëri më qejf, pleqtë përpig-nin duart, hiqnin qeleshet dhe përdridhni mustaqjet. Nga i kish ardhur gjithë ky gëzim, gjithë kjo shkathësi? Mos vallë nga Hekurani që t'i tregonte se dinte ta nderonte, e se s'imbetej prapa tij? Kur mbaroi e vështroi djalin në sy sikur donte t'i thosh se e meritonte të ishte vajza e zgjedhur e fshatit, po pastaj shpejt shpejt i hoqi sytë nga ai e bëri pak si mënjanë.

Dielli atë ditë perëndoi me vallen e fundit të fshatarëve. Caonga ca sheshi u zbraz. Njerëzit iknin duke fi uruar njeri tjetrit natën e mirë dhe duke u lutur që festën e ardhëshme ta kremonin më, të gëzuar.

Selvija, vetëm filli, mori rrugën për në shtëpi. Perëndimi i bukur me dritën e kuqëremtë që kish rënë mbi pullazin e shtëpive, mbi pemët, mbi qiparizet e Shëne-Premtes, e mahnitën. Cdo gjë atë mbrëmje i dukej e jashtëzakonshme. Shpresa të më-dha trokishtë në zemrën e saj.

Hyri në oborr dhe u ul në fronin pranë derës.

Vërsħelli ma e një njeriu që këndonte këngën e Selvijes e bëri kureshtare. U drodh e tēra, se rrugës shkonte Hekurani.

E përcolli djalin me sy gjersa ai u zhduk. Qëndroi më këmbë një copë herë duke mbajtur duart në gjoks, dhe vëtëm kur pa t'anë u fut në shtëpi sikur tē fluturonte.

* * *

Sparrëdhu m'hixxha biex minnha iż-żgħiġi

Kasollja e Shahinajve ishte nē krye tē fshatit e pak si e veguar, kurse banesat e tjera qené rrjesh-tuar njéra pas tjetrēs si tē ishin ndertuar me plan. Uji dħe lagħeشتia i paten detyruar fshatarét tē zgħid-niñ vendin më tħethet, që nuk ishte as njeqind ha-pa i għejre. Midis oborreva kalonti ifugax kryesore, nē dimer tħer ħluc ē baltē dħe nē verē tħer pluhur. Kasollja e Shahinajve qed e vjetr, e ndertuar me puqtēka dħe kallama. Nja' dhjetek pash më larg ish nijē rrap i madha shekullor. Pērkundru all shtrihej kallija e buajve dħie tie nes tē oborrit njē koċek misri. Atē mēngjes, Jashar Shahini u ngrit pak shpejt. Si lau sytte dħe hangri bukē, u ul me djalin e mbes-ses dħe zuri tē rruhej. Fytyrēs sē tij tē rrumbullak-tē i shkonin mustaqet e gjata dħe vetullat e trasha, po ajo xhunga nden minjek ēr e shemitan. Shumē:

Djali i sē mbes-ses loste mē njē bilbil këd dħe me njē hotah o shelgu. Kur, ja, i vogli papandehur foli:

— Lale, laraskat nē rrap!

Plaku la briskun mënjan ē, ngriti kókkeni dħe shau ndyrē.

— O Hekur, mèrr atē teken e dil, — thirri duke fólur me għykē,

Te dera u dha Hekurani!

— Bjeru kolerav! — tha plaku duke l-ndérur krahun dréjt majes sē pemess. M'hux lu iż-żgħiġi

I nipi mori nishan dhe shtiu. Dy laraska u rru-kullisen në fletët e rrapit dhe ranë përdhe. Plaku buzëqeshi i kënaqur.

— More, po s'u sosën të mallëkuarat! E dinë që majën e rrapit e kanë ngordhje dhe prapë s'marrin vesh! — Heshti sa thithi çibukun dhe shtoi: — Si duken gratë, o Hekur, po mbarojnë hazërllekët, apo jo?

— Nga fundi janë.

— E po mirë, nisu për në Çermë dhe merr rakinë; mos u vono, djale, se dita fluturon shpejt.

— Ika, Lale, — ja ktheu i nipi. Hyri në të ndarën e zjarrit, pa dhe një herë të motrën, që do të martohej të nesërmen, mori një kënaçë prej druri dhe u nis.

Djali u kthyte nga Çerma pas disa orësh dhe, posa vuri këmbën në prak të derës, pa Selvijen. U shtang në vënd. Cupa u tërhoq pak prapa, u skuq në fytyrë dhe zuri faqen me majat e gishtrinjve të dorës së majtë.

— Hekuran, të kujtohet Selvija? — ndërhyri e motra.

— Më kujtohet, po jo kështu, — tha ai. — Këta dy vjet që unë bëra në ushtri, ajo qenka rritur shumë, — dhe sepse iu tha pështyma në gojë.

Vajza e shikoi me sy të pafajshëm dhe me një farë ndrojtjeje e turpi përzier.

Atë çast, në koridor, u dëgjuan këmbë. Hekurani doli dhe pa gjyshin.

— Hekur, merru dhe ti me një punë, shko e ca ca dru.

Djali shkoi në oborr, pranë koronecit dhe, para se të fillonte nga puna, ndezi një cigare. Duke thithur duhanin me mëndje të prishur pa nga dri-

tarja Selvijen tek kaloi kokëulur e e shkathët si sorkadhe.

«Eshtë femër me halle, tamam si e bukura e dheut», — mendoi me një drithërimë të pakuptuar në zemër.

Sa e têrhiqte ajo fytyrë! Sa donte ta shihte e ta kish pranë!

Zëri i Jasharit i hoqi mëndjen nga vajza; mori sëpatën dhe nisi të çajë dru.

Në shtëpinë e Shahinajve filluan të hynë të ftuarit; burraf, veshur me rroba të reja, i priste te dera i zoti i shtëpisë, që i drejtonte për në konakun e madh.

Më të perënduar të diellit, në oborr hyri Riza Drënja, u përqafua me shokun dhe Jashari, për t'i bërë nder, e shpuri në dhomë e i la kryen.

Nuk shkoi shumë dhe të ndarat u mbushën. Atë kohë, kalamajtë, që prisnin rrobat e nuses më të hyrë të fs hatit, ardhën me të rendur duke thirrur:

— Po vjen lajmësi! Po vjen lajmësi!

Lajmësi, një burrë i gjatë e me shpatulla si të varura, u fut në oborr duke mbajtur në dorë një bohçe dhe një valixhe. Një djale dymbëdhjetë-trembëdhjetë vjeç mori bohçen dhe hyri te nusja. Atë çast Miniresë zunë t'i venë kënanë dhe në të ndarën ku qenë mbledhur gratë jehoi kënga:

Kjo kënaja pika pika,
Ngreu, moj nuse, shko me rika.

Kjo kënaja vrata vrata,
Ngreu, moj nuse, shko me pata.

Vallen e hijte Selvija, që valëviste shaminë dhe përdridhte trupin. Djali i kish qepur sytë. Shtati i saj i derdhur e kish shushatur.

Në castin që Miniresë do t'i vishnin rrrobat e nusërisë, djali doli në oborr. Koha ish e mirë, yjet xixëllonin. Nga këneta vinin zérat e zogëzave.

Në konakun e grave kënga buçiti:

Kjo vellua fije fije

Nuses sonë i paska hije!

Hekuranit i dukej se, midis zéravetë shumtë, ai i Selvijes sikur ish më i kthjellti dhe më i embëli:

— Hekur, — ja prishi qetësinë e éma.

— Erdha, momë.

— Hajde, bir, shpjeru një sahan meze burrave:

Hekurani mori dy pjata me mish dhe hyri në dhomën plot tym duhani.

Tërë nata kaloi me këngë e valle. Vetëm ndaj të gdhirë të ftuarit shkuan në shtëpi. Hekurani bëri dy orë gjumë dhe në të lindur të diellit u ngrit. Zuri të gatiste konakët për të pritur krushqit. Pastaj, ashtu si e pat porositur Jashari, shkoi gjer në kodrën e Shëne-Premtes për të këputur disa degë ulliri që t'ja vinin duvakut.

Kur u kthye, shtëpia qe mbushur plot. Gratë këndonin dhe kërcenin, ndërsa Minirea, e rrrethuar nga të rejat, rrinte me fytyrë si të vrarë. E éma bënte nga bënte dhe, kur vështronë të bijën, i mbusheshin sytë me lot. Jashari, sadoqë e mbante vreten, nuk e fshihte dot dhëmbjen që ndjente pëndarjen nga e mbesa. Afër drekës, në krye të rrugës, u dukën krushqit. Ca ishin më këmbë dhe ca kaluar. Kalorësit mbanin në duar frenat dhe njeri syresh, sa pa pullazin e shtëpisë së Jasharit, zgjati krahun dhe se ç'tha.

Atë kohë, katër pesë gryka ciftesh u ngritën

përpjetë, u dëgjuan krismat dhe në hapsirën e kthjelltë të qillit u panë gjerdhanët e tymit. Krismat filluan të ndihen më dendur dhe më në fund u shoqëruan me këngë.

Krushqit hynë në oborr. Për nusen patën prurë një qerre të rrerthuar nga të gjitha anët me rrogozë të rinj dhe të mbuluar përsipër me qilim. Krushqit u ulën këmbëkryq në të ndarën e mirë, u gostitën me karamele, me nga një gotë raki dhe zunë të urojnë.

Nusja filloi të qajë. I hodhën duvakun, — një cohë të kuqe të lehtë, — dhe sipër duvakut vunë tri degë ulliri. Atë çast, Hekurani e mori nga krahu i djathtë dhe e nxori në oborr, ku e priste qerrja. Krushqit, me të parë nusen, filluan të këndojnë:

Më rrite, o gjysh, më rrite,

Me kajmak, me tul simite.

Më more, bandill, më more,

Nga gjir' i nënës më nxore.

Në një qerre vunë pajën dhe e nisën. Pas saj filluan të ecin krushqit, gjithmonë duke kënduar; pas krushqve zuri të kërkellijë qerrja e nuses, e stolisur me degë selvije dhe ulliri, që tërhiqej nga dy qe balashër, të cilët mbanin të lidhur në brirë nga një peshqir me vija të kuqe. Pas qerreve, në një kalë me shalë, shkonte hipur Hekurani.

Karvani ecte ngadalë; sa kaloi Plepajt u hodh në fushat e kooperativës së Divjakës.

Nga pasdrekja, gjysëm ore larg shtëpisë së dhëndërit, kishin dalë katër burra dhe një djale, që mbante në dorë një flamur të bardhë me vija të kaltra.

Krushqit qëndruan. I pari i tyre, një burri i shkuar, që ish i ati i dhëndërit, shkoi dhe e poqi me Hekuranin, që rrinte rëndë, pa zbritur nga kali, se ashtu e donte zakoni. Atë kohë nisi kënga: Djali që mbante flamurin doli përpara të gjithëve përti treguar rrugën përcjellësit të nuses.

Akoma pa lindur dielli, Hekuranni shkoi prapa koronecit, mori dy duaj më kallama dhe i shtroi përdhe. Hoqi nga qeprat disa fije kashte të argasura dhe u ul duke mbajtur sytë te dera e shtëpisë së tij. Priste gjyshin që të thurhin resë: që arrindo e shkoi.

Më në fund Jashari doli, dhe kur ëpërfundoi që ish gatitur, ju bë qejfi: U ul ashtu siç e kish zakon; para se të fillonte nga puna, tha një «bisimilah», pastaj lidhi dy fijet e kallamit e ja dha Hekurani. Gjyshi punonte i qetë, kurse Hekurani ish më fytyrë të mvrejtur e i menduar. Gjithë këtë shqetësim plaku e vështronë dhei së kuptonte nga rivinte, ndaj dhe e pyeti:

— Pse je kështu sot, o Hekur? Më dukesh si i mërzitur.

Djali e vështroi në sy: — Sot kemi tridhjet maj. Në këtë ditë, dhjetë vjet më parë, më 1943, u vra babai i nje pasud i së

Plaku pshëretiu, u ngrys në fytyrë dhe iu prenë duart. Në oborr pllakosi një qetësi e përzishme. Të dy nisën të kujtojnë të dashurin e tyre. Djali solli ndër mënd fytyrën e qeshur e të qetë të teti, që s'mbante mënd ta kish sharë ndonjë herë. Kujtoi mësimet që i jepte për të lundruar, peshkuar, për të zgjedhur vëndet ku përtipej peshku. I erdhë përt-

para syve buzëqeshjet, të vrenjturit e fytyrës, psherrëtimat e fjalët plot zjarr që thosh kundër bejlerëve. E në atë çast iu duk sikur ndjeu dorën e babait tek i përkëdhelte flokët e faqet.

Më në fund, përfytyroi atë ditë të zezë, kur e shpunë të vrarë e vëndi gumëzhinte nga krismat e pushkëve, mitrolozëve dhe mortajave. Atëhere Hekuranit i dridhej zemra, se midis atij rrebeshi, në krye të partizanëve, luftonte i ati. Kish frikë për të dhe herë pas here derdhë lot. Vetëm kur dëgjonte ndonjë zë: — Para partizan! — i dukej sikur dëgjonte zënë e tet dhe fytyra i çelej.

Kur kishin pushuar krismat dhe fashistët ua kishin mbathur, atëhere ish qëtësuar, kish dalë te dericka e oborrit, po q'të shihte! në krye të bataljonit s'ish më babai. Katër partizanë mbanin një tezgë të gjatë dhe sipër saj qe vënë një njeri.

Këmbët s'i bënin t'ecte, po gjene pati kurajë dhe, limon në fytyrë, pat shkuar të shikonte se kush kish qenë ai që mbanin partizanët. Nga larg e kish njohur. Qe i dashuri i tij. Pat vënë duart në kokë dhe kish nisur të qante. I kish shkuar dhe i kish parë fytyrën e tij të verdhë.

— Baba! Baba! Baba! — i kish thirrur dhe i kish zënë dorën.

Demiri pat hapur qepallat si me llahtarë dhe, kur kish parë Hekuranin, kish marrë frymë thellë, pat buzëqeshur, po dukej që ishte i deshpëruar, sepse e kishte kuptuar që s'e kish të gjatë.

Hekurani kish ecur bri të plagosurit dhe herë pas here vështronë nga partizanët. Dikush prej tyre kthente kryet që të mos i vinin re lotët e dikush tjetër psherëtinte.

Kur kish hyrë në oborr të shtëpisë, e ëma vuri kujën, gjyshi rrihte kokën me grushte, xhaxhai kish

ngrirë më këmbë, te praku i derës. Demiri, siç ishte shtrirë në vig, pat ngritur pak kokën me zor të madht dhe kish thënë: — Mos qani e mos vajtoni për mua. Pa gjak, pa mundime, pa hidhërimë nuk fitojmë dot. Zérin e fjalët e tij iu bë sikur i dëgjoi edhe atë cast tek ishte duke punuar.

Në këto, i gjyshi, që e kishte vënë re trubullimin e thellë të të nipit, e kishte mbledhur shpejt, dhe, për ta larguar atë dhe veten nga këto kujtime të dhëmbshme, e pyeti Hekuranin:

— Pse i ke ashtu ata gishtrinj, sikur i ke bërë me serrë?

— Po ti, o lale, e di që kam qenë tankist, dhe tankistët për ditë merren me vajra e me vegla, — iu përgjegj i nipi.

— Eë, po prapë zanatin s'e ke harruar. Në festë na nderove dhe resat mirë po i lidh.

— Zanati s'harrohet kollaj, — ja ktheu Hekurani, po prapseprapë nuk jam ai i pari. Gishtrinjtë më janë mësuar me vajra.

Jashari e shikoi si i habitur dhe nuk e kuptoi ç'do të thoshte ai me këto fjalë.

— Nesër, lale, do të shkoj në Çermë, në kantjer, e do të zë punë atje; unë kam ngarë tankun, ndaj di të punoj edhe me eskavator e me buldozer.

Jashari la kallamin, lagu duart e i fërkoi dhe deshi t'ja kthente Hekuranit, po i nipi s'e la.

— Duhet që edhe ne të rrojmë ca më mirë. Shtëpia s'e zë bukën, vetëm kopshti me pemë dhe ajo copë arë na e mbajnë xhanin. Halëza e peshkut s'të jep gjë. Sadoqë të ze peshk, prapë nuk do të nxjerr veçse cerekun e asaj që do ta marr nga puna në kantjer. — Heshti, qërci disa kallama e shtoi: — Pastaj, unë, lale, në ushtri u bëra komunist, dhe detyr-

rat e miaj tani janë më të mëdha karshi vëndit. Ne të rinjtë.

Jashari e pa në sy dhe përnjë çast vështrimet e tyre u takuan. Fjala komunist plakun e çoi në ditët e kaluara. Ai përfytyroi dimrin e njëmij e nëndëqind e dyzet e dysë. Atëdimër, një ditë kur që ulur në oborr dhe rrinte i menduar, me shpirtin helm e zëher, i biri Demiri pat dalë nga shtëpia më një pushkë në krah; i që afruar e i pat thënë dukë përqafuar:

— Mos u dëshpéro, lalë, s'mund të qëndroj më, unë jam komunist.

— Po mua më pyete që u bëre komunist? — i pat thënë më inat Jashari dhe e kishte vështruar me bisht të syrit. Demiri nuk i kishte bërë zë, e kishte përqafuar edhe një herë për së dyti t'anë dhe ishte larguar duke mbajtur përdore Hekuranin. Pak më tej kishte puthur edhe Hekuranin, dhe plaku e kish parë tek kishte fshirë sytë më mëngën e palltos, e që zhdukur.

Mendoi këto Jashari dhe tha me vete:

— Sikur të ishe gjallë, o Demir, do të shaja, se s'po të del fjala që na pate thënë. Ne siç ishim ashtu jemi: pa tokë, në kasolle! — Pastaj rënkoit tundi kokënd dhe vazhdoi. — Si bëhet dermani Tërbufit jo! U vrave kot, or bir, për Fushën e madhe!

Që në ushtri Hekurani mendonte për jetën dhe për punën që do bënte kür të lirohej. Megjithëse ish peshkatar i zoti, prapë sikur ai zanat s'i hynte në sy. U mësua me teknikën, por që ta përdorte këtë në jetën civile e të bëhej traktorist, eskavatorist, apo buldozerist, pa tjetër i duhej të largohej

nga fshati e nga gjiri i familjes, sepse në vëndlindje s'kishte ku t'i gjente këto mjete. Tërbufi me ujin e llucën e tij s'e linte. Po si të ikte nga familja e sidomos nga e ëma e nga i gjyshi, që i donte dhe e donin më shumë se veten? Kjo çështje e pat shqetësuar Hekuranin dhe më në fund kish vendosur që kur të ish në shtëpi ta shikonte e ta zgjidhte.

Si u kthyesh nga ushtria, ditët e para, ca nga mali që kish, ca nga festa e peshkatarëve e veçanërisht nga martesa e së motrës, nuk pati kohë të mendonte për të ardhmen. Por pastaj, pak ditë pas dasmës, kur mbeti shtëpia pa një therrime miell e Jasharit iu desh të dërgonte të birin, Azizin, te një miku i tij për t'i huajtur ca drithë, Hekurani nisi të mendohet jo vetëm përvete e përfamiljen e tij, po përtërë fshatin. Fshatarët e Plepajit, sadoqë pushteti i kishës ndihmuar me kredi të ndryshme, akoma vuanin ekonomikisht. Hekurani e kuptonte se të gjitha këto katundit ja pat sjellë Tërbufi.

Duke menduar kështu, i ulur në një mezhdë, vështronët ujët, që kish shtrirë krahët tej e përtej gjer në buzë të kodrave dhe që i dukej sikur i kish mbërthyer edhe atij duart e s'e linte të lëvizte.

Sa më shumë kalonin ditët, aqë më shumë i shtohej mërzia Hekuranit, dhe ajo arriti kulmin ditën e përvjetorit të vrasjes së t'et. Atë ditë iu mbush mëndja top, se e vëtmja rrugë për të ish-të punonjtë në kantjerin e Çermës, që po përgatitej për tharjen e Kënetës. Atje ai do të tregonte tërë aftësitë e tij e do të vinte tërë forcën për të mirën e familjes e të fshatit.

Që atë mbrëmje, tek po rrinin pranë vatrës, e hapi përsëri bisedën që kish bërë në mëngjes me Jasharin.

— E mendova dëshirën tënde, — ja ktheu i gjy-

shë, bisedova dhe me Azizin, — dhe zgjati dorën nga i biri, që po rregullonte një palë opinga bualli, — dhe e lamë që, si të kemi ngulur kocet, të shkosh në pulinë, atje në kantjer.

— Plaku pa Hekuranin, që u çel në fytyrë dhe shtoi:

— Ti do të merresh ditën me teknikën, natën ke për të ardhuf në shtëpi, kurse unë, meqenëse më punojnë akoma duar e këmbë, do vazhdoj me peshkun. Azizi do të merret me bujqësi. Shpresoj të na vejë mbarë.

Të nesërmen, me të lindur dielli, Hekurani mori udhën për në Çermë. Pa kaluar skelën e Pendëkuquit, pa Selvijen, që kish vënë përparrë një tifë me pata. Iu drodh zémra dhe téré rrugës nuk iu hoq mëndja nga ajo. Kur arriti në kantjer, nisi të ndjejë një farrë shqetësimi. Nga larg pa tre katër njërež që monotonin pjesë dhe vegla në eskavator! U mendua të shkonte të bisedonte më parë me ndonjë teknik e pastaj të hynte të zyra e shefit të kantjerit. Dhe ashtu bëri. Iu afroa një eskavatori dhe përshtëndëti teknikun.

— Puna mbarë, o shok.

— Mbare paç, — ja ktheu tjetri.

Hekurani, pa marrë lejë, hipi në kabinën e eskavatorit dhe nisi të vështrojë më vëmëndje mëshet dhe pedalet.

— Mos ke qenë eskavatorist? E shoh se tu bësyri pishë, — e pyeti tekniku.

— Jo, o shok, kam qenë tankist.

Tekniku i dha dorën dhe djali e kuptoii se kish të bënte më një shok armësh.

— Patentën e ke? — e pyeti tekniku.

— E kam, shoku...

— Besim më quajnë, — ja ktheu tjetri.

— Mua Hekuran. — Pó ku ke shérbyer, shokù Hekuran? — Në Tiranë. Po ti? — Dhe unë atje. — Në ç'vit? — Kam tre vjet. Po ti? — S'kam as dy javë që jam liruar. Tekniku nxori një paqetë, i lidha një cigare dhe ja ndezti. — Kam ardhur përpunë, shoku Bësim; nuk di a do të ketë ndonjë vënd. — Si s'ka, hajde shkojmë bëashkë te shefi. Nga ç'fshat je?

— Jam nga Plepajt, nga ai fshati atje përtëj, ku duket ai rrapi, i madh, i lu, përgjegj Hekurani. dhe i tregoi fshatin me dorë.

— Qënke yëndali; shumë mirë; po si organizuar je?

— Jam komunist. Bësimi qeshi, u hodh nga eskavatori dhe i ra shokut shpatullave gjithë qejf.

— Shkojmë, shoku Hekuran, — i tha dhe që të dy morën rrugën për në ndërtesën e kantjerit.

Gëzim Shkurti qe caktuar shefi i kantjerit që dë të ngrihej afër Tërbufit.

Këtë emërim ai s'e priti mirë, dhe jo vetëm kaq, po bëri qemos që të mos shkonte. Zuri «miq e shkë», po as njeri s'ja mori parasysh kërkesën që të punonte në kryeqytet.

Atë ditë pat mbetur vetëm në zyrë. Kish hedhur këmbën mbi këmbë dhe e tymoste. Në të parë dukëj sikuri sodiste Tërbuin, që dukej si në pallëm-

bë të dorës, kurse në të vërtetë ish kredhur në mendime dhe kujtonte ditët e fundit në universitet. Atëhere e kish pasur shpirtin tjetër lloj; kish qenë i gjëzuar, se pas kaqë kohe kish mbaruar studimet dhe kish vënë diplomën në xhep. Së shpejti do të shkonte në Shqipëri dhe mikul i t'et, pa tjetër do ta emëronte në kryeqytet, me ndonjë pozitë të rëndësishme, pastaj hajde t'i delte njeri përpara. Do të jepte urdhër të bëhej kjo e kjo, do të projektonte «vepra të mëdha». Do të kish të ardhura të mira dhe do ta varroste atë «jetë të poshtër» që i bënte eëma dhe emfotia. E tek kujtonte këto, përfytyronte t'ëmën kuzinjere që punonte në një restorant të kryeqytetit, kur do t'i thosh:

— Mëmë, mjafjt punove. Tani hiqe një herë e mirë përparësen se t'u bë djali. — E eëma do ta puthet e tërë ditën do të rrini rehat se s'do ta linte të bënte as dhe punët e shtëpisë.

Në kohë pushimi do të dëfrente, do të zgjidhte vajzen më të bukur. — E kush nuk do më dojë mua! — i thosh vetes në pasqyrë duke fërkuar flokët e zezë kaçurrel e duke buzëqeshur më bukurinë e ftyrës e të shtatit të tij.

Në këto vegime, një e trokitur në derë e solli në vete. Mori frymë thellë, vërviti përjashta bishtin e cigares dhe foli:

— Hyrë!

Në zyrë u dha Hekurani me shokun e tij të ri.

— Mirë ditja, — përshtendetën.

Gëzimi ua ktheu me një të ulur të kokës dhe i ftoi të rrinin.

— Q'deshët? — pyeti i pakënaqur.

— Shoku shef, — tha Besimi, — Hekurani, — dhe zgjati dorën nga peshkatari, — porsa ka mbaruar

ushtrinë. Atje ka qenë tankist dhe tashti kërkon të punojë tek ne. — Gëzimi vështroi Hekuranin si me të tallur (dhe pyeti:

— Sa shkollë kini? — Të shtetit.

— Kam mbaruar shtatëvjeçaren.

— Është, kujtova se mos ishit tapë! Megjithatë prapë nuk ju jap dot, fjalën: Të shikoj një herë. Sidoqoftë bëni një lutje, biografinë e dokumentat e tjerë; shkonike pyesni në Lushnjë çfarë duhen pér këtë punë, dhe sillmini një herë t'i shohim.

Shoku shef, ne më duket se kemi nevojë pér teknik! Shoku Hekuran është edhe komunist, pse të vejë poshtë e përpjetë? — tha Besimi. — Këto gjëra, mikunim, megjithëse ju jeni dhe sekretar i organizatës bazë të Partisë, m'ikanë bësuar mua. Prandaj më mirë, mos ndërhyjn! — u përgjegj shefi rëndë. Mandej u ngrit në këmbët e vazhdoi. — Kështu, shoko, bëni si ju thashë unë. — Dhe i zgjati dorën, po nuk arri ti të përcillej, më të, se në koridor u dëgjuan zërat e në çast ju hap dera, dhe hy-në tre burra.

— Po ti, Besimi, këtu? — pyeti, një prej tyre dhe vështroi saj Besimin Hekuranin. — Erdha më shokun. Ka mbaruar ushtrinë dhe ka patentën e tankistikit. Eshtë nga Plepajt, eshtë dhe komunist. — Si e keni emrin? — pyeti shoku që porsa kish ardhur. — Hekuran Shahini.

— Hekuran! — u gëzua ai dhe shpejt shpejt kërkoi në xhepe, nxori një fletore, e hapi dhe vuri re se ish po ai emër që ja kish dhënë sekretarja e partisë.

— Të njihem, shoku Hekuran, quhem Hajri

Aliu. Për ju dhe familjen tuaj më ka folur sekretarja e Komitetit të Partisë të rrethit. Ajo më porositi që t'ju pyes për vëndet ku do të hapim kanalin. Më tha se jeni peshkatar i aftë dhe e njihni mirë Tërbufin... Po si? Doni ta lini zanatin?

— Sa të më lerë, po e lë, shoku Hajri, — iu përgjegj Hekurani me një gëzim të papërbajtur.

— Mirë bëni, Hekurani, ne do t'ju marzim në punë. Që nesër bile. Apo jo, shoku Gëzim?

— Po të urdhëroni ju, pa tjetër, shoku kryein-xhenjer.

— E po kështu, — tha më në fund kryein-xhenjeri, — tanë mirë u pafshim; po ju prësim, shoku Hekurani, — dhe i shtrëngoi dorën.

Hekurani doli nga zyra. Faqet i digjnin flakë. Vëtëm kur u gjënd një oborr u kujtua se ish me Besimin; e vështroi shokun në sy duke buzëqeshur dhe e përqafoi.

— C'punë bën Hajriu? — pyeti si kishin ecur më shumë se dhjetë hapa!

— Është projektuesi i tharjes së Tërbufit, është xhanan burrë.

Kur arriten te xhadeja, Hekurani i dha dorën shokut, u nda me të dhe u nis për në shtëpi.

Në të kthyer peshkatar vendosi që të shkonte në fshat me lundër. Në Gjiler zgjidhi një barkë dhë filloj të vozisë përmes Tërbufit. Duke lundruar, kujtoi edhe një herë fjalët e Hajriut, që i kish thënë: «Nesër do filloni nga puna...» dhe ja mori këngës i lumtur e i gëzuar:

Çfarë kërkon ländej këndejej,
O'thëllëz' e fushës-o?

Kërkoj rrugën dhe s'e gjej
O' yll i sabahut-o!

Si doli Hekurani, me Besimin, Hajriu dhe ata që e shoqëronin u ulën rrëth tavolinës, që ish mbu-
luar me gazeta. Nga çanta që mbante në dorë krye-
inxhenjeri nxori dy libra të trasha; para se t'i hapte,
u dha shokëve nga një cigare, dhe, duke vështruar
me buzë në gaz Gézimin, i tha:

— Projektin për emisarin e Tërbufit e përfund-
duam. Tani na ngelet akoma të vendosim q'vijë do-
të jetë gryka e emisarit, në të Strymit apo në të Pa-
tës. Këtë punë mendoj ta bëjmë brënda javës dhe
pastaj të filloni, Gézim!

Gézimi i ndezi cigaren, ua ndezi dhe të tjerëve
që ishin kolegë të tij, e ndezi dhe vëtë e s'foli.

Hajriu e dinte se Gézimi e kish marrë punën
shumë ftohtë. Ai nuk ishte i kënaqur që e kishin
dërguar në punimet për tharjen e Tërbufit. Gjith-
monë rrinte buzëvarur, e i mërzitur. Prandaj i tha
shokut:

— Të gjithë jemi të rinj. Kush dy vjet më parë
e kush dy vjet më pas, po gati që të dy në një kohë
i kemi kryer studimet, dhe megjithatë na besohen
vepra të tillë të mëdha. Kjo duhet të na bëjë të
ndjejmë veten të lumtur, ne intelektualët e Shqipä-
risë së Re. — Më kujtohet rrëfimi i një shoku —
vazhdoi të tregonte Hajriu, dhe këtë e bëri me që-
llim, — Ai kishte mbaruar aty nga viti 1939-1940. Ai
shoku më ka thënë: «Kur mbarova studimet më
muarën në një shoqëri italiane dhe tërë ditën e di-
tës bëhesha lodër e tyre. Kur ndonjeri kërkonte të
më jepte diku, të rëndësishme, tjetri përgjigjej:
«Mos e nga, se është nga ata «Bono për Albania». Ja c'fat kanë patur inxhenjerët e vjetër, kurse, sot
del nga shkolla e të besojnë një sektor të tërë. Të

bëhet zëmra mal se ndjen që dija e puna jote do të japë frut.

— Ashtu është, — mërmëriti me gjysmë zëri inxhenjeri.

— Kështu është, kështu! Në kohën e Zogut mbartonin universitetin inxhenjerë e agronomë dhe sëlleshin nëpër bulevardet e kafenetë e Tiranës e të qyteteve të tjera pa pusi.

Hajriu u ngrit në këmbë, i vuri dorën në shpatulla dhe shtoi:

— Mbështetës t'i kanë thënë dhe të tjerë, po prapë meqënëse ndjej kënaqësi se shoh frytin e punës sime mendoj se bëj një fare detyre që t'i përsëris. Do ta shikosh dhe vëtë se kanali do të jetë për ty një universitet tjetër, bille më i madh. Tani po të dörëzoj projektin e emisarit. Studjoje edhe një herë megjithëse ti je në dijeni të tij.

Gëzimi mori dy librat në duar dhe i vendosi në një dollap prej druri, mbylli dollapin me çelës dhe u kthye e ndenji në vëndin e mëparshëm.

— Sot më thanë, — vazhdoi të flasë Hajriu duke vështruar Gëzimin në sy, dhe këtë gjë e bënte me të gjithë ata që bisedonte, — se përfundimi i projektit të tharjes së Tërbufit dhë bonifikimi i Myzeqe-së do të bëhet nga një ekspeditë që do të ketë dhei dy inxhenjerë të zgjedhur sovjetikë.

— Pse, projektin juaj nuk u aprovua? — pyeti Gëzimi, po edhe si më thumb.

— Në projektin tim është ideja, po aty ka shumë pikëpyetje. Në duam të thajmë Tërbufin, po ta thajmë që të na japë frut. Për të na dhënë frut duhet bonifikuar jo vetëm fusha që do thahet, po gjithë Myzeqeja. Tani dalin mjaft probleme; për shëmbëll, me ç'ujë do të vaditet fusha!

— Me tanë të lumenjve, — u përgjegj Gëzimi.
— Nuk është ashtu. Lumenjtë tanë në verë shterojnë dhe nuk e kanë sasinë e nevojshme të ujut. Këtu duhet edhe diçka tjetër. Duhen krijuar një ose më shumë rezervuarë. Heu edhe sa punë ka! Kërkohet një studim i ri dhe një projektim i ri. Gjithë kjo punë do të bëhet gjatë kohës që ju, Gëzim, do të hapni kanalin, të cilin mund ta quajmë fillim të punimeve të mëdha në Myzeqe. Tani ngrihem, shokë, — tha Hajriu. Dhe duke qënë më këmbë, vazhdoi: — Për të përcaktuar grykën e emisarit, siç bisedovë dhe me sekretaren e Komitetit të Partisë, do të shkojmë në Plepaj pasnesër. Do të nisemi prej këndej.

Kryeinxhenjeri mori kasketën dhe, si i shtroi me dorë flokët gështenjë të rrallë, e vuri në kokë. Pastaj, i përcjellë nga të tjerët, doli përjashta.

— Na erdhı vapa shpejt sivjet, — iu tha shokëve. Dhe siç e kish zakon, i hoddhi krahun Gëzimit, e të dy krah për krah zbritën kodrën gjér në xhalde. Aty u tokën më njëri tjetrin. Hajriu hypi në maqinë dhe mori udhën për në Lushnjë, kurse Gëzimi mbeti një copë herë duke vështruar veturën. Makina s'po dukej më. Ai u përkul, shqiti me forcë një fije bari dhe pastaj zuri të ecë me hap të përtuar. Kur arriti në zyrë, u përplas pas karrigesë e mërmëriti:

— Shet mënd, shqyrr që ka mbaruar studimet tre vjet më parë, se po t'ish ndonjë inixhenjér me eksperiençë më të gjatë kush e di sa do ta vriste.

Selvije Drënja kish vënë përparrë një kope të madhe me patë e, duke mbajtur në duar një purtekë të gjatë e të hollë, u binte shpendëve, që të lë-

viznin më shpejt. Si eci një copë herë në një plajë të veshur me thierza, kaloi përpara një shelgu të madh. Nga fletët e gjelbra varesin merimanga të gjata, që vetëtinin në rrezet e diellit sikur të ishin spërkatur me margaritarë. Në majat më të larta, një tufë laroshe barkmurme cicéronin kryelartë. Të trëmbur nga këmbët dhe zëri i vajzës, zogjtë fluturuan duke përpjekur krahët, me zhurmë. Selvija ngriti kokën, rregulloi me dorën e saj topolake shaminë që i kish rënë mbi sy dhe ndoqi zogjtë me vështrim. Si eci dhe pak, i la patat të hynin në kënetë. Aty pranë i zuri syri një gonxhe zamaku të egër. Ashtu fytyrqeshur, duke përkulur trupin e saj të plotë, çiku lehtë kërcellin e lules dhe ndjeu aromën e ëmbël kündërmモンjëse. Këputi gonxhen, i morri erë fort sa që fletët e lengshme dhe të freskëta zunë të zhubrosen. E vështroi lulen me sy të ndritshëm e, me një kujdes të jashtëzakonshëm, pastaj fytyra e saj e hieshme dhe e gjallë sepse i mori një pamje të zymtë. U ul përdhe dhe, ashtu pa lëvizur, thithte me etje parfumet e shumtë të kashtores, dëgjonte zëra e tinguj të ndryshëm që vinin nga bregoret, me qiparisa që përhapeshin gjer përtej, thellë në mes të kënetës.

Psherëtiu duke mbajtur sytë mbërthyer në një vënd pa vënë-re fluturimin e kërzave, fishkëllimave dhe rosakëve kokëjeshilë që përshkonin ajrin si me përtim, afër e larg.

Një zburmë remi e tronditi. Zëmra i rrahu me të shpejtë. Desh të fshihej pas një kaçubeje me gjinështra, po nuk arriti. Mbeti si e ngrirë dhe s'po mblidhje dot veten. Sytë i mbante te lundra, që sa vinte afrohej. Psherëtiu, ul pak kokën dhe faqet iu bënë trandafili. Hekurani e vështronë i heshetur. Apo e vështruqësinë e filloj se e veshur

Mirë mbrëma, Vije, — e përshtendeti ai me gjysëm zéri.

— Mirë mbrëma, — ja ktheu ajo dhë buzët iu drodhën. Ngriti pak kokën, e vështroi vëtëtimthi dhe u turpëria sikur të ish zënë në faj.

Djali këpüti një gónxhe zambaku dhe vja hoddhi në këmbë. Po nuk pati kohë ta vështronte së sile mori lulën, sepsë nuk e la një zhurmë remi që u dëgjuat aty pranë. Voziti si me nxitiim dhë, kur u siguria se zhurma vinte që përtej gardhit, ktheu ikökën dhe pa vajzën që mbante gonxhen në dorë.

Selvija shikonte zambakun e kënetës dhe ish krejt e turbulluar. Nga gëzimi faqet iu vijosën; nishani i zi që kish në mollëzën e faqës së majtë i xixelloi kur i rrëshqiti mbi të, një pikë loti.

Ditë të tëra e kish pritur këtë çast. Hekurani e donte... Ëndërimet që i patën lindur vite më parë dhe që ishin nxitur nga e motra e Hekuranit, kur ai qe ushtar, atë ditë e pushtuan të tërën dhe i vinte të fluturonte me krahë. Hekurani e donte.

Aziz Shahini, i biri i Jasharit, po e cte rrugës duke hequr këmbët osh. Ish i zemëruar dhe gjithë ky zemërim i pat ardhur se e patën thirrur në Këshillin e fshatit për një mbledhje me rëndësi.

Ku i gjejnë këto mbledhje në zjarrin e punës, mërmëriste dhe grindej me vete.

Një herë vendosi të mos shkonte, po prapë e dinte që Rizai do t'i dërgonte korierin përsëri; si ja kish bërë edhe herë të tjera, e do ta shante e do t'i thoshtë si i pat thënë dikturë. Njihovat qëdoq e ndiq

— Ty, o Aziz, tē kanē zgjedhur kōt anētar tē Kēhillit.

Më nē fund, Azizi hyri nē ndértesen dhe pa rreth njē tavoline tē għejtnej njiex grua veshur me kostum gri, me flokēt tē zeż-za me karfice ġie tē hedhur djath-tas. Fytyra me njē tē fshikur plumbi i kuqélonte. E njuhu. Ishte Shega Hajdari, sekretarja e Komite-tit tē partisē. Nē tē mēngjér tē saj Azizi pa dy njeri għad-għażi mosħatare qé s'i njihte. Njéri qe trupmádh, me flokē tē prera shkurtier e fytyrē qeshur qé, si dēgħi, eo quanin Hajri Aliu, dhe tjetri qe njē djalē i pashem, po mevetulla tē vrejtura, qé t-tieb therris-nin Gżemix Shkurti. — Shega Hajdari lu ngħid dher i dha dorën. Po kēsh-tu bēnē dhe tē dy, shokēt e tjeri. — Erdhēn tē gjithi, — u tha mēn nē fund Rizaj qytetar-ve. — Atēhere fillojmé, o xha Riza, apo jo? — pyeq-ti Shega. — Fillojmé, mojk biji, — tha ai. Shojti cigaren, vuri tē dy duart siper tavolinēs dhe tha:

— Shokē, kētē mbledhje tē kēhillit po e bējmē qé t'u themi shokēve, — dhe zgħati dorën nga inxhenn-jeret, — fjal-ġiet tona pēr disa gjéra qé kanē nevojē. Kēto difi na fillojnē punimet pēr tharjen e Tērbu-fit. Puna u waqtē imbarġi ketyre shokēve ġie me krahē tē leħte.

— Amin, dashtē zofni, — uruani edhe fshatar-ett e tjeri.

— Qé thoni ju, — vazħdoxi xha Rizai, — inxhenn-jeret kanē menduar qé kanali i Tērbu-fit tē shkojje nē fshat in-thoni, dhe gryka e kanalit tē kalojē nē njér-en nga tē dy vijat: ose nē Vijen e Strymit ose niē Vijen e Patēs. — Heshti, shtyu mē tej qeleshien qé kiski vēnē siper tavolinēs dhe shtoi: — Kēta duan

edhe mendimin tonë se ku është më mirë ta bëjnë grykën, — përsëri heshti, afroi karrigen pranë tavolinës, kruajti me gishtrinjtë e trashë e tërë kallo, kokën tullace dhe përsëri nisi: — Unë e kuptova se si e duan të jetë gryka dhe u thashë se të tillë gjëra ka Vija e Strymit dhe mendoj që ajo të bëhet dhe grykë kanali. Tani flisni dhe ju, se kjo është vërtet pune e madhe.

— Mirë e ke, o Riza, mirë u ke thënë. Këtu kemi dy vija, apo jo? Mirëpo Strymi është më i gjerrë, më i thellë dhe del në sop me hundë më të gjatë, — u hodh e tha një plak që mund të ish vërsnik i Rizajt, — dhe edhe unë them se atje duhet hapur gryka. Tani këta e dinë se ku iu bëhet më mirë.

— Ashtu është, — folën të tjerët, veç Azizit.

— Kurse Vija e Patës, — vazhdoi plaku, — është më e cekët, më e ngushtë dhe ka hundën më të vogël.

— Mirë fole, o komshi, — ia priti Xha Rizai, — po unë u këshilloj të mendoheni mirë që t'i ndihmojmë sa më shumë këta shokët. Sa pér mua, unë vënd më të mirë se Vlijen e Strymit nuk gjej, sepse veç atyre që zure në gojë ti, ajo ka edhe shumë anë të tjera të mira: Po të bëhet gryka te Vija e Strymit, do të kursejmë afër treqind pashë kanal pa gjermuar. Veç kësaj, kanali nuk do të presë thikë, po drejt.

Inxhenjerët buzëqeshën.

— Ti, o xha Riza, si duket e ditkë përmëndesh nga do të shkojë emisari, — tha Hajriu.

— E di, djale, e di.

Azizi ngriti pak kokën dhe mërmëriti:

— Folët mirë, o vëllezër, po desha t'ju kujtojë dhe pér diçka: Ne, si këshillë, duhet të shkojmë dhe leverdinë e fshatarëve; dhe kanali të shkojë në atë grykë që u bën më pak dëm atyre.

— Nuik po flet mirë, — ja priti Rizaj, dhe, si zgjati pak mëngën e xhaketës së zezë, vijoi: — ne duhet të përpinqemi që Tërbufi të thahet sa më parë. Sa përdëmet që do fë bëhen, mos e vrissni shumë mëndjen, toka do të zëvëndësohet posa të thahet këneta.

— Mirë e ke, shoku kryetar, po këneta nuk thahet së shpejt; ku do të gjejnë fshatarët të hànë?

— Këneta e zezë, vitin që vjen, do të jetë tharë, — u hodh e tha Shega. — Mua më duket se xha Rizaj po flet drejt. Të gjithë kemi si detyrë ta thajtë sa më parë kuçedrën, si e quani ju.

— Mirë e ke, mirë e ke, — ja prenë fjalën fshatarët.

— E mirë e të mirave, — vazhdoi ajo, — është t'u tregojmë vëndin inxhenjerëye e t'u themi se këto vija janë kështu e kështu dhe pastaj, cilën të pëlqejnë, të marrin atë që pëlqejnë atë të marrin.

— Ashtu është, mo bijë, folë fjalë me mënd, — belbëzoi Rizaj, dhe iu drejtua inxhenjerëve:

— Hytë dët në mëndjet tona, o shokë, apo jo?

— Ato që deshëm, i kuptuam. Nesër kush do të vijë më ne?

— Me ju do të vij unë, Hekurani i Jasharit dhe dy peshkatarë të tjerë. Vëçse Hekurani duhet thirrur, se punon në kantjer. Pesë lundra mjaft i kemi, më shumë s'besoj të duhen.

— Mjaft janë, o xha Riza, — tha Shega.

— Atëhere kështu, or miq: — e mbylli bisedën Xha Rizai, — nesër më të lindur të diellit, ja nisim me bismilahi, si i thonë, — dhe u ngritën e dualën në oborr,

Jashar Shahini doli nga shtëpia dhe po ecte duke i mbajtur duart paš. Po ta vije re mirë, e shquaje që çalonte pak fare, se këmbën e majtë e kish një çikë më të shkurtër. Ish veshur me rroba kadifeje, që u pat dalë boja dhe që s'kuptoheshin fare ç'ngjyrë kishin pasur, kur kishin qënë të reja. Në këmbë kish mbathur një palë këpucë të rënda, të cilat i hiqte zvarrë. Qeleshja e bardhë, e vëtmja gjë e re në trupin e tij, i rrinte pak e madhe. Plaku po shkonte në kopshtin me pemë, që s'ish shumë larg fshatit. Si kapërceu rrugën kryesore, fshiu fytyrën me dyshen, që e kish hedhur në supin e majtë, dhe hyri në kopshtin e frethuar me drizë të dëndura e të gjata. Sapo hodhi këmbën brënda tha një bësmilahi dhe zuri të ecë duke vështruar bajamet, shegët dhe manat. I queshte nuri, se që të gjitha ishin ngarkuar sa s'thyheshin. Në fund të kopshtit dëgjoi një zhurmë dhe mblodhi buzët.

— Hë c'do më prishin hardhinë, — mërmëriti, se e kuptoi që graria po shkundte mana. Nxitoi çapin dhe atëhere të çaluarit u duk më shumë.

— Ti, moj, hapi kokërdhokët! Shiko se mos shkundni dégët ku është spërdredhur hardhija, se pëstaj t'i shkula dhëmballët! — i tha Bules, sé shqes sé Azizit.

— Mos u bëj merak, Lale, — ja ktheu e reja, që kish hipur në majë të manit.

Përposh, e éma e Hekuranit dhe një fqinja e tyre hapen një çarçaf.

— Shkundë, Bule, — i tha e éma e Hekuranit.

Dega u tund dhe në pëlhurën e pastër u përplasën kokrrat e bardha e të pjekura të manit. Jasari u ul në bisht dhe nisi të mbledhë manat që

binin në barin e zverdhur. Mbushte duart dhe i hidhte në një kaçile. Në këto e sipër, dëgjoi një të kollur.

— Ecë e shiko kush është, — i tha së mbesës, e sakaq u ngrit në këmbë, zuri kryqet me duar, shëmtoi fytyrën dhe rënroi.

— Ú plaka, dreqi e mori. — Pastaj ktheu kokën; — Ti qënke Aziz? E, a e bëtë mbledhjen e Këshillit, — E bëmë! E bëmë! — ja ktheu i biri tërë hundë e buzë.

Jashari vështroi Azizin dhe picëlloi sytë.

— Pse të ka rënë hieja e lugatit, apo të shau prapë tullaci?

— Nuk më shau njeri, po hajde ulemi, se nuk i kemi punët mirë.

Jashari u ul dhe po vështronte të birin në buzë se ç'do t'i thosh.

— Mora vesh në Këshillë, se kanali për të tharë kënetën do u bëka këtu, në Plepaj. Si grykë kanali kanë zgjedhur dy vijat: atë të Strymit dhe të Patës. Rizaj ua mbushi mëndjen inxhenjerëve, që për grykë kanali të jetë e Strymit, se po të bëhet ajo e Patës, ai atje ka bostanet dhe i ikin nga dora.

— Po mirë, ç'të keqe na sjell kjo neve?

— Si s'na sjell të keqe! Pa shih Shelgun e Lumturisë; kanali do të presë drejt dhe kopshti, ynë na iku nga dora!

Plaku u pre në fytyrë.

— Po ti, o tutkun, çfarë bëre? Gojën përsë e ke? Vetëm për bukë? Të ngriheshe e të thoshte ndonjë fjalë, të mbroje mallin tënd.

— Nuk ja dal dot Rizajt. Ai ka parë dynja më shumë nga unë dhe ka gjithë Këshillin me vete: ç't'i bëja unë Rizajt?

Jasharit sytë po i mjegulloheshin.

— Hë, dale, se do të më shohë se kush jam! —
dhe sakaq u gjënd më këmbë.

Jashari se vinte zverdhej. Shikoi djalin, që nisitë hante manavi getë, duke i hedhur bishtat pa u ngutur në një vënd, dhe mërmëriti gjenie me rinat:

— Do më shohë se kush jam unëligjet e lindjeve, që më përfundon. Si i shihet Shkodra, që i cili është qyteti i tij? * * * * * Të gjitha qytetet e Shqipërisë janë shumë, këtu jep e cilinë. Shqipëria është e rrethuar nga Shtëpia e Riza Drënjes që ndërtuar me kallama, kish dy dritat e mëdha nga lindja, dhe një nga jugu. Disa javë më parë, Rizaj i kish hequr një sherbet gëlqereje dhe muret zbardhnin për bukur. Shtëpia qe mbuluar me kashtë. Cdo njeri që s'e njihte gjëndjen e fshatit, po të shihet këtë shtëpi të mbuluar me kashtë, pa tjetër do ta shante të zotin e saj që s'kuqtonte nga bota. Kashten edhe Rizaj, e kish zët, po s'kish c'bënte. Tjegullat s'bëheshin në vënd; që t'i binte nga larg, kushtonin sa gjysma e shtëpisë. Megjithatë, kish vendosur t'i blente me paratë që pat hequr mënjanë. Brënda shtëpia ish rregulluar mirë e bukur. Cdo gjë ish në vëndin e saj. Dy dhomat dhe kordori qenë shtruar me dërrasa. Një e ndare, ajo e dimrit, kish një oxhak në krye. Muret i kishte të bardha dhe dy rafte të gjata e të gjëra qenë ngulur në ta e qenë mbushur me enë, më të shumta prej balte. Poshtë qenë shtruar dy rrogoze. Sa here që ulej Rizaj, Selvija, dhe, kur s'ish ajo, vetë plaku, shtronte një postiqe dashi dhe rrinte e ngrohej. Pranë murit, afër buxhakut, ish mbështetur një jastëk i mbushur me bar. Afër derës, nga të dy dy anët, ishin yënët dy sëndyqë të vjetër, të cilëve u që hequr përsipër një bojë kafe. Dera e gjelbër puthite jashtë, me një bravë pak si të madhe. Dy dritat e mbulleshin me kanatë. Ditën,

përmes xhamave, Hyntë dielli dhe të zotët e shtëpisë as që donin ta ndalonin. — E pëndarë tjetër, oda e mirë, skish ndryshim nga e para, vëçse ajoli nuk kish oxhak. Në vënd të rafteve, në mur, ish futur një binar, ku ishin mbërthyer gjashtë çengelë të vegjël, të ndritshëm, që përdoreshin për të varur rrrobat. Në krye të dhomës ish vëne portreti i Stalinit, futur në një kornizë të punuar prej zhuge. Në murin e djathtë qenë vendosur shumë fotografi, më e madhja syresh ish vëne në një kornizë me xham.

— Eshtë im bir, — thoshte xha Rizaj sa herë që e vrinte ndonjë i huaj atë fotografi.

Në cengelet rrinte varur përhershë ndonjë placë e ndonjë qëleshe. Poshtë dyshemeja që shtruar me rrogoza të rinj lale dhe mbi ta qenë hapur dy qilima të vegjël. Pranë derës ishin vënë tri karrige, të thjeshta, tre jastekë rrinin pranë njëri, tjëtrit mbuluar me një cipë të bardhë, qëndisur jo me shumë mjeshtëri. Edhe dritaret qenë mbuluar përgjysmë me nga një perde të tillë.

Në mbrëmjen e asaj ditë që u bë mbledhja, që këshillit për të biseduar me inxhenjerët, Rizaj që shtrirë në qilim, dhe duke mbajtur kökën në pëllumbë të dorës së majtë, kish mbështetur bërrylin, në jastekë e po mendohej me sytë mbërthyer të derë. Një llambë Nr. 5, me qelqe të lare, ndriconte konakun ku rrinin vetë.

Dera u hap dhe Selvija i tha me zë të ulët, por e nxituar:

— Babë, ka ardhur xha Sharë, — Rizaj u ngrit me të shpejtë, futi në brez brisqun, që i varej të një rryp meshihë, dhe doli.

Mirë se erdhe, — e poqim me Jasharin dhe sive

pa tē trubulluar; e'kuptoi dēmiku i tij vinte pér hall.

Jashari s'foli, la shkopin prafëderës, hoqipë pucët e rënda më gozhidë dhe pa Rizahë sa evësi jn Rizaj e pikasi përnjéheresh ftohitësinë që s'po tregonte mysafiri.

— S'dua hasjë, pa imbaruar punë, tha Jashari duke mbushur çibukun nga kutia e tij.

Rizaj u prek nél sedër. Shokù s'po i sporanonte kutinë dhe kjo ishte një llój paralajmérini sel du hej patjetëri t'i plotësonte dëshirën.

Sot nuk është as ditë e martë, që tē tē ikëtë ngatëruar shejtani, — i tha Rizaj më tē butë duke e vështruar si më habi dhe më një farrë nervozizmi.

— Mora vesh se ti, o Riza, kërkon që tē kalojë gryka e kanalit të Vija e Strymit — Ashtu, o Shari, se atje i ka leverdi më shumë? Sinohka ka leverdi, the? Pér cilin? Pér ty?

— Pér shtetin! — Pér shtetin, po a nuk e mendove një herë se mua më pret kokën?

— Të pres kokën! — u habit Rizai. Mylli spërgjysmë sytë dhe shtoi s'të marr vesh, o Shari!

— Si s'më marke vesh? Po tē shkojë kanali nga Vija e Strymit mua më iku kopshë më shtatëdhjetë rrënje pemë! Me sé do tē rrojë unë pastaj? Nuk më thua, me se do tē rroj unë, è?!

Rizaj krófti kokën tullace më majat e gishtrinj-ve dhe nga që s'dinte ç'të thoshtë, heshtë pér një hop.

— Vërtet, keq e paske, po s'ke se q'bën, more Shari. Siç më tha inxhenjeri, Vija e Strymit shkurton dy muaj punë dhe ka edhe shumë leverdi tē fjetat që inxhinieri i merr vesh ato.

— Shiko, o Riza, unë tē kam miki! Ti kët qëns

partizan dhe im bër nuk u vra që ti, shoku i tij, t'i prishësh kopshtin që ai i la të birit. Dëgjo, o Riza: ti duhet të ndërhysh e t'u mbushësh mëndjen inxherëve se Vija e Strymën, nuk është për ta. Shpëtëmë, o Riza, shpik ndonjë gjë; u thuaj se vahu s'mban, se shkërmotet; aman o Riza!

Rizaj u prish në fytyrë dhe iu drodhën vetullat.

— Ti më këshilloke që të gënjej! — Bëj c'të duash, vetëm shpëtomë kopshtin, mos më helmo tanë në pleqëri!

— Nuk gënjej dot, keq më vjen, po s'kam se ç'bëj. Nuk gënjej dot qeverinë e t'u nxjerr punëtorëye punë të tepërtas!

Jasharit iu zu fryma. Shqetësimi ja humbi dumimin:

— Të kesh turpi! E heq veten dhe njeri me mënd! E di pse s'do për te Vija e Patës, se të prishen bostanet, — shkrofëtiti, dhe vështroi tjetrin si ndonjë ujk.

Rizaj u bë dyllë i verdhë. Atë cast iu duk sikur e vranë. Nga që ish shushatur, s'foli, po vështroi mysafirin me përbuzje:

Jashari u ngrit më këmbë, veshi këpucët, dhe, sa doli te dera, u kërcënuar:

— Ke për të parë sa të vlen lëkura!

Rizaj u drodh, sëtye iu shqyen dhe s'e përbajti dot veten.

Tyt shej-shej-shejtan! — iu mbajt goja. Kësh-tu i ndodhë përherë kur trubullohej. U ngrit më këmbë, doli përjashta, e duke parë kurrizin e dalë të Jasharit, përsëri foli:

Budalla! I shkalluan! — Tundi kokën, — c'dja-lë ke pastur, more dallkauk, gjynah që ka qenë i yt!

— U ul në stolin e ngulur pranë derës, u mbështet pas murit dhe pa dashur, iu kujtua Demiri, dhe

jeta që pat kaluar me té në kaliben e peshkatarëve; pastaj hyri në shtëpi më bûzë té varurën. Hoq i xhaketën dhe, si e kish zakon, u mbështeti te jastëku, duke mbajtur më dorën e djathtë kokën e tij të madhe.

— Do të kemi avaze më Jasharin, — mëmieritë nëpër dhëmbë dhei i thirri së bijës t'isillte darkën! —

— Agimi i kaltër po binte nës Plepaq! Në akashfotët dhe në hûrdhet dëgjoheshin britmat e rosavës.

Hëna po rrëshqiste me ngadalënë të përenduar! Drita e saj e ëmbël qëndiste mbi kërietë një rrëpargjendi me kularë të vegjël, të lëvizshëm!

Mëngjesi që i bukur e është frëskët illoj! Hojzerash përhapeshin në ajrini e pastëri. Me të kenduan agjeli i trëtë, Shahinajt u zgjuan nga gjumi. Azizi kau sytë dhe, pa'u nxituar, mori veglat e punës e është nisprët në arë. Në rrugët e fshatit kish gjallëri. Azizi kish hedhur shatën në krah dite, mençapin e gjatë e nëtë ngadalshëm, e cte duke shkelur rëndë, në rrugicën plot me barishte të egra nga të dy anëta. Me të dalë nga fshati, ngjiti një kodër të vogël, pastaj ta në fushë. Bari gjelbëronte, vesa ruaza, ruaza e sfolliste filjet e holla dhe aty këtu përkulte majat e pafur qishme. Lulet e egra përhapnin aronat e këndëshme. Lulëktuqet dhe përvashëzat kryelarta, isado të plakura, prapë e mbanin gjallërinë. Zhapinoku fletë-verdhë me kercellin e trashë qytante i zymtë e hienëndë. Në lëdhe, boçat më gjëmba që ruajnë pûshim manushaqi si më të kaltër, qëndronin rëndë rëndë, tundeshin tërë naze nga veriu i lehtë dherësikur kërenonin bërishtet e tjera qëltë mos afroheskin.

IV mëball shqip det illeib

— Agimi i kaltër po binte nës Plepaq! Në akashfotët dhe në hûrdhet dëgjoheshin britmat e rosavës.

Hëna po rrëshqiste me ngadalënë të përenduar! Drita e saj e ëmbël qëndiste mbi kërietë një rrëpargjendi me kularë të vegjël, të lëvizshëm!

Mëngjesi që i bukur e është frëskët illoj! Hojzerash përhapeshin në ajrini e pastëri. Me të kenduan agjeli i trëtë, Shahinajt u zgjuan nga gjumi. Azizi kau sytë dhe, pa'u nxituar, mori veglat e punës e është nisprët në arë. Në rrugët e fshatit kish gjallëri. Azizi kish hedhur shatën në krah dite, mençapin e gjatë e nëtë ngadalshëm, e cte duke shkelur rëndë, në rrugicën plot me barishte të egra nga të dy anëta. Me të dalë nga fshati, ngjiti një kodër të vogël, pastaj ta në fushë. Bari gjelbëronte, vesa ruaza, ruaza e sfolliste filjet e holla dhe aty këtu përkulte majat e pafur qishme. Lulet e egra përhapnin aronat e këndëshme. Lulëktuqet dhe përvashëzat kryelarta, isado të plakura, prapë e mbanin gjallërinë. Zhapinoku fletë-verdhë me kercellin e trashë qytante i zymtë e hienëndë. Në lëdhe, boçat më gjëmba që ruajnë pûshim manushaqi si më të kaltër, qëndronin rëndë rëndë, tundeshin tërë naze nga veriu i lehtë dherësikur kërenonin bërishtet e tjera qëltë mos afroheskin.

Azizi ecte duke shijuar pa buje natyrën e mrejku kullueshme. Si kaptoj një kapercyell, që ndante ferriat e gjelbëruana mespërmes, u fut në arë. Misri kish i shtuan fletët dhe që bërë për shatë të dytë. Ai ndenji një copë herë më këmbë dhe kundroi tokën e valët ergjata e të lehta që formonin gjethet e misërit nga veriu, mëngjesor. Rastaj ngriti shatën e filloj nga puna. Tani kish zbardhur mirë. Nga lindja ish formuar një rrëth i madh, i çelët, që tregonte se dielli ish duke lindur.

Azizi prashiste i qetë, mblidhëte dheun pas bimësime kujdes dhë e shkiftonte tamam si duhej. Shata dukej si lindonjë pëndë pule më duart e tij dhe kuptohet që tmbahej nga një dorë mjeshitri. Herë pas here ai përkultë trupin dhë qëronte gramin ose podonjë fereckë të vogël shembulli është që është emri i tij. Në të lindur të diellit erdhë Jashari. Ai vuri dorëngj si strehë kapellë dhe pa djalin që punonte. Pastaj, ngadalë, i ndjekur nga një dash ogic që s'ë linte kurrë vetëm iu afroa të birit. Djali i pa t'anë dhe vazhdoi punën. Jashari u ul më bisht për të shkurtur lindonjë rrënjen grami të rrallë që kish ngelur. Ftyra e imvretur e sytë e kuq si të buhatitur, tregoni se ai s'kish fjetur. Punonte ngadalë dhe kurse kur pshëretintë. Pas cukohe, në arë erdhë edhe Nekija, e emri Hëkurani, me një shat në krahë dhe zuri të prashishtë edhe ajo. Toka ishte e butë e shkërmiqej mirë. Afér drekës, Shahinajt kishin prashitur një copë tokë të mirë. Më pak kish prashitur Nekija, po punia e saj nuk ndryshonte nga ajo e Azizit. Bulja, e shiqja e Azizit, u solli bukën. Ubulën të katerë më hiencë një shelgu dhe nisën të hanë. Të gjithë kishini oreksit i ukratën e tij. Aziz është i mbrojtur duke vështruar herë tianë, që

ash shtruar këmbëkryq dhe luant nofullat ngadalë, si me përtim, herë të künatën, që hante shpejt duke i përcjellë kafshatat njerëz pasi tjetrës. Kur e ikurri hidhte gjanë sy edhe së shoqes që përtypejeme bülçitë mbushur, nisun nga iku i tij, e përfshirë Pa mbaruar bukën imbesa e vogël kaptoj kapen-cuillin.

— Lale, — i tha të gjyshit, — ka ardhur Shega me një burrë; më tha se do teci rrijë përdarkë.

Jashari krojti gurmazin, piu ujë dhe u ngritu

— Shyqyr elhamdylylah, — tha dheshtikoi Ne-
kijen që u gjend më këmbë, mbase pa tu rigopur.

— Ju nisuni nga i shëpia dhe i themani patokum; na bëni një darkë të mirë. Ti Aziz mbapo së ngrënë, lëre shatin dhë shka tu ndihesh grave odi qëndresha Azizi pshëretiu thellë. Se c'desh të thoshi po kur vuri re se i ati e pamë zemërim, nuk foli!

Pas pak do, të vij edhe unë dëm murmuriti Jashari dhe mbushi qibukun është i përdorur këtia —

Dielli digje, po prapë jo më forcën që ka ai i korrikut dhei i gushtit. Veriu që luante fletët e ple-pave, të shelgjeve e të lisave, përhapte në fushë një farë freskë, të këndëshme, pastronte ajrin dhe rruga s'dukej e rëndë. Nëpër pemët cicërinin viqet dhe mezhdave, nërdegët e ferrekave, këndonte drizaku. Peligorkat fluturonin pa u lqdhur, duke hapur krahët e bukur me pendët enkuqe, të kaltra e të bardha;

Jashari ge shtriretë nëbie, të një plepi dhe po priste të ikte vapë. Duaqt i kish kryqezuar pas kekës dhe vështronë majati e pemës. Fletët e plerit shushurisnin. Retime e holla ngjanin si fasha të shqyera e dukej sikur i langoheshin me frikë, kaltërisë së ligjillit deri o shtunë obë ullsd strasë. It tiflësim

Plaku ijepte e merrte me mëndje të tij se g'do tefliste asaj imbrëmjeje. «E kanë marrë me gjithë mënd djemtë», thoshte me vete. «Po sikur ta thajtë vërtet Tërbuin? Sështë e mundur, s'e thau d'ot Italia e jo ne. Dora e Zotit, vetëm ajo e than. S'kaqë lindur atal njerez». Kështu i jepte fund bisedës me vetëvete plaku. Dhe me këto mendime e zuri gjumi.

Kur u ngriti dielli po rrëshqiste nga perëndimi. U shpi, gogësitë dhesi i mbushë cibukun, mori rrugën përhëfshatë.

Kur hyri Jashari në shtëpi, retë riga ana e detit, sipër majave të pishave, kishin marrë ngjyrën e bakrit. Pas një copë here ardhi Shëga me Hajrinë, Gëzimin dhe me sekretarin e Këshillit.

E po shtëpia johë sikur ka imë kripë, o djalë, — ja ktheu Jashari duke e tokur laundin.

Hekur, nall bjerë një rrugozë të rrilmë përjashtaqëse kemi kohë të mirë — Turdhëroi Jashari të nipi, që është qëndron e vërtetë. Në këtë qendrë.

U ulën pranë njeri tjetrit duke formuar një rrëth të vogël. Si gjithë njerëzve që vini në shtëpinë e Shatinjave, ashtu dhe inxhenjerëve, e sidomos Hajriut, i bëri përshtypje rrapi i madh. Që në fillim, ai ja mbërtheu sytë dhe e vështroi me kujdes.

Fletët e rrapit fërfellinë lehtë lehtë. Degët e hollë dhë majuckat tundeshin gjithë naze. Degët e trasha qëndronin të palëvizura të mbuluara nga lëkura e përhime. Trupi i tij i madhi e i mbështjellë ngë veriu me lëvozhgë të trashë dukej sikur ish ulur këmbëkryq aty në mës të oborrit dhe priste pa mërzitur t'i bënte ballë qdo stuhie e rrebeshtë dhe

për shumë vjet të tjerë. Hija e tij zinte tërë oborrin e Jasharit, oborrin e një fqinje dhe arrinte gjér te kashtoria e kënetës.

— Kush e di se sa i vjetër do të jetë ky rrap, o xha Jashar, — foli Hajriu.

— Shumë i vjetër është, — kiu përgjegj plaku kryelartë.

— Sa vjeç do të jetë vallë? — pyeti miku.

— I ka mbushur të katërqindet, — mërmëriti Jashari duke thithur qibukun.

— Ja paske nëmëruar vitet, mënduket.

— Po, mëre djalët, ja kam nëmëruar; kjo pemë ka historinë e saj, — tha plaku serioz në fytyrë.

Inxhenjeri vështroi Shegën në sy.

— Që thoni ju, kjo pemë rrëfen edhe historinë e shtëpisë sime; po t'i lemë këto. Hekur, pa ngreau na sill ndonjë gotë. Si thoni, or miq?

Atë e di i zoti i shtëpisë, — ja ktheu sekretari i Këshillit.

Hekurani usqdit dhe pas pak opërpara miqve

uvunë dy shishe me raki, pjata me qdjathë, mish

pate e peshk.

— Hajdeni djema, mirëse na erdhët dhe punëra

të mbara, uroi Jashari.

— Mirëse të gjetëm, të ardhshim në gëzime,

ja priten njeri pas tjetrit mysafirët dhe

gatat.

Nata kish rënë, yjet xixëllonin, hëna e plotë po

delte nga kodrat e Golemit. Ngjyra e shkëlqyer e

vishte natyrën në të florinjtë. Jashari shtirej si i qetë, po një hall i madh e gryente përbërenda. Mëndja i punonte te toka. Këta njerëz ishin ata që do të

vendosnin se ku do të shkonte kanali. Po t'i jepnin karar që të puqej me Vijën e Strymit, e sharruan.

Do zoti e umbushet mëndja ta ndrojnë drejtimin,

se ndryshë e qava kopshtin. Pastajt më mirë ngreau e ikë nga Plepaj, «doritë rrashomë keq se në kohën e Zogut e të Italisë» — thoshte më jetë i cili është Po sikur të hapte bisedë spërt punën e Kënetës se mos u shkëpuste ndonjë ifjalë? i llojt — usdrast nuk vodë. E, si thoni do ta thani do tij gjithë këta ujë? — pyeti Jashari pas një copë here.

— Do tati thajmë! o lëxha Shari, opastajt do të shikoni imbarësi! — Johnipëska është vrasundanë së I —

— Dashtë zoti, dashtë zotij, — shundit kdkën plaku, po prapë ztron ditja së linte të qetëzë Pà dëgjoni, more miq: mos marvini farti veshin; po i do t'ju bëj një pyjetje! Sa dhënduhet të gërmioni që tati hih qet gjithë këta ujë? nuk është fortësi i këtij vixni!

— Shuri, na duhet; si të thonimë së 50 —

— Po sa, më tregoni më qerri! Sarqerri qheado

të gërmioni? Nëm i o jemi i p. Është së nobr li iz an —

— Lerta thotë Gëzimi, se i ky do tjetë së madhi i

punimeve, — ja ktheu Shega.

— Me miliona, — mërmëriti Gëzimi s'ndodhi

Jashari pshëreti, mblohdhinpak buzët dhëtundi

kokën.

Në çast Hajriu e kuptoi se plaku i sikur s'besonte të thahej Tërbufi. Buzëqeshi e tha:

— O lëxha Shari, thuaj të drejtën, më duket sikur s'të besohet që do ta thajmë kënetën:

— Jo se nuk më besohet, po si thatë edhe vetë, po që kështu, duhet të mbledhesh gjithë dynjanë që të gërmojnë, ndaj më është bërë menidja dhallë,

— Do tati shohësh! si do t'i thahet, — buzëqeshi Shega!

Plaku i shikoi në sy, dhe përmirëzë çast iu kujtua ajo vajzë fshatare që s'merrte veshongat dynjaja e që sofishte bërë e ditur dhe e pyesni të gjithë,

Hajde, përmirëzuar t'ndë, o lëxha Shari, që

mos e vra shumë mëndjen; këneta do thahet, me si, guri, — tha kryeinxhenjerë teminë që i ka fituar.

I zotin i shtëpisë ktheu gotën dhe duke mbajtur sytë gjithmonë te mikur, pyeti:

— Po si do ta thani kënetën? Nga do të shkojë kanali? Ku do të dendhet uji?

— Kanali do të hapet këtu, në fshatin tuaj; ka të ngjarë te gryka e Vijës së Strymit. Ai do të marrë drejt, nëpër fushë, në pyllin e Divjakës, afër Kullarit, dhe në detet e pibë rul, që i është shtëpi bokë.

Jashari u trondit, po s'e bëri vete.

— Punë të madhe do të bëni, — mërmëriti si, me gjysmë zëri.

Për një hop u bë qetësi. Kush kthente gotën, kush hante meze, kušh tymoste.

Hajriu shikonte plakun, donte ta pyeste për diçka, po druhej se mos e mërziste; megjithatë e pyeti:

— O xha Shari, sikur e hape bisedën e rrapi, po s'e sose. A është e mundur të na tregosh historinë? — iu lut.

— Historinë, the? — u mendua pak dhe luajti nga vëndi. Thithi cibukun dhe filloi.

Ky rrëfim ka erdhur gojë më gojë gjë tek unë. Këtu e katërqind vjet më parë, stërgjyshi im rronte buzë, kënetës, atje ku shkon sot xhadeja. Ish peshkatár dhe djalë i pamartuar. Në shtëpi kish t'anë, t'ëmën dhe tri motra më të vogla. Një natë u bë kjameti. Vetëtimat e bënin errësirën ditë. Ra një shi më shtama. Papo ja nisi një furtuhë e llahtarëshme sa që luante fëmija në bark të nënës. Kështu, mërishtë, kaloi nata. Dita u gdhi i sterë e zezë. Ra brezher, pastaj edhe tërmet. Aty jafer s'drekës, kur deti gjëmonë më të madhe, luajtjodheu, u ndje një kris-më e fortë dheriçat bregu i aknëtës. Shtëpia me laçkë e plackë u vërvit në shkavë, sidonjë ashkel

duri, u flak në ujë dhe u mbystën të gjithë. Vetëm stërgjyshi im, rahmet pastë, Gjitar ja thoshin emrin, njeri me kuvet, sado i trullosur, dolli në sterë. Mbeti vetëm, u ngrit, iku nga vendi e u ngul në Plepaj. Sipas zakonit, kur ndodh ndonjë gjë e keqë dhe ka frikë se mund të ngjasë prapë, në vëndin e ri në mbjellini një rrapi, që shtëpi dhe familja të rrnjë sa rrapi. Dhe stërgjyshi ynë, rahmet i pastë shpirti, mbolli këtë rrapi. Rrojti shumë, afer betëdhjetë vjet, dhe, kur vdiq, i la të birit amanet që pemën ta mbante e ta arriste si fëmijë. Të mos linte sorrë, në pemë të mos qëndronin e të – mos këndonin në degët e saj qyqet e kukuvajkat. Ky amanet, or mitq, erdhi brez pas brezi gjë në ditët tona. Rrapin e kemi nabajtur si biritë vetëm dhe afrojn edhe sot e kësaj ditë, siç e patë, nda shpirti. Plaku thithi cibukun, heshti fije cope here dhe shtoi.

— Sa për tharjen e kënetës, kam dëgjuar shumë gjëra. Bile dhe im gjysh, se babai më la të vogël, thosh: «Do t'i vijë dita edhe kësaj kuçdre dhe do të thahet nga dora e njeriut. Po ata njerëz që do ta thajnë, do të jenë ndryshe. Atyre do t'u kullojë djersa e artë. Kjo djersë do të bjerë në ujë dhe ujet do të futet dymlje, pasqë nien dhë». Kështu ná thosh-te gjyshi.

— Domethënë të vjetrit besonin se do të thahej Terbuji, dhe se do ta thante djersa e artë? — Ja bëri kryeinxhenjeri.

— Po, more bir; dhe ja, ju thashë; rrroja, me shpresatë mëdha që t'i shikoja këta njerëz, po si duket, — e prëu fjalën, tundi kokën e shtoi, — si duket, sido t'i shoh dot. Mbësë ju do t'i shihni. Të gjithë buzëqeshën:

— E po ta ngrëmë pér njerëzit me djersë të artë;
— çfaqi dëshirën sekretari j këshillit.
— Me gjithë qejf, o vëlla, — foli Jashari. E pér
poqi gotën, pastaj ndenji ca si i shastisur dhe shtoi,
— po si ta pimë gjersa s'kanë lindur?

— Kush e di, xha Shari, mund të kenë lindur,
dynjaja është e madhe, Hajde pra, pér shëndetin e
tyre, — tha kryeinxhenjeri.
— Amin, amin. — mërmëriti plaku, kota ashtu si
më tym.

Sa ngritën gotat, Shega e pyeti si me kureshtje:
— Po ndonjë fjalë të vjetër, si është grumbulluar
gjithë ky ujë, mos ke dëgjuar gjë?

— Kam dëgjuar shumë fjalë, po më e përmëndura është kjo: — Dikur Tërbuffi ka qënë kasaba e
madhe. Në këtë kasaba banonte një princ. Ai na
kish rënë në sevdamë një yajzë fshatane. Vajza ishte
e bukur si yll i mëngjesit, sa që kush e shikonte
te në sy, vërbohej nga shkëlqimi. Princi mendoi ta
merrte, po i ati s'e la. Atëhere ai u zhduk pa nam
pa nishan. Bukuroshja u mërzit shumë pér humbjen
e pricinit, dhe një herë qëndroi kohë të gjatë duke
pritur pranë tri çezmave. Nga që e kish mëndjen të
hutuar, i la çezmat hapur dhe ato mbytën kasabanë.
Ka dhe fjalë të tjera që një zot i di sa janë të vërteta. — Heshti thithi qibukun. — Kështu, ore miq, muas
mos ma vini yeshin; unë them se këneta s'thahet;
sidoqoftë, juve t'ju vejë imbarë, vetëm puna e vijës
së Strymit s'më pälgen; Unë mbaj mënd një herë, ka
shumë kohë, që dëshën të bënin një hendek te Vija
e Strymit pér të lidhur dy kanalet, po nuk e bënë
dot, se nuk mbante dhei; tabani i vijës ishte i butë,
kurse vija e Patës është më ndryshe. — Të falem nderit, o xha Shari, do t'i shohim
tha Shega, do t'i shohim, vetëm se qenke, në

kundershtim me mikun tênd xha Rizanë. Ai na tha se Vija e Strymit eshtë më e mirë. Jasharit i luajti faqja e djathë. Ndënji një copë herë pa folur, pastaj tha: bukë?

— Hamë dë kaphshita bukë? — Bato i tjetër —
Hamë, xha Shari, i tha Shega. — Hekurani shtroi buken dhe nisi t'u shërbejë miqve. Biseda që bëri plakti me inxhenjerët dhe Shegën në fillim e kënaqi, po më vonë e trubulloi. Ai kuptoi menjëherë mëndjen e gjyshit dhënsa s'ua mat t'i thosh se nuk kish të drejtë. — Nërgjyshi
Kur rane miqtë të flinë, Jashari thirri Hekurani.

Dëgjo këtu, mëra vesh se neser do t'u rrëfesh të dy vijat. Ty të besojnë se jë komunist, mbushja mëndjen që kanali të shkojë te vija e Patës. Hekurani shthahgu në vënd! E vështroi tere inat dhe infërmëriti: — Hajde, hajde q'mëndon, dhe pâ i vënë shumë veshin, ratë flinte. Në fund të frugës kryesore, atje ku nga tê dy anët shtrihet Kënetë e Zëzë, dhe Tërbufi, qenë lidhur barka tê vogla tê lyera brënda e jashtë me serë. Disa qenë vendosur gjysma në vah dhe gjysma në ujë. Bregu i Kënetës ish i shkrifët, dheu i zi, i përzjerë me rrënje barishtesh, shkërmioqej sa herë që hyppnin njerëz në barkë. Në breg uji qe i turbull, kurse më tej vinte i kulluar. Sipërfaqen nga e djatha e mbulonte një gramin i dendur me fije tê holla tê gjelbra dhe me kërcëj tê hollë, që i ngjanin shumë karabushit tê qepëvë. Në mes, uji qëndronte i palëvizur, i kaltër; vetëm ndonjë korobace a bretkocë ja

prishte qetësinë dhe atëhere hapeshin në të ca rrat
thë që zmadhoheshin sâ ventë më shumë e shkritis
heshin buzë barit dhë lëpushkave.

Kjo quhej: «Skelallë Pendëkuqit». Atij mengjet
zi, në këtë vënd qenë grumbulluar njerëz. Varkëta
rët po zgjidhnin lundrat. Hekurani po rrëgullonte
vëndin në këtë përmë. Vuri ca kashtë në dixi
rekun që përdorej për tu vlerur, qëroi më një lugë
prej druri në formë lopatë të vockël ujën që kishi
zënë barka; dhe pastaj dbli në breg. Si rrëgulloi dhe
një lundër tjetër, i dha dorën Hajriut dhe kur i bë
pëntë gjithë, dëgjoi zërin e Rizajt që të niseshin.
Barkat rrëshqitën. Në krye voziste Rizajt me She-
gën, pas tyre viinte sekretari i Këshillit me Gëzim
Shkurtin. II treti lundronte Hekurani me Hajrinë.
Pas Hekuranit viñin dhe disa barkatë tjetra solli
ja. Në të ndalët në sipërfaqen e Kënetës, përparrë
shkoi Hekurani. Duke vobzitur iu kujtuavatit ditën
që i tregoi Vijënsë Strymit, dhe iu bësikur dëgjoi
zënë e tij: «Muaj më madhëju zhytë në ujëra për të
gjetur. Vijënsë Strymit, nu muriduan, po dhet fituan;
tani në dimë kufitë rri ngjalë; ndaj, i bin, imbaji mënd
mirë kufitë e sasaj se do të duhen».

Tërë ditën lundruan. Kohë më kohë Hajriu dhe
shokët e tij ndalniin barkat, matnin i hellësinë e ujit,
gjérësinë e sipërfaqes dhe mbanin shënimë. Djali
u tregonte kufitë e Vijës e tymoste dhe vështronë
me kërshtëri. Kuptonte se puna e asaj dite i kish dhë-
në frytë mëdha. Vonë, atëhere kur donte dhe ndo-
një orë që të perëndonte dielli, barkat duallën në
breg. Njerëzit ecën më këmbë disa hapa, spastaj u
futën në një kopësht me pemë. Atje u ulën këmbë
kryq dhe të zotët e kopshtit u suallën ujë për të pë-
rë. Teknikët nxuateng nga cantat bukë dhe nisën të
hanë. Pas buke fshatarët u prunë një kacile me ma-
na.

— Hekurani hante pemët dhe dëg e brente. Si do ta bënte punënamë gjyshin? — kë mireodën përfundim

Pas buke Hajriu hapi hartenë një fron të vogël portativ dhe i thirri të gjithë fshataret që e shoqëruan. — Kështë kanali! Në e quajmë Emisari i Tërbuosit, — shpjegoi duke treguar me gisht dy vijë të trasha. — Pa shikoni, në letëri kishim vendosur që Emisari të kalonte këtë, të gryka e Patis, kurse tanë punëtorëve u bie të çajnë drejt ghe kështu atë do të gërmojnë disa kilometra më pak. — Veg kësaj kemi dhe shumë të mira të tjera. Vija e Strymit na ndihmoi që ta thajmë kënetën më shpejt. — Kështu, mire vëllezër! Ju falëm i nderit shumë! Të falëm i nderit, xha Riza, paç pleqeri të bardhë; të falëm i nderit, shoku Hekuran, — dhe inxhenjeri iu dha dorën e gjithëve duke i falenderuar me radhë! — Spësia e spësive Hekurani me Rizanë muarën rrugën e fshatit, po plakur sepse nuk i dha muhabet. Në fillim djali u habit, pastaj e pikasi shkakun e kësaj ftohtësie.

«Mban mëri përpunët e shernit me lalën! — tha mi vete dhe foli: — Shokë i moshëm i është!

— O xha Riza, po q'ke që tri i hidhëruar me mua?! — mështë mëndrrësë e përgjigjet: — Në këtë rast, Rizaj e vështroi në fytyrëvdhe qëshi me qesëndi! — Rizaj i cili, jashtë që çonq e cthorq! — Të paktën!

— Shaka të duken ty të sharaf e t'ët gjyshi?

— Po ti, o xha Riza, se nje hapatë! — mos ja vurë shundëveshin!

— Mos ja vë shumë veshin? — po, mos! — qështë mdonjë i vogël yt gjysh?!

Hekurani u mirejt e ungjethuse nuk e priste këtë fjalë. —

— S'i kanë lezet shtëpisë suaj. Mua më tha Shega që për çdo gjë duhet të mbështetem tek ty, se je komunist; kurse ti s'je i zoti as t'i mbyllësh gojën t'ët gjyshi! — foli Rizai i dëshpëruar.

Hekuranit iu flakëruan sytë dhe iu duk sikur i ngulën një thikë në zemër.

— Nejse, natën e mirë, djalë, me ty s'jam zemëruar, po binde t'ët gjysh, — shtoi Rizaj.

Hekurani i zgjati dorën dhe Rizaj ja tundti duke e shikuar në sy.

Me t'u ndarë nga kryetari i këshillit, Hekurani qëndroi një copë herë më këmbë, duke i parë plakut shpatullat e ngushta e krahët pak si të gjatë. Pastaj u kthye nga e majta dhe u til në një mëzhdë. Mori një fije grurë breshke dhe filloi t'i heqë halat

Rrezet e kuqërrrema të diellit i binin në fytyrën e vrejtur. Dukej se digka bluante me vete.

Puna në kantjer Hekuranit i kish vënë shumë detyra. A: si njeri i çalltisur donte që çdo gjë ta bënte pastër e mirë dhe të nderohej me mundin e tij. Nuk duronte dot të sharat dhe përpiquej të mos u jepte shkak që ta qortonin. Zanati i ri kërkonte punë me ngulm. I duhej vënë veshi çdo gjëje, edhe vidave më të vogla, edhe telave më të hollë, se vëtëm kështu mund të bëhej zot i maqinës e, në rast nevoje, të dinte ta zbërthente, ta riparonte dhe t'i bënte shërbimet e nevojshme. Pa i kushtuar kësaj pune gjithë vëmëndjen dhe kujdesin, e dinte se nuk do t'ja delte dot mbanë, ndaj dhe andrrallat e gjymit për kopshtin s'i kish përfillur. Po ja që kish bërrë gabim, edhe atyre u duhej vënë veshi, ndryshe fjalët e liga si për të ashtu dhe për familjen e tij do të merrnin dhenë; jo, vetëm kaq, po mund, të ndodhni dhe gjëra shumë të papëlqyera. Dhe tanë,

tek rrinte sipér mezhdës mendohej tē gjente mënyrén pér ta rregulluar këtë punë e pér tē shuar zjarrin e porsandezur.

VÖLNER UND SIEBEL STAATLICHE

Punën e pastër dhe tē mirë Shahinajt e kishin trashëguar nga pleqtë. Vetë natyra i kish mësuar tē zinin zanate tē ndryshme, që tē siguronin bukën e gojës. Jashari, që në tē ri tē tij, s'kishte parë kurrrë gëzim. Pér tē mbajtur familjen i qe dashur tē bëhej peshkatar dhe tē thurte rrogoza. Shumë kohë pat punuar edhe si argat; korrte kashtë e kallam me mëditje pér beun e Elbasanit. Ndryshe nga i ati, Azizi kish dëshirë pér bujqësi. Po kjo mbetej vetëm dëshirë, se s'kish as tokë, as qe pér tē punuar. Qëkur kish qenë akoma i vogël ai qe pajtuar çoban dhensh te një aga. Pastaj pér vite me radhë kish punuar si bujk me rrogë te një bez në krahinën e Dijjakës.

Vetëm reforma agrare u dha tokë Shahinajve dhe Azizit iu plotësua dëshira. Prej asaj kohe, Jasharit dhe familjes zuri t'u qeshë buza. Azizi, si bujk i etuar pér zanatin, thuri gjerdhet që ndanin arën e tij nga tē fqinjëve dhe s'la pëllëmbë tokë pa punuar. Po edhe në atë tokë që mori mund tē mbillte vetëm misër, se nga vjeshta e dytë gjer në mars, ngandonjëherë dhe gjer në prill, ajo mbushej me ujë dhe s'mund tē hidhte dot grurë. Kopshti ishte mjeti kryesor që u mbante fryshtë. Dhe tani që atë do ta prishte kanali, pér familjen e Shahinajve kjo qe një gjëmë e madhe. Veç kësaj, Jashari, e nganjëherë dhe Azizi, mendonin se Tërbufi nuk do tē thahej. «Italia s'e luajti nga vëndi, dhe as ne s'do t'i

bëjmë dot gjë» — thoshin ata me vete. Dhe pastaj vazhdonin: «Jo, jo, nuk kanë lindur njerëzit që të thajnë Tërbufin, s'kanë lindur!» Jashari zinte kokën me dorë e mëmëristë me zemrën helm e pikë: «Kopshti po na ikën dhe kënetë nuk do thahet që nuk do thahet. Ah qeros, qeros!» shante Rizanë, — ti do dru, or qelbësirë! Dale, dale, po s't'i theva kërcijtë!

Edhe të nipit, Jashari ja kish bërë benë, se, edhe ai as majën e gishtit s'luajti për të mbajtur kopshtin, Nganjëherë thosh t'i hiqte një dajak të mirë, nganjëherë thosh ta përzente, po prapë diç e ndalonte përbënda.

Puna e kopshtit kish shqetësuar gjithë shtëpi: në. Të mëdhenj e të vegjël rrinin të vrëjtur, sikur t'u kish ndodhur ndonjë vdekje.

Nekija, me të dëgjuar lajmin dhe kur pa plakun të shqetësuar, u trondit. Asaj ja ndillte zëmra se në shtëpi po vinte rrrotull sherri. Të birin do ta shanin e do ta bënin për pesë para. Ajo ishtë gati të bënte ç'mos, po vetëm djalin të mos ja trazonin. Si grua e zgjuar e kuptonte se me fajin që kish bërrë Hekurani, s'do t'u shpëtonte fjalëve, mbasë dhe drurit.

Si gjithëmonë, edhe këtë herë donte të mos binte në gojën e Bules, së shoqes së Azizit.

Bulja u gjëzua shumë për këtë mosmarrëveshje në gjirin e familjes. Afër drekës, ajo përgatiti bukën dhe bashkë me një kotruve ujë mori udhën për në arë, te i shoqi. Gjithë rrugës mendoi ç't'i thoshte Azizit, që ta ndërsonte kundër Hekuranit. I shkoi e vrëjtur, uli tepsinë nga koka dhe ja shtroi. Azizi erdhë me ngaadalë. Që në fillim vuri re se e shoqja diç do t'i thosh. U ul këmbëkryq, u kthyte si mënjanë dhe lau duart. Si i fshiu me një peshqir që e

përdorte edhe si shami, para se të futëtë kafshatën në gojë, mërmëriti «bismilahi» dhe nisi të përtipej. Bulja e kish Nekijen halë në sy, sepse e vjehra, kur ishte gjallë, e mbante Nekijen në pëllëmbë të dorës, kurse Bulen e shante: — Hë, ti, m'u bëfsh kurban, mirë më thanë mua që mos e fut në shtëpi atë shushunjë, atë qafire; luaj vithet! — i thërriste dhe ja hiqte me kokë të fsheshës.

Këto të shara ishin të përditëshme dhe Bulja kujtonte se atë e ndizte Nekija. «Kush i ka thënë që të mos hyja në shtëpi e të mos bëhesha nuse e tyre? Nekija, ajo shtriga!» — dërdëliste me vete.

Kur vdiq e vjehra, Bulja sikur lindi dhe që aso kohe nisi të marë hak. Vëzhgonte dhe, kur i gjente kunatës gabimin më të vogël, e ngatërronte lëmshin me mjeshtëri.

Këtë mëri kish dhe për Hekuranin, bile dhe pak më të madh. Pa vajtur në ushtri, djali e kish rrahu dy herë, për punë të s'ëmës. Dhe ata dajakë ajo s'i harronte. Veç kësaj edhe ajo kish planin e saj për punë të kopshtit. Ajo mendonte: «Jashari s'e ka të gjatë; pemët do të na ngelin neve, sepse Nekijen dhe Hekuranin do t'i mërzis aqë sa të shkojnë nga sytë këmbët pa e kthyer kokën pas».

Hollake në fytyrë, me sytë larushë, qëndronte si e vrejtur, si me siklet përpëra të shoqit kur ky hante bukë, me qëllim që i i shoqi të pyeste pse rrinte ashtu.

Azizi hëngri drekën, fshiu buzët e duart dhe nxori kutinë ta dridhëte.

— Ç'ke që rri si kecka në vapë? — mërmëriti ai duke mbajtur sytë te cigarja që po dridhëte.

— Lëre, lëre, o burrë, na bëri vaki një hata e madhe.

— C'bëri vaki? — ngriti kokën Azizi.

— Lala u sëmur pér punën e Hekuranit. Ky s'e dëgjoi Lalën. Njerëzit e qeverisë caktuan Vijen e Strymit pér të bërë kanalin; na iku kopshti.

— Qysh? Qysh? — u vrejt Azizi dhe në çast i ra cigarja nga dora.

— Ja, yt nip i ngatërroi punët. Vija e Strymit do të bëhet gryka e kanalit. Kanali do të shkojë drejt dhe do prishë kopshtin tonë.

Azizi e vështroi të shoqen me inat, sikur të ish ajo fajtorja dhe i bërtiti duke u ngritur më këmbë e duke u rënë enëve që kishte përparrë.

— Vithisu, mos të ta shoh bojën!

Shkoi ngadalë në një hie plepi dhë u shtri. Fjalët e së shoqes i hynë si zagali në mish. U mërzit, u rrutullua sa më të majtë në të djathë, pastaj u ngrit me sy të llahtarisor dhe nga dëshpërimi s'dinte ç'të bënte. U mat të shkonte në shtëpi, të merrte vesh më mirë, po prapë u përmbajt. Atë ditë duhej të mbaronte prashitjen, se vapë sa vinte po shtohej. Nisi të punonte me mëndje të prishur. Duart s'i bënin pér punë dhe qdo gjë iu neverit.

— Hajde, o laço, hajde. Ti do dru, nga ti s'ka hair shtëpia, — thoshtë pér të nipin.

Punoi si me zor gjersa perëndoi dielli, pastaj, me shatën në krahë, bëri pér nga fshati.

Hyri në shtëpi. Nekija ë vuri re përnjëherë zemërimin e tij. Iu prish gjaku e u ndez në fytyrë.

Azizi, si la shatën, shkoi në konakun ku ish i ati.

— Mirë mbrëma, — pëershëndeti.

Jashari s'foli, po e vështroi me kujdes. E pikasi se Bulia do t'ja kish treguar të gjitha.

— E mbarove prashitjen?? — pyeti plaku.

— Më ka ngelur dhe pak pér nesër në mëngjes.

— Paske ecur si breshka, o djalë, — shfryu tërë zëmërim plaku.

Heshti një copë herë dhe shtoi: — Pse i ke varur ashtu turinjtë?

— Kot, ja, mora vesh punën e kopshtit.

— Hë, hë, — kruajti gurmazin Jashari dhe u kollit lehtë.

Në këto fjalë u dhia te dera Hekurani. Si hoqi këpucët u ul në fund të dhomës.

U bë qetësi. Të treve iu kishte rënë një hie e rëndë në fytyrë.

— Mbarove punë me të qeverisë? — pyeti Jashari duke folur si më grykë.

— Mbarova sa për sot, — ti dëgjuat zëri si i zemëruar i djalit.

Azizi luajti nga vëndi, e pa me inat të nippin dhe tha:

— Jau fërkove kurrizin, doje t'i merrie me të mirë që të të dorovitnin. Po a nuk mendove se na preve krahët?

— Nuk i fërkova njeriut kurrizin. Ti mos u bën merak për kopshtin; kur të thahet këneta do të marim tokë sa të duam e do të bëjmë një kopsht të ri, — foli më guxim djali.

— Ashtu të thotë radakja ty, që ma ke mbushur me kashtë. Kush të jep shtatëdhjetë rënje pemë, o hajvan!

— Mbaje pakë gojën; ta dish se nuk jam mësuar të gënjej njeri!

— Surratit tënd i thua të mbajë gojën, more edepzëz! — u çirr Azizi e u ngrit më këmbë.

Atë kohë brofi dhe Hekurani.

Tyt! Qenër e bir qenësh! Si s'keni turp që ziheni në syt' e mi! — thirri Jashari dhe me shkopin që kish i ra rrugozit shtruar në tokë. — Uluni dhe të mos dëgjoj asnje fjalë!

Të dy u stepën.

Azizi u përbajt, po e ndjente trupin t'i drithej.

Jashari pa fytyrat e tyre tē ndezura, u përtyp dhe bërtiti:

— Po qetë tē zotë, shkoni e i thyen i brinjët Riza qerosit, e jo tē haheni me njeri tjetrin si hajvanët. Ai qen i bën tē gjitha, se do tē ruajë kostanet që ka te Vija e Patës. — Heshti, hodhi këmbën mbi këmbë, i vështroi përsëri dhe shtoi: — Shporruni, këtej, tē mos jua shoh bojën, dhe po dëgjova prapë tē bëni fjalë, ju përzura nga shtëpi!

Hekurani u ngrit ngadalë, lëshoi një psherëti më dhe hyri në tē ndarën tjetër.

Nekija pa nja dy tri herë Azizin me zëmërim dhe i shkoi tē birit pas.

— Ti, moj, thirmë nusen këtu, — dëgjoi Nekija zërin e vjehërit.

Në ato fjalë, hyri në dhomë Bulja si te trëmbur.

— Ecë, ecë tëhu, — mërmëriti plaku i shtëpisë duke e vështruar me tërsëllëm dhe pastaj iu shkreh:

— E kush tē tha ty ta shponje t'ët shoq për punën e kanalit? Hë, kush? Yt atë? Tyt, edepsëze, spece e dreqit. Jashtë, dhe mos u përzje më me këto punë, se...

Bulja dolli kokëultur.

Sherri u kufizua. E pse vallë?

Jashari, që ish përgatitur ta qortonte tē nippin, u frenua. Shkaku ish se s'donte tē mbillte përcarje në mes tē fëmijëve. Vetë mund tē shante, mund tē rrihte cilindo, po që tē shaheshin e tē ziheshin pjesëtarët e shtëpisë me njëri tjetrin, nuk e lejonte. Ai kish detyrën kryësore që tē mbante në krahët e tij gjithë familjen dhe ta fregullonte si t'ja priste mëndja. Përcarjen s'e duronte, këtë e kishi amanet

edhe nga të vjetërit. Ndaj atë mbrëmje, me autoritetin e tij, i preu rrugën sherrit midis fëmijëve dhe shtëpia shpëtoi nga turbullimi.

ASDZ Hekurati i përgjithshëm
dhe vjetor i kujtimit të VI

Gushti ishte më të dalë. Në buzë të xhadesë, në një pllajë, që grumbulluar gjithë teknika që do t'i hidhej Tërbufit. Turli maqinash, të zinte syri. Sipër, ku dikur ishte postkomanda e karabinierisë, që vendosur administrata e kaitjerit. Lloj lloj tingujsh dëgjoheshin; që nga zhurmare limës gjer te të goditurat e varesë; që nga zhurma e motogikletës gjer te gumzhitja e eskavatorit.

Hekurati punonte me zell dhë po bënte përparrime në zanatin e ri. Qdo gjëje i kushtonte kujdes, pastrimit dhë vajitjes së rrotave, mbërthimit e zbërtimit të ingranazheve, punimit të motorit, lëvizshëmërisë së krahutit e lopatës. Për gjithë këtë përparrim ai kish fituar zemrën e Besimit edhe të shokëve të tjerë. Megjithatë ai nuk ish i kënaqur me vreten. Ku ish ai e ku Besimi! I vinte zili kur vështronë duart e shkathëta të shokut, që me lehtësinë më të madhe rregullonte motorin, cilindrat, karburatorin, valvolat e thithjes, dhomën e shkrepjes, pistonin, distributorin e vegla të tjera. Nuk i hiqej nga mëndjë dora e përpikët kur kontrollonte krahun dhe e shpinte atje ku dointe.

«Je larg, shumë larg», — i thoshte vetës. «Duhet akoma të punosh me vëmëndje e kujdes», — po kur kujtonë se nuk kish as tre muaj që më rrej me mjeshterinë e re, ngushëllóhej për një çast. Një ditë, tek po rrinte në kabинën e eskavatorit, të cilin e drejtonte Besimi, shikonte duart e më-

dha e törë kallo të shokut që këviznin märshet me ustallëk dhe nuk i hoqi sytë gjersa maqina mbriti pranë një kodre. Atë ditë gjithë eskavatorët do të bënин provën e fundit, para se të fillonin nga puna. Ndaj që të dy i patën kushtuar vëmëndje si zërit të motorit, ashtu dhe ecjes së maqinës e përdorimit të mjeteve të drejtimit.

Kur mbritën në kodër, eskavatoristët panë se atje kish vajtur shefi i kantjerit dhe brigadieri. U përshëndetën me njëri tjetrin dhe në çast Besimi luajti një marsh: krahu u ngrit, pastaj u ul, lopata gryejti dhenë, u mbush, u ngrit, u rrutullua djathësaz dhe u zbraz. Besimi mbuhi kështu katër pesë lopata dhe më në fund u bind se eskavatori ish në rregull.

— Hekur, po na, ulu ti dhe hidhe dheun të vargëzuar përpara, — i tha shoku dhe zbriti nga maqina e shkoi te të tjerët që po e tymosnin, dhe po vështronin.

Hekuranit iu drodh zëmra. U ul në sedile, shke li pedalin, luajti marshet dhe më sy që sikur i visheshin, vështronte lopatën që gërryente dhenë e që mbushej, po jo buzë më buzë, pastaj, kur u rrutullua më të djathtë dhe kur u derdh. Ai vuri rë se dheu nuk binte i vargëzuar. Besimi i bëri një shënje me kokë. E kuptoi që shoku nuk u kënaq. Shtëngoi nöfullat dhe shau veten, pastaj studjoi vëndin, uli lopatën dhe luajti marshet pa drojtje. Kësaj radhe lopata u mbush. Luajti me shkathtësi krahu dhë e hodhi dheun të vargëzuar. E ndjeu se këtë radhë veproi mirë, ndaj dhe nuk e vështroi shokun. E mbushi përsëri lopatën, pastaj edhe një herë, edhe një herë. Më më fund shqipti motorin e u hodh përdhe.

Besimi fu ra krahëve më buzën në gaz.

— Eskavatori ju punon si sahat, ju lumtë! tanë miqt' e mi pastrojeni dhe vendoseni në konservim: Nesër të gjithë eskavatoristëve do t'u jepet leja: Kur të kthehem, rruga do të jetë mbaruar dhe do t'ja nisim Tërbu fit. Pastaj u kthyen nga Hekurani dhë e pyeti: — Ti, Hekur, ku mendoni ta bësh lejën?

— Këtë vit do të rri në fshat, shoku brigadier.

— E po si të duash. Tanë merrni maqinën se po vjen tjetri.

Besimi ja la eskavatorin Hekuranit, i cili është shpuri në kantjer. Atje e ngritën në dy trenj të mëdhenj, e pastruan, e vajosën, i mbuluan motorin me mushamë dhe, kur mbaruan punë, dielli donte dhe nj'a dy pash të perëndonte.

— Po tashti, shoku Besim?

— Tani, Hekur, shkojmë; kthejmë nga një gotë për t'i lënë shëndetin njëri tjetrit. Pas pesëmbëdhjetë ditëve do të shihemi prapë.

— Mirë, Besim.

Hynë të dy në klub dhe porositën nga një biritë.

— Hajde, Hekur, për miqësinë tonë dhe për shëndetin tënd.

— Për miqësinë dhe për shëndetin tënd, — iu përgjegj Hekurani.

Gotat tringëlliten.

Si mbaruan dhe nga një gotë tjetër u ngritën dhe dualën jashtë. Dielli kish perënduar. Prapa kohë drave të Kryekuqit retë dukeshin si shufra bakri të derdhura.

Të dy shokët, zbritën, bregoren, shkuan poshtë në xhade dhe atje u ndanë duke u puthur e u përqafuar.

— Rruga e mbarë, Hekur, të fala nga shtëpia.

— Të falem nderit, Besim, rruga e mbarë të qof-të dhe ty, të fala bëji mëmës:

Hekurani hyri në fushë, nxitoi çapin dhe, si bëri nja dy kilometra rrugë, u gjënd në buzë të kënetës. Zgjidhi lundrën dhe rrahu ujin me rrem. Lart yjet filluan të ndizeshin dhe nga lindja doli kurota e artë e hënës.

* * *

Shumë të errëta janë netët me re në Tërbuf. Në qiellin e zi sterrë, vetëtimat e dendura që të lbyrin sytë pasqyrohen në ujin e qetë me një shkëlqim verbonjës, pastaj ja nisin bubullimat shurdhonjëse. Era e thatë dhe e vakët që vjen nga fusha sjell me vete aromën e barit të shplarë, afshin e llumit, e të lagështisë, që përzihen me erën e rrënës së tij të kash-tës e të lëpushkave.

Rosat e egra bërtasin. Kredharakët dhe barinjtë e ujit cirren me llahtarë. Bajzat lëshojnë zërin e vajtueshëm dhe fletët e presjes shushurinjtë me një tingull të trishtuar.

Në gardhet e thurur prej peshkatarëve ndihet zhurmë. Peshq të mëdhenj e të majmë, të trëmbur nga gjëmimet, çajnë me vërtik ujet, futen në kordonet e ngushtë, nga të dy anët me kallama, dhe hyjnë në kocë. Kujtojnë se janë të rrëthuar, përplasen pas resës e e turbullojnë ujet sa që në vendin përqark formohen njolla të mëdha balte.

Në netë të tilla, peshkatarët gjëzohen. Janë të sigurtë se të nesërmen do t'u qeshë fati. Vetëm fshatarët rrëth kënetës rrinë me frikë në zemër. Dëndur dalin e përgjojnë se mos dëgjojnë gumëzhimën e Shkumbinit. Ja kanë frikën këtij lumi; se, kur

vërshon, u shkreton arat dhe nganjëherë u futet në shtëpi e u rrëmbejn lackë e plaçkë.

Familja e Jashar Shahinit atë natë qe e shqetësuar. Plaku rrinte në krye të dhomës, kur e kur tymoste dhe me sy të trubulluar vështronte i dëshpëruar. Puna e kopshtit e kish qetësuar, se i patën thënë që punimet në fshat do të fillonin nga vera e ardhëshme.

«Këtu e në verë kushedi sa mëndje do të dalin» — i epte shpresë vetes.

Nekija, eëma e Hekuranit, po dridhje lesh, kurse Bulja, me këmbën e djathtë tunde një djep dhe medua rthurte çarape. Hekurani ish mbështetur në mur dhe shihet njerëzit e shtëpisë që u kish rënë një çehre e vajtuëshme. Tani që ish me leje merrej me zanatin e vjetër. Ai ndjehej i gëzuar, se qe i sigurt që kocet e tij do të kishin zënë; po në të njëjtën kohë e brente dhe një farë shqetësimi, se kish frikë mos dilte Shkumbini, që kish ardhur buzë më buzë.

Familja ra të flinte vonë, plaku e la Hekuranin të ruante, se mos dëgjonte zhurmë përtëj, afér buzës së xhadesë.

Djali dilte kohë më kohë, ngulte vështrimin diku thellë në errësirë dhe ndizte nga një cigare.

Asaj nate Shkumbini vijoi udhën e tij të zakonshme. Afér buzës kish shtrirë aty këtu degët, po këto ishin të holla dhe s'bënin dëme.

Ndaj të gdhirë, Hekurani zgjidhi lundrën e nisi të rrahë ujët me rem. Në heshtjen mëngjesore, një mjergullë e hollë valëvitej mbi kënetë. Majat e presjes kishin ulur kryet nga pikat e mëdha të vësës. Në pyllin e dëndur të kashtës dëgjoheshin fëshfëshe të gjata. Shpenzë të ndryshme uji, të trembur

nga barka, strukeshin me ngut në gjethet e zverdhura. Zhgaba e kënetës me krahë të hapura, fluturonte një me penien, vështron te poshtë me sytë e saj si qelibari dhe, në çastin e volitshëm, i turrej gjahut. Në hurdhën e presjes së djegur Hekurani pa një zhgabë të madhe që vinte në drejtim të tij, u fsheh pas një bërryli me rakita dhe shtiu me teken që kish me vete. Shpendi në fillim u ngrit, pastaj u rrukullis në ajër e ra përdhe. Djali, si mori zhgabën e vrarë, vijoi lundrimin. Më në fund u duk resa. Valët e lehta përplaseshin pas saj. Gardhi i rrethuar shtrihej sa të hante syri dhe në katër vënde dilte si me hundë, tamam si kambanore kishe.

Në kocen e parë bëhej zhurmë; brënda lëvrinin peshq të mëdhenj. Djali rrëmbeu menjëherë çernikun dhe e futi në ujin e rrethuar me kallama. Ngutej, se peshqit mund të shkulnin kocen nga një çast në tjetrin. Kallamat, sado të forcuar me hunj të gjatë, qenë anuar dhe dridheshin sikur të binte tërmët. Në çernikun e parë kapi tre peshq të mëdhenj. Posa filloj të nxjerrë çernikun e dytë, ndjeu një të dredhur në duar.

— Të zura, — mërmëriti. Nguli këmbët më mirë në lundrën e lidhur nga të dy anët në hunj, dhe e ngriti me téré fuqinë. Një goxha peshk qe futur në koshin prej rrjete. Hekurani buzëqeshi i kënaqur. Gjahu qe i mbarë. Lundra u mbush. Ai mëngjes provonte edhe një herë se peshkatari qe usta në të gjeturit e vëndeve të përshtatëshme pér gjuesti. Tani gjyshi s'do të kish më gojë t'i thoshte se aty ku pat ngritur kocet, do të zinte minj këni te dhe ndonjë cironekë.

Lundra rrëshqiste lehtë në sipërfaqen e kthjellë të dhe të qetë. Qielli sa vente po qërohej. Me të dali dielli inga një re e murme, natyra u vësh si në

ergjënd. Rrezet që binin pingul në ujin e kulluar formonin pasqyra të gjata, që thyheshin në valën më të vogël, po që nuk e humbisnin shkëlqimin.

* * *

Jashari ish ulur në një rrugë dhe po qëronte një shkop për ta bërë hosten. Si mbaroi punë, mori brezin e gjerë, e ngjeshi pas belit dhe bëri nga obo-ri. Sa dolli në derickë, dëgjoi zëra te Skela e Peshkut. Të vegjelit ja mbathën me vrap; me ta shkoj dhe e mbesa e vogël. U mat të dilte, kërkoi shkopin dhe nisi të grindej gjersa e gjeti. Në oborr takoi çupën që kthehej me një frymë.

— Lale, Hekuri ka zënë një peshk të madh, na, kaq, — dhe hapi krahët.

Plaku picërrroi sytë si me gjësim e zëmërim bashkë. U ul përsëri në vëndin e mëparshëm. Përtej, në rrugicë, pa Hekuranin të përcjellë nga tre katër veta. Nxori kutinë dhe filloj të mbushte çibukun.

Sa hyri Hekurani në oborr, ai u rigrith dhe i dolli përpara.

— I madh qënka! — tha. — Ato kocet e tua zënë nganjëherë edhe të tillë dhe a e di pse?

— Jo, lale, s'e di, — e qesëndisi Hekurani, po me një ton të tillë që plaku s'e kuptoi.

— Ka qënë i uritur dhe, duke ndjekur korobat, ra në lak.

— Mirë, o lale, mirë, — buzëqeshi djali, vari peshkun në një qepër të koçekut dhe hyri brenda.

Plaku iu afroa peshkut, e vrejti me kujdes nga të gjitha anët dhe tha i habitur:

— Sa i madh qënka! — Me të dëgjuar këmbët e Hekuranit, u step, dhe kur pa djalin që kish vënë

në krah dy kosha të thurur me purtekëza rakite, thithi çibukun fort dhe mbeti i shastisur.

— O lale, e kam lundrën dënga; po deshe hajde më ndihmo.

— Hë-he! — qeshi plaku si me të tallur, ti i ke shpatullat sa nuk t'i nxë dera, dashke edhe ndihmë! — I foli kështu sepse kujtoi mos i nipi ja pat me rumuz ato që i tha, dhe u kthye përsëri te peshku.

Megjithëse gjyshi e porositi Hekuranin që të mos i vinte kocet në vendin që ishin ngulur, gjene i ardhë mirë që zunë gjah, po edhe s'mund të rrinte pa e sharë të nipin që s'e kish dëgjuar, se kjo që e para herë që s'e dëgjonte një njeri nga të shtëpisë. «Minj dhe korobace ke për të zënë», i kishte thirrur të nipit.

Me gjithë inatin që kishte, u bëri zë grave që të shkonin ta ndihmonin Hekuranin.

Me të dalë i nipi nga oborri, plaku hapi derikënd dhe shkoi përpara. Një dash i madh me brirë të gjatë që vetëtinin dhe me perçet të lyera me bojë të kuqe e të gjelbër, u ngrit nga streha e shtëpisë dhe e ndoqi Jasharin nga pas.

— Hë, bandill, ardhe, — i tha: u ul në bisht, i lëmoi turinjt dhe i dha ca bukë misri, që e mbante përherë në xhep. Nisi të ecë duke u mbështetur te shkopi, i ndjekur nga dashi që përtpej.

Te skela e kënetës mbajti këmbët dhe po vështronte Hekuranin tek hidhje gjähun në koshat. Sadoqë ish i vrejtur në fytyrë, prapë ndjente një farë krenarie, se të gjithë ata, që ishin përreth po e mburrnin Hekuranin.

Mbi kënetë binin shkarazi rrezet e diellit dhe valët e lehta, që i theyenin këto rreze, çonin driten e tyre në sytë e plakut, prandaj ai vështronte si me

zor. Përtej, thellë, atje ku derdhej Shkumbini, kish rënë mjegulla dhe afshi i saj vinte gjer aty ku që lidhur lundra, e cila lëkundëj herë djathtas herë majtas.

Plaku më në fund vendosi të ndihmonte djalin.

— Rri, o lale, mos fëlliq duart, se e rrëgulloj vetë, — i tha Hekurani.

Jashari bëri sikur s'dëgjoi; zuri dy peshq dhe i hodhi në kosh. Në çast, se si i vanë sytë te zhgaba e vrarë që Hekurani e kish lënë në buzë të presjes, dhe u ngrys përnjëherë në fytyrë.

— Ti e vrave këtë? — pyeti plaku me sy të harkarritur.

— Unë, — iu përgjegj ai.

Gjyshi shtrëngoi nofullat, shau ndyrë, mori shkopin dhe ngau nga shtëpia.

— Qen! — thirri përsëri sa bëri dhjetë hapa.

Në shtëpi hapi një rrugoz të vogël, u ul dhe u mbështet pas murit. I vinte inat dhe, nga që s'dinte ç'të bënte, u shtri duke mbështjellë kokën me të dy duart.

* * *

Jashar Shahini pat qënë gjuetar i mirë, kurte me vëmëndje se cili zog qe më i fortë se tjetri. I donte të gjithë ata shpendë, që ishin të fuqishëm, qoftë dhe sikur të qenë të shëmtuar. Plakut s'i pël-kura dhe, sa herë që i shihte sikur i dhimbnin sytë. Atij i pëlqente laroshja, i pëlqenin dhe harabeglat e misrit dhe gargujt. Kënaqej të shikonte gurgullin kur zihej me këmqirithin dhe kur e vinte për-

para, sadoqë gargulli me trup ishte më i vogelinë kish për mburrje kur binin laroshet te rrapi; ai mund të rrinte me orë të tëra duke i vështruar. Kënaqej kur dëgjonte zërin e tyre, të mprehtë. Detidur merrte krunde, ua hidhët harabelave; ulej larg e i kundronte kur hanin. Nga shpendët e ujit më shumë donte narecin. Një herë kur ishte për peshkim, pa të zihej nareci me bajzën. Të dy shpendët uji të një madhësie. U kënaq dhe qëndroi aty afër një orë. Nareci e mundi bajzën dhe e ndoqi dulke krakarit.

Kështu e kish Jashari, ndaj u hidhëruat është ditë, kur pa zhgabën e vrarë, se e donte qëndrueshëm brenda shpendëve. Ai i kish porositur djeintë që zogjtë dhe shpendët e fortë të mos i vrasin. Vecanërisht zhgabën, gargullin, laroshet dhe ciqet.

Një copë herë të madhë indenju i shtrirë; vetëm kur dëgjoi zërin e larosheve sipër mëdrapi, ungrit, buzëqeshi dhe dolli përjashta. Zogjtë me kokë së kaltër, bark të murmë dhe krahët larëllasë rrinin si fëngrirë në një degë të hollë në majë të rrapi; kur e kur kruanin püplaf e gushës me isqepin e tyre të fortë, shkriftonin fletët e krahëve, bishtit, pastaj ciceronin me tingull rrënqethës.

Plaku s'ua hqte sytë dhe i ndiqte me svëmëndje lëvizjet e tyre. Sa herë që ciceronin hrante kokën dhe përdridhë mustaqet. Së fundi zogjtë i fluturuan. Jashari i ndoqi me vështrim gjersa i zhdukën!

Nga kafshët e buta Jashari donte demat dhe vecanërisht deshtë. Merrte përhershë një orë të vogël dhe e rriste, kujdesëj përtë si përfshi fëmijë dhe e mbante dashin manar gjersa plakej fare. Edhe kur shkonte në Lushnjë për ndonjë plackë, s'e ndante dashin.

Mishin e shpendëve të fortë, të dashit e të de-

mit, s'e vinte në gojë dhe jo vetëm kaq, por as njerezit e shtëpisë s'i linte ta hanin.

— Si ikën zogjtë, ndolli dashin dhe nisi ta kontrollojë mos kish ndonjë këpushë. Në këtë punë e sipër dëgjoi zëral dhe pa njerëzit që vinin. Iu kujtua zhgaba. U inatos përsëri. E la Hekuranin sa shkarkoi koshin e i tha:

— Dëgjo, o lanet, po të pashë tjetër herë të vrashpendë të fortë, do të të thyej shkopin pas kurrit. More vesh? — i bërtiti duke u dredhur.

Hekurani e shikoi në sy, rrudhi vetullat dhe s'foli. Dolli përjashta, mbrehu buajt në qerre, e ngarkoi qerren me peshq dhe mori rrugën për në Koooperativën e Peshkimit.

Qerrja kërkellinte, rrrotat lëviznin, ngadalë duke shkelur në pluhur e duke lënë pas dy vija të gjata. Hekurani mbante hostenin në dorë dhe, i ngrysur në fytyrë, mendohej. Sharjet e gjyshit s'duroheshin. Kështu kish qënë edhe më parë! pa avajtur Hekurani në ushtri, apo kish ndryshuar? — Mendohej, kujtonte të kalluarën dhe thosh:

«Ashtu si ishte, ashtu është. Lala s'pyet për gjë. Ai do që vetëm atij t'b shkojë fjalë, qoftë e mirë, qoftë e keqe. Ai do që t'i bindesh si ndonjë i vogël dhe të shkosh si i verbër në rrugën që të tregon ai! Dreqi e mori, — u nevrikos me vetem e tij. — Gjithë bota me botën, vec, fshatit tonë. Po edhe fshati ynë duhet të shkojë si gjithë të tjerët dhe lala duhet të bëhet njeri» — Shpoi, buajtë dhe qerrja lëvizti më shpejt.

— Ah, shpejt! — i bërtiti vodë s'ndasni që e vesh. — Shpejt! — i bërtiti vodë s'ndasni që e vesh. — Shpejt! — i bërtiti vodë s'ndasni që e vesh. — Shpejt!

Nekije Shahini, e éma e Hekuranit, qe hje grua shëndetligë, me trup mesatar, me petka tē vjetra qe s'mbahej mënd kur qenë veshur. Me një tē parë, mund tē dalloje zgjuarësinë dhe pastërtinë e shpirtit tē saj. Sytë gështenjë, pak tē mëdhenj, vështronin pérherë pa djallëzi, buzët e vogla plasa-plasa dukeshin sikur s'dinin tē filisnin fjalë tē liga.

Nekija qe martuar posa kish mbushur tē gjashtë-mbëdhjetat. Ishte vajzë e pashme dhe punëtore, e madhe; dinte çishin punët e shtëpisë, punët e arës dhe tē bagëtisë. Sa qe me burrë, ajo rrojti e lumbatur, po kur u vra Demiri, jetoi e shqetësuar, Jashari, sadoqë e donte, ishte huqli i prapë.

Gjithë shëndetin ja rrëmbyen vitet e vuajtjes dhe tani qe e drobistur, e munduar, e frudhur si një mollë e fishkur.

Jeta e saj shkonte pérherë njësoj, e mërzitësh me dhe mos më keq; vetëm kur përkëdhelte tē bixin, Hekuranin, sikur kënaqej. Për tē kujdesohej së tepërmi. E kish rritur dhe tani që ai kish mbushur tē njëzet e katër vjetët, e ndjente vetën krenare.

Hekurani e donte shumë t'ëmën; i dëgjonte fjalën dhe mundohej si e si që tē mos t'i thyente zemrën.

Një mbrëmje Hekurani hyri si cazë vonë në shtëpi. Gjyshi kish shkuar te një fqinj dhi s'ish kthyer, kurse xhaxhaj pàt vajtur tē huante pak drithë. Në shtëpi mbretëronte qetësia, kandili i varur në mur kuqëlonë tē ndarën. Në hyrjetë saj qe vendosur një sëndyq i madh, i vjetër, në struall qenë shtruuar rrogoza dhe pranë derës ishin vendosur dy katruve me nga një vegjë. Në mure qenë varur rrje-

ta peshku, kurse nga trarët vareshin dy vargje me qepë.

Hekurani, si hoqi opingat, u ul. Qe i menduar. Nxori kutinë dhe e drodhi. E hiqte cigaretën dhe den-dur vështronte nga dera mos vinte i gjyshi.

Pas pak, në dhomë hyri Nekija. U ul, e vështroi djalin drejt në sy dhe s'foli. Mori një shtëllungë lesh dhe nisi të tjerë.

Hekurani, si mbaroi cigaretën, u ngrit dhe u ul afér s'ëmës. Për një çast vështrimet e tyre u takuan dhe Nekija i fërkoi kokën.

— S'qënke më qejf, Hekri, — mërmëriti gruaja si e pakënaquri.

— Jam si përherë, moj momë.

— E shoh, e shoh. Të daltë mërzitja e ëmbël,

bir. Atë kohë hyri në shtëpi Jashari; të dy, nënë e shkopin, hoqi këpucët, dhe para se të ulej pyeti të nipin:

— *I ngule kocet?*

— *I ngula,* — iu përgjigji.

U ul duke rënkuar, mblodhi këmbët kryq dhe zuri të mbushë cibukun.

= *Sonte do të kemi shi; peshku do të rihet. Nësër në mëngjes ngreu heret se, si të kontrollosh kocet, do të vesh t'i ndihmosh Azizit.*

Hekurani ish ulur mbi sëndyq pranë s'ëmës, që vazhdonte të tirte, dhe s'foli.

— Uluni në shesh, si ka urdhëruar Perëndia,

tha Jashari duke treguar vëndin me dorë.

Qetësia në konak vazhdoi një copë herë të mëdhe. Kur e kur dëgjohej gjepi që mbushej me fije lesi dhe që përdridhej në duart e Nekijes. Vetëm

një zë që erdhi nga oborri, një zë i trashë, theu heshtjen.

Hekurani u ngrit përnjéherë e doli. Pas tij dual-lén dhe eëma e i gjyshi. Në hajat u takuan me Bulen, që kish dalë nga e ndara tjetër për të parë.

— Erdhe, Aziz? — pyeti Jashari.

— Erdha, lale, erdha.

— Mbarove punë?

— Mbarova.

Hekurani ngriti një thes dhe e shkarkoi në hajat. Aty shkarkoi edhe thesin e dytë. Azizi u hoqi buajve zgjedhën, i futi në kasolle dhe, si u shtroi kashtë e u hodhi për të ngrënë, hyri në shtëpi. Ë shoqja, Bulja, e priti si përherë më këmbë i mori gunën, ja vari dhe të dy, njeri pas tjetrit, hynë në konakun e zjarrit. Një saç qëndronte mbi vatë; flaka që dilte nga anët i jepte dhomës më shumë drithë. Pranë saçit, një bukë misri e zbuluar dhe gjysmë e pjekur lëshonte avull e përhapte aromë të këndeshme.

Azizi nuk i ngjante as t'et as s'ëmës. Kish trup të madh dhe shpatulla si të varura, fytyrën vrarëlie, hundën me majë, buzët të holla dhe sytë të zes, të vegjël. Flokët e dëndura, të pashtuara, i mbulonte me një qeleshe të bardhë. Ishte njeri i myllur.

Azizi, si piu cigaren, zgjidhi brezin e mesit, hoqi çorapet e leshta të grisura në gishtinj dhe lau këmbët në prak të derës. Pas pak hyri në konakun ku ish ulur i ati, e kunata dhe i nipi. Mblodhi këmbët kryq dhe qëndroi si e kish zakon me kokën gjysmë të ulur.

— Të dha bereqet Qaniu?

— Më dha dhe të bën shumë të fala.

— Të fala pastë, ja paça borç, — foli Jashari me fytyrë të çelur.

Atë kohë në dhomë hyri Azizesha, i vuri zjarrit ca dru dhe u ul në krah të Nekijes.

— Po ndonjë të re ç'kemi andej? — pyeti Jasari. Pastaj luajti nga vëndi dhe u mbështet në një jastëk.

— E kanë mbathur bregun e Shkumbinit. Xhadeja na ka ardhur afër fare. Aty në rrugën e Lushnjës, ku ka qenë komuna e Çermës, kanë ardhur plot maqina. Disa si traktorë me presje prapa, disa me hundë të gjatë. Ato, o lale, ishin të mëdhaja. Papo kish dhe me rrota të gjera e të rrënda. Ç'të të them? Ishi bërë një pazar i madh me tyrli maqinash. Plaku tundi kokën. — E kanë marrë me gjithë mënd çunat, — dhe vështroi Hekuranin, — po sado që të bëjnë, s'kanë lindur akoma ata që mund të thajnë gjithë këtë deri ujë! Banuri i mëndrojë që t'i bëjnë atë! — S'kanë lindur! Pse? Ndryshe do të jenë ata? — pyeti Hekuranin.

— Ndryshe, ndryshe. Nejse, pa na shtronit të ha më një kafshatë bukë. Gratë u ngritën, shtruan sofrën, thyen bukën; vunë në mes një sahan më fasule dhernisën të hanë pa bërë fjalë.

Jasharit po i linte mbresa të këqija sjellja e Hekuranit. Në shumë gjëra i nipi s'po e dëgjonte. Ndrysht pat qenë ai përpara se të vinte nga pushtria. Atëhere, sa herë që i fliste plaku, ai s'guxonte ta vështronte në sy e jo t'i kthente fjalën.

Puna e kopshtit, e koçeve dhe vrasja e zhgabës ja kishin thyer zemrën.

— I thotë vetes komunist. E çfarë komunisti

është ai kur s'dëgjon fjalën e të madhit! — psherë-tinte. — S'e kam punën mirë me të, është i sertë, tamam kokën time ka, po unë, ama, kur isha i ri, s'bëja gëk para të mëdhenjve, kurse ky ta pret me së-patë, — psherëti gjene dhe tundi kokën.

«Sa për të punuar s'ja gjeni dot shokun. Të ndero nqerrataj», — mëmërithi në fund dhe u ngrit nga shtresat.

«Kanë ngelur të dy batall, duhet gjetur punë për ta», — tha dhe i thirri Bules ti sillnin mëngjesin.

Si hëngri një copë bukë, mori rrëmin, e yuri në sphetull dhe, i mbështetur te shkopi, nisi të ecë. Dashi e ndoqi nga pas, po Jashari mbylli derën e oborrit, i dha pak bukë misri nga vrimat e gardhit, i përkëdheli perçen dhe e jardhëroi:

— Shko, kalesh, shko shplodhu!

Dashi qëndroi një hop sikur të mendohej, idhe kur u largua i zoti, u kthyte me përtim, nën strehën e koronecit.

Jashari e cte duke thithur ajrin e freskët e të lagësht që mbulonte tërë vendin. Qielli, ish i qëruar, ca re të holla si fiije Jeshi rudi zgjateshin e zgjero-heshin, sikur t'i shkrifte një dorë njeriu. Njëra syresh, që dukej vënde vënde sikur të ish shqyer, arrinte gjer prapa kodrinave të Golemit. Përfund ajo ndriçohej nga dielli që akoma s'kish lindur.

Te Skela e Pendëkuqit, Jashari zgjidhi lundrën dhe filloj të voziste. E kish bërë me mënd që të shkonte gjer te hundha e presjes, së djegur, për të kontrolluar.

Lundronte i qetë ashtu siç ish i qetë edhe. Tërë bufi, i cili dukej sikur kish rënë, më një gjumë të thellë.

Plaku vështronë i heshtur, dhe sadoqë i ishte mësuar syri me pamje të tillë, u kënaq.

Uefut në hundhë, pastaj kaptoi një shteg. Një rosoë që u ngriti me vërtik, e trëmbi. Shpendi, përgjedjetë plakut, nuk shkoi larg, u kthyesh e fluturoi fare ulët. Atëq cast, dhjetë rrema larg, nj'a pesëmbëdhjetë rika të vogla misënë të notonin varg dhe të trëmbura. Ato përpinqeshin të arrinin në buzë të presjes dhe disa prej tyre u matën të fluturonin, pomaë kot e turbulluan ujet.

Plaku i qëndrot të veshtronte me kujdes. Sytë imbarite te rikat, e më shumë të rosa që s'u ndahej. Një herë ajo fluturoi aq afër plakut, sa u duk sikur desh ta sulmonte. — Trimëreshë, — mëmëriti ai, duke parë shpendin. I erdhi keq, ktheu lundrën dhë u fut në presje, që të përgjonte se q'do të bënte rosa.

Tani rikat sikur u qetësuān. Rosa, si erdhi dhe një herë rrötull, u ul. Të vocklat u mblodhën e e vunë në mes, notuan gjer afër rije copë toke në mes të hundhës dhe qëndruan. Rosa shpupurit pendët dhë, si u sigurua që s'kish njeri, ndelli të vocklat me zërin e saj të ashpër e u platis pas tokës. Rikat i rrin është. Disa i hipnin mbi kurriz, disa i futeshin nën krahë, disa tonin në ujin pranë dhe të tjerat kruanin kokën me këmbë dhe gushën e krahët me sqep.

Shpendi qëndronte, shikonte me kujdes, herë pas here gjërmonte llucën me sqepin e tij si lugë, nxirrte ushqim dhe ua jepte fëmijëve.

Kjo pamje e preku Jasharin. Voziti lehtë që të mos u prishte rikave qetësinë dhe bëri përga hundha pranë. Vuri re se peshku i madhi po përtypëj në pëse gjashtë vende. U kthyesh, po gjithënje me menjdjen te rikat dhe te rosa.

Edhe shpendëve Zot i ka dhënë mënd që të duan dhe të ritin fëmijët. — theshi me vite.

Mëndja i shkoi të Azizi e të Hekurani, pastaj të mbusat e tij. Për të parën herë në jetë sikur iu kujtuan më kthjelitë mundimet që kish hequr për t'i rritur. Një ndjenjë krenarie ja pëershkoi trupin. Pat vepruar si baba i mirë dhe gjer atëherë s'që turpëruar përpàra fëmijëve. Atyre u kish dhënë mënd e zanat e i kish rritur me ndër.

Dolli në buzë të kënetës. La lundrën, mëri shkopin e ashtu, me hap të lehtë, ju ngjit një kodre. Ul në hien e një lisi, nxori kutinë, mbushi cibukun, e vuri në gojë, qiti masatin, i ra gurit strall dhe eshka mori përnjehérë. Mblodhi gjunë, vuri dorën në ballë si strehë kapele dhe vështroi rrëth e rrötull.

Dielli, që kish lindur, i jepte një dritë të shkëlqyer gjithë natyrës. Në të djathtë, buzë kodrave, dukej Lushnja me shtëpitë e bardha, të futura midis një gjelbërimi të dëndur. Poshtë saj, fusha zverdhonte. Të lashtat e vona formonin dallgë dhe dukeshin si të mbuluara me një carçaf të arte të holdë, që valvitej lehtë e tërë naze. Në të mëngjér dukej Rrogozhina me oxhaqet e fabrikave, me shtëpitë e reja e të mbuluara me tjegulla, që kuqelonin nën rrezet e diellit mëngjesor. Më afér shtriheshin arat e mbjella me misër e pambuk dhe vëndin gjelbëronte kù më thellë e ku më celur. Tej, në buzë të një kodrine, ku pat qenë dikur posta e xhandarmërisë dhe e karabinierisë, që ngritur kantjeri përtharjen e Tërbufit. Maqina, të ndryshme, qenë bëre gati për punë. Përmes arave shkonte një vijë e gjatë që mbaronte në Sulzotaj.

— Po e mbarojnë prugën, — mërmëriti dhe vështroi përpëra. —

Tërbufi plak ishte gjithmonë i qetë. Kashtorja e kish rrethuar ujët si thembër byrekut. Nga juga e

veriu presja e kallami hapnin krahët dy herë më gjéré se sa vetë ujët.

Plaku i pa me kujdes dhe vëveti zemra iu bë mal. Këtu pat ardhur dëndur, vendin përreth e kish parë mirë e bukur. Po asaj vere i dukej i ndryshuar. S'të zinte syri asnjë pällëmbë tokë të papunuar.

— Lum ju, o fshatarë, që rroni në ato anë, — e në çast kujtoi rrëfimet e një miku nga Çifliku i Ri.

«Po bëjmë jetë, o Shari, po rrojmë si jo më mirë», — i pat folur ai duke i zënë ngojë t'ardhurat që merrnin nga duhani, pambuku, e duke i treguar përshtëpinë e re që pat bërë ato kohët e fundit.

«Rroni, o fusharakë, rroni, — psherëtiu fort dhe vështroi më zemërim ujin që kishte pënparrë. — Neve na ka imbirë kucedra, lanet pastë! — po në çast syri se si i vajti tej në kantjer, te rruga e Sulzotajt, e tha me vete:

— Ta thajnë vërtet?! — Shëtit me sy gjithë fushat dhe sikur mori prej tyre përgjegje pohonjëse. Buzëqeshi, po shpejt u vrenjt.

Zbriti nga kodra dhe mori rrugën e fshatit duke mbajtur kokën gjysmë të ulur. Hyri në oborr, u ul në një rrugoz, që i shtroi Bulja me të shpejtë, dhe ndezi çibukun.

«Më sill ca ujë, moj nuse, — i tha Azizeshës.

E reja ja plotësoi dëshirën. Piu ujët më gllënjkë të mëdha dhë, si shojti etjen, e urdhëroi përsëri Bulen:

— Thuaji asaj të vijë një çikë.

Azizesha iku pa u ndjerë. Sa hyri në dhomë, nga shtëpia doli Nekija.

— Urdhëro, — tha urt' e butë e ema e Hekuranit.

— Dëgjo: thuaji t'ët biri të gatitë fushqanën, se nesër në mëngjes do shkojmë përi gjueti.

— Si urdhëron, — ja iktheu e reja më përulesti.

Në fshatin Plepaj po shuheshin dritat e fundit të kandilëve. Vesa po vishtë me një cipë të hollë fletët e pemëve dhe të barishtave. Matanë fshatit, në Hurdhjet e fshehta, disa bozhore qenë ulur e po lëshonin një zë të çjerrë e të trashë. Era që frynte nga jugëperëndimi sillte në fshat klithmat e tyre që përziheshin me krrakarimat e patave të buta dhe prishnin heshtjen e natës.

Zeri i lopcarit dhe muallitjet e lopëve ftonin fshatarët për të lëshuar gjedhet. Nëpër rrugica, dëgjoheshin zëra burrash e aty këtu skuqnin në mëgëtirë cigaret e ndezura.

Jashari me të nipi ecnin pranë e pranë. Plaku e tymoste dhe shkonte nga dy hapa para Hekurranit. Mbante nën sjetull rrëmin dhe kish hedhur në krah fushqanë. Si hypën në lundë, djali futi remin në ujë dhe e shtyu me tërë fuqinë përpara. Barka rrëshqiti. Gjysh e njoj kishin ndenjur kundruall një ri tjetrit dhe s'bënин zë Hekurani rrinte si i drojtur.

Plaku veshtronte si mëmjanë dhe herë pas here hidhët sytë nga i nipi. Donte të hapët muhabët me të, por e kuptione se s'ish rasti. Sa u futen në hurdhat e mibuluara me gram e me lëpushka, Jashari hodhi cigaren e tha:

— Më jep rrëmin dhe mërr fushqanën.

Djali e shikoi në sy, i zgjati lopatën e vogël, morri fushqanën që ish më shumë se dy metra e gjatë, fshiu dhëmbët e imprekëtë metalikë me vajin që e kish marrë më vete dhe e kapi te obishti.

Plaku kujtoi se i nipi dore bëhej gati, kurse ai u ul pa bërë zë. E la të lirë të vepronë si të donte, sepse kishi frukë mos thosha ndonjë fjalë që nuk i dilte mirë.

Si kaluan një vijë të ngushtë ujore dhe kapërxyen një strugë të zbuluar, Hekurani u ngrit. Shquante çdo gjë me imtësi. Sytë i shpinte rrëzë presjes, në gramin që kur e kur dilte sipër ujut. Lundra rrëshqiste me ngadalë, pa u ndier. Jashari vështronë të nipin se mos i jepte ndonjë shënje. Kish gjuajtur me të shumë herë dhe e dinte se djali apo shihë peshkun, e sulmonte dhe nuk bënte si të tjérët që prisnin tu afrohej.

Duke luajtur rremin, pa të nipin që ngriti doën dhe e lëvizë përparrë, ndjeu se këmba e djathëtë e Hekuranit anoi pak lundrën dhe sakao e kuptoë ç'dréjtim i i jepte barkës.

Jashari veproi si i tha i nipi. Në një shenjë tjetër, ngadalësoi bankën dhe pa se nja njëzet rremat përparrë po ngrihej lëpushka.

«Qenka i madh!» — tha plaku dhe vuri kujdes që të mos shkaktonte as zhurmën më të vogël.

Varka u afroa. Peshku gjithmonë po përtypoj i kënaqur, se nganjëherë lëshonte zë sikur të gurgullonte uji. Hekurani ishte gati. Nga lëvizjet, ai e kish kuptuar se gjahu po qëndronte në një pozicion, jo të volitshëm. Peshkatarët në të tillë raste presin orë të tëra gjersa peshku të mbarojë përtypjen e të marrë rrugën.

Ai që vret peshkun në një mënyrë të tillë është ustaj i fushqanës dhe peshkatarët thonë: «Eshtë nga ata që vret peshkun në brinjë».

Plaku e kish kuptuar se i nipi pat ngecur dhe habitej që jepte gjithmonë shenjën të lëvizte.

«Mos do t'i bjerë në brinjë?» — mendonte.

Teksa plaku po vriste mëndjen, Hekurani ngulimë mirë këmbët në lundër, ngriti dorën dhe vërvitë fushqanën me tërë fuqinë.

Dhëmbët e çaliktë shpuam më parë një lëpushikë dhe me vërtik u futën në mish.

— E kapi, — mërmëriti djali me buzë në gaz.

Plaku psherëti i kënaqur dhe ngau lundrën.

Peshku po përpëlitez, dölli disa herë sipër ujit, theu kërcejtë e lëpushikavë dhe do të vazhdonte akoma, po s'ë la Hekurani. E ngriti me fushqanë dhe e hodhi në barkë.

— Mirë na vajti më këtë, qënka llovushkë e madhe! — mërmëriti Jashari. La rrëminin dhe nxori kutinë ta ndizte.

— Nema mua rrëmin, — ja bëri Hekurani.

— Rri, rri shplodhu, — e këshilloi plaku duke e parë mësy.

Jashari, si tymosi, zuri të vozitë perseri duke çarë një shëtëg që e shpinte në një kurdhë tjetër. Sa e kaptuan, Hekurani i dha shenjën se një peshk tjetër po përtipej. Plaku perseri nisi të véré kujdes, po kur iu afroa bëri një farë zhurmë. Peshku u trembo dhe rrëshqiti me shpejtësi.

— Na iku, — tha plaku me keqardhje.

— Jepi rrënit më shpejt, — tha Hekurani duke qenë gati të sulmonte, — djathtas, më shpejt, — vazhdoi të flasë dhe papandehur vërvitë fushqanën që filuturoi në ajër dhe u ngul në Kokë të peshkut.

— Të lumtë, djalë! — bellbëzoi plaku.

Ai e kuptonte se ta qëllosh peshkun në ndjekje është shumë zor. Duhet të kesh sy shumë të fortë dhe dorë shumë të sigurtë.

Pas peshkut të dytë, gjysh e nip vranë dhe tre të tjerë. Do të kishin vazhduar akoma, po dielli kish nisur të digjte dhe ishin të sigurtë se s'do të kishin frut.

Te skela takuan peshkatarët e tjerë. Ata u mblo-

dhën dhe po vështronin me kureshtje gjahun e Hekuranit.

— Të lumtëndora, Hekur; dy në brinjë i paske mbërthyer!

— Vërtet në brinjë! — habiteshin të tjerët.

— Këtë, o djem, në brinjë dhë duke çarë ujet rrufe! — ja bëri plaku duke treguar me dorë njerin nga peshqit.

Djali buzëqeshi. Rrallëndodhë që plaku ta lavdëronte, ndajt dhe u kënaq. Uli kokënsi me turp, vuri peshqit në thes dhe ikën duke dëgjuar lëvdatat e peshkatarëye.

Në mes të rrugës Hekurani pa Selvijen që i kaloi pranë. I hodhi sytë e qeshur që u përpaqën vetëtimthi me të sajtë dhe vijoi të ekte në krah të gjyshit.

— Po kjo vajzë e kujt është? — pyeti Jashari me zë të ulët.

— Është e bija e Riza Drenjës.

Plaku e pa vengër të nipin dhe ai u skuq flakë.

— Phu, lanet qoftë, — u grind me vete dhe vjoi rrugën.

Sa hyri në oborr, dolli nga shtëpia Azizi si i çakërdisur. Buzët i dridheshin nën mustaqe, dhe foli me sy të shqyer:

— Sot matën kopshtin dhe kanë vënë sinoret e kanalit.

Jashari u ul. Ju pre fuqia dhe një djersë e hollë i njomi ballin.

— Më sill kotruven, — tha me gjysmë zëri dhe fshiu qafën me dyshen që mbante hedhur në sup të majtë.

Hekurani i solli ujë. Jashari ktheu kotruven dhe piu me gllënjkë të mëdha.

— Shkojmë nga kopshti, — i tha Azizit dhe, si rregulloi brezin e gjërë me vija të kuqe, të bardha

e tē zeza, mori rrugën dhe eci si me nxitim, duke hedhur këmbën e shkurtër zdrenkthi.

Hyri më kopsht dhe sakaq sytë i zunë gurët e mëdhenj, nga tē dy anët, tridhjet-dyzet metra larg shoshoqit së gjéri. I shikonte dhe i dukeshin si gurët e varrit tē tij.

— Po na ikën kopshti, — tha i ngashëryer.

I ra truallit pér së gjati dhe, kur doli në fund, u kthye, qëndroi dhe, me sy tē përgjëruar, shkoi vëndin ku do tē shkonte kanali.

— Gjithë pemët dō na prishen, — mblohdhi grushitet dhe mërmëriti:

— Sa tē jemë unë gjallë, s'kanë pér tē vënë kazmë këtu.

— Dëshironi t'krijxhi i kësaj vëllazëri?

VIII

Pesëmbëdhjetëditëshi shkoi, njerezit përsëri u kthyen në punë dhe kantieri, që pat ngelur si i vdekur, u gjallërua. Edhe shefi i kantierit e bëri lejën në një kohë me eskavatoristët e më ata që s'e linin dot punën përgjysmë gjatë kohës që do tē gërmohëj kanali. Gëzimin e ëma dhe e motra e priten tē mallëngjyera. Në kryeqytetet ai i kaloi ditët pér mrekulli. U kënaq, po kjo kënaqësi sikur ja bëri-më tē zi vëndin ku do tē jetonte. Sapo u kthye përsëri në punë, u mërzit. I rai një herë poshtë e përpjetë kantierit, e pastaj shkoi në zyrë. Aty nuk ndejeti kohë, dhe bëri pér në Lushnjë se mos takohej me Hajriun pér tē caktuar ditën kur do tē hidhë teknikën në punime. Të nesëmen në mëngjes bisedoi me Hajriun, caktoi sektorët ku do tē punonin eskavatorët, pastaj u kthye përsëri në kantier, thirri brigadierin dhe sekretarin e organizatës, Besim Qolin. Biseduan

së bashku dhe i udhëzoi se ku do të punonte maqineria. Kur mbeti vetëm u mendua që të nesërmen të shkonte për peshkim, meqenëse kish marrë me vete filispanjë dhe grepa. Ky mendim ja ngrohu zemrën dhe zuri të përgatitej të shkonte në ndonjë gji dhe të mëngjesohej e të drekohej atje.

Në përgatitje e sipër ndjeu një zë që e thirri dhe pa postierin që i zgjati një letër. E rrëmbeu letrën dhe mbërtheu sytë mavi në gërmat e shkruara me kujdes. Letra i vinte nga Fatbardha Mezini, nga vajza që kish njojur në Tiranë kur ishte me leje. U ul, hapi zarfin dhe nisi të lexojë me kureshtje. Duke lexuar fytyra i queshte dhe, kur ish gati në mbarim, kërkoi zarfin. Brënda në zarf gjeti një fotografi. Vuri fotografinë sipër tavolinës dhe po e vështronë me sy të përmalluar. Fotografia i ngjalli shumë kujtime:

Kur kish qënë në Tiranë me leje, një ditë të dielë, kish mbetur në shtëpi dhe po hekuroste kollaren. Atë kohë dëgjoi një të trokitur, hapi derën dhe pa të hyjë një vajzë e bukur që, posa i hodhi sytë djalit, u turpërua.

— Eshtë Afërdita në shtëpi? — e pyeti ajo.

— Tani vjen, urdhëroni brënda, — e ftoi Gëzimi.

— Ju falem nderit, po kthehem kur të vijë Afërdita.

— Imë motër sapo ka ardhur, urdhëroni brënda. Dhe vajza s'ja prishi, hyri në dhomën e pritjes, u ul në kolltuk dhe mbuloi gjunjët me fustan.

— Ju jeni i vëllai i Afërditës? — pyeti vajza.

— Po. Ju mos jeni Fatbardha? —

— Unë jam, — buzëqeshi ajo përsëri e turpëruar.

Djali e la një copë herë vetëm, vuri në këmi shë kollaron dhe erdhi duke mbajtur në dorë një

III

pjatë me karamele, gostiti vajzën dhe nisi ta vësh-trojë me kujdes.

«Pa shiko si qënka», — mërmëriste me vete.

— Dhe ju vitin e fundit të universitetit bëni?

— Vitin e fundit, po s'jam në një fakultet me Afërditën.

— Dhe ku mëndoni të punoni?

— Dëshira ime është në Myzeqe, në vëndlindje!

— Ashtu! — u habit, — jeni myzeqare.

— Po, kam lindur në Lushnjë. Ju, me sa kam dë-gjuar nga Afërdita, jeni caktuar të punoni për thar-rjen e Tërbufit.

— Po.

— Lum ju. Për myzeqarët Tërbuji është me të vërtetë kuçedër; kushedi sa njerëz do t'ju urojnë e do t'ju falënderojnë.

Atë kohë hyri e motra dhe biseda sikur u pre. Të dy vajzat u ngritën dhe dolën. Fatbardha i zgjati krahun dhe Gëzimi zuri një dorë të vogël të butë si pambuku.

Tërë atë ditë, ngado që vinte, Fatbardha i mbeti në sy dhe kur e ftoi e motra pasdite të vinte në mbrëmjen që do të organizonte universiteti, kur mori vesh se aty do të ish edhe Fatbardha, e se ajo do të recitonë, e falënderoi të motrën, dhe u kujdesua të vishej sa më mirë që të dukej sa më i pashëm.

Salla llamburiste, njerëzit zunë të vinin një nga një.

Filloi koncerti. Më parë këndoi një student, pastaj dy vajza, më vonë kori. Gëzimi dëgjonte dhe kûr u tha: «Tani studentja e vitit të katërt, Fatbardha Mezini, do të recitojë pjesë nga veprat e Naimit», Gëzimit iu drodh zëmra dhe ndjeu faqet t'i digjeshin.

Fatbardha doli nga perdja, eci disa hapa dhe, si
ndënji një çastë pa bërë zë, filloi:

O malet e Shqipërisë, e ju, o lisat' e gjatë,
Fushat e gjera me lule, q'u kam, ndër mënt dit' e
natë,

Ju, bregore bukuroshe e ju lumenjt' e kulluar,
Çuka, kodra, brigje, gërxhe, dhe pyjetë gjelbëruar...

Gëzimi dëgjonte i mahnitur. Zëri i ngrohtë dhe
tingëllonjës, kundrimi i ëmbël dhe përkëdhelës i vaj-
zës e kishin bërë për vete.

— Sa e mirë që është, — mërmëriste duke vësh-
truar i magjepsur fytyrën, gazmore, shtatin e hedhur,
të veshur me një fustan të kaltër të miendafshët,
gushën e bardhë, në të cilën varej një yll floriri me
pesë cepa.

Fatbardha recitonte dhe Gëzimi vështronte bu-
zët e vogla si qershija që nxirnin vargjet me dashuri
dhe ngrohtësi.

O flutura krahëshkruar, që fluturon nëpër erë,
As merr dhe zemrënë time me vet'-hezë dhe ma-
... shpjere
Nër malet e Shqipërisë, tek kullosën bagëtia,
Tek i fryn bariu xhurasë, tek më rrinë mënt' e mia,

Ajo mbaroi recitim, përshtëndeti me faqe të
skuqura dhe, duke vështruar në sallë, sytë i vanë te
Gëzimi, që përplaste duart pa reshtur. I buzëqeshi
dhe ngadal u kthye e u zhduk prapa perdes. Pas pak
koncerti mbaroi dhe të pranishmit u lajmëruan se
pas pesëmbëdhjet minutash do të kish dans.

Gëzimi doli në oborr, ndezi një cigare, i ra posh-

të e përpjetë sheshit që llamburitej nga elektrikë të mëdhenj, pastaj hyri në sallë.

Fatbardha po kërcente me një student. Gëzimi u ul në një fron dhe s'ja ndanite sytë. Kërkonte të vinte re dhe lëvizjet më të vogla e, duke shikuar, i lindi në vetëvete një pyetje:

— Mos dashurohen me njëri tjetrin?

Orkestra pushoi dhe çiftet shkuan në vëndin e tyre. Fatbardha e pa, përsëri i buzëqeshi dhe Gëzimi ndjeu zëmrën t'i rrihte. Kur shkoi në një vënd, përkundrejt djalit, nisi ta vështrojë më dëndur.

Orkestra ja nisi një valceri. Gëzimi shkoi dhe e ftoi. Fatbardha u ngrit pa përtuar e duke kërcyer kuvëndonin. Tërë atë mbrëmje ndjejtën bashkë. Qeshën, bënë shaka, biseduan... dhe c'do fjalë e afronte më shumë djalin.

Mbrëmja kaloi dhe Gëzimi përfytyronte ditët e tjera. Përpara i delnin takimet, kujtonte fjalët e matura e ndjenjat e lumtura kur ish pranë saj. Nga di-ta në ditë vajza i dukej më e mirë, më e dashur. Dhe ja, nata e fundit, të nesërmënë djali do të shkonte në kantier. Ecnin përmes bullevardit «Dëshmoret e Kom-bit», pastaj u ulën në parkun Rinia. Vajza e vështronë me dhëmshuri dhe Gëzimit i shtohej më fort dëshira që atë natë t'i thosh ndonjë fjalë. Duke biseduar i zuri dorën, pastaj belin.

— Gëzim c'bën kështu? — e qértoi vajza dhe luajti nga vëndi.

— Fatbardha, unë të dua, të dashuroj, — i tha dhe zëri sepse iu ngjir.

— Gëzim, mos u nxito! Ne posa jemi njojur! Duhet akoma të bisedojmë, ta njohim njëri, tjetrin më mirë. Pa mendohu, është një jetë për të kaluar mendohu mirë, Gëzim. Pastaj unë jam akoma studente...

Vajza heshti një hop e përsëri foli duke mbajtur kokën gjymë të ulur. — Unë vetëm këtë mund të tē them: ti, Gëzim, do të jesh njeriu kryesor që do të qëndrosh në zemrën dhe dhe mëndjen time, — këto fjalë Fatbardha se si i tha, dhe vetë s'e-kuptoi. Në çast, djali, në dritën elektrike, pa faqet që iu shkuqën.

Më vonë u ndanë.

Duke kujtar të gjitha këto, me fotografinë e Fatbardhës ndër duar, Gëzimi jetoi edhe një herë ato çaste të lumtura që pat provuar atje në Parkun Rinia, dhe në atë çast iu bë sikur dëgjoi edhe një herë zérin e ëmbël të vajzës:

— Mirë u pafshim, Gëzim! Mirë u pafshim!

Pastaj psherëtiu, e vendosi fotografinë në mes të një fletoreje, u ngrit, dhe, ashtu si i hutuar, vazhdoi të përgatiste ushqimin për të nesërmen.

Gëzimi u zgjua në të zbardhëlluar, mori ushqimin dhe doli nga dhoma ku flinte; sapo lindi dielli u gjënd në majë të një kodre. Përqark e rrethonte bukuria mahnitëse e natyrës, po ai sepse s'e shijonte. Ekte, dhe kur u fut në mes të një pylli, la bukën e plaçkat përdhe, u shmpi dhe u ul. Sadoqë thithte aromat e ndryshme e të pasura të pyllit, të mbushur me lloj lloj bimësh e pemësh, prapë nuk ndjente kënaqësi.

Një lule i bëri përshtypje, iu duk se nuk e kish parë ndonjëherë, e këputi dhe e shikoi si ndonjë i vogël. Atë çast mëndja i shkoi te Fatbardha e për një hop mbeti duke vështruar si i kotë. Një veri i lehtë që shkundi pemët dhe lëshoi përdhe fletët e zverdhura të plepave e përbloqdhë; u ngrit, eci mi-

dis pemëve dhe dolli në një rrugicë buzë kënetës. Vazhdoi në udhëzën që gjarpëronte bregut të Tërgufit e më në fund qëndroi në një gji të zveshur. Më parë hangri bukë, pastaj hodhi dy grepe si nj'a një-qind pashë larg. Lidhi filispanjën në dy kallama dhe nga torba e lëkurtë nxori një komplet grepash më të vegjël. Si i koi me karema, i vërtiti nga njëzet metra larg. Shpresonte se do ta humbiste mëndjen pas gjahut, por jo toruan e kish të prishur aq shumë, sa që, kur luante valëza e lehtë filispanjën e i dukej sikur peshku po i sillej grepit, kujtonte se ish pér peshkim. Shkoi kohë më ketë pritje e qetësi që iu bë e mërzitëshme.

Në çastin kur vendosi të mbledhë grepat dëgjoi një rrem që rrinte ujët dhe pa një barkë që po i afrohej.

— Po ky, nga doli pa u ndjerë?! — dhe shikoi barkëtarin, të cilin e njobu se ishte Jashar Shahint.

— Paske dalë pér gjueti, o djalë, — i tha Jashari dhe zbriti nga barka.

— Dola po nuk më ecën, o xhaxho.

— Me se gjuan?

— Me grepa, i kam ushqyer më kareme, po më kot.

— Pa nxirre ta shoh grepin, o djalë.

Gëzimi s'ja prishi.

Jashari vështroi grepin dhe buzqeshi.

— Mos u mundo kot, o djalë. Me muaj të tërë të rrish, s'ke pér të zënë peshk. Fundi i kënetës është tërë llum dhe grep i hyn i téri në baltë. Mund të bëjë vaki që të kapësh ndonjë ngjalë, po ngjalë të hollë kështu sa gishti; breshka uji mund të kapësh, së ato futen në llum. Ndaj mos u lebetit më kot. Ky grep është i mirë pér në grykë të Kularit, në buzë të detit.

— Qënke' peshkatar, si duket, o xhaxho.

— Të rrosh në buzë të Tërbufit dhe të mos jesh peshkatar vaj halli pastaj; se do të vdesësh për të ngrënë.

Jashari u shëshua në breg dhe nxori kutinë. Gëzimi, si mbloodi grepat, shkoi e ndenji edhe ai pranë tij. Kur hodhi sytë në barkë pa se brënda kish një dhjetë peshq.

— Paske qënë për gjah, më duket.

— Isha, kontrollova kocet; na, dridhe një herë.

— Të falem nderit, s'e ndroj duhanin se më zë kollë, — pastaj i zgjati paqetën dhe Jashari mori një cingar dhe e vuri në vesh.

— Ti, o djälë, — tha Jashari, duke e tymosur e dukë kundruar Gëzimin, po deshe të shkosh kohën, gjej ndonjë armë gjuetije dhe gjuaj shpëndë. Megjithatë të kemi kryetar të punës, po të të shpije unë në ca vënde që të kënaqesh.

— Ashtu! — tha Gëzimi, dhe ngriti vetullat kular.

— Pse, ç'do të më kushtojë mua. Englendisem dhe unë një copë herë me këtë rast.

— Armën e gjej. Po kur ta lëmë, o xhaxho?

— Kur të duash. Ti shtëpinë e di. Hajde me diell, që të shkojmë në kaliben e karrocakeve, të flemë atje natën e të nesërmen të zémë pritat. Ke për të bërë qejf. Unë që sot po i dërgoj fjalë një mikut tim që të ruajë një hundhje e mos ta trembi.

— Mirë, xhaxho; unë po gatisë armën, po mbush dhe ca fishekë.

— Ashtu bëj, vegsé saçmat të janë pesëshe, ose gjashtëshe. Po pate mundësi merr dhë ca saçme për mua, se më janë mbaruar.

— Të falem nderit, xhaxho.

— S'ka përse. Ti a do vish tani me muaj në bar-kë, apo do shkosh steresë? se unë u ktheva përt ty, rrugën e kam tutje, — dhe bëri me dorë ngë veriu.

— Po shkoj këmbë, xhaxhö, të falem nderit.

— S'ka përse, s'ka përse, — ja priti Jashari dhe u ngrit, ja hipi barkës e i ra ujit me rrem.

Gëzimi u ngrit, vuri grepat në torbë dhe mori udhën buzë Tërbu fit, drejt kantjerit të ri që po ndërt- tohej e që nuk ish më larg se një gjysmë ore.

* * *

Buzë detit Adriatik, ku derdhet Shkumbini, shtrihet një pyll i madh. Aty ka drunj të lashtë qind-vjeçarë, drunj më të riq e filizë të njomë.

Në mëngjes, kur nxjerr synë dielli nga manastiri plot selvi i Shen-Premtes, rrezet që vërshojnë në majat e pishave mbushur me vesë shkëlqejnë e ngjyra e tyre bëhet aq e kthjellët sa që dallohen edhe degët më të holla.

Në mbrëmje, rrethi i kuq i diellit dhe kaltrësia e detit përzihen me gjelbërimin e pyllit dhe njeriu mund të pyesë me vete: mos vallë jan, në ëndër, apo mos jam ai dashnori i përrallave të bukura, që po shkoj në këtë vend përtë gjetur, të Bukurën e Dheut?

Këto bukuria ka pisha; kur është koha e mirë; po kur prishet, kur lëvizin retë me shpejtësi e hëre pas hëre derdhën, apo kur fryn murlani, pisha merr pâmje tjetër. Majat e saj lëkunden e formojnë dallgë të gjata, që dallohen me ato të detit vëtëm ngëngjyra e errët. Një zhurmë e vrashët dëgjohet kudo: gumi zhima e valëve trazohet më erën dhe krismën e degëve që thyhen, më bubullimat e rrufetë që shpër-

në Hurdhjet e fshehta dhe pa perënduar dielli të gjithë ja hipën maqinës e shkuan në kantier.

Para se të largoheshin eskavatoristët, Hajriu i mblodhi dhe u tha:

— Ju, shokë, patë së si do të hapet emisari. Esh-të llogaritur që për nder të dhjetëvjetorit të Çlirimt, me punën tuaj që do të bëni në këtë vepër, do t'i jepni fshatarësisë tokën që ka zaptuar Këneta e Zezë. Vej kësaj emisari është nga kanalet kryesore, ose, më mirë të themi, një nga punët e mëdha që hynë në kompleksin e tharjes së Tërbufit. Kanali do të shpëtojë nga lagështia shumë fshatra. Nëpër të do të kalojë gjithë uji i Tërbufit. Ndaj, si përherë, si e keni treguar dhe në veprat e tjera të mëdha, të keni kujdes, të mobilizoheni dhe të punoni me mënd. Unë gjer tani kam qënë me ju. Që të thajmë Tërbuin, na duhen dhe shumë punë, na duhen projekte të tjera. Këto ditë përfshirë na kanë ardhur dy inxhenjerë sovjetikë dhe mua më kanë ngarkuar të punoj me ta... Me ju do të jetë shoku Gëzim. Ta ndihmoni shokun. Ai është i ri po me talent dhe me siguri do t'ja dalë në krye punës... Tani, shokë, mirë u pafshim.

Hajriu e toku me të gjithë, pastaj shkoi në zyrën e Gëzimit, i pa përsëri fytyrën e vrejtur dhe i tha:

— Këi kujdes, Gëzim. Partia ka besim në forcat e tua.

Shefi i kantierit pshëretiu.

— Shoku Hajri, meqënëse po ikëni dhe do të shkoni në Ministri, po të doni të mirën time dhe të familjes, përpinquni të më transferojnë në Tiranë. Ju them të drejtëm, nuk mund të punoj këtu.

Hajriu u ul, mori frjmë thellë dhe foli:

— Akoma nuk të është shqitur nga mëndja largimi prej këtej.

— Nuk më ikën nga mëndja, se kam detyrime familjare në Tiranë. Mëma rrojti kaq vjet pa mua, si të rrojë dhe tani?

— Këto, o Gëzim, janë fjalë. Nuk është mirë që bisedon kështu. Në shtëpi ke mëmën dhe motrën. Motra është me bursë dhe s'ke përsë të vraç mëndjen pér të. Mëma edhe ajo punon dhe rron si zonjë e vërtetë. Ti ke mundësi ta ndihmosh nga ana materiale. Atëhere çfarë detyrimi ke tjetër?! Nuk është mirë pér ty, dhe nuk i kanë lezet njeriut si ty të bisedojë pa arësyetuar. Shiko, njihu me njerzit, afrohu me ta, shikoju hallet, ç'halle kanë. Hidh sytë përtej dhe çmoje frutin e punës sate pér njerëzit, dhe mos u fut në guackën tënde, mos shih vetëm interesin tënd e ç'interes se! të rrish në Tiranë! E ç'kuptim ka pér një inxhenjer të zanatit tonë të rrijë në Tiranë?! Nuk është ky interes i lumturia jonë. Interesi i lumturia jonë janë përpjekjet pér një qëllim fisnik; të kryejmë detyrën që na ngarkon shqëria. Puna dhe mundimi duhet t'i kushtohen lumturisë së atdheut e të popullit. Unë të dua me shpirt, prandaj po të flas. Dhe ki kujdes, hap sytë se këtu populli të ka besuar një vepër shumë të madhe. Ti duhet të jesh babai i njerëzve. Të ruash teknikën dhe të mos ngjasin gjëra të papëlqyera. Mblidhe veten, Gëzim, puno i qetë dhe derdh gjithë talentin tënd.

— Tani mirë u pafshim, — uroi më në fund Hajriu.

Gëzimi psherëtiu, i zgjati krahun shokut dhe ja ktheu:

— Mirë u pafshim.

E përcollë gjer sa hipi në maqinë dhe kur mori udhën shoku i tij, hyri në dhomën e gjumit dhe u përplas në krevat duke mbuluar ftyrën me duar.

* * *

Rruġa e re Čermē-Sulzotaj çante pērmeſ fushēs. Ajo s'donte t'ja dinte nē qoftē se verēs nga tē dy anēt toka iſh kockē e thatē dhe dimērit plot me ujē. Ajo nuk u trembej vērshimeve tē Shkumbinit dhe ujít tē Tērbufit.

Muzgu i mēngjesit ngrinte nē kêtē rruġe njē zhurmē tē madhe qē dēgħohej għer larg. Dhjetra es-kavatorē dhe buldozerē shkonin duke uluritur isī tē frikēsonin ujin e ndenjur pēr shekuj me radħe. Ċdo gjie u zgħajnej mē heret atē ditē. Njerēzit hipnien nē pemmē a nē ndonjē vēnd tjetēr tē lartē dhe shikonin nga vintekko gumēz himē. Shpendet e egra fluturonin tē llahtar isura e tē cakērdisura. Sykuqet, sezhat dhe baldosati shqetē soħeshin dhe kridheshin nē ujē.

Afér drekēs Plepallarēt u grumbulluan bużże rrugħes kryesore dhe vēshtronin eskavatorin e fuqishem e tē madh qē ecte si me pērtim. Eskavatorin e drejtonte Hekurani. Besimi e kish lēnē kasten shokun e tij qē ta shikonin fshatarēt e tē thosħnin: ja dhe njē i yni di tē ngasē tērē kêtē alamet binaje. Dhe kēshtu ndodhi. Fshatarēt e ndiqnien pas makinien dhe mērmērisnin.

— Shikoni, Hekurani, ore, Hekurani e ngaka!... Ja si i luuān veglat!... E mësoi usħtrial!... Atje ngiste tērē atē tank!... I zoti i dorēs eshtē, usta pēr tē gjitha!...

Kur iu afrua shtēpisē sē tij dhe pa qē kishin dalē tē gjithē njerēzit, u bużeqeshi — Paskan dalē dhe tē shtēpisē time, — i belbēzoi Besimit

— Mbaje maqinien, — i tha shoku. Dhe tē dy zbri-tēn. Hekurani e njobu me għijsin, xħaxhanē, dhe t'

ërnën. Jashari s'e la që s'e la pa e gostitur me një go-
të qumësht shokun e nipit.

— Të më vish, more djalë. Shtëpia jonë është
dhe e jotja, — i tha Jashari kur u ndanë dhe e qafoi
Besimin me përzémërsi.

Eskavatori zuri të ecë, i ndjekur nga kalamajtë
e fshatarët, që me fjalët e tyre bënин përshkrimin e
pjesëve të ndryshme e sidomos të krahut.

Me t'iu afruar shtëpisë së Rizajt, Hekuranit iu
drodh zëmra. Bashkë me Rizanë kish dalë për të shi-
kuar dhe Selvija.

— Beskë, ai plaku është kryetari i Këshillit; ka
qënë partizan; duhet ta ndaloj maqinën, se na zë-
mërohet.

— Po si, kam dëgjuar për të. E kam parë kushe-
di sa herë në kantier.

Pranë derickës së shtëpisë së Rizajt eskavato-
ri qëndroi dhe plaku sa s'fluturoi nga gjëzimi.

Selvija, kur pa Hekuranin në gabinë, u skuq.

— Vije, na nxirr ca qumësht dhe këput ca ko-
krra bostani, — i tha plaku së bijës.

Vajza rendi sikur të fluturonte, kurse Rizaj ha-
pi krahët dhe foli:

— Mirë se na erdhët, pëllumbat e mi, — dhe i
rroku në qafë, më parë Besimin, pastaj Hekuranin.

U dha cingare. Atë kohë erdhi Selvija du-
ke mbajtur në duar një enë me qumësht dhe dy go-
ta. U mbushi djemve gotat me qumësht dhe me do-
rë të dredhur ja zgjati njëren Hekuranit duke e vësh-
truar me sy të ëmbël e përkëdhelës, sa që e shusha-
tën djalin.

Vajza, si u dha qumështin, shkoi në kopshtin
pranë dhe këputi dy shalqi, ua dha me ato, pastaj
ndejti më këmbë duke vështruar herë pas here fy-
tyrën e Hekuranit që aty skuqej aty zverdhej.

— Të falem nderit, xha Riza, i tha Besimi, duke e shikuar plakun në sy dhe shtoi: — Na plotëso dhe neve një dëshirë: hipi eskavatorit të shkojmë bashkë gjer përtøj te Shelgu i lumturisë.

— Me gjithë qejf, biro, — dhe xha Rizaj u ngjit në kabinë.

Besimi u përshëndet me Selvjen, kurse Hekurani zgjati dorën dhe e pa me ca sy të zjarrtë sa që sytë e saj s'i qëndruan dot vështrimit të tij. I shtërmgoi dorën më fort se kurdoherë dhe shkoi e u ngjit në maqinë.

Hekurani ndezi motorin dhe vuri në lëvizje maqinën. Rizaj e vështronte dhe kënaqejet. Tek e shikonte si në brinjë, plaku thosh me vete:

— Tërë Demiri! S'i ka lënë gjë. — Pastaj shtoi gjithë po me vete, sikur ta kish përpala shokun e tij të vjetër me të cili pati ndarë gëzimet e hidhërimet: — Mundimi dhe gjaku s'të vajtën kot, o Demir. Gëzimin që do të ndjeje për këto ditë ja le tét biri që s'po të turpëron.

Kur qëndroi maqina, Rizaj zbriti; bashkë me të zbritën edhe dy eskavatoristët. Plaku u dha dorën.

— Më gëzove shumë, djalë, — i tha Hekuranit, — më të lumtë, kështu duhet, se ke pasur një baba që s'e ka pasur njeri. Plotësoja amanetin dhe merri forcën që do të kish ai për ditën e sotme. Ju vaftë mbarë, djemt' e mi. Dhe dëgjoni, dyert e shtëpisë sime janë të hapura; po nuk më erdhët vetë, do të vi t'ju marr unë, po me të shara ama, — u dha dorën eskavatoristëve dhe u nda prej tyre.

Besimi dhe Hekurani u ulën në shesh, e ndezën, pastaj çanë një shalqi dhe, si e hëngren, panë rajo-nin ku do të punonin. Pas pak u dëgjua zhurma e eskavatorit. Lopata u mbush me dheun që u hodh mënjanë.

— Hekur, mbaje mënd, ora është gjashtë e tri-dhjetë e pesë minuta. Pra, në këtë orë të datës 3 shtator 953 filluan luftën kundër Tërbufit.

Hekurani i buzëqeshi dhe i shtrëngoi dorën shokut.

* * *

Punimet për hapjen e kanalit muarën hov kur u shtua maqineria. Në rajonin poshtë Plepajt, në drejtim të detit, zunë të punojnë tre eskavatorë dhe dy buldozerë; në rajonin e Sulzotajt zhunma e maqinive ishte e vazhdueshme. Në pyllin me pisha që kish zaptuar gjithë bregdetin, vëndi ziente. Pisha të moçume rrëzoheshin, têrhiqeshin dhe në mes të pyllit çdo ditë e më shumë hapej një rrugë e gjërë.

Puna ziente në një gjatësi përbimi njëzet kilometra; Azizi desh të vështronite punimet, t'i binte një herë poshtë e përpjetë vëndit, sadoqë duhej të ecte dy ditë të mira. Jasharit nuk i tregoi se ç'qëllim kishte, po i tha se donte të vinte te e mbesa që qe martuar në Kular, fishat buzë detit. I ati e lejoi dhe e porositi të merrte edhe qerren e të ngarkonte ca kallama të butë.

Pa lindur dielli, Azizi u nis për udhë. Rruga e qerres shkonte pranë punimeve dhe ai kish mundësi të vështronte ç'bëhej. Shponte buajt dhe herë pas here përshtendoste punëtorët e specialistët që punonin. Vërtet, syri s'i zuri asnje që të gjermonte me kazmë. Me dhjetra eskavatorë dhe buldozerë qenë rreshthuar gjatë njëzet kilometrave dhe ushtonin pa pushuar. Lopatat e mëdha mbusheshin, ngriheshin dhe lëshonin dheun togje togje që dukeshin si korda. Buldozerët rrafshonin tokën, qëronin vëndin nga pemët e gardhet. Hendeqe të gjërë e të thellë,

të shkëputur nga njëri tjetri, dukeshin në shumë vënde ë rrÿpit të caktuar për kanal. Punimet shkonin mirë; këtë e shikonte dhe Azizi. Atij s'ja priste mëndjë që brënda një kohë aq të shkurtër të bëhcj një punë kaq e madhe. Përshkoi gjithë rajonin dhe, më të perënduar të diellit, hyri në oborrin e shtëpisë së mbesës. Azizin e priten mirë. Dhëndri i foli për punët e veta, po s'la pa përmëndur dhe punimet e Tërbufit.

— Paskemi qënë të fortë dhe s'e paskemi ditur, o Azizi, — kish përfunduar dhëndri.

Të nesërmen, si ngarkoi kallamat, u nis pér rrugë. Ekte dhe vështronë me habi. Brënda asaj kohë të shkurtër që kish ndenjur të e mbesa, ishin ngritur kodra, të reja me dhe, ishin lidhur shumë hendeqe me njëri tjetrin, ish gjërmuár një vënd shumë i madh pyjor.

Kur u kthyen në fshatin e vët, hyri në shtëpi tërë qejf, shkarkoi qerren, irregulloi kallamat dhe u ul duke përshtendetur t'anë.

— Si e le atë çupë, o Aziz, si i kishte kalamajtë?

— Të bën selam, lalë; ishin mirë. Aliu më dhanjë dorë duhan, — dhe u ngrit i zgjati Jasharit një torbë të mbushur plot.

— Më pastë uratën, — mërmëriti plaku si i mori erë torbës.

Atë kohë aty pranë u ulën dhe Azizesha me Nekijen.

— Po ndonjë gjë ç'kish nga Kulari?

— Plot gjëra, o lalë; po gjëmon dheu nga maqinat, s'ka pëllëmbë tokë që të mos jetë ngacmuar. Janë ngritur me dhjetra kodra si ajo e Shën-Premtës.

— Ashtu, ë? — thithi cigaren Jashari, tundi korkën dhe pshëretiu.

— Çudi! Çudi! E kanë marrë me forcë të madhe!

Me forcë e kanë marrë. Të gjëzojnë zemrën. Dhe sikur të mos kishim punën e kopshtit. — Ee, kopshti, djalë, kopshti! Ai na e turbulloj, ai po na fut në dhe të gjallë; më mirë të vdes se sa ta shoh të shkallmuar, — psherëtiu Jashari dhe shtoi: — Pandalë, ishalla Zoti u ndërron mëndjen. E kam një shpresë, se përpara do të kenë Hurdhjet e fshehta që do t'i pengojnë. E kam, një shpresë, dhe të madhe bile, — përfundoi plaku dhe u ngrit e doli përfjashta.

IX

Gjinkalla s'dëgjohej më. Një farë freskie le-dhatonte fytyrat e njerëzve, po prapë ta kishëndë rrije në hie. Besimi dhe Hekurani kishin lënë punën dhe qënë ulur në barin e thatë. Degët e Shelgut të Lumturisë u prisnin rrezet e diellit. Besimi kish zbërdhyer këmishën dhe i dukej gjoksi me lëkurën e pjekur leshtore, kish nderur këmbën e djathë përpara dhe që mbështetur përdhe në pëllëmbën e dorës së majtë. Hekurani rrinte, këmbëkryq. Të dy thithnin nga një cigare dhe vështronin diku në horizont.

— Hija e këtij shelgu më kujton hiet e pemëve të repartit; a e mban mënd kur shtriheshin në kohën e pushimit?

— Atë po kujtoja edhe unë tanj, o Besimi. — Hekuran, ti s'kë ardhur fare në vendjne ri të banimit. Eja të shkojmë sonde nga kantjeri. Të më shikosh shtëpinë, — buzëqeshi. — Më duket se sonde jep koncert grupi diletant i Lushnjës. Vemi e shohim, se thonë që ka këngëtarë të mirë. — Hekurani vuri buzën në gaz:

— Dostë vi, o Besim, se më mori malli dhe për shokët.

— U ngritën të dy dñe u shkundën. Hekurani hoqi ca rrödhe që i qenë ngjitur pas pantallonave dhe, më hap të ngadalshën, mori rrugën.

Udha ish téré pluhur. Përpëra, kur e kur, turtujt dy e nga dy ngriheshin nga mezhdat, fluturonin si të lodhur dhe binin në arat që kishin qenë me misër e qenë vjetë.

Në kantjer kish lëvizje. Shumë punëtorë shkoni poshtë e përpjetë. Disa ishin mbledhur grumbull pranë pusit dhe laheshin. Në garazhin e maqinerive një grumbull tjetër vështronte disa eskavatorë dhe buldozerë.

— Paskan ardhur voronezhë të tjerë, — tha Besimi sapo i pa dhe qëndroi përpëra maqinave vigane.

Krahët e gjatë të eskavatorëve, që mbaronin me një lopatë shumë të madhe, e bënë Hekuranin t'i xixëllonin sytë.

— Me një nga këta do të punosh edhe ti, — ja bëri Besimi.

Hekurani e pa dhe s'foli.

Atë ditë Hekurani u takua me shumë shokë. Një zhurmë maqine u tërroqit vëmëndjen të gjithëve. Kthyen kokën dhe panë grupin artistik diletant të qytetit që kish ardhur përu të dhënë koncert.

— Shkojmë lahem, Hekuran, se jemi bërë téré pluhur, — i tha Besimi.

Hynë në dhomën ku flinte Besimi. E ndara ish e gjatë dhe e ngushtë. Pesë krevate prej druri qenë radhitur në një vijë. Hekuranit i bëri përshtypjë pastërtia e dhomës që ish mobiluar thjesht dhe ku çdo gjë ish në vëndin e saj. Po më shumë përshtypje i bëri rregullimi i orëndive. Krevatet qenë vendosur me kujdes. Bataniet e gjellbra mbështilinin dy-

shekun nē formë katrore, çarçafet delnin një pëllëmbë e ca nga fundi, nē një vijë. Jastekët më këllefe pëlhure sikur rrinjin nē rresht. Shtretet qenë rregulluar ashtu si i rregullontë dikur nē ushtri edhe Hekurani. Të gjitha këto i kujtonin kazermën ku flinte, çarçafet e bardha dhe atë gjumë me të cilin s'që ngopur kurre.

— Mua m'u bënë kaq kohë me ty, po s'ta kisha parë fjetinën. Këtu bie erë ushtri, o Besim, si duket të gjithë shokët e tu e paskan kryer shërbimin.

— Jo, o Hekur, tre vetë s'kanë shkuar akoma.

Besimi hodhi peshqirin nē qafë, mori një sapun nga një valixhe druri vëndosur poshtë krevatit, dhe, duke hequr këmishën, tha: — ushtria, që thua ti, na mësoi shumë gjëra. Ajo vërtet ka qenë shkollë e mëdhe për ne e për të gjithë shokët tanë.

Besimi i dha shokut një copë sapun dhe një peshqir. Shoku hoqi pallton dhe të dy dolën jashtë. U janë e u shplanë. Besimi veshi një palë froba të pastra prej doku dhe shkuant të dy në mësë. E ndara që mbushur plot. Vetëm nē një vënd ngai fundi gjetën dy karrige të lira. Punëtorët hanin e bisedonin. Dikush fliste për punën, dikush hantë dhe i hidhët një sy gazetës, një tjetër përtypej pa folur.

Të dy shokët, si u drekosën, dualën përjashta dhe nisën të bisedonin.

Nuk shkoi shumë dhe grupi diletant nisi të jep te koncertin. Hekurani vështronë dhe sikur qmallej me klubin, korin dhe orkestrën e repartit.

Pas koncertit vijuan udhën. Ecnin me hap të lirë në rrugën tërë pluhur. Hekurani nisi t'i flasë shokut për jetën e tij dhe, padashur, i bëri fjalë për Selvijën, vajzën e Rizajt.

— Ndaj të vështronë ashtu ajo; po pse nuk i thua ndonjë fjalë, apo kë frikë?

Pastaj edhe Besimi i tregoi për jetën e tij. I tha se ish nga nji fshati Maliqit, se kish marrë pjesë për tharjen e kënetës së atjeshme dhe se fshati i tij i dikurshëm i ngjante shumë Plepajt. Më në fund Besimi i tha edhe se ish i fejuar, i tregoi se ish dekoruar dy herë dhe se kish marrë pjesë në shumë ndërtimë të vëndit. Biseda e të dyve që shumë e përzemërt dhe kur i uruam natën e mirë njeri tjetrit, sepse s'donin të ndaheshin.

Hekurani ecte tërë ngazëllim, po pa bërë as pesëdhjetë hapa, iu kujtua Selvija. Përfytyronte sityrën e saj rrumbullakëtë, sytë e zes që i shkëlqenin vazhdimisht dhe që pasqyronin shpirtin e pastër, të thjeshtë e druajtjen e saj, që është një nga shenjat e para të dashurisë. Përfytyronte trupin e saj të zhđervjellët e të plotë, me krahë të rregulltë, që skamja dhe mundimet s'kishin arritur ta rrëgjonin. Më në fund, psherëtiu e tha:

— Duhet të takohem me të, të bisedoj, s'rrihet më kështu.

Kur pati arritur në shtëpi e pat hyrë në oborr, e vendosi edhe një herë që të takohej sa më parë me Selvijen dhe t'i hapte zemrën.

* * *

Hekurani, në fillim, e ndjente se nuk do ta kish shumë zor me eskavatorin. Çdo gjë i dukej e lehtë, vetëm manovrimi, i krahut ishte një nga gjërat e papërpunuara si duhet prej tij. Krahu i eskavatorit i ngjante shumë kullës së topit të tankut; po ai, në ushtri, kish qenë shofer tanku dhe jo artiljer tanku. E njihte topin, qëllonte me të kur ta donte puna, po i mungonte pervoja që ta përdorte si duhej. E kish dhe pak fajin vetë, se nuk i pat, vënë kujdes man-

vrimit të kullës, duke pandehur se nuk do t'i hyjnë në punë. Ky i shqabimi që kish bërë në mbushtri dhe që tanj pose vuante, prandaj duhej të përvetësonë më mirë manovrimin e krahut të eskavatorit në kthimet dhe në mbushjen e zbrazjen e lopatës.

Hekurani e ndjente veten ndryshe dhe kjo vinente se punonte me dëshirë, se jeta e tij kish marrë një rrugë që dukej qartë. Gjendjen shpirtërore të djalit e vinin re gjithë familja dhe në radhë të parë Jashari dhe Nekija. Të dy qenë të gëzuar, sidomos e éma.

Kohët e fundit Hekurani dukej i dëshpëruar dhe i pakënaqur. Ai i pat vënë vetes si detyrë që brenda një muaji ta zotëronte si duhej krahun e eskavatorit, po kaloi shtatori dhe gjysma e tetorit e, megjithëse kish përparuar, dorën e saktë e të shpejtë të Besimit s'e kish fituar. Kjo u provua ditën e 14 tetorit. Atë ditë Besimit i dhimbte koka shumë dhe s'doli në punë. Eskavatorin e drejtoi vetë Hekurani. Po ç'ndodhi? Nga 140% që realizohej norma qdo ditë, ra në 110%. Dheu nuk ish hedhur i vargëzuar dhe kanali nuk kish paraqitjen e nevojshme.

«Edhe një vit të rrish, prapë s'kë për të bërë gjël» — shau Hekurani veten.

Gjithë këtë dëshpërim të Hekuranit Besimi e kish vënë re dhe ja kish pikasur shkakun. Një ditë i foli rreptë, sa që Hekurani u habit me arësyetimin e drejtë që i bënte shoku.

Një shkak tjetër që e mundonte ishte dhe dashuria për Selvijen. Sa herë që Hekurani kthehet nga puna, kalonte pranë shtëpisë së saj, vërvhellen te dhe, kur shihet vajzën të dilte në prak të derës, psherëtinte.

«Më shtire në lëngim», mëmëristë ai herë

pas here dhe me sy tē vuajtur e fytyrë tē pezmatuar këndonte këngë që i gufonin nga thellësia e shpirtit. — Atë mbrëmje, i përkëdhelur nga një veri i freskët që rrjite me krah tē lehtë fshatin, kashtoren dhe kënetën, Hekurani po kthej nga puna i lodhur.

Në mes tē udhës i hipit një mërzitje e madhe.

Ekte si i këputur. Me tē parë majat e Shelgut tē Lumturisë, mëndja i shkoi vetëtimthi te Selvija. Psherëtiu thellë, tundi kokën dhe u mallëngjye.

— Selvije, moj, Selvije; — mërmëriti. I ra një plisi me këmbë dhe e shkërmiqi. Eci kuturu një copë udhë tē gjatë dhe kur doli nga bërryli i presjes, pa vajzën e dashur që ish ulur sipër thierzave e gjetheve tē thata tē Shelgut tē Lumturisë. Qëndroi duke e vështruar.

Selvija u ngrit në këmbë, shkundi fustanin e kuq me pika tē bardha dhe mbeti e palëvizur.

Djalit sa nuk iu çaz zémra. E humbi dhe erdhë në vete, kur pa Selvijen tē hulej përsëri. Eci ngadalë duke vrejtur fytyrën e skuqur dhe tē turpëruar tē çupës:

— Mirë mbrëma, — ja ktheu vajza me zë tē hollë dhe u kapërxye. — Djali u ul pér kundruall, rrëzë disa gjineshtrave që e fshihnin nga sytë e fshatit. E vështroi Selvijen si me drojtje. I pa sytë, qerpikët e gjatë e të zinj, vetullat e trasha tē zeza, ballin e gjëre në tē cilin binte aty këtu ndonjë flok që s'e kishte zënë shamia.

Djali që turbulluar. Mori në dorë një fletë thierzë dhe e përdroodhi. S'dinte si tē hapte bisedë. Pa nga tē gjitha anët dhe, kur dalloj patait që bënin zhurmë, me zérin e tyre tē gjerrë, mërmëriti.

— Sa pata ke, Selvije? — Njëzet, — iu përgjegj ajo shkurtitë.

Hekurani e kuptoi se nuk e hapi mirë bisedën.
C'ti thosh? Ndenji një copë herë i hutuar.
Vajza qëndronte kokëulur dhe kur e kur e
vështronte shtrëmbër.
Më në fund, Hekurani i zuri duart:
— Vije, të dua, Vije, të dua! pa ty s'rroj dot! —
dhe i shtrëngonte duart.
Vajza gjelltitej, merrte frymë me zor, sytë iu
njomën me lot gjëzimi dhe i ndriçonin si qelibari.
Ai i fërkoi duart, flokët, pastaj, pa folur, u ngrit, i
zuri faqet me dorë dhe mundi të flasë me zë të nga-
shëruar:

— Të dua, xhani im!
Si pat bërë një dhjetë hapa, u kthyë dhe i
pëshpëriti:

— Vije, të shtunën mbrëma takohemi këtu pér-
séri. Më prit...
Vajza buzëqeshi dhe ngau patat duke vështruar
herë pas here prapa. Hekurani rëndete sikur ta ndiq-
te kush pas dhe kthente kryet e shikonte edhe ai.

X

Të shtunën tjetër, Selvija, para se të conte pa-
tat në shtëpi, qëndroi një copë herë në buzë të kë-
netës. Një lagështi e freskët që vinte nga perëndimi
i guduliste hundën. Endjente zemrën të lehtë e të
gëzuar. Era ja ngrinte fustanin e loste me qimet e
pulpave të saj topolake; gjoksi i përhidhej sa herë
që mbushej me frymë dhe vinte në pah tërë buku-
rinë e tij.

Mëndjen e kish te Hekurani dhe kur e kur nën-
qeshte me buzët e vogla, të kuqe e të fryra. Më në
fund, u ra patave dhe hyri në shtëpi. Dalëngadalë i

futi shpendët në qymes, u hodhi për të ngrënë dhe shkoi në odën e mirë; poshtë nimit nxori një sëndyq të vogël stolisur me varak, e hapi dhe qiti prej andej disa plaçka. Hoqi fustanin. Nëpërmjet linjës së hollë i dukej gjoksi i mbushur, i dukeshin krahët e bukur me një gropëz në bërryl dhe shpatullat e rregullta e të lëmuara, që lëshoheshin anëve, si të derdhura në mermer. Linja e hollë i jepte hie dhe bukuri të veçantë trupin lakuriq. Fustani prej basmaje rrëshqiti në trupin e bëshëm pa naze. Vajza nisi të krihet duke parë fytyrën në pasqyrë; zuri flokët kokorodhe me karfica e doli në oborr.

— Babë, do të shkoj në dasëm, — tha.

— Te kush? Te Zenuni, apo te e bija e Ilmiut? se kemi dy dasma në fshat.

— Te Bajamja po shkoj, te e bija e Xha Ilmiut.

Iku me çape të ngadalshëm dhe sa doli në oborr, hyri në një rrugicë të fshehtë përmes presjes. Ekte me zemër të ngrirë. Kish frikë se mos takonte ndonjë të njohur dhe e shikonte që kapërxente shtigje të fshehta. U ruhej shumë fjalëve të botës, se llafazanët s'kishin punë tjetër në fshat. Herë pas here vështronë nga pas, majtas e djathtas. Për fat, rrugës nuk takoi njeri. Me t'i afruar Shelgut të Lumburisë, zemra i rrahu me të shpejtë, se dalloj djalin. Ngadalësoi këmbët dhe një e dredhur e vazhdueshme i pushtoi trupin. Hekurani u ngrit. I shtrënguan dorën njeri tjetrit, u panë në sy pa e pasur veten në dorë. Hekurani e përbloodi më parë. Sytë e tij nisen të vështrojnë me zjarr të padurueshëm. S'u përbajt dot. E përqafoi, e shtrëngoi, e puthi në buzë e në gushë.

— Selvije, Selvije... e dija që do të vije... E dija që do ta mbaje fjalën... Shpirt, Selvije. Vajza dëgonte e drithëruar. Në fillim kundër

shtoi, pastaj e llanë forcat dhe mbeti në krahët e të dashurit. Kur erdhi në vete, u shkëput dhe u mat, të ikte, po vështrimet e tij depërtuanë embël në zemrën e saj. Atë çast, djali e kapi për dore. Selvija e kuptoi se ç'donte të bënte. Duke shikuar lundrën, buzëqeshi dhe me kujdes u ul në strepën e mesit, sipër kashtës që ish shtruar mirë e bukur. Ishi peshkatari e shtyu pak barkën dhe i ra ujtit të qetë me rrëmin që mbante në duart e fuqishme.

Kaluan një rrugicë ujore nga të dy anët më kashëtë. Hekurani ngiste dhe mëndjen e kish përparrë, se mos takonte ndonjë të njojur. Kur dolën në hapësirën e gjerë të kënetës, u lehtësuat Vështroi me buzë në gaz Selvijen dhe i tha:

— Mos folë me zë të lartë, se na dëgjojni; uji e përhap shumë zérin.

Vajza tundi kokën. Shikonte e habitur. Ish bërë nëntëmbëdhjetë vjeç dhe s'ja priste mëndja që të ish kaq bukur natën në Tërbuf.

Sipërfaqja e ujit shkëlqente kaltroshe, si t'i qe hequr përsipër një llustër e kristaltë. Yjet pasqyrohen në të sa të picëllohen sytë. Bregut, kashta e gjelbër, e veshur me tylin e errët, mbulohej nga drita e hënës dhe merrte ngjyrë të mrekullueshme, si të manushaqes, si të përvashës dhe nganjëherë si me të dy ngjyrat bashkë. Hëna e plotë, e zjarrtë, lëshonte një rryp floriri të drejtë dhe dukej sikur lidhet me fytyrën e vajzës, që edhe ajon shkëlqente e llamburiste. Barka lëvizte e qetë nën marshin e tingujve të fshehtë të natyrës dhe shoqërohej nga bibli i kënetës me sqep të bardhë, nga zogëza e ujit, nga pulëbardhat që rrinin nëpër rakita dhe që e habisnin vajzen, se dukeshin si trëndafilë të bardhë të panumurt që radhiteshin kur e kur në bregun e qëndisur e të stolisur. Në një gjë si të futur, Heku-

rani mbajti lundrën. Vajza u ngrit e doli në vah; pas saj u hodh edhe djali. Bënë disa hapa dhei qëndruan pranë ca shelgjeve të rinj me trupatë njomë.

Vendi s'qe i gjerë; nga të gjithë anët ai qe rrethuar nga uji e qe i veshur me rakita e pemë të tjera të egra, shumë të shkurtëra. Dukej si një pyll i rrallë, po i bukur.

Të dy të rintjtë qëndruan pranë e pranë. Selvija ish qetësuar dhe ndjehej mjaft e kënaqur. Vështronë Hekuranin me sy të zjarrtë të përvëluar. Djali i pshtolli kryet ndër duar, e përkëdheli e i tha:

— Tani mund të fjalosemi. — Pastaj i zuri llëret topolake dhe shtoi: — Më do shumë, Vije? — Zëri i dolli i ngashëryer dhe i turbulluar.

Vajza nuk foli, faqet iu njomën me lot dhe, si padashur e papandehur edhe ajo vëtë, i hodhi duart në qafë e i tha:

— Të dua, aq të dua sa s'rroj dot palty!

Djali i ngjiti buzët në buzët e saj.

Lart, onjë yll u shkëput e u bashkua me një tjetër.

Një zhurmë, që çau ajrin me vërtik, u prishi qetësinë. Vajza u tremb dhesi mvrejt në fytyrë.

— U trembe? Janë rosa, Vije. Na kaloi një tufë sipër kokës.

— Sa më trembën! Mu ssikur shkoi ndonjë ballon. M'i shurdhuan veshët.

Takimi me vajzen i hoqi Hekuranit mendimin që e gjerryente, kurse Selvija, edhe pse u takua me të, prapë mëndjen e kish të ngritur. Donte të pyeste se c'mendonte ai përditë ardhmen dhe si do i ta rregullonin punën që të bashkoheshin. Gjithë qditën kish kurdisur shumë, fjalë, po tanias që ish e zonja të gjente fillin. Ndenji një copë herë si e humbur dhe vëtem zëri i Hekuranit e solli në vete.

— Vije, çfarë mendon?

— Asgjë, Hekur, vetëm ja, si të të them, grindja e prindërve më ka turbulluar.

— Mos u mërzit, Vije, ata prapë do të pajtohen. Vajza pshëretiu.

— Ashtu qoftë. Po sikur të mos dojë yt gjysh të të martoje me mua, si do t'ja bësh?

— Pa ty s'rroj dot. Vije. Ose me ty ose s'ka. Oh, xhani im. Ti, vetëm ti je për mua. Unë jam i yti dhe, ose do jem me ty, ose s'do jem fare. Selvija e përqafoi djalin dhe e puthi me zjarr.

— Selvija ime, Selvija ime, shpirti im, pa ty s'rroj dot. S'ka fuqi që të na ndajë.

U përqafuan përsëri të mbështjellë nga qetësia madhështore e natyrës që kundërmonte nga aroma të ndryshme gjallérönjëse.

Ajri i pastër dhe veriu i lehtë u ledhatonte fyturat, u shpupuniste flokët dhe fërfëllinte shaminë që kish rënë në shpatullat e vajzës.

Kur po ktheheshin, Hekurani voziste si më i lehtësuar. Ky takim i tregoi rrugën nëpër të cilën duhej të shkonte. S'kish asnje arësy që ta ndalon të të mos martohej me Selvijen. Ajo ish një nga vajzat më të mira të fshatit dhe shpirti ja desh aq shumë.

XI

Fjalët e Hajriut sikur e shkundën për një kohë Gëzimin. Ngrihej që në mëngjes dhe shkonte në punë, herë në një sektor dhe herë në një tjetër. Megjithëse e shikonte se gjithçka kish marrë vrull, prapë qëndronte ndaj punës iftohtë dhe nuk ndjen te as një farë kënaqësie. Kështu po i kalonte ditët. Atë mëngjes duke ecur në buzë të presjet e trembi

një rosak që u ngrit menjéherë. E ndoqi me sy shpëndin gjersa u zhduk. Rosaku i kujtoi Jasharin e bisedën që pat bërë një muaj më parë. «Si nuk shkova një herë pér rosa», — tha me vete dhe aty pér aty vendosi të shkonte atë mbrëmje meqenëse kishte siguruar dhe një çifte.

Pasdite shkoi te Jashari dhe plaku pa përtuar mori tekjen.

Ndaj të perënduar nga bregu i Plepajt u shkëput një barkë e vogël. Ajo u fut me shpejtësi midis presjes, në vijat e ngushta ujore, që ndante vahet me njeri tjetrin, dhe doli në hapësirën e qetë të Tërbufit. Çdo gjë që zinte syri në natyrë pasqyrohej në ujin e kulluar, më e bukur, e dukej sikur në fund të tij ngrihej një botë tjetër e stolisur me xhixha të shkëlqyera diamantesh.

Barka vazhdonte lundrimin. Jashari e fuste rremin në ujë kaq me kujdes sa që nuk bënte as gurgullimën më të vogël. Kudo kish pllakosur qetësia. Vetëm më të rrallë dëgjohej ndonjë zhurmë që shkaktuhej nga zhytja e kredharakëve, bajzave ose vidrave dhe që përzihej me zërin e zogëzave të ujit, apo të ndonjë rose o rosaku të plagosur.

Në fund, barka u kthyte në një bërryl, pastaj në një vijë të ngushtë futur midis kashtës.

— As e ndezim një herë, o djalë, — ja bëri Jashari.

— E ndezim, xhaxho, — ja këtheu Gëzimi.

Inxhenjeri nxori kutinë dhe i dha një cigare «partizani». Nisën ta tymosin dhe pa dashur dëgjonin lëvizjet e peshqve që kur e kur ngriheshin sipër ujit dhe përplaseshin në sipërfaqen e tij.

Rremi vazhdonte të rrihete ujin dhe barka e futur në një pyll të dendur kashte e kallami lundron-

te pa u ndalur. Së fundi, tej, u duknjë gjëbesezë e midis saj një dritë e mekur.

— Erdhëm, — ja bëri barkëtari.
Nuk shkoi shumë dhe nga kasollja u dëgjua një zë:

— Ti je, o xha Shari!

— Unë jam, — ja ktheu plaku.

Të dy udhëtarët zbritën nga lundra e hynë në kasolle.

Miqtë u dhan dorën peshkatarëve, pastaj Gëzimi hoqi kapellën dhe u ul pranë një arke të vjetër.

Para se të hapnin bisedën peshkatarët, sipas zakonit, i dhanë dhe një herë dorën e mirëseardhjes, pastaj më i vjetri i zgjati kutinë. Gëzimi s'e mori duke thënë se nuk ndërronte duhan.

— Shumë u vonuat, o Shari, u bëmë merak, — i tha më plaku që rrinte pranë Gëzimit.

— S'ka faj xha Shari, u vonova unë, — ja këtheu Gëzimi.

— O Lym, ne s'kemi ngrënë; a ke ndonjë bej të mbajmë aty?

— Po si, e kemi bërë hazër, — iu përgjegj më plaku i peshkatarëve e sakaq u ngrit e u fut thellë në kasolle, hoqi diçka nga çatia prej kashte, që s'ish më e lartë se një boj e gjysmë injeriu, dhe ardhë pranë zjarrit.

— Domethënë qefullit i thoni bej ju, — tha Gëzimi duke vështruar peshkun sa krahu futur në hell, që ish pjekur pér qejf, po që Gëzimit iu vështiros kur pa duart tërë kallo të peshkatarit.

— Kemi gjuhën tonë ne, shoku inxhenjer, — ja bëri dikush.

Më plaku i peshkatarëve shtroi një dyshe sipër kashtës, nxori nga një trastë një gjysmë buke tepsie, e theu dhe ja vuri mikut përpara. Në një pjatë bal-

te vendosi peshkun dhe Gëzimi zuri të hajë, po si me zor, megjithëse kish uri.

Si mbaroi së ngrëni, inxhenjeri piu ujë nga katruvja me një gotë alumini dhe, kur ndjeu një farë ere e iu kujtua se me atë enë pinin të gjithë ata që e rrëthonin, hoqi gotën për një herë.

Pas buke zunë ta tymosnin; kush ish ulur këmbëkryq, kush qe shtrirë, kush qe mbështetur më ndonjë send dhe s'kuvëndonte.

Kandili i ndezur kuqéronte fytyrat dhe gjithë orenditë që kish kasollja: tri shtamba të vogla pranë derës, tri tura të mëdha rrjetash, të mbledhura në rregull e të vendosura anës së kasolles, strumbullarin e tymosur, ku varej një teke e vjetër dhe lëmshë me spango e grepa që binin gjer afër truallit. Në kreun e kasolles qenë mbledhur dy dengje të vogla me shtresa e mbulesa. Gëzimi sa vinte dhe mërzitej nisi të mallëkojë veten që erdhë në këtë kasolle dreqi.

Jashari e diktoi dhe i foli Lymit:

— O Lym, pas zjarrit ka lezet ndonjë rrëfim. Po nga ato të Sulçes, se kështu pa folur nuk shkohet gjithë nata.

— A ke dëgjuar ndonjë herë për Sulçen, o shoku inxhenjer? — pyeti plaku.

— Jo, — ja ktheu inxhenjeri.

— E që thua ti, na ishte një herë një Sülçe. Po vetëm dije se nuk është përrallë, po është e vërtetë dhe ka ndodhur gjashtëdhjetë vjet më parë. Ky Sulçia qe usta i mirë; shkonte në shtëpi të fshatarëve, të ndonjë prifti a hoxhe, dhe te ndonjë që kish; me një fjalë, atje ku delte leku. U lyente shtëpinë dhe me paret që merrte na pinte raki, po çfarë të pirë se! Mbrëmje për mbrëmje bëhej karroqe. Dhe një natë, ashtu i pirë, na mori rrugën që t'ja zinte

ndonjë fshatari. Këmbët e shpunë në kishë; hyri brënda dhe ndezi çakmakun. Kur, përtëj, na i zënë sytë një shishe me verë dhe disa kuleç që i kish lënë prifti pér shpirrat e të vdekurve.

«E gjeta xhenetin», — ja bëri me vete Sulçia, — e iu sul verës dhe e thau. Këmbët s'i bënин të ngri-hej. Ra në dysheme dhe sakaq e zuri gjumi. Në mes të natës na dëgjoi një uturimë të madhe në tavan, nëpër mure e dysheme. U ngriti llahtarisur.

«Shpirrat e të vdekurve!» — tha e i hipën dridhmët. Ungrit po s'i bënин këmbët dhe u përplas përdhe. Gjumi s'e zinte. Zhurma vazhdonte me të madhe. Binte Sulçia i shkretë në shehadet, megjithëse ishte në kishë, po s'kish derman. Zhurma po zhurmë. Ndenji përdhe këmbëkryq, ngriti kokën e thirri:

— O shpirtëra të vdekur, unë piva verën tuaj; po të doni hajdeni thitheni se e kam këtu, — dhe i ra barkut me pëllëmbë. Qëndroi një copë herë duke pritur se mos vërtet vinin të vdekurit, po asnjeri s'erdhi.

«Çfarë dreqi janë, pa dalë se mos shoh ndonjë të vdekur e çmallem me të». — ja bëri. Iu kujtua çakmaku, e shkrepi, po ç'të shohë, minjtë na, si lepuj, shkonin nëpër mure e konizma, le, le, le.

«Ah, mor kopila, ama ju paskeni qenë», — bëre-titi sa u tund gjithë kisha.

Ra të flinte, mbuloi kokën dhe e zuri gjumi. Aty ndaj të gdhirë u hap dera e kishës dhe hyri prifti, një djalë i ri që s'kish as tre vjet që priftëronte. Pas tij hyri dhe një femër. Prifti ndezi qirinë e gruaja iu hodh në qafë. Më ta ka mbërthyer prifti gruan, pa na i hoqi fustanen... Sulçia bënte sehir.

«Do t'ja punoj këtij qeni», — tha. Në kohën e duhur, Sulçia hipën në ajodhimë dhe bërtet me zë të trashë:

«O të mallkuar, pse, vëndi i këtyre punëve është këtu?!

U ngritën që të dy me brekët nëpër këmbëvet duallën jashtë me të shpejtë. Jashari qeshi me të madhe! Dashur pa dashur qeshi edhe Gëzimi.

— Apo paske qenë dreq, o Lym, — tha Jashari duke u gajasur.

Peshkatari qëndronte rëndë.

— Kështu, o Shari, puna e Sulçes. — Dhe e pa në sy inxhenjerin. — Kjo mesele është e vërtetë. Dhe Sulçen e kam pasur usta. Ai ma mësoi zanatin. A do të ta tregoj jetën e tij?

— Folë, o Lym, folë, — mërmëriti Jashari dhe nisi të dredhë një cigare.

— Që thoni ju, ky Sulçia na u rrit jetim. Nisi të bredhë fshatrave e më në fund na hyri pas një bojaxhiu. Bojaxhiu ish usta i mirë, po pianec i madh. Ai i mësoi zanatin Sulçes, po na i mësoi edhe pijen. Katër vjet ndenji pas tij, gjersa ustaj vdiq. Përsëri Sulçia mbeti vetëm, pa shtëpi pa katandi. Nata e zinte sa në kishë në xhami; herë jashtë, herë në ndonjë mullar me bar. Rrojti sa rrojti kështu gjersa një herë na u sëmur rëndë. Për fat të tij, sëmundja e zuri në qytet. Lëngoi tri ditë në xhami, gjersa një burrë me mënd, që iu ndodhi si baba e shkuar babajt, e mori në shtëpi. Pesëdhjetë ditë zuri dyshekun. I zoti i shtëpisë u kujdes sikur ta kish djalë; gruaja, vëllai i tij dhe e shoqja e të vëllait i rrinin te koka.

Peshkatari psherëtiu thellë, thithi cigaren e viroi, — e shëruan, o shoku xhenjer. Me t'u shëruar Sulçja, i zoti i shtëpisë e thirri, u ul këmbëkryq para tij dhe i tha:

«Tani u shërove, djalë; paske qenë :jetëgjatë:

Unë po të jap një këshillë: lere rakinë, në qoftë se e domjetën. Po fillove përsëri atë të shkretë, vdiqë».

Sulçia u përtyp. «E marr vesh se është vështirë, po duhet ta lësh; bota bëjnë gjëra më të mëdha, kurse ti frikësohe e dridhe përpëra rakisë. Si thua — Do ta lesh?»

«Dua, — i qe përgjigjur Sulçia, — possit'ja bëj». «Si t'ja bësh?» — i zoti i shtëpisë qe menduar.

«Lere zanatin; ti vetëm kokën ke, zërë një zanat që s'ke ku ta gjesh rakinë», — e këshilloi.

«Që s'kam ku ta gjej rakinë?» — pyeti Sulçia i habitur.

«Po. Shko në kënetë dhe bëhu peshkatar. Atje s'ke ku e gjen rakinë. Që sot do t'i them një korocaku të të ketë në kujdes».

I zoti i shtëpisë qe ngritur më këmbë.

«Kështu bëj, — i tha e shtoi: — tani hajde shkojmë për një vizitë te një miku im se ka djalin sëmurë».

Shkonte Sulçia me mëndjen te fjalët e mikut. Hynë te shtëpia, kur ç'të shohë: i sëmuri qe dobësuar për së tepërmë, sytë i qenë shqyer, buzët i qenë bërë plagë, fytyra i qe zverdhur e dobësuar, që mos o zot. Sulçes i erdhi keq për djalin. Doli me zemër të këputur. Kur mori vesh të nesërmën se djali që kish vizituar pat vdekur, mbeti shumë i dëshpëruar. S'priti më, po hyri në kënetë e u bë peshkatar. Që atëhere Sulçja ndjeu se ishte njeri. Miku u kujdesua me anë shokësh, e fejoi dhe e martoi. Po dhe Sulçia s'iu kursye, u bë burrë po burrë, i zoti i punës, i shakave dhe i qđo gjëje.

Ky ishte Sulçia, po kish kokë më vate. Ish njeri që nuk besonte Zotin. «Zot dhe shejtan jam vetë», thosh. Dhe vërtet zot e shejtan ish. Kur frynte smoreci e vala ngrihej në quell, Sulçia merrte barkën

dhe delte te shtegu i Kiçit. Përgjonte dhe kur dëgjonte ndonjë ulurimë, turrej pa humbur kohën. Pësëmbëdhjetë veta ka shpëtar nga vdekja. Papo kur e pyesje pse më parë pinte, nuk shante ustanë që i kish mësuar rakinë, po pasanikët: «Ata e kanë fajin, se mbajnë florinë mbyllur, ata më bënë pianec, si bënë dhe ustanë tim. E ç'të bëja me ato që nxirrja? Të martohesh? — thosh. — Po të martohesh do të keshë fëmijë; fëmija do të hajë, të rritet dhe të mësojë, kurse unë s'mundja. Kush e ka fajin, unë? Jo, bajlerët. — »

— E po prapë u martove, o Sulçe, prapë bëre si do zoti!

— U martova, — na thosh ai, — se bota do të kthehet dhe do të kthehet pa derman e, në mos fëmijët e mi, nipërit dhe mbesat e mia do të rrojnë si njerëz, si kanë filluar të rrojnë në Rusi, — na thosh me zë të ulët. Dhe ne habiteshim me të, po gjene e dinim se gjithë këto fjalë i kish huajtur nga miku i tij që u dha dermën italianëve në luftën e Vlorës. Pa na thosh Sulçia: «Edhe Tërbafi do të tha het, or djem, dhe atëhere popullsia do të shohë hair. — Dhe t'ët bir Sulçia e mësoi, o Shari, që u bë i parë në luftë. E di unë këtë. Eqë thoni ju, fjalët e Sulçes dolën. Nipërit e tij u bënë me shkollë. Një oficer, një doktor, një xhenjer. Le nipërit, po edhe e mbesa, Bardha, sivjet mbaron shkollën e madhe. — Cila Bardhë?! — pyeti Gëzimi.

— E mbesa e Sulçes, Bardha Mezini.

— Shiko! shiko! — buzëqeshi inxhenjeri.

— Si duket e njohke, — shtoi peshkatari, — nejse, kështu na ish Sulçia. Ja po ju rrëfej diçka tjetër. Ai thosh se s'u besonte xhindeve dhe, për ta prouar këtë, dëgjoni çfarë rrënkës na punoi. Një natë që thua ti, ish verë. Sa u err, Sulçia.

dolli nga kasollja, vajti kontrolloi kocet dhe u kthye. Bënte vapë e madhe. Vendosi të lahej. U zvesh lakuriq dhe, si u la, u kthye në búzë të vahut. Gjatë kësaj kohe një Sali, Saliu i Puçes i thoshin, kish fjetur. Sulçeja hyri në kasolle dhe aty i ra ndër mënd të trembë Salinë. Me këtë deshi të më rrëfente edhe mua se si çfaqen xhindët. Mori ca rakita të thata, i bëri kapicë dhe i vendosi në mes të kasolles, pastaj dolli me kujdes dhe, si e lau trupin e surratin me llum, u kthye përsëri; ndezi çakmakun e u vuri zjarrin rakitave. U bë një flakë e madhe. Sulçia rrinte afër zjarrit dhe herë pas here bënte «gëk! gëk! gëk!» duke u hedhur topthi.

Saliu u zgjua. Kur pa njeriun lakuriq me atë fytyrë të përcmuar dhe zjarrin e madh, i hyri drithma. Mori një batanie dhe u mbulua kokë e këmbë.

Unë rrija përgjoja. Si Sulçes ashtu dhe mua na vinte pér të qeshur, po prapë e mbanim.

«Gëk! Gëk!» — thërriste Sulçia. Saliu dridhej e luante sa djathtas majtas. Më në fund Sulçia e zu ri Salinë pér këmbe. Ai i ra me shqelm dhe u mblodh kruspull ndën batanie. Sulçia bënte gjoja sikur donte ta zbulonte dhe Saliu dridhej i téri. Si e mundoi një copë herë kështu, Sulçia u ngrit, i hodhi ujë zjarrit dhe, duke bërtitur «Gëk, gik, guk!», ra bulldum në ujë dhe nisi të bëjë zhurmë me duar e me këmbë. Qëndroi një copë herë në ujë, kur shikon Saliun t'ja marrë vrapiq përmes bazit. Nga llahtara i shkreti kish byrur me kokë duajt e kashtës që rrethonin kasollen. Sulçeja u tremb se përpara Saliut kish gropë dhe po të binte shkonte në atë jetë. Mallëkoi veten pér këtë shaka të tepëruar. Në çast mori varkën dhe, duke lundruar me të shpejtë, ja preu rrugën, jo pér të bërë shaka, po pér ta ruajtur nga gropat. I dolli përpara dhe përsëri nisi t'ja bëjë:

— Gëk, Gëk!
Saliu qëndroi dhe u ul. Sulçia lehtë lehtë u kthye në kasolle, hoqi nga trualli shkarpat e shuarra, e mbuloi vendin si më parë, u vesh dhe thirri:

— O Sali! O Sali!

— Ej, — i përgjigjet Saliu si i ngjirur.

— Hajde, hajde; pse ke shkuar në mes të bazit?

— e u drejtua nga ai.

— Ti je, o Sulçe? — e pyet me buzë të dredhura Saliu.

— Unë jam. Pse ke dalë gjer këtu?

Saliu u ngrit më këmbë dhe mezi qëndronte.

— Ç'të ka ndodhur? Pse filet si i shkalluar?

— Lere, lere. Po ti ku ishe?

— Kontrollova kocet bashkë me Lymin. Si është puna? Pse je bërë kështu?

— M'u faneps xhindi, — i tha Saliu. — E pasqë me sytë e mi. Më bënte «gëk! gëk!», më zuri nga këmba, pastaj u kredh në ujë, u la sa u la duke bërë zhurmë të madhe e duke bërtitur e pastaj nuk e pasqë më se nga bëri. Veç kur dolla nga kasollja e ja dhashë vrapi, ai ma preu përsëri rrugën mu përtej bazit!..

— C'na thua, more, ç'janë këto budallallëqe?! Ke fjetur me vithe zbuluar dhe ke parë ëndër! — i thotë Sulçia.

— Rri, o Sulçe, se m'u faneps xhindi, desh më mbyti. Kam frikë të hy në kasolle.

— Ke parë ëndër, o Sali, ke parë ëndër, dhe nga frika, ashtu përgjumësh siç ishe u ngrite e dolle.

— Po zjarrin që e bëri ai në kasollë edhe e shoi me katruve?

— Edhe zjarrin e ke parë në ëndër.

Saliu fliste i trembur dhe kish frikë të hyntë në kasolle.

— Sa tē zbardhë ajo iditë dhe po iki. Lanët qof-të peshku! — mallékonte me vete.

— Ecë, or dreq në kasolle, — i thotë Sulçeja dhe hyri brenda e ndezi kandilin më çakmak. Atë çast në ujë luajti një peshk i madh.

— O bobo më zuri! — thirri Saliu dhe hyri në kasolle.

— Ore, mblidh mendjen! S'ka xhind, or jo, ke qenë në ëndër tē them. Ja, shiko, ku e ke zjarrin e ndezur dhe shkarpat e shuara. — i dëftente vendin Sulçia.

Saliu hapi sytë. U habit po dhe sikur u qetë-sua. Mori katruven, tē cilën Sulçia e kish mbushur përsëri dhe, kur e pa plot, sikur i erdhi pakë gjaku në vënd.

— Mos kam qënë me tē vërtetë në ëndër?! — mërmëriste.

— Me siguri; pastaj ne kemi një çerek ore që kemi ardhur dhe po konim ca grepa, — tha Sulçeja.

— Keni një çerek ore? Po xhindin që lahej, nuk e patë?

— Çfarë xhindi? Unë tē them që ke qenë në ëndër. Ti hala avazin e Mukës!

— Po mua s'më patë kur dolla?

— Të pamë, po menduam se tē kish shpëtuar, që ja mbathe vraptit.

— Ç'më thua, o Sulçe?

— Ç'të them? Ja, ke qenë në ëndër. Po bjerë tanë, bjerë e fli.

— Ja, kështu çfaqen xhindët, — m'u drejtua mua Sulçia duke vënë abuzën në gaz. Po tē mos ishim ne, Saliu do ta hapte në gjithë kënetën se iu çfaq xhindi e fjalado tē merrte dhenë.

— Kur ka vdekur ky Sulçeja? — pyeti Gëzimi.
— Po ka kohë. Vdiq ahere kur erdhi Zogu në

futq. Brojti shumë. Kur vdiq, i biri ish martuar dhe kish fëmijë.

— Na kënaqe, o Lym, ta paçim hua, — i tha Jashari Lymit, Pastaj u kthye nga të tjerët: — Nuk zëmë një sy gjumi, o shokëni, se nesër do të ngrihem shpejt.

— Biem, — ja pritën ata me një gojë.

Peshkatari më i ri u ngriti e shtroi: Shtresat më të mira ja shtruani Gëzimit, i cili râ pabu zveshur. Pas inxhenjerit ranë të flinin të gjithë.

Gëzimi e pa me systë e tij që peshkatarët hoqën dyshekun dhe jorganin e tyre dhe ja shtruani atij pér të fjetur, kurse ata vëtë u mblohdhën të gjithë në një batanie; po megjithatë ai nuk e kuptonte bujarinë e tyre ashtu siç nuk e kuptonte se gjithë këtë ndër, si Jashari ashtu edhe peshkatarët, ja bënin vetëm se kishin respekt pér punën e tij. Ai rrinte zgjuar, i vinte të pështirë nga shtresat e peshkatarëve dhe thosh me vete: «Kush e di se të kujt janë!» Pas ca ndjeu të pickuara në këmbët dhe u shqetësua aq shumë sa që desh të ngrihej. Mërzitja iu shtua akoma më shumë kur dëgjoi të gërhiste dikush.

«S'është e mundur të flihet, — grindej me vete dhe kthehej herë nga një anë herë nga ana tjetër. — Ç'më duhej mua gjuetia?! Po këta si rrojnë këtu ditë e natë! Këta s'janë njerëz!» — Mandej iu kujtua rrëfimi i peshkatarit pér Sulçen. «Edhe gjyshi i Fatbardhës peshkatar si këta paska qenë!» tha me vete dhe i erdhi keq që ish e mbesa e Sulçes. I ati i Gëzimit kish qenë këpuçar. Ai punonte gjithë ditën e ditës me çekan në dorë pér të rritur fëmijët dhe kurrë nuk arriti t'i shihte një herë të nginjur me bukë e të veshur si duhet, sepse më shumë ish pa punë se me punë. Gjersa më në fund, ca nga lodh-

ja, ea nga jeta e keqe, u sëmur rëndë e ra e vdiq në kohën e okupacionit fashist, duke i lënë gruan e fëmijët udhëvet.

Të gjitha këto Gëzimi i dinte e i mbante mënd fare mirë, por as atë natë, as ndonjë herë tjetër nuk i kujtonte. Ai kish harruar se populli, ai popull që i kishte dhënë edhe sot shtresat e tij për të fjetur, kish derdhur gjak e djersë dhe e kishte dërguar atë që të mësonte, të delte inxhenjer e të punonte për lumturinë e atdheut, duke tharë Tërbuin e çdo vënd tjetër që kishte qenë gjer atëhere burim sëmundjesh e varfërie.

Të nesërmën Gëzimi u ngrit pa zbardhëlluar
dita.

— A fjetë mirë, shoku inxhenjer? — e pyeti peshkatari më plak.

Gézimi béri sikur s'e dëgjoi.

— Xha Lymi ka dérguar e ka marrë shtresat e të birit, që e martoi javën e kaluar, për të bërë ti rehat, — i tha Jashari me kast, sepse ai e kish parë sa lart e mbante hundën mikur.

— Ashtu, tē falem nderit, xha Lym, — tha Gézimi rëndë rëndë.

Si u veshën e u armatosën u nisën për gjah. Një peshkatar i ri, Jashari dhe Lymi muarën tri varka. Gëzimi hipi me Lymin. Tërbufi dukej si i llustruar e shkëlqente aq fort sa të lbyreshin sytë. Kudo ndjehej një freski gjallëronjëse. Yjtë xixëllonin si të mekur.

PJESA E DYTË

I

Kish hyrë marsi, ledheve dhe plajave kish plan-
sur bari i njomë dhe luleshqerrat duke i dhënë vën-
dit një bukuri të veçantë që të çlodhët sytë; arave,
përtej Tërbuqit, kishin filluar të lëronin për mbjell-
jet e pranverës. Të lashtat bleronin. Toka e majme
i ushqente dhe çdo çast ato rriteshin, forcoheshin e
hidhnik krahë. Veriu i hollë frynte mbi arat me të
lashta, që dukeshin në rrëzët e diellit si të mbulua-
ra me mëndafsh të gjelbër të vetëtitur. Në tokat pra-
në Tërbuqit, zotëronte gjithëmonë dimri; uji, që for-
monte pellgje të mëdhenj, e kish bërë dheun të mos
vinte në vete edhe për një kohë të gjatë. Patat e egra
krajkarsin dhe kulloštin të qeta, se gjuetari, sado
qejfli, s'mund ta çante ujin e llucën që arrinte më
sipër gjunjëve.

Brënda në Tërbuf presja dhe kashta kishin nxjerrë filizat e njoma, lëpushka kish nxjerrë dhe aty këtu ndonjë gonxhe të pahapur, që u ngjante shumë goglave të qiparisave.

Hekuran Shahini kish më shumë se gjashtë muaj që punonte me eskavator. Dëshira për t'u bërrë mjeshtër, puna e vazhdueshme dhe vullneti i madh e kishin bërrë ta mësonte zanatin si duhej. Es-

kavatorin e kish në dorë. Dinte ta përdorte, ta pastronte, ta vajoste, ta riparonte dhe ai s'e turpëronte. Gjithë dimrit punoi fereckës së Divjakës, se atij krahuhu dheu s'mbante shumë lagështi. Nga fundi i shkurtit e transferuan në rajonin e Hurdhjeve të fshehta, jo vetëm atë, po gjithë eskavatorët e kantjerit, se kanali nga deti gjer te Këneta e Zezë qe hapur dhe s'kërkonte më punë. Tani mbeteshin edhe shtatë kilometra kanal dhe uji i Tërbufit do të derdhej në det. Shtatë kilometra patën mbetur, po hajt t'i bëje dot! Duhej të çaje Hurdhjet e fshehta, të futeshe me téré ato maqina në vahun që lëkundej or' e ças edhe nga një qerre po të kalonte, jo eskavator. Duhej të hyje në atë llucë, në atë dhé e në atë baltë ku s'ish e mundur të mos ngecje brënda! Sidoqoftë, eskavatoristët i kishin marrë parasysh të gjitha. Llucë, baltë, ata do të çanin përpara. Inxhenjeri ngulmonte se vahu do të mbante, pasi kishte trashësi. Ai, sado ftohtë që rrinte ndaj punës, i këshillonte eskavatoristët të mos frikësoheshin kur të lëkundej vahu. Hekurani donte t'u besonte fjalëve të tij, po edhe sikur s'i besohej. Vahu vërtet ish i trashë, po kish një yçkë. Po të binte shi, dheu hahej e hollohej aq shumë sa që kish ndodhur të kredheshin edhe kalarës.

Hekurani e dinte me kohë se kanali do të kalonte Hurdhjeve të fshehta, po nuk shqetësohej, se i kishin thënë që porsa të arrinte emisari në Tërbuin e vogël, Këneta e Zezë do të fillonte të thahej dhe, kur të nisnim punimet në Hurdhjet e fshehta, toka do të ish si kockë. Këto fjalë s'dolën. Uji te Këneta e Zezë jo vetëm që s'ish shterur, po dhe qe shtuar, megjithëse prej Kënetës së Zezë, në kanal, ishin bërë shumë hendeqe, ku uji gurgullonte me të madhe e lëshohej drejt detit me rrëmbim.

Me ujin e Kënetës së Zezë dhe në atë vënd ku
ish piketuar, kanali s'ish e mundur të shkonte për-
para. Do të ndodhët pa tjetër ndonjë fatkeqësi.

Këto Hekurani i mendonte, po druhej t'i thosh.
Kujtonte se do t'ja merrnin përters dhe nuk fliste.
Ai qëndronte në krye të kolonës së eskavatorë-
ve. «Voroneshi» i tij ushtonte e ulej si ndonjë barkë
që ul kicin e përparmë kur rrighet pas nga valët téré-
duf. Kur e kur maqina mënjanohet aq shumë, sa që
thoshe: ja, tani u kredh.

Pa marrë parasysh këto, djali punonte. Kohë
pas kohe i rrithë zemra me frikë, por e mbante ve-
ten. S'ish mirë të frikësohej, nuk duhej të shfaqte
shqetësim. Ç'do t'i thoshin shokët kur ta dëgjonin!
Punonte duke ndrydhur frikën. Herë pas here ulej
në tokë, shikonte zinxhiret se mos dilnin nga trarët
që i kish shtruar vahut e që i kish mbuluar me kash-
të përtëmosh shkarë. Kur sigurohej se çdo gjë ish
në rregull, vazhdonte punën.

Zor të madh e kish kur lëvizte eskavatori. Gji-
thë presja lëkundëj sikur të kish rënë tërmët.

Atë mëngjes Hekurani nisi nga puna posa lindi
dielli. Do të lëvizte eskavatorin. Bashkë me ndihmë-
sin ngritën trarët, i shtruan në llucën e mbuluar me
kashtë të thatë, dhe, duke ecur zbathur në llumin që
arrinte gjer te gjunjët, vështronin se ku ish piket-
uar kanali dhe ku duhej të hidhnin dheun. Duke bi-
seduar me njeri tjetrin, dendur ulnin trupin, shqit-
nin nga mishi shushunjat, fërkonin lëkurën dhe ve-
pronin në një mënyrë të tillë që të epnin të kuptojë
se asgjë nuk u bënte përshtypje. Nga njëherë sha-
tin dhe i përplasnin shushunjet fort përdhe.

— Fillojmë, — tha më në fund Hekurani. Ndezi
eskavatorin e, duke mbajtur sytë te ndihmësi, ndron-
te marshet që të shkelte në trarë. Vahu lëkundëj.

Atje ku vahu vinte më i hollë, maqina ulej, dhe atëhere Hekurani zbriste, vendoste rrëzë sinxhirëve trarë të tjerë dhe i jepte motorit me tërë fuqinë. Pesë herë zbriti për të bërë një rrugë nga dhjetë metra të gjatë.

— Dy orë bëmë, vetëm përtë luajtur dhjetë hapa, dreqi e mori! — shfryu Hekurani dhe me mëngën e palltos fshiu fytyrën që i qe bërë tërë pika balte.

— Më duket se do t'i lemë eshtrat këtu, — mërmëriti ndihmësi duke ndezur një cigare.

— Mos ki frikë, po hajde, — ja priti Hekurani dhe hyri në kabinë. U ul në vëndin e tij, ktheu krahan e eskavatorit, lëshoi ngadalë lopatën, e mbushi dhe luajti marshin tjetër. Eskavatori, si e kish bërë zakon, u përkul sikur t'i lutej tokës ta mbante fort që të mos kridhej, pastaj ngriti lopatën anës, nga e cila kulloi llumi i zi, që lëshoi një erë të qelbur. Krahu u mënjanua, u ul pak ngadalë dhe lopata lëshoi dheun e përzier me ujë.

Lopata u ngul për herë të dytë. Hekurani luajti përsëri marshin, eskavatori u përkul përsëri, po lopata mbeti. Djali ja dha më me forcë, po dhe kësaj here s'doli gjë. Eskavatoristi ngrysi vetullat. Kuptoi se te çengeli, që lidhë krahan me lopatën, punët s'i kish në rregull.

— Më jep çelësat e mëdhenj, — i tha ndihmësit dhe, si e mori, doli nga kabina. — Mbaji marshet fort, mos e shuaj motorin, — shtoi duke vështruar shokun dhe hipi në krahan që ulej poshtë si ndonjë urë. Në fund të krahut pa çengelin që lidhë lopatën. Ish në rregull. Duhej parë çengeli tjetër. U lëshua dhe i zunë këmbët te faqja e lopatës. Hyri në llum gjer sipër gjunjëve. I hipit një e dredhur, se ndjeu të ftohtë të madh. Sa rëndoi të lopata, ajo rrëshqiti, po Hekurani u mbajt menjëherë te litari

dhe, duke hyrë në ujë gjer në gjoks, mbështolli këmbët pas tij. Kështu s'mund të kontrollonte gjë. U ngjit në krah të maqinës dhe i foli shokut:

— Shkurtoje pak litarin!

— Në rrotën vinxh çdo gjë është në rregull; fajin e ka krahu, — mërmëriti dhe duke u dredhur, eci sipër tij, hypi në kabinë dhe i tha shokut:

— Shiko rrotën e poshtme të krahut.

Ndihmësi u hodh në tokë, kontrolloi e thirri:

— Rrota ka zënë dhe.

— Qëroje, — e urdhëroi.

Për pak lopata u ngrit përpjetë dhe u lëshua në vëndin e duhur.

Hekurani, që mbante përherë rroba rezervë, ndrua dhe nisi përsëri nga puna. Po mendjen e kish gjithmonë të prishur, se ish i sigurt që kanali s'mund të bëhej në Hurdhjet e fshehta.

* * *

Besimi Qoli po ekte rëndë në llucën e baltën e qëruar nga presja. Me t'iu afruar eskavatorit të Hekuranit mbajti këmbët, dhe, si njeri që e dashuron zanatin, ndenji një hop për të parë një herë se si punonte shoku i tij. Të manovruarit e krahut, mbushja, dhe zbrazja e lopatës me mjeshtëri ja bënë qejfin dhe me buzë në gaz vazhdoi udhën e hypi në kabinë.

— Puna mbarë, o shokë, — përshtëndeti.

— Mbarë paç, — ja ktheu Hekurani dhe i zgjati dorën e ja shtrëngoi fort.

— Si shkon, Hekur, a shpohet lluca?

— Shpohet, o shpohet, — foli.

Besimi atë ditë vuri re në fytyrën e shokut po ata së të vrejtur, po atë fytyrë të mërzitur që i kish vënë re prej disa ditësh.

— «Ç'ka që rri këshfu? Ç'ngjet më të?» — pyeti me vete duke ndezur një cigare.

— More Hekur, kam ditë që s'të shoh më qejf, mos je gjë i sëmurë?

Hekurani e shikoi në sy një copë herë dhe psherëtiu.

— Dua të filas më ty, Besim.

— Mirë, Hekur, pas pünës, ku të duash.

— Te Shelgu i Lumturisë.

— Te Shelgu i Lumturisë, qoftë e hajrit, — tha Besimi duke u përgjegjur me fjalët që i kish marrë hua Riza Drenjës.

Hekurani la punën dhe mori rrugën e shtëpisë. Eci në këmbë më shumë se një orë. Hyri në oborr, përshëndeti Jasharin dhe të dhëndrit dhe, si u la, nisi të hajë bukë. Pas buke, qëndroi pranë tyre duke i parë të thurnin resë.

— Paskan zënë kocet, më duket, — hapi bisedën Hekurani duke parë katër turra me ngjala varur në qeprat e koronecit.

— Zunë, zunë, or bir; si i keni punët andej? Si duket Këneta e Zezë? S'ka të shteruar, se bozhoret qdo mbrëmje bien të qeta.

— Jo, lalë, ujë ikën kiamet, po nuk ka firasur asnjë gisht, sikur e mbush shejtani.

— Dëgjo, Hekur, duhen parë «Shtigjet e Ngjalës» dhe «Shitegu i Mahmutit». Sot, kur kontrollova me lalën kocet, vura re se uji ish ulur një pëllëmbë. Kjo s'ka bërë vaki ndonjë herë. Mos e mbush Tërbuffi Kënetën e Zezë? Duhet parë, — tha dhëndri.

Hekurani çeli sytë dhe vështroi të kunatin sikur ta shihte për herë të parë.

— Ish ulur një pëllëmbë? — psherëtiu dhë në çast mëndja i vajti te shtigjet. U ngrit dhe, pa bërë zë, doli në rrugë. Shkonte me mëndjen të ato gry-

kat që lidhnin dy kënetat. Më të dalë të fshatit, u kthyte djathtas. Në skelen e Pendëkuqit mori një lundër dhe nisi të vozisë. Se si i dukej rremi, nga që kish kohë që nuk e kish zënë me dorë. Lundronte dhe gjithë aromat, erërat, verinë, fësh-fëshen e kash-tës, presjen dhe kallamet i ndjente si kurrë ndonjë herë. Mos kish mall të lundronte? Të peshkonte? Të vinte për gjah? Futi lundrën në një gji, u hodh në vah, eci duke çarë me bërryle kallamin e penien dhe arriti te Shtegu i Ngjalës. Uji vërtet shkonte me shpejtësi dhe derdhej në Kënetën e Zezë:

Hekurani tundi kokën me inat.

«Ja ç'na qënka!» — tha duke marrë një plis gjysmë të njomë e duke e flakur. Uji lëshoi një zhurmë të vrazhët duke hapur rrathë të mëdhënëj.

«Ky shteg ta mbushi Kënetën e Zezë?!» — tha me vete duke i mbajtur sytë te rryma.

Vështroi përreth dhe vuri re se kashta e kalla-mi qe lagur e nxirë ndonjë pëllëmbë sipër bazit. Vërtet Tërbuqi kish nisur të shteronte. Kënetë e Zezë mbushej prej tij. Por nuk i besohej se vëndi ku shkonte gjithë ai ujë, ish shtegu që kishte përpara.

«Sado ujë që të futnin shtigjet, prapë s'mund ta mbushnin dot kënetën. Atëhere, nga vinte uji i Tërbufit të madh në Kënetën e Zezë?».

Ngadalë e i menduar zuri të ecë. Me të vajtur te lundra u kujtua se kish lënë takim me Besimin; pa diellin që donte edhe nja dy hostenë të perëndon-te, i hypi lundrës dhe nisi të rrahë ujet me të shpejtë.

Gjithnjë po ai mendim e brente; «Çudi, po nga futet ujet në Kënetën e Zezë!» Gjer atëhere pandeh-te se i dinte itë gjitha të fshehtat e kënetës, gjithë strugat, presjet, shtigjet, vijat, se s'kish lënë pë-

llëmbë ujë e tokë pa shkelur në ato anë, por, si duket, s'i dinte të gjitha.

Të firasurit e Tërbuosit i largoi dhe atë besimin që pat formuar në vetëvete, se gjoja në Kënetën e Zezë kish burime dhe ato e mabushnin. Kjo gjë e gjëzoi, se sikur të kish vërtet burime, ujët s'do të shteronte kurër dhe puna do t'u vinte dëm. Po nga vinte uji? Kjo duhej gjetur.

Si lundroi një copë udhë në vijat e ngushta që ndanin vahet me njëri tjetrin, bëri nga hurdhja në të djathtë, la lundrën dhe u hodh në breg. Së largu pa Besimin që po e priste.

Ngau, këmbët dhe sepse nisi t'i rrahë zëmra me të fortë. Si do t'i priste shoku mendimet e tij? Iu afrua Shelgut të Lumturisë dhe u ul nën degët që kishin nisur të lëshonin bisqë të njomë,

— Ke shumë që po pret, o Besim?

— Sa të pish një cigare rehat rehat.

— Isha në Kënetë. Dhëndri më tha se në Tërbuosit eshtë ulur uji dhe ashtu kish ndodhur. Ai, si duket, shkon në Kënetën e Zezë, ndaj s'po luan nga vëndi, ajo buallicë.

— Eshtë ulur uji i Tërbuosit, the?

— Uji shkon me siguri në Kënetën e Zezë, po se nga shkon nuk dihet. Gjithë të fshehtat e Tërbuosit i di, po këtë gjë s'e zgjidh dot. Mos ka ndonje nendek nën dhe?

— Mundet, o Hekur; duhet të lajmërojme anxherin e t'ja lemë atij ta zgjidhë. — Pastaj heshti dhe pyeti: — Ti më the që të takohëmi; mos deshë të më thoshe ndonjë gjë?

Hekurani pshëretiu:

— Po, o Besim, desha të bisedoja. Mëtë mendim e kam që kur nisën punimet në Hurdhjet e fshehta. S'e kemi zënë mirë punën, më duket. Ka-

nalin, po s'u tha Këneta e Zezë, s'e ndërtojmë dot përmes presjes së Hurdhjeve të fishehta.

Besimi vështroi shokun drejt në sy duke u munduar të kuptonte se nga i lindte ky mosbesim.

— Mirë, më shpjego më shkoqur; përsë nuk e kemi zënë mirë kanalin?

— Dëgjo: këtë mëndje që kam tani e kam pasur me kohë, po nuk shqetësohesha, se që të gjithë thoshnin: para se të arrijmë te Këneta e Zezë, pas dy javë, ajo do të thahet. Ne kemi një muaj që po punojmë në rajonin e Hürdhjeve të fishehtë dhe Kënetë e Zezë s'po shteron. Hurdhjet e fshehta kanë një yçkë: kur bie shi, vahu hollohet dhe ka bërë vaki që janë mbetur edhe kalorës kur kanë shkuar pranë tyre; kurse ne, o Besim, po i biem përmes. Sikur të vazhdojmë këshitu, jo vetëm që do të pësojmö fat-keqësira, po do na shkojë mundimi kot.

Besimi vuri gishtin në buzë dhe u mendua.

— Këtë duhet t'ja thuash shokut përgjegjës dhe sa më parë që të jetë e mundur, — e këshilloi serioz në fytyrë.

— Nuk di se si do të ma presë, o Besim.

— Le ta presë si të dojë. Në qoftë se je i sigurtë që nuk e kemi mirë, ngreje zënë.

Hekurani buzëqeshi dhe i ra shokut krahëve.

— Ke të drejtë, Besim, po hajde një herë nga shtëpia.

C'e do, një ditë tjetër. Unë them tani të vemi nga kantieri dhe t'i thuash shefit mendimin tënd. Thuaja, mos ki frikë.

— S'po ta prish; shkojmë atëhere. S'kam pse të frikësohem.

Atë ditë, në oborrin e Këshillit po vinin plot njerëz. Fshatarët qenë lajmëruar se do të bëhej një konferencë ku do të flitej se si do të thahej Tërbu-fi.

Dita qe ca e butë, retë e holla lëviznin me shpejtësi dhe mblidheshin në lindje, qëndronin grumbull, pastaj shpërndaheshin e zhdukeshin si mjegulla në rrezet e para të diellit. Bënte pak ftohët, po sikur të zije ndonjë shtroje, dielli të kënaqte.

Me fshatarët në mbledhje shkoi dhe Jashari me dy nuset. Ish ulur në një kërcu dhe e tymoste. Pranë tij qënë ulur edhe katundarë të tjerë. Përpara qe vë-në një tavolinë pak e vjetër dhe në murin e ndërtësë së Këshillit qe varur një hartë e vizatuar pa mjeshtëri, po që ish e kuptueshme.

Konferencieri, para se të fillonte, bashkoi duart, u ra flokëve të verdha me gishtarinjtë e hollë dhe nisi të flasë. Jashari dëgjonte me vëmendje. Kuptonte qëdo gjë që flitej, se qytetari bisedonte ngadalë duke përdorur fjalë të thjeshta dhe, të gjitha ato që thoshte, i shpjegonte në hartë. Jashari pa se Tërbu-fi zinte një vënd prej tetë mijë hektarësh. Pa kanalin ku po zhvilloheshin punimet; Vijën e Strymit, ku kish nisur të punonte draga, përtej, afër Lushnjës gjer në Kënetën e Thanës, pa një kanal tjetër më të vogël, të cilin folësi e quante «Kolektori i Myzeqesë». Kanali kish një gjatësi të madhe. Aty do të derdheshin lumi i Lushnjës, Lunja e Karbunarës dhe gjithë ujërat e tjera që më parë derdheshin në Tërbuf. Kolektori lidhej me një kanal të madh e shumë të gjëra, që folësi e quajti «Emisari kryesor». Pastaj Jashari dëgjoi se si do të mbathej Shkumbini; bre-

gu i tij do gurosej, që uji të mos delte anëve dhe lumi të shkonte në det.

«Të gjithë këto punë, do t'i jepin fshatarësise dyzet mijë hektarë tokë të vaditur» — përfundoi konferencieri.

Si mbaroi konferenca fshatarët u shpérndanë grupe grupe e shkuan secili në shtëpinë e vet, Jashari, duke ecur ngadalë, me atë shkopin e tij me dorezë çadëreje, arriti i fundit. Me t'arritur në shtëpi, u ul një rrogoz dhe filloj të mbushë çibukun. Fytyra e tij tregonte se konferenca i kish lënë mbresë të thellë, megjithëse Hekurani i kish folur edhe më parë se si do ta thanin Tërbuin.

Në këto e sipër dëgjoi në oborr zëra e të qeshura. U ngrit, dhe pa djalin e së mbesës së madhe që po vinte.

— Mushtulluk, babagjysh! — thirri vogëlushi.

— Hajli, Hajli, — tha duke qeshur Jashari.

— Moma lindi djalë, — thërmëriti djaloshi dhe shkoi i puthi dorën.

— Me jetë të gjatë, me jetë të gjatë, — uroi plaku dhe kapi një hekur aty pranë. — Rroftë sa hekuri, moj bijë i tha 'ëmës së Hekuranit, përgafoi djalin dymbëdhjetëvjeçar, pastaj Nekijen dhe Minirenë, që kish ardhur në shtëpinë e gjyshit.

— Babagjysh, lala dhe moma më thanë të vish: me gjithë momë Nekijen, dhe me teze Minirenë; kam prurë dhe tre kuaj.

— Mirë, bir i babajt, do të vimë. Bëhum i hazër, moj bija, — u tha Nekijes dhe Miniresë e hyri brënda duke mbajtur për dore djalin.

Pas tri orësh, Jashari, hipur në kalë, pas tij edhe Nekija me të bijën e me të nipin, morën rrugën

gën. Nekija mbante frerët dhe një tepsi mbështjellë me një dyshe të re. Si ecën më se dy orë në rrugën midis Hurdhjeve të fshehta, dolën në fushë, buzë kanalit.

Jasharit ja kish qejfi të shikonte punimet, po nuk kish rast që të vinte. Tani që i doli puna, do të shihte me kujdes se ç'bëhej. Pranë arës së tij pa eskavatorin që punonte. I dha mushtullukun Hekurranit dhe vijoi rrugën. Kanali qe hapur i gjërë dhe shkonte drejt; vënde vënde punimet vazhdonin akoma dhe eskavatorët e buldozerët ushtonin. Ish gërmuar gjysma e kanalit, po tani kish mbetur pjesa më e vështirë.

Jashari shtangu i habitur. Në fushë qenë formuar kodra të mëdha e të gjata sa të hante syri.

— Punë kanë bërë, jo shaka! — thosh me vete. Iu kujtua harta që kish parë atë ditë dhe mëndja i vajti te vëndi i Hurdhjeve të fshehta.

«Zor ta futin gjithë këtë bina në Hurdhjetë fshehta, — thosh për eskavatorin, — vahu s'do ta mbajë dot. Jo, jo, s'e mban dot. Ai s'ka mbajtur qerrë me buaj e jo gjith këtë alamet». — Tundte kokën, luante frerin dhe vazhdonte duke mërmëritur me vete: «S'është kollaj të thahet këneta. Gjynah! do t'u vejë mundimi kot! Do t'u mbetet gjithë kjo punë batall! Po shyqyr që filluan nga ana e poshtme, se të kishin zënë nga sipër, më iku kopshti kot.

U çel në fytyrë kur kujtoi kopshtin që mund t'i shpëtonte, por prapë u vrëjt e pshëretiu kur mendoi se Tërbufi, mjerimi i tyre, do të mbetej pa u tharë, sipas mendimin të tij.

Ashtu i turbulluar, ngau kalin e sytë s'i hiqte nga kanali i gjërë e i gjatë pa fund.

Bule Shahini pat mbetur vetém. Në shtëpi kish pllakosur qetësia. Më të rrallë dëgjohej të qarët e fëmijës së saj. Azizi vinte në darkë. Shpinte buajt në kasolle, u shtronte kashtë, u jepte pér të ngrënë dhe, si hante bukë, ulej duke mbajtur varur shpatullat e gjëra. Nuk fliste, vetëm kur kërkonte ndonjë gjë urdhëronte të shoqen t'ja binte. Bulja rrinte përkundrejt, arnonte ndonjë send, i hidhte më të rrallë nga një vështrim të shoqit dhe vijonte punën.

Atë mbrëmje, Bulja qe ulur këmbékryq në një rrogoz shtruar pranë rrapit dhe vështronte rrugën kryesore.

Një mace e murme, e madhe, po e thatë nga trupi, ish bërë një me tokën, rrëshqiste ngadalë duke mbajtur sytë si qelibar te një zog çurpuliqe, që me çafkën përpjetë, rrinte mbi një sòp hendeku në rrugën kryesore të fshatit. Me t'u afruar macja, çurpuliqja e qetë hapi krahët, fluturoi pak dhë, si e kanë zakon këta zogj, u ul përséri dhjetë hapa larg vëndit të mëparshëm. Zogu përséri mbante kokën përpjetë. Sytë e tij panë macen që zvarrisej më dinakéri të madhe. U ra gjene krahëve dhe u hodhi pak më tej. Bulja e ndiqte me vëmëndje macen që gjurmonte gjahun. Atë kohë doli nga shtëpia Hekurani. Ai pa macen që iu hodh pér së treti çurpuliqes së zgjuar, mori një plis dhe ja këputi. Kafsha mjauilliti dhe rendi me të katra. Bulja u vrejt në fytyrë, pa Hekuranin që buzëqeshte, qëndroi si e ngirirë dhe e ndoqi me sy gjer përtëj. Befas se ç'i ra ndërmënd. Hyri në shtëpi me kujdes, që të mos zgjonte fëmi-jën, mori një dyshe dhe iu vu pas Hekuranit. Ekte rrugës me çap si të nxituar. Dielli në të perënduar i

skuqte fytyrën. Veriu i mbrëmjes i fërfëlinjtë fus-tanin dhe herë pas here ja ngrinte sipër gjunjëve.

Sa doli nga fshati, nisi të gjurmojë me kujdes. Donte të dinte ku shkonte djali i së kunatës kaq larg fshatit në atë mbarim dite, sepse dhe më parë kish pikasur se djalin diç e shqetësonë. Ndaj ajo ecte me vëmëndje si ajo macja që ndiqte curpuliqen.

Kur perëndoi dielli, e pa djalin të ulej te Shengu i Lumturisë. U habit, priti sa priti, po dhe s'i du-rohej. U mat të dilte e të ikte, po atë çast dëgjoi këmbë. U fsheh më mirë dhe, midis degëve të gjinështrave, dalloj Selvijen. Vajza ecte si e nxituar. Ajo shkoi te Hekurani. U përqafuan të dy, pastaj u fshehën prapa një kaçubeje me gjinestra.

«Ja si qënka puna!» — buzëqeshi me djallezi Bulja dhe u kthyte nga kish ardhur.

* * *

Plepallarët mbushnin ujë për të pirë në këne-të. Nja dhjetë hape larg buzes patën ndërtuar një rrugë prej druri me direkë të trashë futur në dhe. Rrugë s'ish e gjerë, po s'ish dhe e ngushtë. Në mëngjes e në mbrëmje graria shkonin me stama e bucela druri dhe mbushnin uje. Shumë vajza e gra që kishin mbaruar punë, rrinin e bisedonin. Para se të perëndonte dielli, ta kish énda të qëndroje atje. Rrezet e kuqërrrema të binin në rremat e ujit, shndrisnin dhe të dukej sikur sipërfaqja që qëndisur me perla xixëllonjës të lëvizëshme në sfondin e mëndafishtë ngjyrë trandafili.

Nga kjo skelë e drunjë dukeleshin, veç kashtores, edhe arat e mbjella të Sulzotave e të kooperativës së Divjakës. Veriu formonte valë të lehta. Ngjyra e gjelbër e grurit të njomë përzihet me të kuqtë e

diellit në perëndim, me kaltërsinë e qiellit dhe valët krenare shtrihestin gjerë e gjatë me një bukuri të mahnitëshme në ato mbrëmje të bucura marsi. Veç këtyre, një bukuri tjetër i jepnin vendit vargu i kodrave të Karatoprakut, që ndajnë fushën e madhe me detin Adriatik e që janë mbushur plot me pemë të buta e të egra, të cilat iu rrinë kodrave përsipër si kurorë.

Thonë se e Bukura e Dheut, që la çezmat hapur kur mendonte për princi dhe u bë shkak të formujej Tërbufi, delte përherë dhe vështronë këto vargmale. Ajo vështrone pemët dhe thosh: «Selvia është pema më e bukur nga të tjera». Po kur lulëzonte gështenja, ndronte mëndje dhe thosh: «Jo, jo, gështenja me krahët e saj është këdënë e madhe». Kur çelte mersini, shkonfe dhe kendonte përpoch tij, këpuste lule, i thurte kurorë dhe i shkonte princit. Një herë princi i kish vënë kurorës një lule që e kish gjetur në malet e Elbasanit dhe që quhej «Ylli i Maleve».

«Vetëm kjo nuk mbin këtu», i pat thënë princi, E bukura e Dheut e kish gjetur edhe këtë në kodrat e Karatoprakut dhe në kurorën me lule zerdelije, kumbulle e molle kish vënë dhe një «Yll malit».

Në vjeshtë, së Bukurës së Dheut ja kish ëndë të vështronë ullinjtë, hardhitë që përkuleshin e daloreshin midis llojeve të tjera të pemëve frutore dhe zbuluronte me to trupin.

Gjithë këto bukuri që kishin magjepsur edhe të Bukurën e Dheut dukeshin nga vëndi ku merrnin ujë. Atje edhe ajri sikur që më ridryshe, më i pastër, ndaj mblidheshin dhe njerëz. Dendur, kur ish e mirë koha, nga ky vënd përhapej kënga e vajzave dhe e grave. Po kur prishej koha, në këtë vënd fyrinte një thëllim i tërbuar që të merrte mëntë. Thonë

sekur pat fryjtur smoreci (erë e detit) kish bërë vaki që kish marrë dhe njerëz e i kish flakur në llum.

Atë mbrëmje, koha dukej sikur po prishëj, po prapë një katër pesë vajza dhe gra patët mbushur ujë dhe po bisedonin. Midis tyre ish dhe Bulja. Ajo u që lutar fshatarkave të rrinin se do të dëgjonin një gjë të çuditëshme. Kur po perëndonte dielli, edhi për të mbushur ujë dhe Selvija.

— Tani kini për ta dëgjuar, — si mërmëriti Bulja.

Selvija përhëndetë shoqet, mbushi ujë, dhe si mat të ikte.

— Për ku po nxiton, moj Selvije, pse s'na begenis, apo ta mori mëndjen bandilli.

Vajza uli shtamën, dhe vështroi Buljen e skurqur në fytyrë.

— C'më vështron! mbrëmë ku na vajte andej nga Shelgu i Lumturisë? Dukesh si engjëll ti, po je një keckë që s'e ke shoqen! Selvija u shqetësuat që shumë sa i ra shtama nga dora.

— He! Ti kuckë, na hiqe e ndershme, na e mban hundën përpjetë! Po, po, ditën kështu dukesh, po natën shikon e zhgryhesh nëpër presje e penie. Së shpejti do të na e nxjeresh dëbiçin sa koka e xha Rizajt, — fliste Bulja nga pas.

Shoqet e tjera dëgjonin dhe qeshnin: "Bashkë me tò qeshte dhe Bulja!"

— Pas pak, ne vendim e ujit, erdhën edhe gra të tjera dhe Bulja niste e bregdetit perseri.

— Që thoni fu, moj shoqe, ja, kështu e kështu i pashe.

— Të tjera dëgjonin dhe fjala mëori dhene!

III

Mizat e dheut kishin rrregulhuar një rrugë të gjatë midis gramit, në arën e Jashar Shahinit, dhenë një vënd si sop ato patën bërë folënë brënda në dhe. Vrima të mëdha e të vogla qenë shpuar në një truall të qëruar sa një tepsi e madhe. Mizat gjezdisnin, merrnin ushqim dhe ktheheeshin të ngarkuar. Njëra syresh, e ngarkuar me një barrë tri katër herë më të madhe se trupin e saj, shkonte dhe, kur lodhej, e lëshonte; pastaj e merrte prapë dhe vijonte rrugën gjersa e shpuri në fole. Mizat të tjera shkonin e vinin dhe të gjitha pënonin pa u lodhur për të nxjerrë ushqim dhe për të mbajtur veteri.

Dielli i marsit me rrezet e tij u ndihmonte në punë; u ngrohte trupin dhe sikur u shkrinte këmbët që s'u ndjenin të lodhur. Pranë rrugicës së milingonave lëronte tokën Aziz Shahini. Ai punonte shpejt e me kujdes. Sa arriti te rrugica e mizave, ndenji nji copë herë duke i vështruar; puna e mizave i la mbressë.

«Sa të vogla dhe sa punëtore!» — mërmëriti me vete.

Azizi qe i pari që nisi të lëronte në Plepaj. Një ditë më parë i kish thënë Jashari se toka qe bërë për plug. Po i ati, që sikur ish ftohur pak e s'mund të ngrihej ta vështronë arën, e këshilloi Azizin që, para se të nisë punën, t'i conte një plis që ta shikonte. Dhe djali mori rrugën për në arë. Me të yenë plugun, s'i bëhej të ikte nga puna. Tamam si miza e dheut që s'i ndahej barrës së saj pa e shpënë në fole, ashtu edhe ai donte të mbaronte sa më shpejt lërimin. Për një hop harroi porosinë e t'et dhe zuri të lëronte. Vetëm kur dielli ish ngritur shumë lart në

kupën e qiellit, ai u kujtua: Mori një plis, e futi në torbë dhe u nis për në shtëpi.

Shkonte i qetë dhe sado që tokat duhej punuar, se koha po mbante, gjene s'mund të rrinte pa shpënë në vënd porosinë e t'et.

Hyri në shtëpi me fytyrë të çelur, ja trastën në qoshe dhe iu afroa Jasharit.
— E, lalë; si duke, je ndonjë cikë më mirë? —
— Pse u vonove kaqë? pa sille torbën ta shoh.

Plaku buzëqeshi i kënaqur kur i biri nxori plisin.

— Mashalla! Mashalla! — vështron te dhësin dhë i bmerre erë.

— Ara është bërë, turru. Aziz, merr dhe gratë të punojmë. Dashtë zoti të shërohem shpejt, pa vi edhe unë t'ju ndihmoj.

— Jo, lalë, se punojmë vetë, rri mos u ngre zotote, se mos ftohesh.

— Ee, duhet të punojmë të gjithë, ecë, ecë, mos më mëso mua. Shata pa bisht s'punon dot, more bir. Shko ha një cikë bukë dhe nisu.

Azizi mori plisin dhe shkoi në dhomën tjetër.

Bulja, që po rregullonte saçin, u ngrit më këmbë. Azizi i dha plisin duke e vështruar drejt në sy.

— Pse të ka rënë dieja e sheftanit?

E shqoja e pa dhe psherëtiu, pastaj la torbën në hajat dhe erdhi e ndenji në bisht pranë të shqoqit. Mori një hekur, tra zozi zjarrin, dhe iu drejtua Azizit që po dridhte një cigare:

— E dëgjovësë c'flet fshati? — i tha e nxehur në fytyrë.

— Azizi, ngriti kokën, pastaj lagu kartën e cigare, dhe duke mos e bërë vetem tha.

— S'kam dëgjuar gjë, po shiko mos i shpif tinga koka.

Ee, i shpif unë! Unë nderoj derën tuaj, se të kam burrë, nderoj derën e shtëpisë ku kam njëzet vjet që po punoj.

— Mirë, mirë, folë, q'do të thoshe?

— Yt nip na paska rënë në sevda.

— Ç'flet, moj budallaçkë, s'ka bërë vaki në shtëpinë tonë kjo që thua.

— Dëgjo, dëgjo; Hekuri do të bijën e Rizajt, Selvijen. Kërkoni të marrë të bijën e hasmit, more vesh?

Azizit i mbeti cigarja në dorë, ngrysi vetullat, mori mashën dhe kapi një thëngjill në zjarr.

— E shikon këtë? do të ta djeg gjuhën, nëpërkë! pusho, se s'bëjnë vaki këto gjëra.

— Gjuhën digjma, po të të gënjej, po ja; për atë bukë e më zëntë sytë që po të them të vërtetën. Po s'më besove, ngrue dëgjo në fshat se ç'thonë.

— Vështro, të mos të të dëgjoj mi! Gëk të mos bësh! shiko se yete, ja fut në vesh lalës, pa ta kam për të kashaisur kurrizin! Kësaj, pune ja dali vëtë në krye... E bërë farmakum, të ha dhjetë iki!

— Unë s'flas, gojën do ta kyc; po ti, po qe burrë, zbardhna faqen, dhe lanarturpin që po na kanoset, dëgjove?

— Hiqmu që ikëtej! fillova rëtë na mësosh, — i shfryu gjene i shoqi, dhe i u ngrit e dolli përjashta.

Nevruze Drenja, e motrat e Rizajt, ish grua natike. Dikur, kur, kish qënë e re kish shërbyer në shtëpi të një beur. Atje kish hyrë në tarikat idhe, që atëhere, s'besonte gjë tjetër përvetë shehlerëve dhie dërvishlerëve. Sa herë që dervishët shkonin nëpër myhybët e tyre, të dërguar nga shehlerët për 'ndot

një karroqe misër, pér ndonjë qengj e cjak, do të ktheheshin te shtëpi e Rizajt. Rizaj s'bënte zë, s'ja prishte qejfin së motrës, se e kish më të madhe. Kish vite që Nevruzja s'bënte punë. Pat zënë një qoshe, kish veshur një fustan të zi dhe, para se të flinte, tërhoqte tespijet duke mërmëritur: «ja Muhamet, ja Ali» dhe vazhdonte kështu gjersa i mbylleshin systë. S'donte ta luante njeri dhe sikur të bëje shaka e ta trazoje, le që të shantë rëndë, po më vonë s'të fliste me gojë.

Nevruzja ish fanatikë edhe ndaj femirave. Sikur ta kish në dorë s'do të linte as dhe një vajzë a grua të delte përjashta. Kur vonohej Selvija, grimdej me vëte duke zënë më gojë gjithë emrat e shenjtë. S'dilte më tej nga praku i derës. Edhe kur qëllonte të vinte në ndonjë fqimj, e mbështillte kokën me një burulluk të bardhë aqë shumë sa vetëm hundën dhe systë linte jashtë.

Atë natë Nevruzja, si hëngri, bukë, nisi të mpleksë një çarape leshi. Kur ranë të flinin njerëzit, uli llambën dhe zuri, të tërhoqte tespijet. Kur filloj t'i rëndonte systë gjumi, puthi tespijet, tha një bismilahi e kënaqur, se dhe atë natë i këndoi shpirtit, dhe ra të flinte e qefë. Të nesermen u ngrit pak si vonë. E mbesa i pruri mëngjesin: një tas me qumëshët të përshestur. Me të mbaruar së ngremi, në shtëpi hyri një plakë tjeter. U ul pranë saj dhe nisen të shkëmbejnë shëndetet.

— C'dégjova, c'dégjova, moj xhiko Nevruze! Këto femrat e sotme i hëngërt kolera.

Nevruzja pa shoqen që mbylli systë kur mallë-koi:

— Zoti na ruajtë, — mërmëriti si pér t'i kithyer përgjigjen shoqes, — shyqyr që kam një në derë dhe e kam me mënd.

— C'dëgjova, c'dëgjova, moj xhiko Nevruze, — përsëriti shoqja, — Edhe jot mbesë u hazzis!

Nevruzja luajti nga vëndi sikur ta kishin shpuar. Pa shoqen me ca sy të shqyer, futi mollëzat e faveve brënda dhe nga që u ngrit me deftik, i ra shamma që kish hedhur në kokë e iu dukën flokët e gjatë e të thirj.

— Parmbrëmë na e kishin parë me Hekurin e Jasharit që përqafoheshin te Shelgu i Lumturisë.

— Ja baba Ali! — ja bëri plaka dhe humbi duke mbërthyer sytë në tavani.

Shoqja u trëmb dhe thirri. Në dhomë hyri Selvia me furi. Kur pa tezen të alivanosur, mori ujë dhe nisi t'i spërkatë fytyrën.

— Nga ti, nga turpet e tua u sëmur, m'u bëfsh kurban, — tha fqinja dhe u ngrit e iku duke u tunxur.

Nevruzja erdhi në vete pas një copë here. Pa të mbesën që ish zverdhur dhe i bëri shënje të largohet. Mbështollë fustanin rrëthi vëtes, hodhi një batani je kokës e u kruspulloj në buxhak.

Kur erdhi Rizaj, u ngrit.

— Ku je, o vëlla, — i tha, — mbylle derën dhe hajde ulur.

— Pse je bëre kështu, moj motër, c'të ka rënë kjo çehre?

— Ulu, o vëlla, ulu. Qyqja, u turpëruam. A dëgjove ç'ka bërë jot bijë?

Rizaj ndenji këmbektryq, nxori kutinë dhe nisi ta dredhë duke parë të motrën.

— Jot bijë na qënka qafuar me të nipin e Jasharit. I dualën mënëtë, më duket.

Rizajt i ra kutia nga dora.

— A je në vete, moj motër? C'janë këto që thua?

— Të janë zënë veshët, s'ke dëgjuar ç'mollois fshaçi? Harboje, harboje keckën e përroit.

Rizaj u ngrit dhe doli përjashta. E hiqte duhanin paf e puf dhe më në fund e vërviti cigaren tej. Ngriti kokën dhe thirri të bijën.

— Dëgjo, — i tha duke e shikuar rrëptë, — po të pashë të dalësh nga praku i derës, t'i theva këmbët.

Vajza u ngashërye dhe hyri më nxitim në shtëpi.

Dashuria kish hedhur rrënëjë të thella në zëmrën e Selvijes. Këto rrënëjë u mpleksën e u forcuant më shumë që kur nisën takimet. Fjalët eënbla e puthjet e bënë të shpërthejë dashuria në zëmrën e saj siç shpërthen trëndafili në pranverë. Vajza nisi të shijojë bukurinë e dashurisë e atë lumburi që i jep ajo shpirtit. Një takim, një buzëqeshje, një puthje e shtonte dhe më shumë afshin, ndizte ndjenjat, i lidhte fort, i bashkonte më tepër dhe si djali ashtu që vajza shikonin se rrugë tjetër përveç bashkimit të tyre s'kishte.

Dëndur Selvijes i hipte mërzia, sepse kujtonte t'anë, e dinte me siguri se do ta hidhëronte që po vepronë me kokë të saj; po si t'ja bënte? Do të vuante do të duronte hidhërimin e plakut, se e ndjente që kështu ish shumë më lehtë, se sa të shkëputet nga djali. Pa djalin s'rronte dot.

Atë ditë, kur mori vesh i ati punën e Selvijes, vajza nisi të vuajë atë që priste. Rrinte e mjeruar, vështronë fshehur plakun, dëndur i venin lot, po e mbante veten. Përpiquej t'ja plotësonë çdo gjë t'et që ta lehtësonë nga barra që i kish rënë. Nuk

14
FD 2

dinte se ç'mendonte ai. Ç'do të bënte? Kish ditë që i ati s'i fliste fare me gojë. Të pyeste tezen, ajo ish katranosur më keq, se jo vetëm që s'pranonte të fjalosej me të, po s'donte as ta afronte. Që natën që kish marrë vesh punën e saj, i kish nxjerrë shtresat në koridor dhe Selvija flinte në të ndarën ku gutuhej gjella.

Veç vojtjes të t'et, vajzës i kish hypur një mérzitje e madhe, se s'kish njeri më kë të bisedonte. Të dilte nga shtëpia, kish frikë se mos e vështronë babaj pastaj kush i dëgjonte dhe fjalët e botës? Dëndur mendonte Hekuranin: ç'bënte ai? A kishin marrë vesh gjë shtëpia e tij?

Një mëngjes, si pat mbaruar punët e shtëpisë, ge ulur pranë dritares dhe vështronë e menduar. Kur pa se nga deriçka hyri në oborr i ati, ajo u ngrit e shkoi te zjarri.

Plaku, si hoqi këpucët, u ul e e thirri.

Vajza u drodh, u përtyp dhe u skuq në fytyrë. Shkoi ngadalë dhe qëndroi më këmbë. Rizaj e vështroi një copë herë. Profili i shtatit të saj, i ndriçuar nga dielli, që hynte nga dritarja e hapur, fytyra e saj e hequr, e skuqur nga turpi, kaçurrelat e flokëve të bukur, rrohet e buta të leshrave pranë vëshëve, vezullimi i venitur i syve, goja e pafajshme, bile dhe fustani i vjetër i zbardhur, e mbushëm Rizanë me një dhëmshuri aq të madhe atërorë, sa që pshëretiu me gjithë shpirt.

— Ikë, — i tha, nga që s'ish i zoti t'i fliste përc'kish menduar. Selvija e vështroi në sy, u zbeh në fytyrë, u gnashërua, nisi të qajë dhe ra përmbyss duke vënë kokën në gju të t'et.

— Më mirë të vdes, baba, s'duroj dot më, s'duroj dot!

Plaku nisi të dridhej, ngriti dorën, desh t'i ledhatonte flokët, t'i thosh ndonjë fjalë që ta reshtëte, po se ç'e ndalonte. S'i dûronte dot psherëtimat e çu-pës. Shikoi përreth i tronditür. S'dinte se ç'të bënte. Fshiu sytë me një peshqir që e përdorte si shami dhe u ngrit duke rënkuar.

* * *

Një frikë e fshehtë, një tronditje e padukshme po endej në shtëpinë e Shahinajve. Më çquar nga të gjithë këtë frikë e tronditje e ndjente e ëma e Hekuranit, Nekija. Ajo kish pikasur me kohë se të birin diç e mundonte; pat folur me të, e pat vrejtur nga të gjitha anët, ish menduar, po shkakun e vërtetë s'e kish gjetur.

Tërë ditën Nekija e ngryste më urtësinë e saj, e zonja të përtypste çdo gjë të mirë e të ligë pa bërë fjalë, pa u inatosur. Donte që në shtëpi të mos kish sherr e sidomos të mos kish sherr me të birin. Kur e shanin Hekuranin, kur ai bënte ndonjë të pabërë, ajo ligështohej dhe e mbante më këmbë vetëm dasuria që kish për djalin, hyzmeti që duhej t'i bënte atij.

Si gjithë pjesëtarët e familjes, veç Jasharit, dhe ajone kish marrë vesh punën e të birit. Kjo gjë e kish tronditür shumë, dhe, veç Hekuranit, ajo qe e vetmjë që vuante më tepër nga të gjithë për këtë çështje. Hidhërimi e tronditja kishin lënë gjurmë kudo në trupin e saj, në fytyrën që kish marrë ngjyrën e gjetheve të vjeshtës, në sytë që mezi vështronini e që ishin aq të lodhur, në shpatullat që i qenë kërrusur... Phe vetëm mendimi që t'i dilte krah djalit, kur ta donte puna, e mbante më këmbë.

Një mbrëmje Nekija vendosi të bisedonte me

djalin. Kur u kthye Hekurani nga puna, e thirri në një cep, larg syve të Bules, u ul pranë tij dhe nisi ta vështrojë me kujdes. I biri kish ndryshuar, një fytyrë tjetër i kish rënë, një fytyrë ku vizatoheshin mendime të shumta, halle e derte. Iu coptua zemra, u ngashërye dhe e pyeti:

— Ç'të mundon, o bir? Pse nuk ja thua nënës hallet?

Djali e pa në sy. Kuptoi se e ëma vuante dhe vuante aq fort, sa që s'ja priste mëndja. Fytyra e saj kish marrë një ngjyrë të llahtarëshme, që lodhur e drobitur sa kurrë ndonjë herë tjetër.

— Mome — aman mome, mos u sëkëlldis, mos u dëshpéro, mos mendo për gjë. Ne do rrojmë të lumtur. Pse të vuash ti për mua? Unë s'jam më i vogël. I bëj vetë ballë cdo gjëje. Aman, mome, mos u mërzit, — ja bëri Hekurani duke iu lutur e duke e puthur.

— Hekur, djali im, — psherëtiu thellë gruaja dhe sikur diç ja zuri fytin. Donte të fliste, po s'mundte, — Hekur, djali im, — tha më në fund, — pse nuk ja hap nënës barkun.

— Do të t'i them të gjitha, mome; ti mos u trondit. Unë e dua Selvjen, e dua. Unë do të fejohem me të. Ti mos u trondit. Çdo gjë do të vejë mirë. Lala do të bëjë fjalë, po prapë do të pranojë. Vetëm ti mos u dëshpéro.

Nëna pa të birin në fytyrë dhe vuri re vendos-mërinë e tij të madhe. Fjalët e saj s'do të vlenin, ishte e kotë t'i thosh që të hiqte dorë. Sytë tregonin se që shumë i dëshpëruar që po haste në pengesa dashuria e tij. Djali vuante. Një nga këto vuajtje mund të ish dhe tronditja e saj. Vërtet, s'duhej të tronditej, se vetëm kështu do ta ndihmonte të birin. Po a kish mundësi? Sidoqoftë duhej që edhe tron-

ditjen ta përtypete, të mos e qfaqte, ta mblidhte dhe atë në lëmishin e madh të hallevë të saj.

— Mos u dëshpéro, bir i nënës, s'tronditem. Të jap fjalën se nuk tronditem, — i tha dhe nga që s'e mbante dot veten, u ngrit e shkoi në shtëpi.

Sadoqë i dha fjalën, sadoqë mendoi ta përtypete shqetësimin, prapë s'qe e zonja. Mendime të shumta e ngacmonin. Hekurani s'ja jepnin kurrë vajzën, s'ja jepte i vjehri dhe as i ati i çupës. Si mund ta ndihmonte ajo si nënë djalin e saj, zemrën e saj? Nuk shihë asnjë zgjidhje. Kjo e dëshpéronte më shumë. Vështronte të birin në buzë të grëminës dhe s'dinte se si ta shpëtonte. A kish më keq?

«Qyqja unë, e mjera unë! Ku je, o Demir, ku je tē shohesh se si jam bërë! — thosh ngado që vinte, duke e zënë për herë të parë në gojë emrin e të shogit të vrarë në luftë. Oreksi iu pre, gjumi s'ë zinte. I merreshin mëntë. Djersa e hollë nisi t'i bjerë më dendur. I ftosheshin duart e këmbët, dridhej dhe ecte më zor tē madh. Ngå dita në ditë ndjehej më keq; ngå dita në ditë mundonte veten, se kish frikë mos i pësonte gjë djali.

Zyrat e re e shëfitë të kantjerit ndodhej përbalë portës së jashitme. Korrideri i ngushtë, nga tē dy anët më dyer tē shumtë, ish gjithmonë i errët.

Në mes tē murit prej dërrase, tē lyer përsipër me gëlqere, ciflat e së cilis shiheshin kudo në dyshem, mbështetëj një kanape e vjetër. Te ajo rrinini përherë njerëz, vetëm natën e shihje tē lirë.

Atë mbrëmje, në tē ish ulur Hekurani. Mbante sytë te dera dhe, sa herë që hyntë e dilte njeri, përshtendoste.

— More, po s'paskan tē sosur punët e këtij, — thosh pér shefin. Më nē fund, i erdhi radha, trokiti dhe hyri.

Shefi ngriti kokën dhe pa Hekuranin.

— Uluni, — i tha, nxori shaminë dhe fshiu ballin.

Hekurani ndenji nē mje nga tē tetë karigët që rrrethonin tavolinën e gjatë.

Shefi hapi një sintar, nxori ca letra dhe i dha Hekuranit një «Labinoti».

— Ne e shqyrtuam propozimin tuaj; unë bisedova me shokun Hajri; mblohdëm këshillin teknik dhe përfunduam se disa gjëra janë tē mira dhe ju falënderojmë pér to, kurse disa gjëra nuk kanë baza. Mendimi juaj se uji i Tërbufit, tē madh shkon në Kënetn e Zezë është i saktë. Ne muarëm masa dhe zumë shtigjet, — si përpëliti qepallat, shtoi: — Mendimi pér Hurdhjet e fshehta s'na duket i dokumentuar. Nuk ka pérse tē hahet vahu dhe tē shëmbet dheu, kështu që s'ka arësy pse tē ndrojmë drejtimin e kanalit. Ju vazhdoni punën me gjakstohtësi dhe tē kini besim tē plotë në fjalet tonë.

Hekurani rrudhi vetullat dhe shohti cigaren.

— Shoku shef, unë jam i sigurt, se kur bie shi, vahu hollohet, dhe jo vetëm kaq, por sikur tē futen eskavatorët dhe një një kilometër, pa tjetër do tē pësojnë ndonjë fatkeqësi. Unë punoj në krye tē, eskavatorëve dhe shoh se sa më shumë që shkojmë pérpara, aq më tepër vështirësi ndeshim dhe aq më me nerva tē ngritura punojnë eskavatoristët.

Hekurani heshti dhe e shikoi në fytyrë pér tē vrejtur se mos shefi e keqkuptoi. Sigurisht që ai e keqkuptoi dhe e mori Hekuranin pér frikacak.

— Dëgjoni, shok, është mirë tē mos ngulni këmbë. Vetëm ju jini që mendoni kështu dhe s'më pël.

qen kjo këmbëngulje... Kini besim tek në dhe mos u frikësoni. Asgjë s'kini për të pësuar.

Hekuranit iu drodhën pak faqet, i ra një hie e zezë, e shikoi rreptë dhe i tha:

— Unë kam lindur e jam rritur në Plepaj dhe e njoh vëndin shumë mirë. Te Hurdhjet e fshehta më është vrarë babai për t'i dalë zot vëndit. Vëtë jam komunist, prandaj t'ju mbushet mëndja se s'e njoh frikën. — U ngrit më këmbë, — unë kërkoj që propozimin t'ja thoni shokut Hajri. Dhe ju lajmëroj se nuk do ta lë çështjen me kaq.

— Ohu, na fute në të thella; bëj q'të duash. Vëtëm c'keni, mbajeni për vete; bëtë mirë që nà e thate. Ju porosis të mos fjaloseni me eskavatoristët e tjerë se mbillni panik.

— Natën e mirë.

— Natën e mirë, shoku Hekuran, — ja kthëu si me ironi shefi.

Eskavatoristi doli nga zyra i kuq në fytyrë. Me të kapercyer prakun psherëtiu, luajti supjet dhë mori rrugën e fshatit, i kredhur në mugëtirën e imbrëmjes.

Shefi i kantierit s'i vuri vëmëndjeni e doliu nd propozimit të Hekuranit. Posa pa shtigjet e häpura dhe ujin që shkonte nga Tërbifi në Kënetën e Zezë, dha urdhër që të mbyllnin shtigjet dhe më kaq e mbaroi punën. Ai nuk e vrau mëndjenë më gjatë që të studjonte se mos ndërmjet të dy kënetave kish ndonjë lidhje të fshehtë, apo ndonjë yçkë tjeter dher të vinte në vend e të shihte se si mendonte Hekuranit që të kthehej kanali, ose të pyeste ndonjë fshatar a ishin të vërteta gjithë ato që thosh djali. Mos kokëcarja dhe përgjegja që i dha Hekuranit, e shtyj-

ti Besimin të mendonte mirë dhe, të nesërmen e bisedës me Hekuranin, i shkoi shefit të kantierit, kuvendoi shtruar me të dhe, deshi s'deshi, më në fund shefi u bind se këtë çështje duhej ta shikonte me kujdes.

Pas dy ditëve Gëzimi u ngrit dhe mori rrugën e Plepajt duke menduar që të bisedonte me Kryetarin e këshillit dhe me ndonjë plak tjetër. Ai do të pyeste edhe Jasharin, se atë e njihet më mirë nga të tjerrët, megjithëse nga ai s'priste ndonjë gjë më shumë nga sa i kish thënë Hekurani.

Shkoi në Plepaj, vajti në këshillë, po e gjeti zyrën mbyllur. Qëndroi një copë herë më këmbë para oborrit dhe sytë i vajtën te rrapi i madh i Shahinajve. Atje diktoi Azizin që po priste dru, dhe i bëri zë të vinte ta takonte.

Azizi, si e pa që ishte vetëm, e ftoi mikun në shtëpi. Gëzimi shkoi, u përshëndosh me të dhe e pyeti:

— Në shtëpi është xha Shari?

— Ka shkuar nga kopshti, po urdhëro brënda.

— Jo, të falem nderit, desha ta pyesja pér diçka, po... — dhe e shkoi Azizin në sy.

— Po qe fjalë fshati dhe shtëpie, edhe unë Plepallar dhe Shahinaj jam! Mund të ma thuash, — i buzëqeshi Hazizi.

Gëzimi u ul në një kërcu, përkundrejt u ul dhë Azizi.

— Hallin e kemi këtu: — e filloj bisedën Gëzimi, — një njeri na ka thënë se Hurdhjet e fshehta, kur bië shi, hollohen dhe s'mbajnë. Po ta marrësh nga ana e shkencës, si ta them, unë mendoj se ai sikur s'thotë të vërtetën. Prandaj desha të pyesja xha Rizanë e xha Sharin, që janë më të vjetër dhe nga familje të mira, e të merrja prej tyre fjalë të sakta,

— Unë e di se kush jua ka thënë këto, — ja pri-ti Azizi, — ai është im nip. Po dëgjo, o shoku shef, se desha të vija dhe në zyrë për punë të tij. Nga një njeri që nuk sheh hair shtëpia, nuk sheh as vëllezëria e as shoqëria. Atij mos i besoni po punoni me mëndjen tuaj. Këtu tek ne në fshat është bërë dhe një farë batakçillëku. Kryetari i këshillit mundi që t'ju mbushë mëndjen se gryka më e mirë për të bë-rë kanalin është ajo e Strymit dhe jo e Patës. Gji-thë këtë e bëri se, po të bëhej grykë kanali ajo e Patës, do t'i iknin nga dora bostanet. Ja, thuaj ti, shoku shef, a mund të bëhej kanali në Grykën e Patës?

Gëzimi u mendua dhe tha:

— Nejse, vazhdoni; ajo është punë inxhinjerësh.

— Që thuua ti, — vazhdoi Azizi, — Rizajt i ndih-moi dhe im nip, se ai i do të bijën, dhe kështu ne na la në baltë. Do të na ikë kopshti nga duart për qejfin e Rizajt e të Hekuranit. Ja, kështu është ai, që na ka helmuar dhe farmakosur. Tani po ju nga-tërron edhe ju; dhe e di pse e bën këtë? Se ka frikë të punojë te Hurdhjet e fshehta. Është i djallézuar ai, i djallézuar! ... Sa për hollimin e tokës, ajo, o byrazer, më përpara mbytej, këtë e di mirë, kurse tani po bëhen kaq e kaq vite dhe s'është mbytur njeri, s'është dëgjuar gjë. Kështu është dhe mos ecë hiç gjékundi, mos pyet hiç njeri tjetër, se këto që të thashë unë do të të thonë. Hë, vetëm po pyete Rizanë, dhe po të marrë vesh Rizai se kështu e kësh-tu ka bërë Hekurani, atëhere edhe ai do të mbajë anën e Hekuranit dhe ka për të ta prishur mëndjen më shumë.

— Gëzimi u ngrit, i dha dorën, dhe këtë radhë, pa vrarë mëndjen më gjatë, i mori për të vërteta të gjitha ato që i tha Azizi dhe u kthye në kantier. Sa u ul në karrige shfryjti kundra Hekuranit:

— E dija unë se ai është frikacak dhe i ndyrë!
Shtriu duart, i ngriti përpjetë, gogësiti dhe si,
hodhi këmbën mbi këfmbë, nisi të sodiste fushën.

Hekurani kish tri díté që ish sémurë. I dhimbte fytty i dhe gjoksi. Kur e kur i dhimbte dhe koka. Sadoqë donte ta mposhtëtë sémundjen, prapë ajo s'ë la pârë hedhiur në dyshek. Të katertën díté ish më mirë dhe mendoi të shkonte në punë. Që në mëngjes, si hëngri bukë, mbathi këpucët dhe ndezi cigaren në një prush që i dha ë ema, pastaj mori rrugën. Ishtrruar. Rrezet e diellit i binin në fytyrë dhe i jepnin një pamje freskie. Mustaqet e vogla, që kish nisur t'i linte, i lézetonin fytyrën dhe e trëgonin më të madh nga cësh. Sytë e thelluar dëshmonin për sémundjen, që, sado e shkurtër, prapë kish lënë gjurma. Sadoli nga fshati mori udhëzën buzës së një hendeku. Në të djathhtë, shtrihej presja e gjelbëruar e dukej sikur mbaronte përtej, te kalaja e Tûrres. Në të majtë, ngrihej kodra e Shën-Premtes, veshur me ullinj e qiparizatë që dukej sikur ish koka e vargmalit të Karatoprakut. Përpara shtrirjej fusha e mbushur me pelliçje, megjithëse kish kohë që s'pat rënë shi. Djalii vështronë me vëmëndje vendet dhe fytyra i shprehte një farë kënaqësier.

Si eci ndonjë òré e ca, u kthyё nё té djathëtë
dhe, duke shkuar nёpér një rrugicë tё ngushtë, humi-
bi midis presjes. Sá më thellë që hyntë, aq më shu-
më i kridheshin këmbët nё balte.

Në mes të rrugës qëndroi. Vështroi nga të gjitha anët, dhen kur üsizuria se s'kish gabuar udhen, vijoi më tej: nqyrja e tij është sa mbrojtësi i tij.

Pas dy ore arititi n̄el buzé / t̄ek kanalit veshtroi
t̄e arititi n̄el buzé / t̄ek kanalit veshtroi

përdhe, tundi dorën, shtrembiroi pâk buzët dhe mëriti:

U fëlliqa që u fëlliqa; të shkoj dhe ca, — dhe eci duke shkelur në kokat e presjes që i kish nxjerrë buldozeri. Qëndroi buzë kanalit dhe vuri duart në bel. Fytyra i ndriti dhe një buzëqeshje krenare e pushtoi përnjëherë. Sytë e gëzuar vështronin kanalin e gjerë që shkonte drejt. Në buzë të tij, nga ana e Shkumbinit, kodrat me dhë qenë rrjeshtuar në një vijë, sikur të ish vënë në radhë një armatë e tërë punëtorësh. Djali zuri me dorë faqet dhe iu bë përpara fytyra e t'et që u fliste partizanëve:

«Shqipérinë do ta çlirojmë nga fashizmi dhe bejlerët. Do të ndërtojmë Shqipérinë tonë, ku njerëzit të rrojnë të lumtur. Do ngremë fabrika, uzina, do thajmë kéneta e do ta bëjmë punëtorin dhe fshatarrin zot të fateve të tyre».

Si thanë komunistët ashtu po bëhet, dëshë atë qast e ndjeu vëten të lumtur dhe ndërgjegjën shumë të pastër. Duke vështruar, nxori kutini, drodhi një cigare, e ndezzi më çakmak, dhe si e hoqi dy tri herë, vendosi të shkojë te eskavatori i tij. Afriti në fund të kanalit. U habit se nuk po shikte njeri. U ngjat në një vënd pâk të lantë, që ish formuar nga grumbulli i dheut dhe, nja dyqind metrë në të majtë, dalloj eskavatorët. Si hoqi dorën që e kish vënë si strehë kapelle përt te shquarrrugën që të shpinte te maqina, nisi të secën i asnjën solli.

Me të parë eskavatorët, sepse u mirejt. Diç i raxnderinënd. Aty pranë dalloj një shelg të madh me trapatë trashë. Plépallët eq thërrisnin. Shelgu i Vdekjes». Kur ishte ai ende fëmijë, Mahmut Bej i Elbasani kish bërë një kanal për stolidhun. Kënetën e Zezë me Tërbullin, Prugac më e shkurtëti kalonte pranë këtij shelgu. Një ditë, tek i shpintë gjysht

bukën, dëgjoi një zhurmë dhe pa një qerre që u fundos aq shpejt, sa që jo vetëm e tmeroi, po dhe e habit. Në atë vënd që ish mbytur qerrja po punonin eskavatorët. Po sikur t'u ndodhët dhe atyre si i pat ndodhur dhe atij fshatarit të mjerë?! E mbërtheu një tronditje dhe një frikë e madhe. Ngau këmbët shpejt dhe sa më shumë që bridhite, aq më e fortë i bëhej zhurma e maqinave dhe aq më tepër, e ndjente vahun të dridhej. Kur arriti te vëndi ku punonte eskavatori i parë, u prish në fytyrë. Maqina falej sa herë që mbushej lopata dhe dukej sikur do të fundosej. Iu afrua eskavatoristit dhe e vështroi drejt në fytyrë. «Po ky po i hap varrin me duart e tija!» — mërmëriti dhe tek po e vështronët në sy, iu bë qerrja, buajt dhe fshatari që u kredhën sikur t'i përpinte ndonjë kucedën. Duke përfytyruar këto, ndjeu vahun të lëkundej, pa eskavatorin që po dridhej dhe pjesën e pasmeatëtij që u ngritin jnjë herë, dy herë dhe më në fund u duk lopata, duke lëshuar anëve llum të zi.

Hekurani mori frymë thellë dhe nuk ndenji më, po bëri nga kish ardhur. Kur sosi në kantjer, dielli po ngjitej në kupën e qillit. Qe dërsitur, ish zverdhur në fytyrë dhe, nga që ish lodhur, merrte frymë me të shpejtë.

Hyri në administratën e Kantjerit dhe pyeti për sekretarin e organizatës. I thanë se kish dalë nëpërreparte. Duke nxituar, u fut në depon e maqinerisë, në mencë, në garazh, në klub dhe, më në fund e gjeti sekretarin e organizatës bazë të Partisë në oficinë.

Sekretari, kur e pa ashtu të tronditür, zmadhoi pak sytë dhë e pyeti:

— Ç'ke, shoku Hekuran? Ç'ka ndodhur?

Djali e zuri për krahu, e hoqi mënjanë dhe mëzë të dredhur i tha:

— Merrni masa; dëgjoni apo jo, merrni masa, se do të mbreten shokët.

Sekretari u çudit, e pa me vëmëndje shokun dhe për ta qetësuar e këshilloi:

— Dëgjo, Hekuran, folë me gjak të ftohët.

— S'kam që t'flas; merrni masa të shpëtoni shokët, ndryshe...

— Çfarë ndryshe?!

— Ndryshe do të mbledh gjithë fshatin t'ju sjell këtu që t'ju mbushin mëndjen se është ashtu si them unë.

Sekretari u mendua. U ul në një hie peme dhe, duke e parë shokun në një gjëndje të tillë, tha:

— C'mendon të bëjmë, Hekuran?

— Duhet të ndërpriten punimet, të kthehet kinali, se u fikëm!

U bë qetësi; vetëm dëgjoheshin çekanët që rrin-nin në repartin e kantjerit.

Sekretari nxori një fletore dhe, duke shkruar, tha:

— Mirë, këtë çështje po e shtroj në bërronë e organizatës bazë së Partisë, që sot pasdrekë. Në mbledhje do të vish dheti: Do të rrahim prопозиции tënd. Si thua?

— Bëni që t'flas; vetëm ndalon i punimet, se po qëndrem kur mendoj se fati i shokëve varet në një fije peri.

Sekretari e vështroi dhe një herë e mbledhi bu-zët i menduar. Ejalët e Hekuranit po i bënин përshtypje dhe po i futin një shqetësim aq të madh sa skish ku t'ente mësoli. — Ku do t'vash shoku Hekuran? — pyeti qëndri.

— Këtu do t'rij, do t'pres sa të bëhet mbledhja e byrosë. q nöjneb e që duhet t'fisqë

Sekretari pshërtiu! Sa më shumë që dëgjonte

eskavatoristin dhe sa më dëndur që e vështron te në fytyrë, aq më fort i shtohej besimi në fjalët e tij dhe aq më tepër tronditej.

— Po shkoj, Hekurän, po shkoj të shikoj punimet. Mbledhjen do tambëjmë nga ora pesë.

U ngritën që të dy: Sekretari shkoi nga gara zhi i maqinave, kurse Hekurani bëri për te një fik i vetëmuar në mes të një are më misra. Në të arri tur, u mbështet pas trungut dhe nisi të përfytyrojë gjithfarë të zezash. Herë i bëheshini në sy Hurdhjet e fshehta, herë eskavatori duke u mbyturi; herë shokët që fundoseshin në ullumin e llucën e zezë. Dridhëj i téri, luante vetullat dhe shtrëngonte nofullat. «More, po pse s'më dëgjojnë? — thosha me vete dhe i vinte të hante mishtë më dhëmbë. » Po s'muarën vesh edhe sonde, do t'i shkruaj Komitetit të Partisë. Po s'më dëgjuam dhe atje, do t'i shkruaj Komitetit Qendoror. S'i kam për të lënë rehat; të më shohin. Po pse s'më kuptojnë, mës duan të sabotojnë? mos ka ndonjë armik brenda, mos duan të na e bëjnë si në Maliq? Djallit demori po xhia Rizaj ç'bën që rri duarkryq? Po këshilli ç'bën? Edhe medata do të bisedoj. Do të më besojnë mëh në furi, Hodi bishtin e cigares përtëj, u shtri në brinjë dhe mbylli sytë, se ndjehej shumë i dobët. E kapiti gjumi një copë herë. Flinte i shqetësuar. Kohë më kohë i ngriheshin përpjetë mollëzat e faqeve, pastaj i lëviznin vetullat dhe i drdheshin buzetë. Dukej se shihte endra të këqija. Më në fund është ngritur i llahta risur, zuri fytim me duar, po kur pa se kish qenë në endër, u qetësua. Dielli kish rrëshqitur shumë nga kupa e qillit Hekurani i ngrit dhe nisi të fecë. Sa hyri në kantjer, takoi Qesim Qolli.

Hynë të dy në klub dhe ndenjën pranë një tavoline.

Zunë të hymin një nga një edhe anëtarët e byroshë së organizatës. Veç këtyre, sekretari pat ftuar dhe shefin e kantjerit megjithëse ai nuk ishte komunist. Kur hyri shefi i kantjerit, shikoi me kujdes eskavatoristin dhe tundi kokën, po a për mirë, a për keq, s'u muar vesh. Nëndë vetë zunë vend dhe se cili nxori një bllok shënimesh a ndonjë copë letër, pastaj priten të gjithë të dëgjonin se ç'do t'u thuhej.

Sekretari i organizatës u ngrit më këmbë dhe, si i kundroi të gjithë me radhë, tha:

— Shokë, unë mendova të bëjmë mbledhjen e byroshë jashtë planit dhe në formë të zgjeruar. Shoku Hekuran disa ditë më parë bëri një propozim për një ndryshim të vogël të trasesë së kanalit. Propozimi i tij nuk u pranua. Shoku Hekuran ngul këmbë në të tijën dhe thotë se jemi shumë në rrezik. Unë posa erdha nga Hurdhjet e fshehta dhe vërtet atje punët s'janë shumë në rregull. Unë mendoj ta shohim mirë këtë problem. Fjalën e ka shoku Hekuran.

Të gjithë vështruan eskavatoristin që u ngrit si me përtim. Hekurani, më duart që i dridheshin, shtroi flokët dhe me zë të ngjirur foli:

— Shokë, unë kam lindur dhe jam rritur në Plepaj. Kam qenë peshkatar dhe i jam futur këtij zanati që kur isha nëndë vjec. Tënbutin e njoh mirë. — Hekurani heshti shikoi shefin e kantjerit që se c'bisëdoi me brigadierin, picëlloi pak syfë dhe shtoi: — Im atë ka qenë peshkatar, anëtar partie, i 1942-së dhe komandant i cetas së parë në krahinë. Eshtë vrarë në Hurdhjet e fshehta. Jua thashë këto, shokë, që të më besoni për Hurdhjet e fshehta. — Heshsti, fshiu ballin me mëngën e xhakës së zberthyer dhe vijoi! — Në rajonin ku zhillohen punimet, më

sa mbaj mënd unë, janë mbytur njerëz; kur bie shi, atje vahu hollohet, krijojen hendeqe, dheu nuk mban qoftë dhe një njeri sipër. Këtij vëndi po i afrohen eskavatorët. Në vëndin ku punojnë tani, po të bjerë shi, është rrezik të mbytemi. Unë, shokë, jam i sigurt pér këto që them dhe përgjigjëm pérpara Partisë, qoftë edhe më kokë. Pér këto arësy kërkoi nga byroja të ndërhyjë pér kthimin e trasesë sa nuk është vonë.

Ndenji një copë herë pa folur, pastaj u ul. Dikush luajti karigen, dikush ngriti kokën dhe e vështroi, një tjetër mblodhi buzet.

— Kush do të flasë? — tha sekretari i organizatës.

U bë qetësi. Sekretari vështronte njerëzit dhe, kur pa shefin që ngriti dorën, i dha fjalën.

— Unë, shokë, pashë në vënd propozimin e shokut Hekuran dhe u binda se mendimi i tij pér kthimin e trasesë nuk ka baza. Me këtë mëndje jam edhe tani. Shokun Hekuran unë e besoj. Vërtetë, ashtu ka ndodhur më parë, por sot është ndryshe. Më parë, bregu i kënetës, nga studimet e bëra, shtrihej më gjerë dhe, si rrjedhim, vëndi pranë bregut, kur mbusheshin kënetat, shëmbej e mbytej. Siç thanë fsatarët e vjetër, Tërbuffi shtrihej gjer te Çermat, kur se sot në atë vënd ka dy tre katunde. Kështu është puna me Hurdhjet e fshehta. Më parë kështu ka qenë, si thotë Hekurami, po tani vahu ka një organikë të shëndoshë, është pak i njomë, po i aftë të mbajë peshën e eskavatorit. E theksoj: është i aftë dhe s'ka pse ta bëjmë ndrimin e trasesë. Me mbylljen e shtigjeve kënetë e Zezë brënda dy javëve ka pér të rënë shumë dhe toka në vëndin e punimeve do të forcohet, — heshti shikoi Hekuranin që po e vështron-

te me zemërim dhe shtoi: — Shoku Hekuran duhet t'i besojë më shumë shkencës, — pastaj si u gëlltit dhe luajti pak nga vëndi vazhdoi: — Megjithëse nuk është rasti, prapë unë desha të flisja: Shoku Hekuran nuk është njëri i rregullt. Dëgjova këto ditë nga goja e një pjesëtarit të familjes së tij se ai po ngatërron njerëzit e shtëpisë së vet, për hatrin e një femre. Njeriu që s'do familjen dhe e ngatërron nuk është i aftë dhe për shoqérinë dhe edhe shoqérinë e ngatërron. Gjithë ky mendim i tij për Hürdhjet e fshehta është krijuar, se shokut Hekuran i mungon shpirti i sakrificës, ai trëmbet dhe shpiik gjëra që s'do të ndodhin. Kaq kisha shokë, mendoj ta mbylliim këtë çështje dhe të vazhdojmë punën.

Gëzimi u ul, kurse të gjithë njerëzit zhë të vështrojnë Hekuranin me një sy tjeter.

Besimi e shikonte dhe sikur s'i besohet për çfarë kish folur shefi: «Kur e paska pasur punën kësh-tu pisk pse nuk më ka thënë gjë», — mëmberiste me vete. Megjithatë u ngrit dhë shtruar e pa u nxituar tha:

— Shoke, në u futem, ose u hodhëm nga një temë në tjetren? Sot do të diskutojmë propozimin e shokut Hekuran. Unë them që këtë propozim ta shqyrtojmë si duhet dhe, përsa u përket të metave të shokut Hekuran, mund t'i shohim në një mbledhje tjeter. Desha të pyesja shokun Shef se a ë ka studjuar ai se nga hyn uji i Tërbuifit në Kënetën e Zezë.

— Po! Hyn nga fë dy dy shtigjet.

— Nuk është ashtu. Ditën kur u mbyllen shtigjet, unë vura shenje. Atje vajta sot dhe pashë se uji i Tërbuifit të madh që prej asaj qite është ulur dhe, tre gishtirinj të tjerë, kurse Kënetë e Zezë qëndron gjithmonë njësoj. Nga shkon uji i Tërbuifit?

Unë jam me shokun Hekuran. Ai më ka thënë se ka mundësi të ketë ndonjë vijë të nëndheshme që lidh të dy kënetat. Ka mundësi që kjo vijë të kalojë në Hurdhjet e fshehta. Unë mëndoj, shokë, të bëhen studime me hollësi; më me kujdes dhe, mundësish, të kërkojmë që të vijë një specialist i ujërave të nëndheshme. Në duhet t'u besojmë njerëzve që kanë jetuar kaq vjete dhe që e njohin mirë vendin dhe të mos pandehim se i dimë të gjitha.

Pas Besimit, u ngritën shumë shokë që qëndrojnë midis Hekuranit dhe sherit të kantierit, po që e akuzonin Hekuranin për një farë tronditje të nervave. Më në fund byroja mori këtë vendim:

Të bëhet një studim i ri i Hurdhjeve të fshehta, të vazhdohej puna sipas planit të aprovuar. Gjithë teknikët, dhe maqineria e tërheqjes të përgëndroheshin në rajonin e Hurdhjeve të fshehta.

Hekurani doli nga kantieri me zemër të thyer, dhe i prekur shumë në sedër.

Ekte dhe mërmëriste:

«Mos vallë në ato pak vjete vahju është lidhur dhe s'ka ndonjë rrezik? Mos ka të drejtë inxhenjeri? Kush e di?» — dhe nisi të qërtøjë yeten që u nxitua dhe që e shtroi këtë cështje me kaq forcë,

Po gjene pendohej.

«S'është e mundur, — thoshtë me vete, — Hurdhjet e fshehta kështu kanë qenë përherë, po të bjerë shi, atje bëhet det! Do djalli e mban shinë, do djalli e umbushet mëndja, se për ndryshe do na imbyten njerëzit dhe maqineria», — dhe kur përfytyronte Gëzimin që e kritikonte per punë të familjes farmakosej, zverdhej në fytyrë, pshëretintë dhe sepse i vështirosej ai njeri, që këtë radhë për të ish treguar dhe intrigant.

Besim Qolin atë natë e zuri gjumi vonë. Dy çështje i qenë ngulur në tru si gozhda në pishë. Çështja e Hekuranit dhe përiu e Gëzimit që rrinte si shef sa për emër.

Ç'të bënte me Gëzimin? Të bisedonte! Po mos vallë një herë pat kuvenduar me të? Kushedi sa herë! Kushedi sa herë i qe afruar dhe i pat dhënë të kuptonte se nuk po sillej mirë. Dhe në vend që të priste nga ai fjalë të urta, premtimë, dëgjonte t'i përgjigjej me ironi: «Posi, posa, shoku Besim» dhei e vështronte nga lart poshtë sikur të fliste me një kalama.

Me gjithë këto gjëra, prapë Besimi nuk dësh-përohej.

«Do të bëjë sa të bëjë dhe gjene ka për të ulur kokën. Ka për të punuar si duhet, ka për të kuven-duar si njeri dhe ka për fa qmuar punëtorin. Koha do ta rrahi dhe do ta argasi», — thosha me vete.

Po ja, ikën vjeshtat, iku dimiri, po iktet dhë pran-vera e Gëzimit siç kish qenë kish mbetur. I shkruante letër pas letër Ministritë për tullarguari dhe kur-merrnë përgjegje që së plotsonin dëshirën s'jal var-te dhe shoqërisë.

Nejse, kjo e keqe e fitojnë atë ikohë kuri kanali gërmohet në pjesën e poshtme, nuk dëmtonë, sepse, si brigadieri ashtu edhe eskavatoristët ishin njerëz me përvojë të madhe e kishin të qartë qdo gjë dhe punonin pa u ndalur. Porse tanë që kanali kërkonte vërtet dorën dhe mëndjen e inxhenjerit, dhe kjo do-rë e mëndje mungonte, për Sekretarin e partisë ishte një problem shumë i madhi.

«Mirë thotë Partia, se mëndjemëdhenjtë e njerëzit që i bëjnë bishë punës, sjellin po atë dëm që

sjell armiku i klasës» — mërmëristë Besimi me vete i dëshpëruar.

— Si t'ja bënte me inxhenjerin, si ta bindëte që të studionte si duhet punën e Hurdhjeve të fshehta?

— Do ta shtrëngoj! Do ta shtrëngoj! — vendoste për këtë dhe pastaj mendonte për Hekuranin. I vinte inat që ai s'i pat bërë fjalë për punë të shtëpisë e për grindjen. Nga ana tjetër i vinte inat edhe me Gëzimin përfjalët me thumba që kish thënë për Hekuranin e vriste mëndjenëtë gjente shkakun e gjithë kësaj urrejtjeje. Sigurisht që Gëzimi hakmerrej ndaj Hekuranit, sepse mëndjemëdhenjtë, kur i kritikon, po të gjetën rastin, të dërmojnë fare!

Besimin e zuri gjumi shumë vonë. Kur u ngrit u takua me brigadierin, bisedoij me të dhe shkoi në zyrën e shefit.

— Mirëmëngjesi, — e përshëndeti.

— Mirëmëngjesi, — Pse nuk ken shkuar në punë, shoku Besim; — e pyeti Gëzimi mësytë të vrejtur.

Besimi bashkoi vetullat kular dhe tha:

— Desha të bisedoja më ju.

— Me mua s'ke çfarë të bisedosh. Apo mos vallëta futi krimbin Hekurani dherty! Ai njeri duhet përzënë nga puna, se një ditë do të farmakosë gjithë kantierin.

Besimi u ngrit në këmbë.

— Dëgjo këtu, shoku Gëzim. Ngreu nga karriga dhe hajde shkojmë në punimë. Njerëzit presini nga ti, presin shumë. Kanë nevojë përditurinë tënde.

— Ju e dini, më duket, se këtu luhë jam shef dhe unë urdhëroj. Qeveria dhe partia më kanë vënë mua për këso punësh. Unë jam inxhenjer, kam diplomë për këtë gjë. Ti si parti duhet të më ndihmosh dhe të mos më ngatërrosh.

— Po të ndihmoj, shoku Gëzim, po të ndihmoj.

Po të them të shkojmë bashkë. Ti si specialist, si chef i kantierit, dhe unë si sekretar i organizates së partisë të shkojmë e të shohim punën si shkon, qfarë ndihme kërkojnë shokët, si duhet hapur kanali.

— Unë nuk vi; çdo gjë e kam të qartë. Dje isha një punime, sot kam plan pune tjeter. Po deshe të marrësh vesh se si ndodh puna, ta tregoj, që të mbledhësh mëndjen e t'u bësh agijacion edhe shokëve, se duhet besuar shkenca dhe jo fjala e një frikacaku.

Duke folur kështu, me duart që i dridheshin, nxori planin dhe skicën e Hekuranit dhe shtoi:

Urdhëro, shoku Besim, Punimet kanë shkuar gjer te Presja e dendur. A po s'është kështu? — (dhe yështroi Besimin) Is of oxordijerom. Sëri i tregoi se my Po, ja ktheu ai.

— Hekuri propozon që të kthehet kanali, këtu te Hurdhjet e dosës, që do të thotë, që të na shkojë dëm një copë kanali prej dyqind metra, i cilësi kushton shitetit me qindra mijëra lekë. Pastaj ai propozon që kanali të marre djathtas dhe të hapet rreth katërqind metra kanal i ri, që na kushtojnë miliona. Këtë gjë s'mund ta bëj unë, s'marr asnjë përgjegjësi, jo vetëm unë, po dhe shoku Hajri.

— E kë biseduar më shokun Hajri kete çështje? — Pse, ç'pandëhe ti, me kokën time i bëj unë këto!?

— Po pse nuk e bëre fjale në mbledhjen e byro-së, po vajte dhe sulmove Hekuranin?

— Këto gjëra më përkasin mua. Njerëzit që s'duan familjen unë s'dua ti shoh me sy. Ndaj ti, shoku Besim, shko në punë. Unë sot do të vete në Lushnje, kam për të takuar mbasen me Hajrinë dhe kam për të biseduar edhe një herë përpunë të Hurdhjeve.

Besimi e vështroi në sy; Mbeti një hop me dy mendje dhe pastaj foli:

— Ki kujdes, shoku shlef, ki kujdes! — tundi kokën dheniku dozi i dëshfa.

Gëzimi ngjeli duke vështruar derën që u mbyll, pastaj hodhi sytë te platti dhë te skica e Hekurianit.

— Na nxori andrallë ky f pàudhë! Sa të mbarojë ky i flamosur kanal, se më mëri shpirtin!

— Në këtij ditë nuk mund të mbarojë, këtë gjë.

Shokunib i spjatub * * * * * që këtë gjë është i fortë edhe sëmundje e shokut, që këtë gjë.

Si doli nga kantieri, Besimi shkoi në shtëpi të Shahinajve Jasharin e gjet në një shtroje dielli. Plaku e priti mirë, megjithëse jo si përkera, dhe këtë gjë Besimi e pikasi. Nekija e gështi dhe u gëzua për të sikur t'i kish vajtur ndonjë i afert i saj.

Jashari posa e pa shokun e të nipit, e kuptoi se do të kish ndonjë gjë për t'i thënë, prandaj po prishtë.

— O xha Shari, unë jam i familjes me që kam ngrënë e kam pirë në shtëpinë tuaj.

— Këtë e di zoti, o djale.

— Meqenëse jam mik, nuk më vjen mirë që të flasin poshtë e përpjetë keq, si për familjen ashtu dhe për Hekurin.

Jashari ngriti kokën, dhe lëvizi sikur e shpoi diçka.

— Mora vesh? jo vetëm unë, po një tokë njerëzish e dinë që sikur nuk shkonit mirë me Hekuranin. Kjo gjë ka hyrë në veshin e të gjithëve. Ç'ju ka bërrë Hekuri? Po pati gabuar, na thoni që ta qortojmë e ta këshillojmë.

Jashari e vështroi i vrejtur dhe po vriste mën-

djen, të gjente se cili ish, ai që kish gojasur nëpër botë punët e shtëpisë. Deshi t'i thosh Besimit që të mos ndërhynte në këto gjëra, se ish zoti vëtë t'i rregullonfe, po e kuptonte se miku, i desh, të mirën dhe për këtë të mirë qe munduar gjer tek ata.

— Dëgjo, djalë; ti je i pari njeri me, të cilin po flas për të fshehtat e mia. Puna qëndron kështu; — Jashari hodhi këmbën e mëngjér, sipër kofshës së djathtë, u kërrus, vështroi cingaren, që sa ventë di gjej dhe vazhdoi; — Riza Drenja më ka démtuar shumë. Që të mos i prisheshin bostanet e tij, ai iu mbushi mëndjen xhenjerve që për grykë kanali të përdorin Vijen e Strymit e jo të Patës. Kështu, ai u bë shkaktar që mua të më prishet kopshti. Tek ai kopsht e ka shpirtin shtëpia ime. Dhe Hekurani, sadogë, e shikonje këtë gjë, mbylli sytë dhe s'bëri gëk, sikur t'i kish bërë njeri magji. Ja, për këtë dhe jemi ngrënë.

— Po, pse mërzite, o xha Shari? Po, të të prishet kopshti do të të shpërblehet, do të cmohet dhe asgjë s'do të humbasë.

— Të gjitha këto i di unë, djalë. Qeveria më ka dhënë tokë dhe do të ma shpërblejë edhe kopshtin. Këtë gjë ma ka thënë edhe shqoja Shegë, edhe im nipi, dhe të gjithë. Po mua s'më duhen paret. Pareti një copë herë janë, kurse kopshti më mban shpirtin. Atje e kam shpresën unë. — Deshi të thoshte: «po të mos e thani dot Tërbuin, me se të rroj unë, me atë grushtin e pareve që do, të më ikin?» po nuk e tha këtë dhe vazhdoi. — Nuk më duhen lekët mua, po pemët, kopshti, me të cilin e treta jetën. Më duhet kopshti që shpresoj t'ua lë kalamajve dhe nesër ata të më thonë: «Rahmet i pastë shpirti! Punoi dhe për ne».

Jashari luajti nga vëndi, u mbështet në një

jastëk dhe përfundoi bisedën: — kështu djalë! Kësh-
tu janë punët.

Besimi tundi kokën dhe duke vështruar plakun,
thosh me vete se shoku i tij vërtet s'e paskej punën
mirë me të.

— Po për Hurdhjet e fshehta ç'di të thuash, o
xha Shari?

— Ç'di të them?! Atje do ta kini punën pisk. Po
të bjerë shi keni për të ngecur. Dhe ja, po ta them
hapur: shyqyr që filluat matanë Hurdhjeve, se po të
kishit filluar më këtë anë, kopshti do të prishej. Ta-
ni që filluat poshtë Hurdhjeve, kam shpresë se do të
më shpëtojë dhe kopshti.

— Domethënë Hurdhjet s'i kemi për t'i kapér-
cyer dot?

— Aty janë mbytur këmbësorë dhe jo gjithë ato
bina të rënda. Vëtëm po mbajti kohë, nuk të gënjej
dot, mund të kaperceni. Atëhere do ta qaj kopshtin!

— O xha Shari, po s'do ti të thahet këneta? Qysh
bën dua që të mos kapercehen Hurdhjet?

— Po të thahet këneta, hallall kopshti. Po s'ju
besoj, more djema! Nuk ishit ju që thoshit se kur të
vinë eskavatorët te Hurdhjet e fshehta, Kënetë e Ze-
zë është për t'u zhdukur brenda dy javëve? Eskava-
torët erdhën te Hurdhjet e fshehta, po Kënetë e Zezë
s'po luan! Bozhoret mbrëmje për mbrëmje bien në
foletë e tyre, e mëngjes përmëngjes ngrihen foleve
dhe shpërndahen për ushqim. S'po thahet dot Kënetë
e Zezë, që përpara Tërbu fit ajo është si një prockë
kundrejt Shkumbinit, e jo të thahet Tërbu! Ja, kë-
to gjëra më turbullojnë mua plakun kur i mendoj,
më çmëndim, more djalë. I thonë Tërbu këtij, që s'i
bënë dot gjë kaq e kaq mbretëri! Kush dreq e di se
ç'ka në fund! mund të ketë burim! disa thonë se
vendi është më i ulët se deti. Nejse, juve të ju ve-

jë mbarë. Perëndia ju ndihmoftë! Ishallah, e thani, po vetëm dhe një gjë dua t'ju them: kopshtin s'e le të ma prishni pa parë kanalin te dericka e tij. Këtë gjë ta dini, ndryshe do më merrni më qafë. — Pshestëti plaku.

— O xha Shari, unë të dëgjova gjer në fund. Tani dëgjomë edhe ti mua; Tërbufin do ta thajmë, këtë ta dish mirë si atë bukën që ha, dhe bozhoret së shpejtë do ta ndrojnë folenë. Dhe Hurdhjeve të fsheh, ta kemi për t'uaj gjetur çarenjë. Ne i kemi të gjitha. Ti the se Tërbuji s'ka pyetur përmbrerëira. Po në jemi më të fortë se mbretërit që ke njoher, ti. Më, të fortë se Italia, se Austria, e se Zogu. Ne i kemi të gjitha dhe jo Tërbufin që do ta shporrim, po edhe gjëra më të mëdha do bëjmë. Vetëm shiko, mos u nevrikos, mbaje gjakftohtesinë, se tani, në pleqëri ju dëmtohet shëndeti. Ne kemi një Parti, dhe një qeveri, tonën që s'ka përtë na lënë kurrë, në ditë të hallit. Ne, o xha Shari, kemi miq që do të na jepin qdo gjë përtë ta tharë këtë kuçedër. Dhe do ta thajmë me këto duar! Po zotrote mendohu më mirë. Përmbrerëira do të paguajë, do të japi tokë të re... ke përtë bërë shtëpi prej guri... Të gjitha ke përtë i bërë, se unë, tjetri, tjetri që kemi lënë shtëpitë tonë, po të mos bëheshin këto nuk do i knim kaq larg se, një copë bukë, do ta kishim gjetur dhe atje kufishtim e do të rrënim me gjyshërit, nënët e baba-llarët. Po jemi të sigurt se do ta thajmë Tërbufin dhe do t'i jepim lumtëri fshatarëve. Këto kisha përtë thënë, o xha Shari. Tani të më falësh. Dhe mos u mërzit, mos u nevrikos, se ti vetë më ke thënë: S'ka gjë që s'bën kjo Parti e kjo qeveri. Se janë qeveria jonë, partia jone.

Besimi u ngrit, si dha dorën xha Jasharit dhe ai e përcollë gjer te dericka.

— Brisk është nga goja, — mërmëriti plaku kur û kthye. U ul përsëri në vëndin e mëparshëm dhe nisi të mendohet pér ato që i pat thënë Besimi.

* * *

Hekurani po bindej se byroja e organizatës nuk kish faj që s'ja mori parasysh propozimin, medje ai kish nisur të kuptione se ajo pat bërë shumë që i zgjoi njerëzit të kishin mëndjeni te Hurdhjet e fshehta. Fajin pér çdo gjë ja hidhite vetes që nuk ish i zoti t'i sqaronte njerëzit. E si ta besonin atë, kur edhe Këshilli i fshatit thosh se ai s'kish të drejtë dhë po gënjenët?

Duke u ngrënë kështu me veten e tij, i delte përparà syve Rizaj dhe mërmëriste i habitur:

«Si po ibën këto marrëzira xha Rizaj? Mos u matufeps? Apo mbasë huk do t'i prishë qejfin shefit të Kantjerit?»

Sido që të ishte ky veprim i Rizajt atij s'i pëlgente dhe nisi të dyshojë pér ndershëmërinen e plakut, po gjene dhe pendohej, se e dinte që Rizaj kish bërrë shumë pér punën e përbashkët dhe, ballë kësaj punë, ai s'pat vënë gjë tjetër! Po ku e kish hallin Kryetari i këshillit që po gënjenët njerëzit! «Ku e ka hallin! Ku e ka!» — mërmëriste ngado që vinte! Më në fund vendosi të kuvëndonte me Rizanë dhe, sikur plaku të kish lajthitur, pa tjetër do t'ja mbushë të mëndjen, se nuk e kish punën në vijë.

Atë mbrëmje shkoi në këshillë. Kur hyri brenda në oborr, ndjeu një fare tronditje, se iu kujtuan fjalët që ishin hapur pér të dhe pér Selvijen. Megjithatë e mblodhi veten. Trokiti në derë dhe sa dëgjoi zënë e kryetariit, hyri brenda.

Rizaj, me të parë Hekuranim, u ngrys në fytyrë,

me vajzën. U panë sy ndér sy. Pamja e Selvijes, ftyra e hequr dhe e mallengjyer, qepallat e lagura; faqet me gjurmë lotësh, dy lot që u rrukullisën si dy kokrra breshër, flokët e pakrehur dhe fustani i vjetër që mbante në shtëpi, e ligështuan.

— Hekur, — foli vajza me një zë që shprehte vuajtje.

— Vije! — iu përgjegj Hekurani dhe u derdhë përqafoi. Me afsh tē zjarrtë i puthi buzët, menduar tē dredhura i lëmoi shpatullat. Selvija ishte diell përtë, ajo i ndriste e i ngrohte gjithë ndjenjat, si qetës sonte gjithë mendimet. Ajo lëshonte rreze jete; pranë saj shijonte gjithë bukurinë e shpirtit, gjithë bukuritë e natyrës. Kur kish atë pranë, sytë e tij çdo gjë e shikonin tē qeshur, tē güzuar. Presja, gonxhet e sambakut, prezët e diellit në perëndim, i dukeshin aq tē bukura, aq tē gjalla, aq kuqimplote sa që don-te t'i mbante gjithmonë në sy. Ajrinse mbrëmjes së ndjente aq tē paistë dhe tē freskët, sa që s'ngopej së marruri frymë. Selvija përtë ish-bukuria e izemërës së tij. Ajo i ndriçonte rrugën e jetës. Bukuria e vajzës, shpirti i saj që lamburiste çdo gjë përiethi e vishte me stoli, e bënte natyrën kopsht tē bukur, ku mund tē rrinte tē punonte pa u mërzitar, pa u lodhur dhe i qetë. — Hekur, xhan! Shpirtinim, mos mëlerë vëtëm Nuk i dot, do tē luajshmënc! Shpirti im, mos mëlerë vëtëm! — thosh vajza duke e përkëdhelur në faqe e duke e shikuar aq dhimbëshëm sa që i scopëtohej zëmra. — i orbi që nuk është emri i skenarit

— Nuk! tē ie, Vije! Qetësohut! Nuk! tē lël. Partitë s'irroj dot, — thosh i ai e i fshinte dotët, qëndur. — Hekur, qaljdet çdo natë përparrë shtëpisë, te dritarja e madhe. Të pres, xhan! të pres! — E puthi përsë dyti dhe urlaingua duke qëndur, qëndur, qëndur.

Hekurani mbeti një copë herë, të madhe me arumën e këndëshme të buzëve të vajzës, të atyre faqeve si cipa e pjeshkës e të freskëta dhe i dukej sikur duart akoma po i ledhatonin shpatullat. Një botë tjetër e rrëthonë; bota e lumturisë. Një takim e kaq gjëzime! Po sikur të jetonin bashkë? Do të ish i lumbur. Selvija ish qdo gjë për të. S'rronte dot pa Selvjen.

Hyri në ndërtesën e administratës, në koridorin e ngushtë e të errët dhe, si trokiti në derë, u fut në zyrën e shefit.

Hajde, shoku Hekuran, — e ftoi shefi. I dhanjë cigare dhe si ja ndezi, thash. — Pas dy ditësh do të fillojmë hapjen e trasesë në këtë anë të Hurdhjeve. Ne menduam, me që je vendali dhe e njeh më mirë fshatin, të punosh më buldozer për të qëruan vëndin e piketuar. Andaj, nësër në mëngjes, merr në dorëzim maqinën dhe pasnesër, fillo në Plepaj. Hekuran, posa dëgjoi se e kishin caktuar si buldozerist, iu prish gjaku. Sadoqë shefi nxori një farë shkaku, gjoja për të mos u dëshpëruar, prapë djali e kuptoi se ku i krihite çektani atij. — «Nuk më besojnë. Kujtojnë së kam frikë prandaj e bëra kaq të gjatë punën e Hurdhjeve».

U ngrit dhe, para se të delte, shojti cigaren, e shkeli me këmbë dhe, me kokë të ulur, doli përjashta. Ekte si i vrarë e si i habitur. Tani i duhej të luftonte jo vetëm për të shpëtuar shokët, por dhe për të vënë në vend nderin.

Habitej me qëndrimin e Gëzimit dhe i vinte inat. Gjithfarë mendimesh i avërtiteshin në kokë. —

Herë herë, shoshti si shefi nuk e besonte, pasi nuk ja tregonte dot si duhej shkakun e bellimit të vahut. Herë herë mendonte se shefi mund të ishte armik dhe donte të prishet pune me qëllimet e cakq

tuara. Por sido që t'ishte, Hekurani që i sigurtë se maqineritë, që të futeshin atje ku thosh shefi i kantjerit, do të fundoseshin e shokët do ishin në rrezik të mbyteshin. Prandaj shfrynte me vete kundra atij inxhenjeri aqë mëndjemadh.

«Mirë ai, po Hajriu ç'bënte? — dhe kur mendonte për Hajrinë i mbushëj koka se ai nuk ishte i zoti t'u spjegonte si duhej se si bëhej hollimi i vahut. Dhe s'kish si ta besonin gjersa vahu mbante akoma e gjersa inxhenjeri me kalem në dorë ngulite këmbë e thoshte se puna do të delte me faqe të bardhë. Mirë i kishte thënë xha Rizaj: «tani ë ka fjalën kalem». —

«Kalemi është kalem, po dhe unë is'gjenjeja Inxhenjeri gabon» — tha me vete i vendosur në të së jën dhe hyri në shtëpisë. Në këtë kohë kishte më

Me të vënë këmbën në konak, në dritën e kandilit, pa gjithë njerëzit e shtëpisë që rrinin të hidhëruar sikur t'i kish vdekuri një. Jasharisqës i struktur në qoshe, kish mbështetur ballin në dorën e djathtë dhe dukej sikur vajtonë. Azizi pati vaturi shpatullat dhe duke shpërdredhur një fije kashtë, mbante sytë përdhë në penien e gërshtuar të rrogozi. E këma, të cilën e shikoit drejt nës së, ish zverdhur e qe bërë si ndonjë ftua i pjekur. Bulja e kundroi me ca së të djallëzuar e të ndezur.

Hekurani bëri sikur s'kuptoi gjë. Usul në vëndin e zakonshëm, hoqi çorapet e grisura në thembër dhe i vërviti në fund të konakut. Ç'kish ndodhur që paturenë ajo hie e nuk bëshme në shtëpinë e Shahinajve?

Lajmi se do të prisheshin gardhet dhe se do të fillonte pastrimi në vëndin ku që piketuar kanali qe përhapur me shpejtësi të madhe asaj pasdrekeje. Jasharit ky lajm i që ngulur si thikë në zémër.

— O bopo! Më iku kopshti! I ziu unë! I ziu unë!
— kish thënë duke vënë duart në kokë e duke ecur poshtë e përpjetë oborrit. Graria e vështronin dhe s'kishin guxuar të hapnin gojën. Të vegjëlit qenë dredhur nga frika, e kishin rënëtë flinin pa perënduar dielli. Jashari që bërë tamam si i shkallmuar. Asgjë s'e përbante. Më në fund kishte marrë shkopin; kish dalë në rrugicën kryesore dhe duke ecur kuturu, kish hyrë në oborrin e Këshillit. Kur kish parë derën kyçur me një dry të madh, e kishte zë-në kyçin me të dy duart, e kish përplasur pas dërrasës dhe kish shkrofëtitur: «Qen e bir qeni!» paditur as ai kujt i kërcënohej dhe qe kthyer në shtëpi. Atje kish ndenjur shtrirë gjersat kish perënduar dielli, pastaj ish ngritur ish pështetur pas murit dhe kish vënë dorën në ballë. Kur kish ardhur i biri as që e kish ngritur kokëri, po ashtu bëri edhe kur hyri i nipi. Njihuni! Hekurani e vështroi, deshi të hapte muhabet, po përtej e ëma i jeptë shënje që të heshtëte.

— C'vështron ashtu si lugat, — ja pat më në fund Azizi, — je komunist përbotëm ti, hairsës? Hekurani shqeu sytë il habitur, i kurse Jashari s'luajti nga vendi dhe kjo i adha kurajë Azizit që të vazhdonte.

— Pse s'e hap gojën, apo ke frikë mos të merr dhenë qelbësira që ke në bark? Hekurani ngrysni vetullat, po vështrimi lutësi s'ëmës e qetësoi.

— Nga ti e nga ai i poshtër i kemi të gjitha këto, kokërosaku i drejtë, — shtoi Azizi duke luajtur nga vëndi.

Hekurani nixori pak gjoksin përpara, kapsiti sytë dhe ia kïtheu me zë të qetë;

— Mirë mua më shan, po me babën ç'ke?

Jashari iu drodh dora: *

Azizi mbajti frym n dhe v shtroi t an , pastaj hodhi syt  e kuq te i nipi...
Ti jem iavje, i pabes , p r hatrim e bot s po shet o sht epin . Nuk t  shkojn  k to, nuk i mbulohet ujet me irrijet . Po t  doje ti, q esi t  t  them, nuk b heshin k to q e pomb hen; kush e d gjon at  tri-peshkun para teje? Asnj . S ka f j njeri p r pun  t  kopshtit. Kot i bin m  qaf  xha Rizaj! C kujtuat ju, se jan  budaz H enj bota q e t  heq  Rizaj nga hunda? Planive desh q e kanali t  shkonte te Vija e Strymit dhe atje po shkom:

— He, hé, more mirë tê thema nñé kokérosak:
Rizaj, jo i vjetém që po si têrheq atá përhunde, po edhe
ty. I lumtë, i shpëtës bostanet! Kurse t... — part'anë
që slluante nga vendi, — kurse t... shikò e lajkatoje.
Eçë, se e bija ta luajti çakën. Kërkoni dhe tê fejo-
hesh y e ta bijesh në shtëpi ëndrr. Telleqep...
Jashari, miashtroi më filim. Hekuramini, pastaj
Azizin e tê dy gratë dhe iu shkreh tê nipiitë nily...
Ndaj tis'e çave kokën, gjidi edepsës, ndaj ti
natiimbake i kaba atij... U ingritë më këmbë, shkod-
si i pirët dhë e zuri tê nipiin prej e jake... Folë! Folët
Folë!

Hekurani ngriti kokën dhe e vështroi i qetë e i menduar sikur t'i tregonte se nuk i limin aspak mbresë fjalët e tij. Nga at qumëm i kishte qenë
dhe — Na, qenë — thirri plaku dhe ja veshi fytyrës.
— Sa të jem unë gjallë nuk shkel këmbë. Drenjallari
këtu bëj asenitës nga tifalla e qendrohet. Dëshiron
Hekurani psherët iu, u ngriti, e pa dhe një herë
të gjyshin, tundi kokën dhe mërmëriti. Dëshiron
Kjo mëndje ju ka lënë prapa, — Pastaj doli
në oborr, e ngra obotri më rrugën kryesore.

* * *

Nekija e kuptoi që pa ardhur Hekurani se do të përciste sheri, por s'kish q'të bënte. Kur u ngrit i vjehri e i ra të birit, ajo u pështet pas murit dhe kur doli ai përjashta zuri të lëshohej gjersa u pllatit përdhe. Në këtë kohë vështronë njerëzit, që sa vinte i humbisnin nga sytë sikur t'i mbështillte një mjer-gull gjithnjë e më e dëndur. Më në fund, gjithçka përreth iu bë tym. Po edhe në atë gjëndje që ish iu përfytyrua Hekurani, iu duk sikur e puthi të birin dhe buzët e venitura i qeshën, kurse në fytyrë i ra një nur i bukur. Kur shkoi Bulja dhe i pa fytyrën si lejmon, u drodh e bërtiti sa kish në kokë:

— Qyqja, vdiq Nekija! — Duke u dredhur, saj doli në oborr e thirri fqinjet:

Nekijes i kishi rënënjë fytyrë e vajtueshmë. Djersë të ffohta e mbulonim ballët. Buzët i qenë pu-qur lehtë, qepallat i mbante imbyllur dhe fytyra e saj e fishkur që e venitur, por e qetë, pa as më të voglin shëmtimi.

Fqinjet që ngritën, e shtrinë në një rrrobë në dhomën e zjarrit dhe, si e rregulluan mirë e mirësi ndenjën të koka me frikë në zëmër përfatin e saj.

Jashari kish mbetur te vëndi. Azizi e mori përkrahur dhe e shpuri në qoshe. Dëgjonte që në odën tjetër lëviznin njerëz, dëgjontë zërat që thoshin se Nekija kish vdekur, po s'luajti nga shtresat, jo psë s'donte të vinte të shihte, po psë s'mundëte. Dridhej i téri sa që i kërcisin dhe dhëmbët.

Vonë sikur e mblođhi vëten. U ngrit ngadalë, duke u mbajtur te i biri, dhe shkoi e pa gruan që

s'jepte asnë shënjë jete. U kthyë përsëri në buxha-kun e tij, vuri duart në kokë e u shtri sikur të rrëzohej ndonjë trung. Nisi të qajë e të përpëlitez. Don-te të dilte nga pellgu ku kish rënë, po s'mundte, s'kish fuqi.

Hekurani dëgjoi britmën e Bules, u kthyë më të shpejtë dhe bërtiti:

— Mome! Mome!

— Shkoi i puthi s'ëmës fytyrën me afshin e fëmijës kur sheh t'ëmën në rrëzik, e përkëdheli, i fliste fjalë që i prekën në zemër të gjithë sa ishin atje dhe më në fund u ngrit si i dehur. Një rrymë e ftohtë i përshkoi dejet. Gjithë hidhërimi iu kthyë në urrejtje për njerëzit që ishin bërë shkaktarë të vdekjes së t'ëmës. Kush ishte shkaktari? I gjyshi, — mendoi pa u thelluar. Hyri në odë me qëllim që t'i fliste, ta shante, ta telendiste, po ngriu në vend. Jashari ish shumë i dëshpëruar. Fytyra me pikat e holla të djersës, gjëndja e kobëshme, i dhanë të kuptonte se plaku s'ndjehej mirë.

Doli nga dera kokëlur dhe shkoi ndenji mbi një kërcu, larg syve të botës. Nga kodrat e Golemit doli hëna që pasqyronte në kënetë fytyrën e saj të plotë. Hëna, si gjithmonë, llamburiste e gëzuar dhe e qetë. Ajo as që mallëngjehej me fatin e me vuajtjet e tij.

I shikonte të gjitha këto dhe sepse i dukej sikur ish futur në Tërbuf në netët më të errëta. I dukej vetja aq e vogël, punët dhe dashuria aq të kota sa që ndjente se në kraharorin e tij s'kish më zëmër. Nga që s'rrinte dot duke vështruar qiellin, u kthyë përmbyss.

Një zë i fortë që i erdhi nga shtëpia, e shkundi. U ngrit në këmbë dhe, gjithnjë si ndonjë i pirë, mori rrugën të shikonte përsë e kërkonin.

Nekija rrinte shtrirë. Mbante sytë mbyllur, pa nxjerrë nga goja as ankinin më tē vogël. Tē gjithë kujtonin se kish vdekur. Nuk lëvizte, zémra i rrihte aq ngadalë sa që vetäm mjeku mund ta diktonte se punonte akoma. Si ndonjë shqerrë e urtë, e plagosur pér vdekje, qëndronte si ta rrutullonin njerëzit. Kish hyrë nē një vënd që dhe vetë s'e kuptonte, ish kredhur nē një mjergull që s'e linte as tē shikonte, as tē dëgjonte gjë. Po edhe nē atë gjëndje ajo mundi tē përbledhë gjithë fuqitë e tē mbajë nē sy Hekuranin. S'donte tē vdiste, se e dinte që i biri do tē ngelte vetäm, pa krahë, jetim. Duke përfytruar si nē èndër djalin e saj, dalëngadalë zuri tē marrë veten. Donte ta përqafonte, t'i thosh fjalë tē èmbla, ta pushtonte, po s'arrinte dot, se diç e ndalonte. Përpiquej me mish e me shpirt, jepte e merrte gjersa më nē fund çau mjergullén, hapi sytë dhe vështroi pérreth.

— Hekur! Hekur! — foli duke vështruar me sytë perënduar.

Në tē ndarën u bë zhurmë. U dëgjuan zëra.

— Qënka gjallë! Qënka gjallë! — pastaj u ndienjë zë burri:

— Hekur, o Hekur! — Ky zë ushtoi aq fort sa që e solli nē vete djalin e kredhur nē mendime atje jashtë nē oborr ku pat rënë përbys.

— Të kërkon moma! — tha burri posa e pa.

Hekurani shqeу sytë e hyri me furi. Ndenji më këmbë, vështroi t'ëmën dherendi e përqafoi e e puthi duke u ngashëryer.

Smoreci është era e detit. Katundet rrëth Tërbu fit e zënë në gojë me llahtarë këtë erë. Kur frys smoreci gllabëron çdo gjë që gjen përpara, rrëmbe n varkat e peshkatarëve, kocet, zbulon kasollet dhe, po të zuri duke lundruar, duhet të jesh shumë i zoti t'i bësh ballë. Kjo erë ka mbytur shumë peshkatarë, se vjen papritur. Pak para se të fryjë smoreci qelli vrenjtë, ajri është i lagësht dhe kudo mbretëron qetësi; pastaj papandehur dëgjohet një zhurmë e largët; sipërfaqja e ujit zë lëviz e pas pâk fillon furtuna. Dallgët ngrihen, përplasen me njëra tjetër, hapin kreshtat e bardha dhe shkërmogen ujët si kokrra breshëri. Valët përplasen në breg me furri, duke hedhur në tokë vidra dhe peshq të mëdhenj. Dendur ato shkëpusin vahe që lundrojnë gjersa bashkohen me presjen.

Një furtunë të tillë kaluan Shahinajt. Familja sikur ish qetësuar, po prapë të gjithë qëndronin me zëmër të dredhur e me frikë se mos përsëritezhe shëri.

Tërbu fi, pas smorecit, kur rrinë retë pezull si pastëрма, kur të mbyt zagushia dhe deti gjëmon, u kall frikën peshkatarëve. Ata e dinë se atë që s'mundi të bënte smoreci i parë, do ta bëjë i dyti: kasollet e tyre do të shkallmohen, kocat në shtigje do të pri shen dhe vaj hallit. Në shtëpinë e Shahinajve retë e zeza rrinin pezull, dëndur dëgjohej vërvshëllima. Kish pllakosur një qetësi e madhe dhe gjithkush punonte urt' e butë duke vështruar dëndur plakun. Kyçi i gjithë trazirës qëndronte në duart e këtij.

Atë mëngjes Jashari dukej më mirë dhe u ngrit. Bulja donte ta mbante për krahu, po ai e shikoi aq ashpër sa që e trëmbi. Plaku shkoi duke u pështe-

tur me shkop dhe ndenji pranë gruas së shtrirë që ende s'e kish marrë veten.

— Si duke, bij' e babajt? — i tha Nekijes për të parën herë në jetë dhe i përkëdheli fytyrën.

— Mirë, lalë! po pse u ngrite zotrote?

Jashari e vështroi me dhëmshuri.

«Qëngj i butë», — mërmëriti dhe shtoi: — Mos u mërzit, moj bijë, shërohu, të keqen lala.

Nekija búzëqeshi. Nuk priste të dëgjonte të tilla fjalë nga i vjehri.

— Dëgjo, unë i thashë Miniresë të të marrë cadi. Shko, bijë e lalës, se andej do shplodhesh.

— Si të doni, lalë.

Jashari u ngrit, urdhëroi të mbrehnin buajt dhe, si u bënë gati, e poqi me Nekijen e me të dhëndërin e i nisi. Qëndroi një copë herë më këmbë, gjersa qerrja u kthye përtej Shelgut të Lumturisë dhe, kur i humbi nga sytë, u ul me fytyrë të ngrysur në një rogoz të shtruar pranë koçekut, mbushi çibukun dhe, kur dëgjoi cicërimën e drisakëve, ngriti kokën: Fytyra iu çel dhe sytë iu mbërthyen te zogjtë.

Ndenji edhe pak duke kruar perçet e dashit që i rrinte pranë e duke ndjerë rrezet e diellit pranveror që atë ditë ishin bërë më të nxehtha. Më në fund vendosi të shkonte nga kopshti.

Turbullimi dhe sëmundja e Nekijes e kishin bërrë Jasharin si të ngrirë; kurse hidhërimi për kopshatin e kish shushatur. Fajin për të gjitha këto ngjarje ja kish vënë Rizajt, po qëkur kish marrë vesh se i nipi donte të bijën e tij dhe s'çalltiste për shtëpi, ja kish hedhur edhe Hekuranit. Djali i qe ftohur, s'donte t'i rrinte afër, ta shihte e të kuvëndonte me të. Kur e kish pranë, i vinte ta shante e ta sikteriste, po gjene e mbante veten, se i kujtohej e sëmura, të ci-

lén e adhuronte pér sjelljet e saj tē mira dhé e dohi te me shpirt.

Kur përccoli Nekijen, iu duk sikur u lehtësua, sikur iu zgjidhën duart nga prangat.

Ekte rrugës, duke lénë në pluhur gjurmët e gozhdëve të këpucëve. Hapi i tij i ngadalshëm dhe i përtuar, shpatullat më tē varura se zakonisht, fytyra e hequr, e parruar, dhe sytë e lodhur po tē ndezur, me qepallat që përpéliteshin, tregonin jo vetëm dëshpërimin e tij, po edhe mërinë e madhe që i ziente përbrënda. Po i prishnin pemët pa tē drejtë, pér hattrin e Rizajt, që t'i shpëtonin bostanet atij.

Hyri në kopësht dhe, herë zinte ngadalë trungjet e fiqve dhe i ledhatonte, herë fletët e dardhavë e herë mollët e pabëra, tē mbështjella me një push tē imtë. Më në fund qëndroi pranë një mani dhe e vështroi me kujdes. Ky ish babai i kopshtit. Iu kujtua kur e kish mbjellë. Shumë kohë kishin kaluar që atëhere! Më shumë se dyzet vjet. Dyzet e ca vjet, po bëri kopsht pér tē qënë, e do t'u linte fëmijëve, nipërve e stërnipërvë pemë, që, kur t'i hanin, tē kujtonin babagjyshin e tē thoshin:

«Rahmet i pastë shpirti, punoi edhe pér ne».

Tani kopshti po i ikte papritur e pakujtuar, se ashtu i donte qejfi Rizajt,

Përfytyronte fytyrën e tij ədhe sa s'qmëndejej.

«I lumtë Rizajt, se na e hodhi mirë! Kopshtin po ma prish dhe sherrin ma mbolli në shtëpi!»

U ul në hie, se nisën t'i dridhen këmbët. Sa nxori çibukun, përtej dëgjoi zhurmën e buldozerit, u zverdh dhe çibuku i ra nga dora. Ushëtimi është magjinesë i kumboi e kobëshme e me llahtarë në vesh sikur t'i thoshte: «Të ardhì fundi, do tē vdesësh».

Tek rrinte duke dëgjuar zhurmën e buldozerit i

bëhej sikur ajo sa vinte e bëhej më e fuqishme. Më në fund iu bë sikur luajti gardhi. I ngriu gjaku. Për-pëliti qepallat, gjoja për të vështruar më mirë. Po gardhi luajti për së dyti, pastaj presja e buldozerit e vërviti përtøj. Plaku e vështronte duke zgurdulluar sytë. Pemët iu rrutulluan majtas, djathtas. U mbajt te trungu dhe, duke mos e pasur veten në dorë, thirri me sà fuqi që kish:

— Nuk të le! Nuk të le! — dhe u turr përpara ballë përballë maqinës.

— Ndal! Ndal! — bërtiti dhe i ra maqinës me këkën e shkopit sa iu thye. — Ndal! — thirri dhe një herë dhe iu shtri përpara buldozerit. — Nuk të le të ma prishësh kopshtin, qën bir qeni, jo, s'të le! — dhe, i shtrirë në brinjë, vështronte presjen e maqinës dhe i thërriste atij që punonte: — Ngaje nxirrmi zorrët! S'të le të na prishësh kopshtin!»

Buldozeri qëndroi. Hekurani u hodh përdhe me fytyrë dyllë të verdhë. Shikonte gjyshim që ish laparosur, që s'kish ndryshim nga një i marrë dhe një frikë e madhe i hyri në zemër.

— Ndihamomë ta ngremë, — i tha shokut që e shoqëronte dhe e kapi për krahu.

— Lëshomëni, qenër, lëshomëni! — thërriste plaku duke u përpëlitur, pa ditur se kush e ngriti. Zuri t'i çjerrë, t'u bjerë me shkelma. E nxuarën nga kopshti me mundim të madh. Te dera e shtëpisë thirri dhe një herë si i tërbuar.

Hekurani e mbante dhe e vështronte.

— Mbahu, lale, mbahu! — nisi t'i flasë.

E shpunë në shtëpi, e shtrinë te buxhaku dhe e lanë të qetë.

Jashari s'dinte se ku ishte. Bota i që bërë e trubullit, sa që s'ish i zoti të vështronte asgjë për rrëth.

Dielli po perëndonte. Qielli ish i kthjellët. Dy bardhoshe ciceronin në majë të rravit. Një shqiponjë fluturonte një me presjen. Nëpër rrugët e fshatit kish lëvizje. Lopçari thërriste të zotët e lopëve të merrnin kafshët. Një sopatë dëgjohej te Skela e Pendëkuqit, kërkëllimat e qerreve futeshin në korin e mbrëmjes së Plepajt.

Azizi hyri në oborr, po kur pa se s'po i dilte njeri ta priste, la hostemin dhe, pa u hequr buajve zgjedhën, u turr brënda.

— C'është kështu? — pyeti dhe ndenji në vënd duke parë t'anë të fliste përcart.

Hodhi sytë rretheqark dhe vështroi fytyrat e pikëlluara të njerëzve. Çdo gjë iu duk e zezë; edhe sytë e dashit, që rrinte pranë të zotit, iu dukën sikur qanin.

U ul pranë t'et dhe e thirri disa herë, po më kot. I vuri dorën në kokë dhe ndjeu t'i lagej me djersë.

— C'pati? — pyeti duke kthyer kokën nga e shoqja.

— Për kopshtin; ma e prishën gardhin; po na shkulin pemët.

Azizi shtrëngoinofullat, shqeu sytë me egërsi dhe u ngrit menjëherë më këmbë. Shkoi, u hoqi zgjedhën buajve, i futi në kasolle dhe, nga të shastisurit, s'u hodhi as për të ngrënë.

Shkoi përsëri pranë t'et. Sa më shumë që e shikonte, aq më fort hidhërohej, aq më tepër turbullohej, aq më shumë i shtohej urrejtja për Rizanë. Sa herë që i ati rënkonte, i dukej sikur i ngulej një thi-kë në zemër. Dhemshuria për babamë dhe dëshpërimi për rrënimin e kopshtit e kishin bërë që të mos

mendonte gjë tjetër, veçse si të hakmerrej pér këtë gjëmë të madhe. I ati nisi të flasë.

S'ta le kopshtin, qen bir qeni! S'ta le... Na shkretove shtëpinë, zagar!... Na hëngre kokën!...

S'iu durua. U ngrit në këmbë, doli në oborr, hoqi një hu gardhi, e hyri në oborr të Rizajt.

— Thirrma tét atë, — i tha Selvijes.

Rizaj doli duke mbajtur në krah xhaketën.

— Do të vish brënda? — e pyeti.

Azizi s'iu përgjegjë ngriti, drunë që e mbante fshehur pas kofshës së djathë dhe ja këputi në supin e majtë.

— Aaaa! — ja bëri Selvija me sa kish fuqi, — më vranë babanë! Më vranë babanë! — dhe mbronte t'anë me trupin e saj.

Azizi donte t'i binte pér së dyti, po u nda nga llahtara e vajzës. Me drunë në dorë kapérxeu oborrin dhe mori rrugën e shtëpisë, më i lehtësuar.

Lajmin pér rrahen e Rizajt e mori vesh gjithë fshati. Anëtarët e Këshillit i shkuant kryetarit në shtëpi, po kur e panë se supi i kish pësuar vetëm një plagë të vogël, u qetësuan. Të gjithë ishin gati që punën e Azizit ta çonin në gjyq.

— Lereni mos e ngani, o shokë, s'pësova gjë të madhe. Ai këtë e bëri nga budallallëku. I marri bën ç't'i vijë ndoresh. E kush s'e njeh Azizin! — me këto fjalë i qetësonte Rizaj shokët.

Kur kthehej nga puna Hekurani, dielli kish përenduar. Ai kish vendosur që atë natë të vinte të takohet me Selvijen. Prej ditës që ishin hapur fjalët pér ta në fshat, veç mbrëmjes që i premtoi se do t'i

* * *

shkontakte, nuk e kish parë e as kish kuvënduar me të. Ja kishin prishur mëndjen Hurdhjet e fshehta dhe herë i delte përpara një fatkeqësi, herë një tjetër. Donte të takohej me vajzë atë mbrëmje kur e transferuan nga eskavatorist si buldozerist, po s'e la sherri me gjyshin; kurse mbrëmjet e tjera s'e pat lënë sëmundja e s'ëmës dhe një tok halle të tjera.

— Po na shkon ters, moj Vije, — thosh me vete.

— Atë mbrëmje, megjithëse Jashari s'ish mirë, donte të takohej, nuk duronte dot më. Do të takohej dhe sado telashe që t'i delnin; paskëtaj s'do ta linte më vetëm.

Ekte me këto mendime duke shijuar aromat kundërmonjëse të parfumeve pranverore.

— O Hekur, — dëgjoi një zë.

Djali mbajti këmbët dhe njoihu një nga anëtarët e Këshillit.

— Mirë mbrëma, — e përshtëndeti.

— Mirë mbrëma, — ja ktheu fshatari dhe shtoi,

— More Hekur, ç'po bëhet kështu në fshatin tonë? Ngrihet xhaxhaj yt e rreh Kryetarin e Këshillit! Ku është dëgjuar kjo? Vetëm kulakët bëjnë kështu, o djalë, dëgjove? kulakët! Ktheje në rrugë të drejtë xhaxhanë, se je dhe komunist dhe s'i kanë lezet derës suaj këto marrëzira.

Hekuranit iu duk sikur iu hap dhei dhe e përpjui. Pshëri iu. S'foli, po vijoi rrugën më shpejt. Hyri në shtëpi tërë duf, e gjeti të gjyshin që fliste përcart. Shkoi në të ndarën tjetër dhe pa xhaxhanë që rrinte këmbëkryq. Ai e pa me sy të skuqur si të ujkut.

Shtrëngoi nofullat dhe e kapi prej supit:

— Ç'bëre ti, o kokëkrisur!

Bulja brofi më këmbë me llahtari, se e pikasi që Hekurani ish nxehur shumë. Azizit iu rrutullua

bota, i përcëllói kërca e hundës dhe ja hoqi dorën me fuqi.

— Shko ulu aty, mavje!

— Ty të them, ç'bëre?! — Ngriti zérin Hekurani.

— Të rrasha t'ët vjehër, edepsës!

— Rrahe kryetarin e këshillit, kulak i fëlliçur! — ja priti Hekurani me të madhe.

Azizi u gjend më këmbë.

— Turp të kesh! — shtoi Hekurani, — turp; ma quan veten dhe vëlla dëshmori!

Azizi e zuri për jake.

— Do ta mbyllësh buçen, apo si e ke hallin?!

— Lëshomë, se s'jam Rizaj unë, ç'pandehe ti, apo të ka marrë malli për ndonjë kopaçe, kulak!

— U! plëncderr, mua të më heqësh kopaçe ti? — dhe ja veshi me pëllëmbë syve.

Hekurani ndenji nji hop si i shushatur. Mbërtëu vetullat dhe ja këputi me një grusht, sa që Azizi u pérplas tutje si thes. Fshatari u mat të ngrihej e t'i binte me kaci, po Hekurani ja këputi dhe me një grusht tjetër dhe doli.

— Dëgjo këtu ti, mace, — i thirri Bules në ecje e sipër, — t'i thuash t'ët shoqi dhe t'ët vjehéri, se s'kam për të shkelur më në shtëpinë e tyre, dëgjove?! S'rroj dot me kulakë dhe me njerëz të krimbur!

— Dhe nxitoi çapin, hyri në errësirën e mbrëmjes e bëri për në kantjer.

VI

Riza Drenja në fillim nuk i dha rëndësi punës së Selvijes. E dintë që fjalët hapeshin shpejt, sikur dhe gjëja më e vogël të ndodhtë midis një djali e një vajze. Si dënim për të bijën, kish vëndoşur të mos i fliste disa ditë, që ajo të kuptonte, se e zemëronte

dhe e hidhëronte t'anë me këto që bënte. Më vonë ai kuptoi se kish vepruar gabim, sepse nuk i kish çmuar si duhej ato fjälë që ishin hapur. Selvija sa vinte dobësohej nga shëndeti. Rizajt i hipi frika se mos i ikte çupa nga duart dhe dhimbja për të e mundi forcën e zakonit. Për atë që më mirë ta martonte cupën me Hekuranin se sa t'i vdiste. Por nuk varej qdo gjë nga duart e tija. Martesa e Selvijes me Hekuranin ish edhe në dorë të Jasharit. Kështu që Rizajt ish në gjendje të vështirë. S'dinte si të vepronente. Shikonte vajzën që hiqej e tretej si në thonjtë e kuçedrës, dhe s'ish i zoti t'i vinte në ndihmë.

Kish menduar të shkonte të bisedonte me Jasharin, po e dinte se ai do të hapte muhabetin e kopshtit e do të bëhej sherri sherr. Për këtë ish më se i sigurt. Vinte vërdallë me mënd e pa mënd, pa vënë re punët e shtëpisë e të kopshtit që duhej mbjellë e që e kish pasur aq qejf. Jo, asgjë s'i hynte në sy. Halli e derti e kishin mybytur gjer në fyt e s'po e lëshonin.

Atë mbrëmje hyri në shtëpi si më i lëhtesar, Në oborr takoi të motrën që e zuri për mëngë.

— Riza, të thashë unë, po ti s'më zure' besë. I kanë bërë magji çupës, i kanë bërë magji, ajo shtërga Bule. Tani sa erdha nga tetë Katja, në syt'e, mi ja prishi magjinë. Na shpëtoi çupa! Ja, ke për të parë.

— Mirë, moj motër, mirë të qoftë goja mjaltë, — dhe hyri brënda me kujdes, u fut në dhomë. Selvija, siç rrinte me sytë të mbërthyer në një pikë të padukëshme, kur pa t'anë, buzëqeshi e u ngrit nga vëndi.

— Ulu, çupëz, ulu; — dhe oj vështroi fytyrën e hequr me mollëzat e faqeve të zverdhura. Vajza pa plakuri me sy, të mjerë dhe i erdhë shumë keq.

— Baba, ke kohë që ishë pirë; hidh një gotë sonde. Unë të kam bërë meze; thera një zog.

Rizaj buzëqeshi.

— Mirë, shko më sill mezenë, — i tha e pshërëtiu fort.

Rizaj nisi të pijë. Selvija e vështronte e kënaqur. Pranë t'et ishte më ndryshe. Dukej tjetër njeri.

Në qoshe të dhomës frinte e motra e Rizajt e cila hiqte tespitë, vështronte të mbesën dhe mërmëriste me vete:

— Ta prisha magjinë; tani do jesh si më parë. çupë shtëpie me halle.

Qetësia që mbretëronte në dhomë i ngjante qetësisë së ditëve të verës, kur ndrit dielli, natyra duket si në gjumë dhe s'fryr e s'pipëtin gjë prej gjëje. Disa të trokitura në derë e thyen heshtjen ashtu si prishin bubullimat qetësinë e ditëve të bukura. Selvija u ngrit dhe hapi derën. Përpara i dolli Azizi që kërkonte Rizanë. Qetësia e ëmbël e asaj mbrëmjeje, te Drenjallarët, u kthye në një gjendje të kobëshme. Rizaj, i goditür nga Azizi, u shtri sa gjatë gjëre i vilanosur. E bija sa s'luanë nga mëntë. Ajo i fërkonte babait duart dhe e thërriste e lebetitej. Kur erdhi Rizaj në vete, Selvija sikur u qetësua, i hoqi t'et xhaketën, pastaj këmishën dhe i pa shpatullën që i nxinte. U llahtarës, po prapë e mbajti veten. Vuri në vendin e plagës lecka të lagura me ujë të ftohët dhe qëndroi pranë t'et me buzët që i dridheshin dhe e mbushur me urrejtje. Herë pas here mendonte për Hekuranin dhe thosh:

«Si i la Hekurani punët gjer në rrahje? Ah, mëre Hekur, si u bë kjo punë kështu, si do të bëhesh ti imi, si?! C'do të më thotë babaj, c'do të thonë botë? Shkoi e mori të nipin e atij që i rrahu babanë! Më vrave, Hekur, edhe sikur të mos kesh-faj, më

vravel — Dhe nga që s'e mbante dot veten, u ngrit e shkoi në vëndin e saj. Atje ndenji pa gjumë, e mbledhur kruspull, me kokën pështetur të gjunjët, gjersa kaloi mesi i natës.

* * *

Gjithë sa ngjanë në familje dhe në punën e tij, e kishin dëshpëruar shumë Hekuranin. Nga shtëpia kish ikur dhe tani jetonte në kantjer, po edhe këtu i dukej sikur ish si në ato mëngjeset e ftohtë kur pret në Hurdhje pa shpresë se do të gjuash. Të gjithë, veç disa shokëve, e vështronin me mospërfillje dhe atij i dukej sikur i thoshin:

«Ikë, ore frikacak, vajte na shpife lloj lloj prof-kash nga frika».

Këto gjëra e patën futur në një rrugë pa krye. S'i bënin duart për punë dhe kish ditë që jo vetëm s'e kalonte normën, po as nuk arrinte të plotësonë. Dendur ulej pranë buldozerit, shtrihej dhe, me sy të trishtuar e të ngulur në një pikë, humbiste në mendime.

Çdo gjë që medonte i dukej sikur ish kundër tij, si në shtëpi ashtu dhe në kantjer. Vetëm Selvija i dukej se ish me të. Sadoqë një natë më parë xhaja i rrahu t'anë, ai vendosi të shkonte e të takohej. Vajti afër shtëpisë, iu afrua dritares, përgjoi një copë herë të madhe, shkoi pak më tej dhe, duke vërvshellyer, këndoi këngën e Selvijes, po më kot. Vajza nuk i dolli. Kjo gjë e dëshpëroi.

«Edhe Selvija qënka kundër meje», — mërmëriti në kulmin e dëshpërimit, dhe nga që s'dinte se ç'të bënte, shkoi te Shelgu i Lumtërisë e ndenji në bre-gun gëlqeror të kënetës. Ndezi një cigare dhe mërmëriti i qetë.

«Të gjitha do të rregullohen; e vërteta nuk humbet».

Një bubullimë që erdhi nga përendimi, sikur miretai mendimin e tij. Bubullima e shqetësoi Hekuranin. Djali u ngrit më këmbë, pa se një re e zezë po përhapej në gjithë qellin dhe sa vinte mbledhëtë në prehërin e saj yjet që xixëllonin me frikë.

«Po fillojnë shirat, më duket» — dhe përnjëherë mëndja i shkoi te Hurdhjet e fshehta: shqetësimi i tij që ish mbuluar si me hi, ja ngjethi gjithë trupin si koren elektrik.

«Hekur», — i tha vetëvetes «duhet të luftosh, që të shpëtosh maqinerinë! more vesh? që nesër të shkosh në Komitetin e Partisë, që nesër!» dhe u ngrit me rrëmbim e mori rrugën për në kantjer.

Qelli u mbush me re. Era, që frynte si më nge, i shtynte retë nga lindja. Një re e zezë që shtrinte një bisht si të dhelprës, lëvizte rëndë rëndë si të mos çante kokën për erën.

Hekurani kish shkuar që në mëngjes në Hurdhjet e fshehta, rrinte me zemër të thyer, shifonte vahun, ngulte në të shkopinj të gjatë dhe kur e kur ngrinte kokën nga qelli.

— Hekuran, c'bën këshfu? Pse nuk ke shkuar në punë? — e pyeti i habitur Besimi.

— Po provoj vahun, shoku sekretar. Pa shiko, po vjen smoreci, më duket.

Besimi e vështroi, tundi kokën dhe, për t'i dhënë zemër, e zuri për krahu dhe bëri tri-katër hapa më tej.

— Hekuran, kam menduar t'i bëjmë një letër shokut Hajri se, sado që shefi thotë se ka biseduar me të, prapë s'më mbushet mëndja t'ja ketë rrëfyer punën si duhet.

— Shiko, shoku sekretar, sa të marrë letrën sho-

ku Hajri do të jetë vonë. Po fillon shiu! Ndërhy, kërkohet që t'është maqineria, se do na mbytet! More vesh? Kërkohet, se kështu bën punën e partisë, asnje dyshim mos ki; jam i sigurtë për këtë që them, dëgjove? Sekretari e vështroi në sy.

— Mos më shiko më, hajde të shkojmë, se do të na mbyten maqineritë, do të na mbyten njerëzit!

Besimi dhe Hekurani muarën rrugën të dy bashkë dhe, me të hyrë në fshat, era nisi të shtohej. Presja zuri të falej duke nxjerrë një vërvshëllimë të mprehtë. Filloi të bjerë shi. Pikat e mëdha ranë në fillim të rralla, po të rënda, më vonë u dendësuan dhe mbi pluhurin e vadituri krijuan një kore ngjyrë kafe. Aroma e dheut të zhuriturit që po lagej nga shiu, u përhap menjëherë dhe u ndje një zagushi e madhe. Kur hynë në kantjer, të dy shokët ishin bërë dordolecë.

Gjatë rrugës, Hekuranit i qe mbushur mëndja, se inxhenjeri përsëri do të thosh që të prisnin. Vëtëm kish një shpresë, se tani nuk ish vetëm. Me të që edhe sekretari i organizatës. Po megjithatë prapë nuk gjente qetësi.

«Si s'më pyetën mua», mendonte me vete Hekurani, «ashtu s'do ta pyesin dhe këtë. Ikë, ore, do t'i thonë edhe sekretarin, se dhe ti s'merr vesh, shko e shiko punën se këto gjëra partia ja ka besuar tjetër kujt.»

Besimi dhe Hekurani hynë në zyrën e shefit me furi.

— Ç'është? Ç'ka ndodhur? — pyeti shefi menjëherë.

— Shoku shef, asgjë s'ka ndodhur, po shiko jash-të, shiu po shtohet. Urdhëroni të ndalen punimet.

— Hekuran, ti a di çfarë të bësh; më mirë t'iki

unë prej këtej dhe hajde ti rri këtu se, si duket, ke talent pér këtë punë.

— Duhet t'i shikojmë më shtruar këto punë, — u hodh e tha sekretari — Tani kemi se ku të bazohe mi, më duket. Kuptohet qartë se midis dy kënetave ka një vijë të fshehtë që i lidh me njera tjetrën. Po sikur kjo vijë të jetë të Hurdhjet e fshehta? Duhet ta dëgjojmë Hekuranin. T'i ndalim hë pér hë punimet sa të na svarojnë specialistët.

Shefi brofi më këmbë.

— Vetëm ju i dashkeni punëtorët dhe maqinerinë. Ç'kujtoni se jam unë, ndonjë mëndjelehtë? Jo, shokë, unë jam inxhenjer dhe di si punohet. Kam planin të aprovuar nga ministria dhe po e zbatoj. Vartësit e mi duhet të më ndjekin, dhe partia duhet të më përkrahë pér të drejtuar sa më mirë punën.

— Partia duhet të të përkrahë, po dhe të të drejtoj ku duhet. Partia s'të le të mbytësh njerëzit dhe maqineritë. Sot do të bëjmë mbledhjen e organizatës dhe do ta shqyrtojmë si duhet këtë çështje.

— Është vonë gjer atëhere, — u hodh e tha Hekurani; — po të mbajë shiu kështu si e ka nisur, është vonë.

— Ikë, more ti, se po ua bën njerëzve kokën dhallë! — tha inxhenjeri duke e vështruar me inat.

Hekurani zgurdulloi sytë; kraharoni i gufoi; mblodhi grushtin, po u spraps.

— Tjetër herë folë si të ka hie, — u përgjegj Hekurani i qetë dhe doli nga dera.

Jashtë shiku binte shtruar, me pikë të mëdha. Djali rrinte në prak të derës dhe vështronë duke psherëtitur.

«Si t'ja bëj? Këtyre s'u mbushet mëndja! Do shkoj në Komitetin e partisë».

Ky mendim iu duk i përshtatshëm. Shkoi me të rendur gjer në park dhe pyeti.

— Mos ka ndonjë maqinë pér në qytet?

— Këtu s'ka, po shko gjer në Sulzotaj, se më duket është maqina e bukës, — i tha një shofer.

Hekurani s'priti, ngriti jakën e xhaketës dhe u nis duke nxituar nëpër rrugën që tanë qe bërë balltë. Shiu i rrihte fytyrën dhe flokët që i vareshin bishta bishta mbi ballë dhe e bëri qull.

Era kur e kur i hapte pallton, po djali s'donte t'ja dinte. Shkonte me fytyrë të egërsuar, iu hidhët nga një sy fushave të mbjella me misër, po mendjen e kish gjithmonë te Hurdhjet e fshehta, te shokët, te maqineritë dhe, kur përfytyronte se mund të mbyteshin, këmbët i fluturonin.

Doli në rrugën Sulzotaj-Çermë. U mat të vazhdonte gjer në xhadënë kryesore, po pa një makinë që vinte nga Sulzotaj. U gëzua, zgjati dorën dhe maqina qëndroi.

— Hajde, more, ti qenke bërë ujë! — i tha shoferi, një burrë i thyer, dhe u ngrit pak nga vendi, hoqi një xhaketë e ja dha. — Pa na, vish këtë se mos ftohesh. Pse në këtë derr shiu, o çun?

— Nga e keqja po shkoj, o xha Lipe.

— Domosdo nga e keqja; kush është ai i mënçur që ecën në këtë shi pér qejf! Po ç'të keqe ke, o çun?

Hekurani hoqi xhaketën, pastaj këmishën dhe veshi xhaketën e shoferit.

— E, xha Lipe, ja, kështu po na ndodh, — dhe filloj të tregonte se si ishin punët.

— Po bën punë prej burri, o çun. Ecë te partia; po s'të dëgjuan ata të qytetit, telegram në Tiranë. More, po disa sikur s'janë në figir. Kështu bëj, mos u kurse; a kë lekë me vete? Se kushedi të duhen pér telegramin.

- Besoj të më mbarojnë punë këta të qytetit.
— More, dëgjomë mua, po s'mbarove punë në qytet, na pesëdhjetë lekë dhe hiq telegramin. Vetëm ujdise mirë. Dhe bëja drejt Enverit, babaxhanit tonë.

Hekurani buzëqeshi.

- Kështu e duan disa, gjersa t'u vinë burgjité në vënd, — tha me inat shoferi duke luajtur sa djathtas majtas timonin.

Hekurani vështronë shoferin që qe ngrysur në fytyrë dhe pa dashur sytë i vanë te spidometri. U habit kur pa se maqina ecfe me shpejtësi shumë të madhe.

— O xha Lipe, shumë e ngake!

— E para herë që ngas kaq shpejt. Dua që të vesh sa më parë ti, or bir, se nuk i thonë shaka.

Hekuranit iu bë zemra mal. S'gjente dot fjalë që ta falenderonte.

— Zbrit tami, — tha kur arritën në qytet. — Si të kesh mbaruar punë, pritëm këtu. Dhe shiko hap sytë, çuno, hap sytë!

Hekurani i dha dorën dhe mori udhën për në komitetin e partisë. Te dera e priti një burrë i gjatë.

— Te kush do të shkon? — e pyeti ai.

— Te sekretarja e Komitetit të rrethit.

Nëpunësi e përçolli gjer te dera e zyrës. Hekurani trokiti dhe hyri në një të ndarë. Atë çast u ngrit Shega në këmbë dhe, siç e kish zakon, i buzëqeshi e i zgjati dorën duke i thënë: — Mirëse, — e pyeti ai.

— Mirëse erdhe, Hekur, ulu. — Dhe i tregoi një karrigë.

Hekurani u ul. Pa dashur shëtitit me sy dhomën: dhe pa të varur në mur dy fletëlaydërimë që Komiteti Qendror i Partisë i kish dërguar. Komitetit të rrethit, portretin e Leninit e, të Stalinit, hartën e rrethit dhe një panoramë nga fushat e Myzeqesë.

— C'kemi, Hekur, si i ke nga shtëpia? — pyeti Shega duke vështruar djalin me vëmëndje.

— Mirë jemi, shoqja Shegë; ju si jeni? Keni marrë letra nga Zani?

— Kam marrë; gjithmonë të dërgon të fala. Është gëzuar për ty që po nderon veten dhe familjen.

Hekurani buzëqeshi dhe, padashur, zuri një tavillë duhani që rrinte sipër një tavoline të gjatë, e cila rrrethohej nga dymbëdhjetë frona të thjeshtë.

Shega vazhdonte të vështronte djalin e, si përherë, edhe tani ai i kujtoi Demirin, të cilin ajo e kish pasur komandant dhe shok të luftës.

— Hekur, sigurisht ke ndonjë punë me rëndësi që erdhe në këtë shi. — i tha më në fund ajo dhe ngriti me dorë flokët. E fshikura e plumbit në faqen e djathët iu duk më shumë.

— Po shoqja Shegë. Njëzet ditë më parë i bëra një propozim shefit të kantjerit për kthimin e trasesë së kanalit, se, siç e kemi zënë, do të mbytим maqinerinë dhe puntuoret. Po s'më dëgjoi. Sot po bie shi; po të vazhdojë kështu gjer në darkë, maqinerinë s'e kemi për të nxjerrë, vahu do të hollohet dhe eskavatorët do të kridhen në Hurdhjet e fshehta.

Shega u mvrejt në fytyrë dhe, duke mbajtur një lapës në gishtinjë tregues të të dy duarve, foli:

— Ke njëzet ditë që e ke bërë propozimin, the?

— Po, shoqja Shegë; unë e thashë mendimin tim, pastaj bisedova me këshillin e fshatit dhe, me sa kam marrë vesh, xha Rizai u ka shkuar dy herë për tu treguar se si ndodh puna në Hurdhjet e fshehta, po prapë s'e kanë dëgjuar. Veç kësaj u bë dhe mbledhja e Byrosë së organizatës bazë, po edhe ajo nuk bëri atë që duhej. Gjej kundërshtime të më-

dha nga shefi i kantjerit, i cili më thotë se në një mëndje me të është dhe inxhenjer Hajriu.

— Po pse, Hekur? e ke kuptuar shkakun?

— Nuk më besojnë, kujtojnë se frikësohem të punoj te Hurdhjet e fshehta. Për këtë më kanë hequr dhe nga eskavatori e më kanë lënë në buldozer.

— Ashtu? — buzëqeshi Shega, — s'kanë besim, ë? — dhe ndenji një hop pa folur, duke e vështruar djalin gjithmonë më vrejtje.

— Ti, Hekuran, nuk duhet të dëshpërohesh. Që të ndrosh trasenë në një vënd tjetër, është gjë e madhe, duhej studjuar mirë propozimi.

Hekurani u prish në fytyrë dhe u ngrit në këmbë.

— Shoqja sekretare, po ndëjtët dhe ju me mëndjen e shokëve të kantjerit dhe nuk merrni masa, do të na mbyetet maqineria!

— Ulu, shoku Hekuran. Ti më keqkuptove. Unë desha të thosha se si në të folurit, ashtu dhe në fytyrë ti tregove një farë urrejtje për shefin e kantjerit. Nuk duhet ta urresh, po të përpinqesh t'i tregosh se ke të drejtë. Ka shumë mënyra se si t'ja rrëfesh. Bëre mirë që erdhe, po, më duket mua, pak me vonesë. Ti vjen sot, kur mbapse vërtet ka rrezik. Nuk po zgjatem më; po nisemi. Rrugës tregomë me hollësi se si qëndron puna. — I ra ziles. Atë çast dikush hyri.

— Dërgoni të kërkoni inxhenjer Hajrinë, është në Thanë. I thoni të niset me një herë në Tërbuf, te Hurdhjet e fshehta.

Pas pak maqina mori rrugë e Rrogozhinës. Shiu binte shtruar me pikla të vogla, sikur të ish shkuar në sitë.

Hekurani nisi të tregojë dhe sado që e mbante veten, kur shikonte fushat tërë pellgje, pshërëtinte.

Shega e dëgjoi më vëmëndje. Si në zyrë, po më fort tani në maqinë, ajo kuptoi se djali çdo gjë e thosh me pikëllim, me një vuajtje e frikë të brëndëshme. Ajo habitej me shefin e kantjera, dhe sidomos me Hajrinë, që nuk e kishin studjuar thellë këtë punë dhe që nuk e kishin vënë në dijeni dhe Komitetin e Partisë për të.

Duke vështruar Hekuranin e pllakos! dhe atë një shqetësim, se djalin e kish njojur që të vogël, po nuk e kish parë kurrë kaq të tronditür.

— Ke mundësi t'i japësh më sphejt, shoku Xho-xhi, — i tha ajo shoferit, — dhe mori frymë thellë, sa që i la mbresë dhe Hekuranit.

Kur mbritën në kantjer, shiu kish pushuar. Shega, pa folur, zbriti dhe hyri në administratë. Trokiti në derën e shefit të kantjérat dhe u fùt.

— C'kemi, shoku shef? — e pyeti e shqetësuar.

— Shi dhe asgjë tjetër, — u përgjegj tjetri i kabitur.

Shega shikoi rrrotull, dhe njuhу Besimin.

— Të dy këtu qenkeni. Ejani të hypim në maqinë dhe të nisemi për në Hurdhjet e fshëtitë. S'foli më, hapi derën, doli dhe bashkë me Hekuranin që e takoi tek bisedonte më disa shokë, përpjekja maqinës dhe mori udhën përtë punimet. Veturë e cte, pas saj shkonte një GAZ-67, që tota i eftë fituit vërvisinin ujët dhe llucën gjëri në mezhdat e mbuluar ra me ferecka gomari. Nëm e është vërtauti i njësia.

Në të dalë të Plepajt, nga larg, Shega pa Rizanë dñe dy tre eskavatoristë që i shihin nijomur gjér në palçë dhe që eonin si më të rendur. Urdhëroi shoferin të ndalte maqinën, se dhë Rizaj kish dalë në mes të rrugës dhe pat hapur të dy duart.

— C'kë, o zhë Riza? — e pyeti dhe sado që don-te të fliste e qëtë, prapë zëri sikur iu ngjirid.

— Buçiti uji, Shegë! Plasën Hurdhjet e fshehta. Dërgoni maqinën, të thérresin njerëzit për të shpëtuar maqinerinë.

Atë çast te Shega erdhën nëpunësit e kantjérat, dhe kur pa Rizaj shefin, zgurdulloi sytë, shtrëngoi nofullat dhe tha:

— S'na dëgjuat neve! Po tan? Eë, ç'doni ju; ç'doni ju!

Shega zbriti nga maqina.

— Dërgoni thërrisni njerëzit, — u tha zyrtarëve.

VII

Gjithë dita po kalonte me shi. Nga pasdrekja zunë bubullimat e vetëtëtimat. Era nisi të fryjë më shumë. Dallgët e Tërbu fit ngriheshin tërë duf, nga që s'kishin se ç'bënin, vrisnin veten, duke u përpjekur në breg e duke nxjerrë nga buzet shkumë të bardhë.

Kamjonët, edhe ata si të zëmëruar me kohën, s'donin t'ja dinin nga shiu, breshëri, vetëtimat e bufullimat dhe çanin me shpëjtësi përmes llucës në rrugën që shkonte në Hurdhjet e fshehta. Më më fund, qëndruan. Eskavatoristët, punëtorët dhe zyrtarët zbritën dhe sakaq kuptuan se këpucët s'bënin punë. Të gjithë u zbathën, përveshën pantallonat gjer sipër gjunjëve dhe morën udhën që çante përmes presjes. Sa më shumë që venin përpëra, saq më thellë u futeshin këmbët në llucë.

Me të mbritur më vendin e punimeve, panët se ai që mbushur më ujë. Shefi i kantjérat u prish më fytyrë.

«Nga mbiu gjithë ky?» — mërmëriti dhe vështroi me habi. Atë çast erdhë Hajriu me dy inxhenjerë të

tjerë. Nga të nxituarit ata mëzi merrnin frymë. Hajriu e toku Shegën dhe me Gëzimin. ob edb Shkolla

Hekurani me Besimin shkuantë të eskavatorit që ish futur më brenda Hürdhjeve. Ndezën maqinën, po nё çast dhei u drohi dhe, një pësëdhjetë hapa përpara, u dëgjuan një zhurmë. Vahu u shemb dhe uj buçiti përsipër, nё fillim si ndonjë shatervan i madh, pastaj nisi të paksohej dhe prapë filloj të ngrinej duke bërë zhurmë. Të gjithë zbritën nga eskavatori. Hekurani picëlloi sytë, ndenji një hòp i heshtur, pastaj bëri dy hapa përpara. ob edb Shkolla

— Qëndro, Hekuran! — i tha Shega.

— Nuk ka rrezik, — ja bëri ai i qetë dhe shkoi te maqina.

Te eskavatori u mblodhën të gjithë zyrtarët dhe vështronin kur Hekuranin kur ujët, që gurgullonte sikur të ishin vënë nё zjarr dhjetra kazanë të mëdhenj.

Eskavatori luajti nga vendi dhe, si eci tre katër metra, ngeci. Rreth tij filloj të hapej një gropë që sventer zmadhohëj e thellohej.

— Shoqja Shëgë, duhen trenj dhe kështë, ndryshe shtunxjerrim dot, — tha Hekuranin më nё fund dhe u hodh nga maqina.

— Po, duhen trenj e kashtë, — tha nё gojë dy tre eskavatoristë.

Shega qëndroi një hòp e menduar, pastaj tha:

— Do it'i gjemë, po shkoi nё ishët. — Dhe iu drejtua Hajriut: — Përgatishpëdoj gjë per të nxjerrë maqineritë.

Shega mori rrugën Hajriut i mblodhi të gjithë e u tha. ob edb Shkolla

— Më parë se të filloj më, duhet të kemi rrëgull dhe disiplinë. Të mos bëheri lëvizje të kota. Të gjitha veprimet do të kryhen sipas udhëzimeve të mia.

Eskavatorët do të shkojnë vetëm në rrugët që do të caktojnë dhe do të mblidhen përtëj plepit, — zgjati dorën më të djathtë. — Duhet të punojmë me gjak-ftohtësi. Përpara se të niset eskavatori rruga të mbulohet me duaj kashte, gjersatë arrimë te presja, se pastaj do çajmë përmes saj. Tani, shokë, ndizni motorët, i fshini dhe i bëni gati, që posa të mbrijë kashta, të fillojmë rrugën. Shefi i kantjerit të verë roje pranë shëmbjes së vahut dhenë perëndim të tij, që asnjeri të mos shkelë në ato anë. Inxhenjerët dhe shoku Hekuran do të yinë më mua për të caktuar udhët nga do të lëvizë maqineria. I keni të-kjarta detyrat, shokë?

— I kemi, — ja kthyen.

— Atëhere fillojmë.

Një kambanë e madhe ish varur në degët e një shelgu, në sheshin e fshatit, aty ku kremitohej dhe festa e peshikatarëve. Dhe kambana kish një histori të sajën, nuk dihej se kur që ndërtuar, vetëm për një kohë të gjatë zëri i saj ish dëgjuar në manastirin e Shëne-Premtes. Po një dimri që kish dalë Shkumbini në tre katër vënde dhe kish mbarsur Kënetën e Zezë dhe Tërbuin, pastaj ish shtrirë fushave me shpejtësi, duke mbytur Plepajt, prifti i Manastirit ua dha Plepallarëve këmbanën, që t'i binin kur të ndodhni fatkeqësira.

... Që aso kohe këmbana rrinte varur, dhe, kur dëgjonin peshikatarët në kalibet e tyre zërin e saj, u dridhej mishtë e mëndja u shkonte te shtëpitë, se e dinin që në fshat do të kish ndodhur ndonjë gjë.

Zëri i këmbanës atij viti s'qe dëgjuar; vetëm asaj pasditje tingulli i saj i mprehtë, që përhajej

nga era me furtunë e që futej, në shushurimën e presjes, në zhurmën e shiut që përplasej pas tokës, i shqetësoi Plepallarët. Të gjithë burrat e djemtë u ngritën më këmbë; muarën gunat, e dualën me furi përjashta. Kur shikonin se te sheshi s'kish njeri, i drejtoheshin këshillit. Gjithë fshati u grumbullua dhe prisnin të dëgjonin se ç'kish ndodhur.

Shega, e lagur dhe me kokën mbështjellë me një dyshe që ja pat dhënë Rizaj, hipi në një vënd të lartë dhe, duke duruar shinë që i rrihte fytyrën, tha:

— Shokë fshatarë, maqineria në Hurdhjet e fshehta është në rrezik. Për të shpëtuar na duhen treqind duaj kashtë dhe një dhjetë trenj. Në ndihmoni të shpëtojmë maqinerinë. S'kam ç'të flas më, puna s'pret pér fjalë të shumta.

— Sa duaj duhet të sjellë çdo shtëpi? — u hodh e tha një fshatar.

— Nga dhjetë, — u përgjegj xha Rizaj. — Shpejt, djema, maqinat i kemi hazër; thërrisni dhe grarinë që të na ndihmojnë pér t'i ngarkuar në kamjonë e pér t'i shkarkuar nga Qafa e Iles te Hurdhjet e fshehta. Shpejt, guna! Shpejt! — tha Rizaj.

Fshatarët u shpërndanë. Nuk shkoi shumë dherpranë kamjonave nisen të ngrihen togje të mëdhenj me kashtë.

Shiu vu, po fshatarët s'donin t'ja dinin. Një lëvizje e tillë s'ish parë në fshat, Selvija ngarkonte në kurriz kashtën dhe, me të rendur shkonte e hidhëtë në maqinë. Krahas me tò, të ninj e të reja, burra e gra, punonin me zell pér t'u habitur.

Kamjonët u mbushën. Në dy prej tyre, hipën fshatarët dhe muarën rrugën. Te vendi që quhej Qafa e Iles maqinat qëndruan. Fshatarët zbritën dhe secili prej tyre merrte nga dy tre duaj në kurniz dhe ekte me vrapiqë përmes presjes. Shiu bin-

te. Ata, tē ngarkuar, tē lagur e duke u kredhur gjer nē gju nē baltët, shkonin pa bërë zhurmë.

Rizaj kishte marrë dy duaj kashtë dhe printe pérpara tē gjithëve. Kur e kur ndalej si mënjanë e thërriste:

— Forca çuna! Ja, dhe pak na ngeli.

Fshatarët arritën te vendi i punimeve. Eskavatoristët, buldozeristët, teknikët e ndryshëm, u merrnin duajt dhe i grumbullonin nē një vend.

Hekurani u gjëzua shumë kur pa atë mresht që s'kish tē mbaruar. Si tē gjithë edhe ai rendi tē ndihmonte.

Pa vënë re kush ish, iu afroa një femre e nisi t'i shkarkojë barrën. Kur ngriti kokën vajza që e mbante si tē kërrusur nga kashta që kish nē kurriz, Hékuranit iu droth zemra.

— Selvije, ti je? — pyeti si i shastisur.

Vajza u turpërua, u skuq nē fytyrë dhe, si vështroi njëherë rrëthepërgark, i buzëqeshi dhe u largua pa i folur.

Hekurani mori kashtën dhe sikur ta kish bërë me fjalë me Selvijen, sa herë që kthente kokën ai, e kthente dhe ajo dhe që tē dy shikonin njeri tjetrin nē sy.

Me një shenjë tē kryeinxhenjerit, eskavatorët u vunë nē levizje. Ata shkonin me ngadalë nē rrugën e caktuar që më parë. Vetëm eskavatori, më tē cilin kish punuar Hekurani, ishfutur i hellë, sadoqë grëpa pe mbushur, e nē tē qenë vënë trenj tē mbuluar me kashtë, që tē mos rrëshqiste maqina, po prapë ai s'luante nga vendi. Hékuranit jepë e merrte, shkelte gjithë gazin sa që dridhej dhëu, po prapë s'ishtë e mundur. Rreth eskavatorit qenë mbledhur shumë njerëz. Aty pranë rrinte dhe Selvija e vështronë Hekuranin. Zemra i dridhej se dëgjonte illoj fja-

lësh. Dikushin thosh s'deli dot; një tjetër këshillonte ta nxirrin bme buaj, një i tretë ngulte këmbe e ngrinte zënë që të largohej sa më parë Hekurani më shokë se dori të imbytej.

Selvija shkonte nga një vend në tjetrin dhe shtrëngonte duart me llahtari. Nga një herë i vinte t'i therriste Hekuranit, po shpejt e mblidhte dhe gjithë dëshpërimin e ndrydhte përbrëndar.

Më fund, nga grupi i njerëzve që rrinën shumë afër eskavatorit, u shkëputën dy vete dhe përtetje u dëgjua zëri i buldozerit. Nga presja dualën tre buldozerë të tjerë dhe, si u kthyen, u lidhën me njëri tjetrin dhe pas tyre lidhën dhe eskavatorin e Hekuranit.

«Ja buajt e tu» — u dëgjua një zë midis fshatarëve:

«Tani do ta heqim pa derman», tha dikush.

«E shikon çka bërë frëngu? — foli një i tretë:

«Çfrëngë, more, Stálini», — ia pat një tjetër.

Selvija rrinte e heshtur dhe tani sikur u qetësua pëk. Zhurma e përnjehëreshme e buldozerëve dhe e eskavatorit ish aq e madhe sa që ajo s'kish dëgjuar kurrë ulurimë të tillë. U shasti, mbylli veshët, po në çast fytyra i qëshi se eskavatori lëvizi dhe filloj t'i ulet —

Ooo! Urraaa! Ooo! zunë të therrisin njërit e ulturën pas mëqinave.

Selvija shkonte pranë eskavatorit, bënte sikur hidhje kashtë dhe vështronë e i buzëqeshtë Hekuranit. Shih binte pë pushuar, po shtruar e më inge. Dymbëdhjetë eskavatorë dhe gjashtë buldozerë udhetonin ngadalë duke i mbajtur turinjtë te një plep i lartë me majë të thyer. Afér perëndimit të diellit,

shiu sikur pushoi, po prapë retë vozisnin si të të buara. Maqineria u nxuan në një vend të sigurtë. Eskavatoristët e fshatarët i dhënë dorën njeri tjetri duke buzëqeshur dhe pastaj hipën në kamjonë. Hekurami me Selvjen hipën, në një maqinë dhen denjën pranë e pranë duke ndjerë zemrat që u rrini me të fortë.

— Vije, po vi sonde, — i mërmëriti Hekurani.

Selvija ngriti qepallat dhe me sy të qeshur e vështroi në fytyrë, pastaj uli kokën e ja ktheu:

Tē pres. *ng* *sem* *ilimbulu* *lākā* *lākā* *lākā*
lākā *lākā* *lākā* *lākā* *lākā* *lākā* *lākā* *lākā*

* * *

Selvija rrinte në dritare dhe priste me një ankth të madh. S'dinte në do ti vinte Hekurani apo jo. I kish humbur shpresat, se binte shi dhe shi me gjyma. Megjithatë ajo po e priste dhe do ta priste gjer në mëngjes. Nëpër terr dalloj një njeri që ecte. Nisi të marrë frymë me të shpejtë e të ndjejë zemrën ti rrahë me të forta.

— Hekur! — mërmëriti, — yuri (duart) në krahasor dhe s'dinte c'të bënte.

— Hekur! — përsëriti. Hapi kanatinë e dritarës
dhe nxori gjysmën e trupit jashtë. — Do jetë lagur,
do jetë bërë ujë! — tha duke vrejtur djalin që po
afrohej.

Hekurani, me të mbrijtë i ngulit vështrimin fytyrës së vajzës. Ndjenga e zjarrtë që e përvëlonë se la të priste më gjatë, po e pushtoi fort pa folur. Selvija mbështeti kokën në gjoksin e tij. Qepallat e gjata i binin gjer në mes të faqeve. Ballin e lartë ja zbukuronin dy kaçurrela. Buzët e etura, të mbushu-

ra e gjakatë kuqe nga zjantri i brendeshem, trinintë puqura dhe sikur përhapnin një aromë qehëse. Hekurani i qe i gëzuar Ngadalë spuqit bëzët e tij me të vajzës dhe shpirti iu deh nga një embëksi e pashpjegueshme.

Shiu binte. Vajzës iu kujtua isedjali pohllagej. Izuri flokët, mrobafl dhet u drodh.

— Hekur, qënke bërë qull, do të ftokej. Djali s'e lartë fliste. E pushtoi përsëri, pa e ndjere fare shinë. Voni u nda më vajzeni dhe mori rrugën e kantjerit. Ecje i qetë e i kënaqur.

VIII

Përpara se të shkonte në kantjer, Hekurani u fut nën një strehë. I hodhi një çast sytë shtëpisë së tij, pullazit, dhe psherëtiu. Pastaj vazhdoi rrugën. Me të arritur në dhomë, Besimi i tha që të nesërmen të mos dilte në punë.

Pa lindur dielli, u ngrit, u la, hëngri mëngjesin dhe shkoi të merrte vesh përsë e lajmëruan të mos vente në Hurdhjet e fshehta.

Në zyrat e administratës takoi Hajriu.

— Puna e Hurdhjeve të fshehta u sqarua, më duket, — i tha Hajriu dhe, si i lëshoi krahun, i dha një cingare. — Ka një lidhje të fshehtë midis dy kënetave, dhe viaj ose përrorë i nëndheshëm shkon te vendi i Hurdhjeve. Kur bie shi dhe derdhet Shkumbini, përroi i Lushnjës, Delli i Ferrasit dhe Lunja e Karbunarës i mbushin të dy kënetat mbi nivelin e përroit të nëndheshëm. Atëherë uji i përroit me që do të arrijë të njëjtin nivel, nis të hajë koren e si-

përmë të tokës gjë sa shpërthen dhe bëhet ajo që thua ti: një peshë e vogël dhë vahu shembet. — Kështë është, shoku Hajri; mirë që u muarëm vesh. Është shtë dëshpërojat qëndruese.

— U muarëm vesh, po ti mos u dëshpëro, Hekurani. Shefi i kantjerit ka bërë gabim të madh që s'i vuri rëndësi propozimit tênd. Tani duhet gjetur kështë gryka e përroit.

— Më duket se e kam gjetur dhe grykën. Duhet të jetë foleja e gjarpërit. Të vjetërit thonë se diku nja dy kilometra larg fshatit, ka folenë një gjarpër i madh. Sa i afrohen atij vendi, ai të përpin. Më përpara thuhej se në kohë të keqe, aty gurgullonte uji, gjoja sikur përpiquej gjarpëri, se kish frikë mos e godiste zoti me rrufe. Kurse tani kjo gurgullimë s'dëgjohej. Tani uji pranë atij vëndi bën gropë dhe, po të hedhësh ndonjë gjë e kollofit. Unë kam vajtur këto ditë dhe më është tiposur në kokë se atje është gryka e përroit të nëndheshëm.

Hajriu përsëri e vështroi me dashamirësi e i ra krahëve.

— Vërtet qënke njohës i mirë i kënetës!

Sa vunë këmbën në ndertesën e administratës, në oborr qëndroi një maqinë e vogël prej së cilës zbriti Shega. Ajo e toku me të dy dhe të tre së bashku hynë në zyrën e shefit të kantjerit.

Gëzimi u ngrit. I priti dhe i la Shegës kryen, kurse vetë ndemji në një nga frontet Hekurani, me ta parë, e kuptoi se shefi ish shumë i tronditur. Sjtë i kish të kuq dhe fytyrën të zverdhur. Dukej që s'kish fjetur mirë atë natë...

Atë çast në dhomë hyri dhe Besimi, i cili ishte përshëndeti zuri vend.

Hekurani ndjente sikur ishtë i tjetërt mët atë

rreth. U ngrit në këmbë dhe kërkoi lejet të ikte, po Shega s'e la.

— Ulu, shoku Hekuran ulu. Deshëm të bisedonim një herë kështur si njemi, pastaj do të shpërndahemi. — Shega rregulloi një cullufe që i binte ballit, pastaj foli:

— Nuk e mendoja dhe s'e besoja, shoku Gëzim, që ta kishit lënë punën, këtë punë kaq me përgjegjësi, më mëshirën e fatit, dhe të mos çalltisnit. Ju duhej të kishit lajmëruar Komitetin e Partisë, shokun Hajri, dikasterin tuaj se kështu e kështu po zhvillohen ngjarjet. Si t'ja vëmë emrin kësaj pakujdesie? A është dinë kush vepron kështu? Kështu vepron vetëm armiku, dhe njerëzit që s'kanë zemër, që s'kanë mënd. Ne na vjen keq që kështu ka vepruar një anëtar i familjes së nderuar të Shkurtëve, na vjen keq për punëtorin dhe fshatarin që ju kanë mbajtur pesë vjet me djersën e tyre e ju dhanë shkollë e dituri. Tek ju ka munguar gjithçka dhe të gjitha këto gjëra jau solli papjekuria e madhe që s'i ka hie moshës dhe radhës suaj. S'kam ç'tju them tjetër. Ju keni arritur sa që keni mashtruar edhe kolektivin, se gjoja jeni këshilluar me shokun Hajri. Ky është turp i madh.

Në dhomë u bë s'qetësi, Shega pshëretiu dhe shtoi:

— Jeni i lirë, shoku Gëzim; mbrëmë u mora vesh me Ministrinë e ndërtimit. Në vëndin tuaj është emëruar një inxhenjer tjetër, Kujtim Mezini. Ju hë për hë mbeteni në dispozicion të Ministrisë. Mund të shikoni kù të doni, vetëm ju them dhe një herë se rruga, që keni kapur, nuk është rrugë ku ecën rinia jonë, nuk është për ju, ndaj mendohuni dhe mendohuni mirë. Këtë po e them për të mirën tuaj, përtë mirën e familjes tuaj.

Ajo heshti për një sekondë pastaj iu drejtua Hajriut:

— Tani, shoku Hajri, si keni menduar dhe ç'do tē bëjmë?

— Unë them tē presim dhe Kujtimin dhe tē shkojmë tē projektojmë kthesën e kanalit.

— Mirë atëhere! Kujtimi duhet tē vijë së shpejti.

Të gjithë u ngriten. Shega doli përpara, pas saj dhe tē tjerët. Vetëm Gëzimi mbeti në dhomë. Ai vuri duart në kokë dhe ndenji ashtu një copë herë tē madhe. Pastaj ngatëroi flokët e zeza si tē negrit dhe, kur kujtoi se vendin e tij po e zinte i vëllai i Fatbardhës, pshëretiu dhe nuk i erdhi hiç mirë.

— Ç'do t'i them Fatbardhës për gjith këto që ngjanë? — Përsëri shkatëroi flokët. — Po te Nënës? Motrës?

Vështroi në një pikë tē padukëshme me sy si tē shqyer dhe iu duk sikur pa t'anë që kollej duke i rënë me çekan kacaprokut, pastaj duke qepur me bizë një palë këpucë tē shqepura në taban. Përpëliti qepallat, u ngrit me vertik në këmbë dhe mërmëriti:

— Po, dhe kështu s'jetohet! Doli nga zyra, shkoi në dhomën e fjetjes, rregulloi teshat dhe, kur dëgjoi se e thërrisin, bëri për nga oborri. Bashkë me Hajriun pa dhe një djalë flokëverdhë, fytyrëqeshur, trupgjatë, i cili sa pa Gëzimin, i vajti dhe e toku me tē dy duart.

— Kujtim Mezini, — u paraqit djali.

Gëzimi e pa nga afër dhe shquajti se sytë e tij u ngjanin shumë syve tē Fatbardhës.

Shefi i ri i kantjerit nxori paqetën dhe Gëzimi i mori një cigare, pastaj e ndezi dhe me tym nëpër gojë tha:

— Jam gati t'ju bëj dorëzimet.

Atë çast u afrua edhe Hajriu, i cili e vështroi me dhimbje Gëzimin dhe pshëretiu.

Dy maqina të vogla shkonin në rrugën që konte në Plepaj. Në njerën ish ulur Shega me Hajrinë dhe në tjetrën Kujtimi me Hekuränin.

Hajriu, që një ditë më parë, prej çastit që pa Gëzimin të largohej nga kantjeri, ish i dëshpëruar. Këtë gjë e pat vënë re edhe Shega e deshi ta pyeste, por e la.

Tani kur ishin duke udhëtuar të dy me maqinë, Shega e shihte se Hajriu që i mërzitur e donte t'i thosh diçka, po sikur druhej.

— Flisni, shoku Hajri, ç'doni të më thonë? — i tha ajo.

— Për Gëzimin, shoqja Shegë; po mendohem përtë.

— Dukeni se mendoheni, po edhe unë po mendohem. Dhe ja ç'po mendohem. Ne nga një herë s'punojmë sa duhet me disa njerëz si Gëzimi. Nuk u vumë kujdes letrave dhe lutjeve të tija për t'u kthyer në Tiranë. Dhe s'punuam sa duhet që t'ja zbardhnim atë anë të zezë që i kish zaptuar trurin. Ne u mjaf-tuam vetëm me një fjalë dhe kjo mua më rëndon.

— Ashtu është, shoqja Shegë. Na rëndon shumë. Do të më lejoni mua të interesohem për Gëzimin.

— T'ju lejoj! Po ajo është detyra juaj nga më kryesoret. Pse, si mendoni ju, do ta hedhim poshtë ne atë? As njëherë! Ne do ta ruajmë, do ta sjellim në rrugë. Ja ku duhet të arrimë me Gëzimin. Dhe unë nga ana ime do të punoj. Pas ca ditësh do të marr lejen dhe do t'i shkoj në Tiranë për vizitë. Dhe ju lereni ndonjë muaj të kujtojë dhe të rikujtojë punët pa mënd që ka bërë, pastaj kapeni. Mirë.

është ta keni pranë, se në të afërmen, me punët që kemi përpara, ka për ta larë budallallëkun që bëri.

Hajriu buzëqeshi i kënaqur. Desh të vazhdonte bisedën po maqina qëndroi. Kryeinxhenjeri vëشتroi djathtas dhe njohu shtëpinë e Rizajt.

Hekurani, sa vuri këmbët në tokë, pa Selvijen që fshinte oborrin. Ajo, me të diktuar miqtë, hyri brënda me furi.

Djali s'desh të vinte, se kujtoi fjalët e plakut, që i kishte thënë të mos i shkelte në shtëpi, po s'e la Shega. Ajo e zuri për krahu dhe e mori me vete.

— O xha Riza, — i thiri shefi i ri i kantjerit që, si duket, e njihte. Atë çast hyri në dhomë me një frymë Selvija.

— Ka ardhur Shega, — i tha.

Plaku brofi më këmbë dhe doli me të shpejtë.

— Urdhëroni, mirëserdhët, — tha gjithë i gëzuar dhe i dha dorën Shegës. Kur pa edhe Kujtimin e rroku në qafë me dashamirësi. Dhe për një hop ngeli i mahnitur, se iu kujtua i gjyshi i djalit, Sulçia, me të cilin kish peshkuar kaq vjete.

— Uluni, — i luti miqtë dhe pastaj iu drejtua Shegës: Për ty, moj bijë, duhet të kthej një gur sëmbarthi. Sa ke që s'na ke dalë! — Mori nga rafti paqetën, u dha nga një cigare, nxori peshqirin, fshiu zverkun, fërkoi duart dhe pyeti:

— Mëngjes është, ftohët është, doni nga një gotë raki? E kam të mirë, s'keni për ta gjetur në asnjë mehane të qytetit.

Të gjithë buzëqeshën.

U ngriti e i thirri së bijës të sillte gotat dhe shishen, fshiu për së dyti herë zverkun dhe u ul.

Selvija pruri rakinë e u shtiri të gjithëve mëradhë. Kur zuri të mbushte gotën e Hekuranit, dora

iu drodh. Rizaj mori filxhanin e fundit, e ngriti lart dhe uroi:

— Mirë se ardhët, dalçi faqebardhë në punë.

— Mirë se të gjetëm, o xha Riza, — uroi shefi i ri i kantjerit.

— Të pëlqen? do dhe një?

— Jo, jo, na e ruaj për ndonjë rast tjetër; paske raki Përmeti, ballë kazani.

Rizaj buzëqeshi.

— Të më urdhërosh sonde; kam menduar ta prish pehrizin. Kam ca zogj, e mezi po i ruaj nga huta, — dhe i shkeli synë.

— Do të vi, o xha Risa, — iu përgjegj Kujtimi.

— Mirë se të vish dhe shiko se s'vjen, të mori e mira, të mori, — dhe e kërcënoi me gishtin tregonjës. — Pastaj tha, — apo do t'ja mbathësh që sonde.

— Këtu më ke këtej e tutje, o xha Riza.

— Është emëruar shef i kantjerit, — ja priti Hajriu.

— Ashtu. Më rrofsh. Më rrofsh.

Selvija mblođhi filxhanet dhe doli.

— Punimet te Hurdhjet e fshehta i lamë, — shtoi kryeinxhenjeri. Të gjithë pamë propozimet që bëri Hekurani për kthimin e kanalit në një rrugë tjetër. Dhe menduam se mund t'i mbahemi atij, vetëm duhet ta shkelim dhe një herë vëndin, ta studjojmë më mirë, që të bëjmë punë të saktë.

— Shumë mirë e kini menduar; edhe unë po vij me ju.

— Medoemos, medoemos, — tha Shega, — A ngrihemi tashti?

— Si të dëshironi.

Mjergulla kish hapur krahët. Rëtë qëndronin si të varura, nga perëndimi po ngrihej një re tjeter! Rizaj pa qiellin, njomi gishtin e madh, e ngriti dhe mërmëriti.

— Do na mbajë koha.

Dolën nga oborri i shtëpisë në rrugë.

— Edhe plepallarët po ndërtojnë, — tha Shega, se pa që mbulohej një shtëpi me tjegulla.

— Po zbukurojnë shtëpinë, — shtoi dikush.

— Po ti, o xha Riza, kur do ta heqësh kashtën?

— Po të ketë ndonjë maqinë më nge shefi, që nesër, moj bijë.

— Maqinë për ty, o xha Riza! Që sot, po deshe.

— Jo, sot, jo, se do të vish sonde për darkë dhe do të thonë bota: «e thirri për punë të maqinës».

— Të gjithë qeshën.

— E po pasnesër, atëhere, — ja bëri Shega.

— Do të ta plotësoj dëshirën, moj bijë, — buzëqeshi Rizaj e i hodhi sytë shtëpisë me mure gungra gungra, të lyera me gëlqere e me pullaze që nxinin nga kashta.

— Po të vjen vdekja, — tha me vete, duke parë e duke përdredhur një fije kashte, pastaj e këputi me forcë dhe e vërvitë përtetj.

U hipën maqinave dhe zbritën pranë vendit ku ish grumbulluar teknika. Para se të zbrisnin, veshën nga një palë çizme të gjata dhe filluan të ecnin gjer në buzë të kanalit. Shkonin duke biseduar.

— Moj bijë, do të të them një fjalë. Shikojeni pak më mirë hallin tonë. Kemi familje që janë dëmtuar nga kanali dhe ai komisioni vetëm sa lagu këpucët dhe s'u duk më.

— Kush është dëmtuar më shumë në Plepaj? — pyeti Shega.

— Më shumë është dëmtuar Shari Shahini. Atij iu prish i tërë kopshti me pemë.

— I paska zënë kopshtin, ka pasur pemë të mira. Me që rafjala për Shahinajt, pse nuk i pashë dje? Apo s'janë aty?

— S'e di, — ja ktheu Rizaj.

Shega vështroi Hekuranin sikur ta pyeste në heshtje.

Hekurani bëri sikur s'e kuptoi. Po Shega shpejt e pikasi se midis tyre diç do kish ndodhur.

— Së shpejti dëmet do të paguhen, xha Riza: kështu do t'u thuash fshatarëve.

Sa arriten në vend, kryeinxhenjeri hapi çantën dhe, duke vështruar përreth, tha:

— Folë, Hekuran, si e ke menduar kthesën e kanalit?

Djali e vështroi në sy dhe u skuq në fytyrë. I shkoi Hajriut afër dhe tregoi me gisht. Zëri në fillim i doli si i ngjirur, po më vonë iu kthjellua.

— Unë mendoj që të formojmë dy kularë, një bërryl këtu dhe tjetrin përtëj, te Plepi i madh.

Të gjithë vështruan nga tregoi djali. Një çast plakosi një heshtje që tregonte se njerëzit po i rrin me mëndje të tyre gjithë sa dëgjuan.

— Po sikur të formojmë një kular vetëm te Plepi i madh dhe ta presim kanalin nj'a pesëmbëdhjetë metra më poshtë, a do të na mbajë vahu? — tha inxhenjeri duke e parë djalin drejt në sy, që mos t'i shpëtonte shprehja më e vogël e fytyrës së tij.

— Vahu mban. Kanali do të shkojë po në ara, si do të shkojë dhe këtu.

— Po që kështu, do të krijojmë vetëm një bërryl, se si thoni ju, na duhet të gërmojmë më shumë.

— Ju e dini më mirë, shoku inxhenjer. Dheu, si atje ku thoni, edhe këtu, është njëlloj. Arë e punuar ishte kjo, arë e punuar është dhe ajo. Në gjithë bregun e mëngjér, në pjesën e poshtëme, shtrihen arat e fshatit.

Kryeinxhenjeri futi hartën në çantë dhe ftoi ta ndiqnin pas. Ecnin të qetë, kush duke thithur cigen, kush duke biseduar, Hekurani shkonte, po sepse dukej i mpirë. Nuk i erdhi mirë propozimi, jo se ai nuk ish i drejtë, por, po të hapej kanali ku tha inxhenjeri, kthesa do të bëhej në arën e tij, kanali do të çante mespërmes dhe ca nga gjérësia, ca nga dheu që do të grumbullojë nga të dy anët, gjithë ara delte jashtë përdorimit. Kjo do t'ua shtonte edhe më zëmërimin xhaxhait dhe gjyshit, se pa tjetër do ta merrnin vesh që shkaktari i prishjes së arës kish qënë i nipi i tyre. Ndaj i hidhte këmbët i menduar. Me të arritur te ara përtej, megjithëse koha ish gati përsi, pa Azizin që prashiste.

Grupi u ndal në mes të arës.

— Qënka e punuar! — foli kryeinxhenjeri me keqardhje, duke vështruar Rizanë në sy.

Atë çast, kryetari i Këshillit vështroi Hekuranin që rrinte si i tulatur.

Mbretëroi një farë qetësie. Të gjithë vështrojnë misrin që kish mbirë ndonjë pëllëmbë në tokën e punuar me kujdes.

— Në qoftë se ka leverdi këtu, këtu duhet hapur kanali, — tha prerazi Shega dhe shtoi: — pronarëve të saj do t'u paguhet misri dhe, me t'u tharë Këneta e Zezë, do marrin dhe tokë.

Në këtë bisedim e sipër, si i drojtur e me shatën hedhur në krah, erdhi Aziz Shahini. Ai nderoi duke vënë dorën në ballë e duke përshëndetur me një zë si të vrazhdët, vështroi Shegën, i dha dorën,

pastaj u përshëndet me të tjerët dhe qëndroi me fri-kë në zëmër se mos pësonte gjë ara e tij.

Atë çast kryeinxhenjeri zgjati dorën përparrë dhe tha:

— Kanali do të çajë përmes arës gjer përtëj, te Plepi i madh. Aty do të krijuhet një kular jo shumë i thyer dhe pastaj do të zgjatet gjer te gryka e Vijës së Strymit.

Azizi shikoi të nipin, u zverdh në fytyrë dhe nisi të dridhej, uli shatën dhe u mbështet te bishti i saj. Çdo gjë iu err, ndenji si mbi gjëmba, iu pre goja, u gëllit tri katër herë si të përtypët atë helm që iu bë aq shpejt në grykë. Një hie e mvrejtur, një hie fatkeqe i kish veshur çehren. Duke mbajtur systë në një pikë të padukshme, qëndronte sikur të kish ngrirë; filloi të psherëtijë dhe pastaj të qajë si ndonjë i vogël. Me lot në sy u ul pranë një bime. Fletët e gjelbra gjallëronjëse lëviznin krenare. Azizi me gishtinjtë e trashë tërë kallo i përkëdhelte duke i spërkatur me lot. Ndënji ashtu një copë herë të mëdhe në bisht, duke ledhatuar trupin e njomë të misrit. Më në fund u ngrit dhe, si ndonjë i dehur, mori rrugën e shtëpisë.

Në atë kohë Hekurani ndiqte grupin. Ai e kish parë dhe e kish ndjerë hidhërimin e xhaxhait. I erdhë shumë keq. Herë pas here thoshte ndonjë fjalë kur e pyesnin, po dhe atë me zëmër të rënduar.

Vonë mbaruan së shkeluri trasenë ku do të shkonte kanali. Plani ishte përpiluar si duhej. Në ato toka eskavatori mund të vepronë me lehtësi. Po bëhej kthesa që kish menduar Hekurani, vetëm në një dreitim tjetër, që vërtet kursente shumë kohë dhe mundim. Kur mbaruan punë, qelli ish mbushur me re. Mjergulla kish përhapur më shumë krahët e saj dhe një erë frynte hope hope e ngrinte lart

ndonjë lëpushkë të thatë e ndonjë fije bari. Të gjitha këto tregonin se po vinte shiu me furtunë. Në të hyrë në fshat era nisi të shtohej, presja zuri të falej nga lindja duke nxjerrë një fërfellimë të mprehtë.

— Unë po shkoj pâk nga xha Shari, — tha Shega.

— Do vimë edhe ne, — ja bënë inxhenjerët. Hekurani uli kokën, kurse xha Rizaj u prish në fytyrë.

— Mirë, unë po shkoj në këshillë, se kam ca punë, — mërmëriti Rizaj pa e bërë veten.

— Edhe mua të më falni, — tha Hekurani i turpëruar, dhe u ndanë.

Shega u habit, po shpejt e mblodhi e s'bëri zë. Bashkë me inxhenjerët ajo hyri në shtëpinë e Jashar Shahinit. Atë kohë vetëtima çau qielin dhe bûbullima tundi dheun.

— Ndiznani një zjarr të mirë, — u foli Jashari njerëzve të shtëpisë me të parë mysafirët që hynë në hajat dhe u ngrit më këmbë.

— Mirë se ardhët, — tha e iu dha dorën Shegës dhe shokëve të tjerë.

Të gjithë zunë vënd rrëth vatrës.

— E nga qetë kështu? Nuk e patë se koha ish e turbull që në mëngjes?

— Duhej të mbaronim diçka, o xha Shari. Kanalit ja ndryshuan drejtimin; i lamë punimet në Hurdhjet e fshehta. Ja dëgjuam fjalën nipçes, — u përgjegj Shega duke mënjanuar flokët.

— Hë, po ku do ta çoni kanalin.

— Nja katërqind metra më të djathtë.

— Katërqind metra më të djathtë! Mirë bëni, kini pér të mbaruar shpejt, se si e kishit filluar me

Hurdhjet e fshehta do të rrinit dhe kushedi sa dimëra e s'do të shpëtonit pa ndonjë gjë.

— Si duket, ti paske qënë në një mëndje me Hekuränin, — foli Shega me të qeshur.

— Medoemos, xha Shari i di si në pëllëmbë të dorës këto vënde, — shtoi kryeinxhenjeri.

Në dhomë, pasi dëgjoi fjalët e fundit të kryeinxhenjerit, hyri Azizi. Ai mbante shatën në krah. Qe lagur fund e krye, flokët i kishin dalë nga qeleshja e i qenë ngjitur në ballë e faqe. Merrte frymë me zor; sytë i qenë shqyer dhe vështronë me një hakarrimë të theksuar e të lebetitur.

Jashari u trëmb kur e pa në atë gjëndje, po s'e bëri veten dhe i foli:

— Qënke lagur; shko ndrohu.

Fjalët e plakut e përmblodhën. Doli, po duke pshërëtitur thellë.

Jashtë furtuna vazhdonte, shiu binte me rrënim, degët e rrapit tundeshin, fletët shushurinin dhe përziheshin në gumzhimën e përgjithëshme që pat mbjellë smoreci.

* * *

Furtuna pushoi, po shiu binte shtruar. Në të përenduar të diellit, qelli nisi të kthjellohej. Rrezet e veshën natyrën me dritë të kuqërremtë, po nuk shkoi shumë, dhe re të reja, të zeza, të mbushura me shi dolën nga jugu. Vozitnin ngadalë e me nge. Drita e diellit, retë e zeza dhe gjelbrimi i natyrës krijojnë një mori ngjyrash dhe të dukej sikur ishe futur në botën e ëndrave.

Hekuran Shahini qëndronte më këmbë pranë

derës së fjetores dhe ashtu i menduar siç ish vështronët renë që po i afrohej diellit. Ngjyra e kuqërrremtë i binte në fytyrë dhe sikur e gjalléronte. Ato ditë kishin sjellë shumë gjëra të mira.. Më në fund, ja dëgjuan fjalën. Puna te Hurdhjet e fshehta u rregullua dhe nga kjo ndjente një kënaqësi të thellë në shpirt. Po pse rrinte i menduar atë ndajnatë? Mendohet për shtëpinë. Prishja e kopshtit dhe, tanë së fundi, prishja e arës i kish shkatërruar familjes së tij gjithë burimet e të ardhurave. Këto gjëra shtonin edhe grindjet dhe krijonin pakënaqësi ndaj pushtetit. Atij i binte ta afronte sa më shumë gjysnin pas vetes. Po ç'duhej të bënte? Ai duhej të përpinqej që sa më parë të jepej dëmshpërbërimi, të ndihmonte duke dhënë gjithë rrogën në shtëpi, megjithëse do të rrinte akoma dhe ca kohë vec, që ata të kuptionin se nuk ishin sjellë mirë me të. Nga ana tjetër ai duhej të punonte që të bindëte gjyshin se për punën e kopshtit Rizaj s'kishte aspak faj; kanali duhej të shkonte përmes kopshtit me çdo kusht.

Duke menduar këto, përfytyroi Shegën.

«Do t'ja kallëzoj të gjitha asaj, se lala e dëgjohat atë më shumë se çdo njeri tjetër» — tha me vete dhe e ndjeu veten më të lehtësuar. «Po të rregullohen dhe këtc, pastaj do të jem i qetë, do të martohem me Selvijen dhe do të bëj një shtëpi të re» — fytyra e hareshme që i llamburiste çfaqte gjëzimin e tij shpirtëror.

Doli në oborr. Shiu kish pushuar. Ngriti kokën dhe pa, si përtëj nga lindja ashtu dhe nga perëndimi, yje të shumtë që llamburisnin plot shkëlqim. Vëtëm në kuptë të qiellit, retë ende pengonin xixellimin e tyre. Ndenji një çast kështu duke vështruar kuptën e qiellit dhe mandej, hyri në klub e u ul midis shokëve.

Të nesërmen agoi një ditë e bukur. Dielli s'kish lindur, po natyra ndrinte. Ajri thithej me kënaqësi. Në fshatin Plepaj dhe pérreth njerëzit qenë zgjuar, dikush kish marrë rrugën për punë, dikush përgatitej për të dalë dhe ndonjë i shkuar nga mosha hante mëngjesin ose flinte. Rrapi i Shahinajve dukej sikur që zgjuar edhe ai nga zogjtë e parumurt që cicëronin në të. Në degët më të larta të tij qëndronte një tuftë me kryearta; ato kishin kthyer gjoksin nga lindja dhe prisnin rrezet e diellit.

Në këta çaste një krismë e madhe, që ja kalonte shumë herë bubullimës, u përplas pas bregoreve, shtëpive e mezhgabeve dhe jehoi anembanë. Dheu u droah, në buzë të kënetës uji u ngrit pesë gjashë bojë njeriu. Fletët e rrapit të Shahinajve fëshfertët. Në ajër fluturuan shpendë të ndryshme, të parumurt. Në sipërfaqen e ujit dualën peshq e ngjala të vrara. Njerëzit u habitën.

C'kish ndodhur? C'ish gjithë ajo krismë e padëgjuar në ato anë?

Inxhenjerët dhe teknikët patën gjetur grykën e vijës së nëndheshme që lidhte Tërbuin e madh, me të Voglin. Foleja e Gjarprit, që Hekuranit i kish sjellë aq dyshime, ish vërtet gryka që lidhë të dy kënetat dhe që gjatë kohrave pat sjellë aq dëme. Ajo grykë duhej mbyllur që të këpuntej lidhja midis kënetave dhe brënda, një kohe të shkurtër të lirëshin afër dy mijë hektarë që ishin zaptuar prej ujit.

Mënyra e mbylljes u gjet me anën e dinamitit. U vendos të shëmbej dhëu që vinte si i ngritur dhe të zinte grykën. Forca e dinamitit u imbaroi punë

inxhenjerëve. Gryka u mbyll përgjithmonë. Fytyrat e njerëzve ndrinin. Dukej se ajo krismë ish sihariqi që tregoni fundin e TërbuFit të Vogël, ose të Kënetës së Zezë, si e quanin vendësit. Një eskavator rendëte drejt Folesë së Gjarprit për të mbathur bregun.

Atë çast, punimet për hapjen e emisarit të madh të TërbuFit po hynin në një fazë të re. Eskavatorët do të punonin në një terren të mirë.

Për varianti ne ri të hapjes së kanalit qenë bërrë gjithë përgjalljet, ish kryer pikëtimi i kanalit, që caktuar thellësia, gjëresia, ishte ndarë rajoni dhe gjithë eskavatoristët patën marrë zotime për tejkallimin e normave. Brigada e eskavatoristëve që ndarë në gjashtë rajone. Çdo rajon kish nga ky maqina. Midis rajoneve qe shpallur garë. Shefi i kantjerit pat vënë një flamur dhe ai që do fitonte garën dhjetëditore, fitonte flamurin. Flamuri mbahej dhjetë ditë dhe lëvizte kur fitohej gara nga rajoni tjetër. Në rajonin buzë kanalit qe caktuar eskavatori i Hekuranit dhe i Besimit. Të dy shokët punonin me kujdes. Si gjithë të tjerët dhe ata dëshëronin që flamurin ta fitonin vetë. Hekurani çdo marsh që lëvizte, e bënte të studjuar. Krahu i maqinës duhej të ngrihej dhe të mënjanohet me të shpejtë, lopata të mbushej menjëherë në vëndin e caktuar dhe të zbrazej me shpejtësi, dheu të lëshohej varg, gërmimi të kryhej në vëndin e pikëtar, duke i dhënë kanalit thellësinë e nevojshme dhe anëve pjerësinë e duhur. Kanali duhej të dilte i bukur, tamam ashtu si e kish vizatuar inxheneri në letër. Këto kërkonin mjeshtëri të përsosur dhe kujdes të madh, ndaj Hekurani i kish kushtuar punës gjithë vëmëndjen e tij.

Ushtima e dinamitit, që koloviti Voronezhin dhe mënt e përplasi përdhe, Hekuranit i pruri një gëzim

të madh. Vështroi tymin e zi që doli përtëj Shelgut të Lumturisë, pastaj u kthyë se dëgjoi një gumezhu më te Këneta e Zezë dhe sakaq përijët të ngrihej, i shtyrë nga një forcë e madhe. Së shpejtë Tërbuji i Vogël dhe lluca e balta që përzihej nga sinxhiri i ekskavatorit do të zhdukej nga faqja e dheut. Hekurani hypi në maqinë dhe nisi nga puna hënë jehonën e krismës së madhe.

IX

Aziz Shahini qe njeriu më i dëshpëruar në fshat. Ajo pak shpresë se mos kushedi ndrohej plani i hapjes së kanalit në arën e tij iu zhduk me të parë që po pikëtonin tokën. Hidhërimi po e torturonte, mëndjen e kish të prishur dhe as gjë s'i hynte në sy. Epte e merrete dhe s'dinte q'të bënte. Hata e madhe! Po tanë ku do të gjente që të ushqente fëmijët? Një gjëmë të tillë s'ë kish parë kurrë. Druhej t'ja thoshte t'et këto që ndodhnin, se kish frikë mos e trubullonte dhe e sëmurte. Gjithë farmakun po e gjellfuste vetë duke pshërititur e duke rënkuar.

Atë ditë, nga që s'rrinte dot të shih te se si po ja bënin arën, se i dukej sikur po i matrin zëmren pér t'ja çarë, iku duke hëqur osh këmbët e mbathura menjë palë ropinga bualli. I shashjisur, doli në oborr dhe shkoi e qëndroi në buzë të kënetës. U ul, vuri duart në kokë dhe mbuloi fytyrën me pëllëmbët e mëdha. Të ngjethura dhe të dredhura i përshkonin trupin. Një mëri e madhe i zjente përbërënda. Që të qetësohej nxori nga xhepi kutinë dhe me gishtrinjtë tërë kallo drôdhni një cigare. Fytyra i kish marrë një pamje të vrashët, mjekra e zezë dhe e pa-

rruar e bënte më të egër. Sytë me kokërdhokun e dalë e me vështrimin tërë inat nxirrin në shesh mëndimet e trubullta, nervozizmin e tij dhe pazotësinë pér t'i shikuar punët me gjakftotësi, Duke mbajtur sytë në truskën e gjelberuar, që sa kish lëshuar fletët, psherëtinte sepse nuk gjente asnje rrugëdalje. Më në fund u shtri praptazi duke kryqëzuar duart poshtë kokës. Një heshtje e vazhdueshme zoteron te anembanë. Rrallë e tek dëgjohej gurgullimë uji. Veriu, që sa kish nisur, i bëri fletët e truskës të shushurijnë dhe lëkundi mëngët e këmishës së tij të badhë, të pambuktë, që kish marrë një ngjyrë si të kapnisur nga të palarët. Azizi ndenji ashtu i shtrire një copë herë të madhe. Një qëndrim i tillë tre-gonte se ish dorëzuar, se s'kish ç'të bënte. I dukej sikur ish lidhur këmb' e duar. E ç't'i bënte ai qeverisë? Jepte e merrte pér t'ja hedhur fajin ndonjë njeriu të veguar, pò as që e gjente dot. E kush i kish faj që i muarën tokën?

Në këto e sipër dëgjoi këmbë. S'luajti nga vëndi; se njoju të shoqen që pò vinte. Bulja e kish pikasur shkakun e dëshpërimit të të shoqit. Pat dëgjuar atë natë që kishin ardhur inxhenjerët, se He-kurani kish qënë ai që kishtë ngulur këmbë pér hapijen e kanalit në një vënd tjetër. Ai qe shkaktar i prishjes së arës dhe i hidhërimit që kish zaptuar shpirtin e të shoqit. I pikëlløhej zëmrë kur shikonte Azizin që s'mbyllite sy tërë natën e natës e që psherëtintë e rënkonte sikur të kish ndonjë të vdekur në shtëpi.

Atë ditë, duke parë Azisin që s'ish as në qell; as në tokë, vendosi t'i thoshte. Mbësë këtë radhë i dilte pér mirë. Nisi të ecte me ngadalë dhe u ul pranë të shoqit. Mblodhi gjunjët, tendosi fustanin dhe me fytyrë të pezmatuar ndenji pa bërë zë.

— Folë, ç'më erdhe! — i tha Azizi duke e parë vëngër.

Bulja u rrëngeth, vështroi të shoqin në fytyrë dhe iu duk si njëri tjetër, sikur të kish lënguar me javë të tëra dhe pshëretiu.

Kjo pshëretimë e zbuti Azizin. I hoqi sytë dhe duke vështruar përtej një re të zezë që i ngjante një patkoi kali, foli me të urtë:

— Mos më do gjë lala?

— Jo, erdha të të thosha diçka, — dhe u skuq në fytyrë.

Azizi u ngrit; uli përgjysëm kokën dhe po kërkonte çakmakun në xhepat e palltos.

— E po ç'do të më thoshe — i tha përsëri me të urtë.

— Do flas, po kam frikë mos ma marrësh pëters.

— Fole, fole, — dhe ndezi cigaren.

— Unë e di pse je dëshpëruar. Fajin e ka njeriu ynë. Hekuri u tha inxhenjerëve që punimet nuk bëhen dot në Hurdhjet e fshehta. Po të mos u kish thënë ai, ata s'do ta kishin kaluar kanalin nga ara jonë. Kemi kukudhin në shtëpi, o burrë. Ai po na i ndjell të gjitha këto.

Azizi e vështroi në sy dhe gruaja pshëretiu.

— S'më besove një herë, o burrë! — dhe sepse iu rrukullis një lot.

Azizi, ndryshe nga radhët e tjera, e dëgjoi me kujdes të shoqen. Për herë të parë i vështroi me vëmëndje fytyrën, lëkura e së cilës i ngjante një pata-teje të fishkur. Iu drodh zëmra. Duke vështruar Bulen, atij nisën t'i vinë ndër mënd fjalët që s'ja pat dëgjuar kurrë, por përkundrazi edhe e pat qërtuar të mos hapte më gojë. Sa gabim kish bërë! Kish gabuar, se të gjitha ato që pat thiënë e shoqja, po i del-

nin. A nuk kish gisht edhe Hekurani për prishjen e kopshtit, për shkak të të cilat u sëmur i ati? A nuk ish Hekurani ai që solli trazirën në shtëpi? A nuk ish i nipi shkaktari që po i merrnin tokën? Ai ishte? Mirë pat thënë Bulja: kishin kukudhin në shtëpi. Sa të ish ai kukudh me fytyrë njeriu ters do t'u vinte gjithmonë! Ters e lumë! Fytyra e Azizit sa vinte po ashpërsonej, sytë e skuqur nga pagjumësia sa vinin vështronin të xhindosur. Më në fund shtrëngoi nofullat, mblodhi grushtet dhe shau ndyrë. Pastaj brofi në këmbë, vështroi përreth dhe, duke shkelur rëndë, hyri në shtëpi. Gjeti Jasharën, u ul pranë tij dhe nisi t'i flasë për punën e tokës.

Si mbaroi së kallëzuari, Azizi ndenji një copë herë duke vështruar t'anë. Heshtja dhe shushatja e plakut ja shtuan akoma më shumë mërinë për të nippin. U ngrit dhe u ul në boshtin e qerres dhe zuri kokën me duar. Fytin ë ndjente të hidhur farmak. S'i rrivej në një vend. Ara i rrinte gjithmonë përpara syve e s'kish zëmër të vinte ta shikonte, po edhe s'duronte të rrinte duarkryq e ta linte atë si ai babaj trëmbëlak që s'mbron dot fëmijën në rast rreziku. U ngrit dhe, duke psherëtitur, mori rrugën për në arë. Natyra qe stolisur me lule e barishte, por atij s'i hynte asgjë në sy. Përkundrazi, bardhkat me zëmrën e verdhë që stolisnin mezhdat, lulëkuqet dhe shamikuqet që çuçuronin fletët me haze, tinska e njomë e gjelberuar, e gjithçka i dukej sikur mbillnin vetëm hidhërim e vrer. Sa më shumë i afrohej arës, aq më shumë tronditje ndjente. Nga larg pakrahun e eskavatorit që kur e kur delte mbi ferrat që rrethonin arën. S'donte ta shihet, po kureshtja e ngacmonte. Kuptoi se punimet kishin vajtur gjer në gjysmën e arës.

Ee! Ç'mynxyrë që më ka gjetur! — psherëtiu

duke ngjeshur qeleshen që i kish zënë përfundi dy
gisht këllirë dhe vijoi udhën. Kur arriu te shtegu
që të conte në arë, u fsheh që të mos e shihte nje-
ri dhe, si ndonjë lepur që fshihet se mos e shohë ar-
miku, rrinte duke mbajtur sytë të shtetur te maqi-
na e fuqishme.

* * *

Ndërsa Azizi ndjehej njeriu më fatkeq, i nipi,
Hekurani ishte më i lumturi i njerëzve. Kënaqësia
në punë e kish bërë të fluturonte me krahë dhe e
shtynte gjithnjë përpara. Në dhjetë ditëshin e dytë të
punimeve Hekurani dhe Besimi fituan flamurin tran-
zitor të kantjerit. Besimi ja dha Hekuranit ta mban-
te këtë shënjë nderi, se kishte frute të mira. Stofi
i kuq, rrethuar me kordon në ngjyrë ari, valëvitej
sa herë që lopata mbushej e zbrazej. Flamuri i vo-
gël i shtonte fuqitë. Tani e ndjente se qe bërë eska-
vatorist i vërtetë dhe nga më të mirët bile.

Tek punonte lopata nisi të mbushet me vësh-
tirësi. Mos kish pësuar gjë maqina? Provoi dy tri
herë mekanizmin e lëvizjes, të uljes e të ngritjes.
Çdo gjë ish në rregull. Zbriti përdhe bashkë me ndih-
mësin dhe shkoi të vështronte vëndin ku gërmohet.
Menjëherë i ra në sy një shtresë tjetër toke, mori
një shuk me baltë dhe e bëri top.

— E sheh? ramë në baltë shtamash, — mërmëri-
ti dhe në çast, duke hedhur dheun si ndonjë gur,
diçka i ndriti në mënd, buzëqeshi dhe i tha shokut:

— E di sa kanë vojtur fshatarët tanë për të gjet-
tur një shtresë të tillë?

— E ç'e duan, o Hekur, — pyeti i habitur shoku.

— E duan dhe shumë bile. Në fshatin tonë, çâ-

tia e shtëpisë prej tjegullash kushton më shumë se-vetë ndërtesa. Sikur të ngrihej këtu një kaminë e madhe, brënda vitit gjithë Plepaj do mbulohej më tjegulla, — buzëqeshi e gjithmonë duke e hedhur baltën si gur, — vazhdoi: — Nuk e di a do të ketë gjithë vëndi.

— Besoj të ketë, — ja priti shoku duke vësh-truar pérreth.

Hekurani bëri disa hapa duke shikuar arën që-kushedi sa herë e kish mbjellë dhe prashitur, në mes-të së cilës do të kalonte Tërbufi.

— E kush e besonte se këtu do të hapej kanal, kush e besonte se poshtë, katër metra thellë, do të-kish baltë shtame? — tha më vete dhe nisi të shko-jë për të vazduuar punën. Në çast, përtej, luajti ferra dhe u hodh në arë Azizi, Hekurani e pa që ecte-i tronditur dhe i nevrikosur, duke mbajtur në dorë një dru.

Ç'kish menduar të bënte xhaxhai?

* * *

— Katil, — thirri Azizi dhe u derdh përparrë. Qëndroi pranë të nipit dhe nisi ta vështronë i pri-shur në fytyrë.

— Katil! — i bërtiti përsëri dhe ngriti drunë.

Hekurani i kapi dorën dhe bashkë me ndihmë-sin e carmatosën.

— Qen! Do të të vrás! — shkrofëtiti Azizi, duke-ecur kuturu. Si bëri pesë gjashtë hapa, u kthyë përsëri dhe pa të nipin. — Do të ta këput kokën si të-zogut, qen bir qeni! — Dhe vazhdoi udhën duke ecur si ndonjë i pirë.

Zénka me xhaxhanë, që ndodhi papritur e papandehur, e dëshpéroi shumë djalin. Xhaxhanë e pat pushtuar një hidhërim e një zemërim i atillë sa që bëri të pabërën. Fytyra e tij vërtetonte se ishte razi edhe ta vriste të nipin. Hekurani s'kish zor të kuptonte shkakun e këtij dëshpërimi. Po që të vinnte e t'i shpjegonte xhaxhajt se si ndodhët puna, e dinte se në ato ditë s'ishte e mundur. Zemërimi në shpirtin e xhaxhajt që grumbulluar prej kohe; këtë ai e kish pikasur dhe, që t'ja shkulte me të biseduar, sidomos tani që atij i qenë ndezur trutë, kjo ishte e pamundur. Përkundrazi, po të shkonte të bisedonte me të, më shumë benzinë do t'i hidhej zjarrit. Pra, në këto kondita, vetë s'ish i aftë të bënte gjë prej gjëje. Duhej të shkonte te Shega e t'ja thosh të gjitha.

Ruajti të dielën dhe, me të lindur dielli, i hipi një maqine e shkoi në qytet. Si i ra rrrotull pazarit, hyri në një rrrojtore, u rrua e u qeth, pastaj, si pyeti ku e kish shtëpinë Sekretarja, shkoi në një rrugicë shtruar me kalldrëm dhe trokiti në një derë.

Shega doli dhe e priti te porta e brendëshme. Ajo kish lidhur në bréz një pérparëse. Me të parë Hekuranin, bùzqeshi, ngriti flokët që i binin në sy dhe e ftoi të hynte brenda. Djali donte të hiqte kë-pucët që të mos fëlliqtë koridorin e larë, po Shega s'la. U fut në një dhomë të pajisur me orendi të thjeshta dhe ndenji në një fron. Për një çast Hekurani qëndroi vetëm, rrrotulloi sytë niçpër mure dhe sakaq dalloi shokun e t'et, kolonel Zan Hajdarin, në gjoksin e të cilët radhiteshin katër rreshtë me nga tri dekorata. Hekurani e vështroi me kujdes fotografinë dhe do të vazhdonte akoma, sikur të mos kish hyrë Shega.

— Pa na folë, Hekur, ç'kemi, si venë punët?

— Mirë venë, shoqja Shegë; punimet po ecin me të katra. Këtë verë do ta mbarojmë kanalin, — thithi cigaren si me druajtje dhe vështroi përsëri Shegen që po e kundronte me kujdes. — Këto ditë — vazhdoi ai, — te ara jonë, aty ku u kthyen kanali, gjetëm baltë shtamash. I thashë xha Rizajt dhe dëgjova se së shpejti do të ngrënë një kamine.

— Ashtu! shumë mirë do të bëjnë. Le të shohim edhe fshatin tuaj që të skuqë nga tjegullat dhe të bëhet si fshatrat e tjera.

— Do ta shohim medoemos; gjatë luftës edhe në s'kemi qenë prapa tyre, — dhe i hodhi sytë fotografisë së Zanit. — Nga shoku Zani kini marrë letra tani afër?

— Kam marrë. Ju bën shumë të fala. Sivjet mbaron dhe nga vjeshta e kemi këtu.

— Shumë iu bënë atij!

— Shumë vërtet.

— Ee, lum ai, — psherëtiu Hekurani; mbaroi cigaren dhe tha: — Kam ardhur për një hall dhe dua ndihmën tuaj si Sekretare e si mikeshë shtëpie.

Shega përnjëherë mori një pamje të rëndë.

— Neve, në shtëpi, na ka ndodhur një farë trubullire. Familja është shumë e dëshpëruar dhe ka ngelur fare pa të ardhura. Veç rrrogës sime... — dhe djali nisi t'i tregojë duke i kallëzuar ngjarjet me hollësi.

Shega tundi kokën.

— Shumë keq paska vajtur puna, shoku Hekuran, shumë keq. — Mbodhi pak buzët dhe pa djalin që mendohej.

— E di, shumë keq, po këtë gjëndje duhet ta përmirësojmë.

— Duhet ta përmirësojmë, po ti s'ke bërë, mirë që je zënë me xhajën.

— S'kam bërë mirë! Dëgjo, shoqja Shega: jo xha-jën, po dhe babën do ta sikterisja po të zihej me njerëzit e pushtetit. Sot vetëm kulakët zihen me ne...

— Ashtu është, Hekuran, po komunisti duhet të punojë me mënd, të mos ndezë sherrin në familje, po ta shuajë dhe të dalë në ballë të familjes. Mendi-mi i tij, qëllimi i tij të bëhet dhe i familjes. Kurse ti, Hekuran, në çastin më kritik, në vënd që t'i ta sqaroje gjyshin, xhaxhanë, xhaxheshën, t'i bëje të kuptionin thelbin e çështjes, përkundrazi i ke lënë sa që ata... Kjo gjë s'është e mirë. Këtu s'ke vepruar si duhet. — Ajo ngriti flokët dhe e shikoi drejt në sy, — Tani Hekuran, në rastin më të parë, të shkosh në familje; duhet t'i durosh dhe me urtësi t'u mbushesh mëndjen si xha Sharit, ashtu edhe Azizit. Unë, nga ana ime, do të bëj çmos që punët të rregullohen. Do të përpinqem, si the dhe vetë, hem si sekretare, hem si mikeshë shtëpie, — buzëqeshi.

— Të falem nderit, shoqja Shegë.

— S'ka gjë, tani rri një copë herë, vetëm, të të bëj një kafe, — Shega u ngrit e doli, kurse Hekurani mbeti fillkat. Vinte në kolktuk i menduar, duke kujtuar fjalët e Shegës. Gjer dikui i jepte të drejtë asaj, po jo plotësisht.

Në dhomë hyri Shega me tabaka në dorë. Hekurani mori filxhanin dhe uroi:

— Në gjëzime të ardhçim.

— Të falem nderit, — ja, ktheu ajo dhe nisi të rrufisë kafenë. Sa herë që vinte filxhanin në buzë, aq herë vështron te ftyrën e menduar të Hekuranit dhe kuptonte gjëndjen e tij shpirtërore.

Si piu kafenë, Hekurani u ngrit. Shega e për-

colli gjer te porta jashtë, i dha dorën, dhe e këshilloi:

— Mos u mërzit; të gjitha do të rregullohen. Dotë vijë një ditë, dhe s'është e largët, që do të të përqafojë vetë Jashari.

Hekurani iu përgjegj me një buzëqeshje të lehtë dhe mori rrugën për në pazar, duke ecur si me përtim.

X

Neksija u kthye në shtëpi pas një muaji. Fytyra kish zënë t'i gjallerohej. Po prapë s'kish fuqi të ngrihej, rrinte shtrirë, punonte ndonjë çorape, andronte ndonjë rrobe dhe kështu e ngryste ditën. Gjithë kohën mëndjen e mbante të i bri. E kish marrë malli dhe donte ta shikonte, ta ledhatonte dhe t'i thoshte se si i kish bërë këto punë kështu.

Atë mbrëmje qe shumë e mërzitur, se të nesërmen do t'i ikte dhë e bija që e kish sjellë në shtëpi. Vonë e zuri gjumi. Në ëndër pa Hekuranin duke qepur çorapet, me një fytyrë të çuditëshme, pastaj e pa duke ngrënë.

— Hëngre bukë, Hekur? — e pyeti në ëndër.

— Hëngrë, mome.

I zuri të birit dorën dhe ai sepse e shikoi me inat. Ajo e përkëdheli dhe fytyra e tij u zbut.

— Hekur, do t'i thuash momes të vërtetën?

— Po, mome.

— Si do të vejë puna me çupën e Rizajt?

— Si të më thuash ti, mome, si të thotë zemra jote. Vetëm ti mos u mërzit.

Nekija buzëqeshi.

— Mirë, bir, hiq dorë prej saj dhe pajtoju me t'ët gjysh, se është plak, gjynah.

Djali e vështroi me një frikë e një inat që e dri-

thëruan plakën; pastaj fytaraciu ndiuia, sikur iu bë me flokë tèrgjatë e të thnjür, e menjëherë trupit iu shkurtua dhe sikur u kredh nënjë Injergull tè den-dur.

— Hekur! Hekur! — thirri ajo dhe iuzgjuat me llahtarë.

Vështroi përreth dhe nga faqet zuri t'i rraku-lisen lotët.

Endra i lëndoi zemrën; dhe s'ë zuri më gjumi gjersa u gdhi.

«Dua ta shoh, do të shkojatje ku punon».

Tërë ditën Nekijan denji si imbi gjemba. Mëritja iu sh tua akoma më shumë ikuri i është bija. S'kish q'të bënte, përpëlitez në dyshekun prej kash-te dhë mundonte veten më llój illoj mëndimesh. Nga pasdrekja dëgjoi një zë që iu duk së i Hekuranit. U ngrit me vërtik e mbajti vesh më mirë.

— Na shpjere tek i sémura, — dëgjoi përsëri zë-në; po skëtë radhë e kuptoi se ish zëri i shokut të Hekuranit; i Besimit; i Urdhëronit; i jarktheut Bulja. Dhe hynë në dhomën kufish shtrirë e sémuraca. Nekija qe shtrirë te një sili nim i gjerë, i ngritur një gjysëm metër nga triualli, që i ja pat ndërtuar i biri. Me të parë shokunë e djalit, Nekija u ngrit dhe qëndroi ulur, e mbështetur në një qastek u lë.

— Qoftë e shkuar, — i tha Besimi. I zuri dorën me dashamirësi dhe u ul në një frontë thjeshtë, punuar nga të zot ne shtepisë. Pastaj i ddha diçka të mbështjellë në letër.

— Hekurani eshtë mire me shëndet; mos u bëj merak për të.

— Të më trosh, po qithuajtë keqen nënëja, të më vijë, së më ka marrë malif, — dhe siu mbajtin lotët.

— Mos u bëj merak, nëno; çdo gjë do të rregullohet. Vetëm forco zemrën, se je dhe e sëmurë; këshiku më porositi Hekurin.

Nekija ndenji një hop pa folur dhe pastaj, si mblodhi pak veten; hapi bisedë:

— Si ke shkuar, more djale? A ke marrë letra nga shtëpia?

— Kam marrë. Nëna të bën të fala. I kam shkruar për Hekuranin dhe për ju.

— Të fala pastë, të ruajtë zoti.

— Të falem nderit, nënë.

Besimi vështronë të sëmurën dhe i vinte keq përtë, kurse Nekija shikonte Besimin, fytyrën e tij pak të madhe; me tipare tërheqëse që e bënin të dashur; e vështronë dhe herë pas here psherëtintë. I dhimbej, se qe larg shtëpisë, larg nënës. Kushedi sa herë e kujtonte atë e ëma me mallëngjim! Ashtu si mallëngjehej dhe ajo për Hekuranin.

— More djale, as më thua; ç'ka ndër mënd të bëjë Hekurani? Ti e ke shok dhe dont'ja dish shpirtini.

— Ke të drejtë. Mua Hekurani më ka hapur barkun, më ka thënë se çdo gjë do të rregullohet.

— Djale, i thuaj Hekuranit të më vijë, të gjejë rastin të më vijë, se unë s'luaj dot nga vëndi.

— Mos keni merak, nënë, do t'i them, — e'u ngrit. Shërohu sa më shpejt, nënë. — I dha dorën. Plaka e qafoi duke u ngashëryer.

— Mos harro për ç'të thashë, bir.

— Mos u bëj merak; natën e mirë.

Atë mëngjes, pranë Plapajt, në qelliin e kaltërt, u duk një tym i madh, që ngrihej ngadalë e si mëpëtim. Tymi vazhdoi tërë ditën. Në mbrëmje, He-

kurani me Besimin shikonin ku ish ndezur zjarri. He kurani ecte si i këputur, se Besimi i kishte folur pér t'émén dhe ai qé prekur shumé. Donte fa shihen nénén, tē rrinte pranë saj e t'i jepte zemér. Po si tē shkonte? Me këto mendime arritën aty ku qé ndezur zjarri. Fshatarët, sado qé kish nisur tē errësohej, punonin me duar e këmbë tē përveshura: dikush ngjeshte baltén, vajzat e gratë përgatisnin format e tjegullave dhetë tullave tē njoma, disa e shpinini pranë furrave, tē tjetra i futnin në furre dhe së largu dëgjoheshin sopata qé prisnin dru pér tē nesërmen. Puna zjente nga tē gjitha anët.

Rizaj, pa u kursyer, ish futur. në llucë dhe ngjeshte argjilin e njomur me ujë. Kur e kur thërriste e nxiste njerëzit tē punonin më me hov. Cdo shtëpi kish dërguar nga një njeri, burrë ose grua, që tē punonte në kaminë. Rizaj kish vajtur bashkë me Selvien. Vajza merrte baltén e përgatitur, e shtrinte pas formës dhe já jeptë shoqes ta radhiste që tē thahej në diell e pastaj fa fusnin në furre. Rezet e diellit në perëndim i kuqelonin fytyrën vajzës. Fytyra e saj ish pasqyrë e qartë e gjendjes së qetë shpirtërore. Lékura i kish marrë ngjyrën e mëparshme. Trupi i kish ardhur në gjëndjen e dikur shme. Llëret topolake tërihqnin vështrimet e beqarëve.

Në kaminë punonte dhe Azizi. Në fillim e ndjente veten tē rrashkapituri. Kamina ish ndërtuar në arën e tij. Ajo i kujonte jetën dherën pünën që kish bërë aty. Kur nxuarën njerëzit më tē fuqishëm pér tē përgatitur dru në një pylli aty pranë, ai doli vullnetar, kapi sépatën dhe nuk i kish kursyer forcat pér tē rrëzuar e shkurtuar pemët.

Hekurani me Besimin u kënaqën me vrullin e fshatarëve. Të dy i dhanë dorën Rizajt dhe bashkë

me tē nisën tē vizitonin rajonin që zinte një vëndi pak si tē hapur. Duke ecur, Hekuranit i vanë sytë te Selvija. Zemra i rrahu me tiktakë tē forta; qëndroi një hop më këmbë duke e vështruar dhe ajo i buzëti qeshi. Fytyrës së saj i ra një nur i bukur, pastaj i skuq, duart iu drodhën nga tronditja dhe u duk sise kur e humbi.

Eskavatoristët i ranë poshtë e përpjetë haminësi dhe, më në fund, morën rrugën për në kantjer.

Si u lanët e u pastruan, vanë tē hanin bukë. Hekuranit i qe prerë oreksi sepse, sadoqë Besimi i tha fjalë tē mira pér t'ëmën, ai prap se rapë mëndjeni e kish te nëna e te shtëpia. Shkoi në dhomën e fjetjes. Pesë shtretër qenë vënë radhë. Kudo kish pastërti. Hekurani u zvesh, u ul në bisht, kërkoi në komodinën afër, nixori një libër, u shtri dhe nisi tē lexonte. Pér një copë herë sytë i kish në faqet e librit, po mendjeni s'e kish laty. Mërzitja s'e linte tē qetë. La librin dhe ndenji me duar tē kryqëzuara poshtë kokës. Psherëtiu, u ngrit, veshi pantabollnat dhe hyri në klub. S'e duroi dot zhurmën dhe me hap tē shpejtë dollin në oborratje, në një vënd tē qetë, larg kantjerit, u ul. Kudo ndjehej aroma e barit, freskimi i veriut ledhatar, kundërmimi i barishteve tē egra. Nata ish e bukur; yjet shkrepitin tërë shkëlqim. Hëna pasqyrohej në ujë, aq e bukur sa dukej dhe në quell.

Hekurani rrinte i menduar. Më në fund u ngrit, vendosi tē vinte në shtëpi dhe, po tē mos hynte benda, tē paktën tē shihte ç'bëhej, tē mbante vesh ç'fli-tej. Ekte rrugës me gjoks tē hapur, duke ndjerë përkëdheljet e veriut ledhatonjës. Hyri në oborr si i drojtur. Hëna e ndihmonte tē shquante çdo gjë. Gjithë sa i zinte syri ishin ashtu si i pat lënë: kociku i misrit, trari ku ulej, gardhi me rakita e çdo gjë tje-

tër. Të gjitha i shikonte me sy të dhemshur e të përmallur. I dukej sikur kish vite që ish ndarë prej tyre. I ra shtëpisë rrrotull. Më në fund ndenji pranë dritares në haur dhe, ashtu i heshtur, si varfanjak, dëgjonte muhabetin që bëhej brënda. Mornica i kallonin në trup kur i zinte veshi zënë e s'ëmës e, i therrte në zemër kur dëgjonte zërin e të gjyshit. Sadonte të ish me ta e të shkëmbente dy fjalë! U mat dy tri herë të hynte e t'u thosh: «Ardha se s'rroj dot pa ju» — po ja që s'e linte digka tjetër. Po të hynte në shtëpi në ato çaste mund të pëlciste sherri.

Ndenji kohë duke dëgjuar. Vëtëm kur ranë një rëzit të flinin dhe në konaku fik drita, u mgridit. Me zemër të pikëlluar e të dërmuar nisi të ecë me përtesë duke i hedhur këmbët si të mpira. Të vajturit në shtëpi i nxori mallin e zërit të s'ëmës e të gjyshit, i hoqi merakun e madh që kish se mos e ëma ish sëmurë dhe ja shtoi më shumë déshirën për të rrojtur bashkë. «Bisedojnë, po kushedi sa të hidhëruar janë! — mërmëriti dhe humbi në errësirën e natës së majit.

Të nxehtit po shtohej. Njerëzit nëpër arajtë veshur me rroba të holla e mengë të përveshura, korrnin grurin. Qielli kaltronte. Më të rrallë dukej ndot, një re e bardhë si shtëllungë pambuku. Jashar Shashini kish ngjitur bregoren pranë dhe rrinte pështetur në bërryl në hien e një gorrice. Afërti që shtrirë ogici që merrte frymë thellë. Jashari që veshur me një palë rroba doku blu, të vjëtra po të pastra. Jaka e këmishës i mbyllej puqur me grykën dhe ja tregonte më shumë gungën poshtë mjekrës. Po të ndiqje e të vështroje punët që bënte, do të shihje një

ndryshim të madh në veset dhe sjelljet e tij. Kish nisur të kuptonte se fajtor i gjithë sherrit ish ai vesët. Nuk diti të drejtojë si duhet punët e shtëpisë. Vetë i kish bërë të gjitha.

Këto mendime i lindën që kur iku Hekurani dhësidomos ditën kur i nipi, me anë të Besimit, i dërgoi të hollat e rrogës që pat marrë në ato pesëmbëdhjetë ditë. Çdo natë që kalonte i hiqte plakut nga një shkop në ndërgjegje.

— S'erdhi edhe sonde! — thosh duke psherëtitur. Pinte duhan gjer vonë dhe ngashërehej duke kujtuar Hekuranin, fytyrën e tij duart e tij të shkathëta, vegjelinë e tij, t'anë. Tani që i nipi ish larguar, dashuria për të ish bërë më e madhe. Kjo dashuri nisi ta detyronte t'i vështronte punët më mirë. Cili ish i nipi? Djali më i mirë i fshatit, më gjembili, më punëtori, që kish nderuar shtëpinë. Pimos vallë ishte i miri i botës dhe i ligu i shtëpisë. Ndërgjegja i thosh që jo. Djersa e tij pat kulluar që në vegjeli për të mirën e truallit. Kockat e njoma kishin lënë gjurmët kudo që hidhje sytë. Vetë plaku s'ish sjellë mirë me të. Gjithmonë sherre, gjithmonë gërnje. Dhe të gjitha këto, çdo ditë që kalonte, po i çfaqeshin më mirë, më shquar.

Edhe atë ditë, këto gjëra mendonte. Ish mërzitur dhe, për t'u shplodhur, kish ngjitur kodrën ngadalë, duke u pështetur te shkopi dhë që shtrirë nën hien e gorricës. Duke ndenjur atje plaku shihte kanalin që shkonte drejt dhe humbiste përmes pemëve. Pranë kanalit kalonte Shkumbini e në çast iu bë sikur dëgjoi edhe një herë fjalët e Shegës: «Po lind vëllaj i Shkumbinit». Nga e djathta pa se si po tha hej Këneta e Zezë. Aty këtu dukeshin tre katër pellgje të mëdhenj. Në të mëngjér punonin eskavatorët, dhe më tej ai dalloi kopshatin e tij, që e kish për-

shkuar kanali mespërmes. Psherëtinte, por edhe e përbante veten.

— «E bënë kanalin, — mendonte. — Ja edhe Këneta e Zezë, edhe pak do e u qërua». — Pastaj foli me Tërbufin sikur ky të ish një qënje e gjallë:

— Më duket se të erdhi radha edhe ty, o baba-xhan.

* * *

Mëngjesi lindi i qetë, e i freskët. Kjo ditë në Plepaj u gdhi më ndryshe nga të tjerat. Lopçari s'u dëgjua të thërriste. Rruga kryesore që shkelur pak. S'u dëgjua as kërkëllima e qerreve, as blegërima e bagëtive. S'u pa-asnjë fshatar me shatë e vegël tjetër, që të shkonte në punë. Në rrugicë rrallë dukej ndonjë njeri. Do të shquaje vetëm ndonjë femër që merrte ndonjë urrë zjarri, apo ndonjë gjë tjetër te fqinja. Sëpata dëgjohej mbi gjithë zhurmat.

Njerëzit përgatiteshin e mundoheshin për t'u veshur sa më mirë. Të vegjilit gjëzonin që do të visheshin e mbatheshin me rrocab e këpucë të reja. Djemtë pastroheshin. Atyre që u ish bërë mjekra, e rruanin, të tjerët fshinin xhaketat, bluzat, pantalonat, këpucët. Vajzat, para pasqyrave, zbuluronin fagat, krihnin flokët, vishnin hirka të reja që rrëshisnin në trupin e larë. Nuset merrnin faget, i skuqnin, nxinin vëtullat dhe vishnin fustanet më të mira.

Në fshat s'kish njeri të vrenjtur e të ngrysur. Në skelën e Pendëkuqit qenë mbledhur shumë njerëz. Me të lindur dielli, dhjetë barka muarën rrugën. — Pafshi e vrafshi, — uruan fshatarët që rrinin në breg.

Varkëtarët, me rrema ndër duar, trazonin ujin e qetë. Si kaluan në vijën e ngushtë një nga një, hyjnë në hapësirën e Tërbufit.

Ishte festa e peshkatarëve. Për të zënë peshkun më të madh, kishin dalë gjithë gjuetarët më të zot, veç Hekuranit.

Kur filloi dielli t'i afrohej kupës së qiellit, sheshi i fshatit qe mbushur sa s'kish ku të hidhje mëllën. Pleqtë rrinin mënjanë, vajzat e nuset bisedonin dhe vështronin vjedhurazi djemtë e burrat e tyre. Të rinjtë qeshnin, bënin ndonjë shaka dhe s'ua ndanin sytë vajzave.

Në skelë u dëgjua një gërnetë. Në çast të gjithëve u qeshi fytyra. Do të kish festë. Një nga peshkatarët kish zënë peshkun e duhur.

— More, po Rizaj ç'u bë? — pyeti një nga pleqtë.

— Ç'u bë de, ç'u bë, po zihen peshqit dhe plaku i festës s'po duket! — (Rizaj atë vit qe plaku i festës, se plaku i vitit të kaluar kish vdekur).

— Po vjen, po vjen, — tha një tjetër.

Të gjithë kthyen kokën dhe panë Rizanë që e cte rëndë rëndë. Sa u afrua, mblodhi dorën grusht, e ngriti përpjetë (përshëndetje që i kish ngelur që nga koha partizane) dhe foli:

— Si u gdhitë, o burra?

Të tjerët ja kthyen përshëndetjen.

Rizai ish veshur me rroba të reja, qe rruar, kish vënë në kokë një qeleshe të bardhë borë. Jashari vuri re një farë ndryshimi në fytyrën e Rizajt. Ajo dukej e rëndë dhe një pamje të tillë Rizaj e merrte sa herë që kish për të bërë ndonjë punë me rëndësi. Këtë nuk e tregonte vetëm fytyra e tij, po dhe shiriti i dekoratave. Po kalonin dhjetë vjet nga çlirimi dhe Jashari nuk e kish parë kurrë që të vinte dekoratat në festën e peshkatarëve.

— Kush e di ç'ka! — mërmëriti dhe s'e vrau mëndjen më tej.

Në skelë u dëgjuan edhe tri gërneta. Atë kohë,

nga rruga e kantjerit u dukem një grumbull njerëzish. Mbi dhjetë eskavatoristë, veshur dhe ata mirë e bukur, vinin duke kënduar. Njeri syresh i binte fizarmonikës. Të gjithë vëshitronin më kërshëri. Selvija, që gjer ahore kish qëndruar e mëritur, u çel posa i zuri syri Hekuramin. Djali ectë nga fundi i grumbullit dhe shkonte me hap të qetë. Fytyra nuk i cfaqte as gjësim, as hidhërim.

— Ja dhe miqtë e rinj, — tha Rizajt dhe u doli përpara, e si ngriti dorën grusht pranë kokës, tha:

— Mirë se ardhët, shokë!

— Mirë se të gjetëm, xha Riza, — iu përgjegjën.

Hekurani pa Jasharin. Për një çast vështrimet e tyre u përpogën dhe që të dy u rrënqethën. Djali desh ta ndiste, po kur u kujtua se do ta shihte plaku, e la.

Në skelë u dëgjua gërneta e pastaj sazet e tjerat. Qe zënë peshku i duhuri. Midis sazeve pa një djale që mbante në dörë një peshk të mëdhenj të stolisur me gram, lipushka dhe fletë zaimbaku.

Peshkatari i dha xha Rizajt peshkun. Ky e puthi në ballë, i mori peshkun, i ra poshtë e përpjetë grumbullit me vajza dhe ja dha njerës duke i thënë:

— Laje, pastroje dhe piqna përmezë.

Vajza i puthi dorën dhe i dhë peshqesh një dyshe.

Peshku u pastrua, u la dhe u vu në zjarr. Atë kohë nisi vallja.

Si u poq dhe u nda peshku, Rizaj u ngrit. Jashari e kuptoi se atij i erdhë rasti përtë folur.

— Afrohuni më pranë, o shokë!

Njerëzit u mblodhën. Rizaj u ra me dörë mustaqeve, qëroi gurmazin e tha:

— A dini një gjë? Kjo është festa e fundit që po kremtojmë.

Fshatarët panë me sy njeri tjetrin.

— Jo se na e kanduar njeri, po si t'ju them, vitin që vjen s'do ketë vendku të peshkojmë. Kalalin djemtë — dhe ndëri dorën nga eskavatoristët, — do na e mbarojnë sivjet. Uji do të derdhet në det, peshku, ai që do të zihet, do të zihet, tjetri do marrë rrugën për në Qafën e Kularit. Prandaj këngës që kanë thurur të vjetrit tonë për gjuetinë e peshkut i ka ikur vahti. Duhet të këndojmë një këngë tjetër. Vitin që vjen, shumë familje do të marrin tokë, bile do të marrin që këtë verë nga Kënetë e Zezë që dha shpirt. Vitin që vjen duhet t'i këndojmë kooperativës në fshatin tonë. Të këndojmë këngën që këndon fusha e madhe. Mishi i peshkut, që sa i mbante shpirtin fshatarit, do të zëvëndësohet me kokrrën e grurit, misrit dhe pambukut. Dhe në Plepaj do të skuqin shtëpitë nga muret me tulla e çatitë me tje-gulla. Me qindra vjet ka hequr Plepaj. Vuajtjet gjer në vitin 1954 e kishin fuqinë e tyre. Djemtë tanë, Qeveria jonë dhe Partia jonë i fuqen në dhe vojtjet tona, ndaj, o bij e bijat e mijë, thurini këngë festës tjetër, festës së formimit të kooperativës. Thurini këngë e mos harroni të këndoni për ata që dhanë gjakun për ditën e sotme. Mos harroni të këndoni edhe për bijtë tanë, eskavatoristët, të cilëve u kullon djersë e artë. Pastaj, mos harroni, o djem, të këndoni për Partinë tonë të dashur, për Enver Hoxhën, baban e birin tonë të madh.

Njerëzit vështronin plakun dhe u ngjethet mish-të. Të gjithë e dëgjonin me vëmëndje dhe i jepnin të drejtë. Ashtu si thosh xha Rizaj, ashtu ish vërtet.

— Shokë, — vazhdoi xha Rizaj, — pas pesë ditëve kooperativa bujqësore «Kristaq Tutulani» kremton festën e formimit të saj. Ajo ka ftuar dhjetë veta nga fshati ynë që të marrin pjesë në kremitim.

Këshilli i fshatit ka menduar të dërgojë këta shokë,
— dhe numuroi dhjetë vëtëj asq. ishtem. Et jetet
— Si thoni? A mund të na nderojnë në festën e
katundit Lales.

— Po, po, — u dëgjuan zëra nga të gjitha anët.
Jasharit iu bë qejfi se midis fshatarëve ishte edhe
vet Jashari. — * * * — Nëndërsa qëndrojnë shtëpi
të tjerë, etj. * * * — Nëndërsa qëndrojnë shtëpi
të tjerë, etj. * * * — Nëndërsa qëndrojnë shtëpi
të tjerë, etj. * * * — Nëndërsa qëndrojnë shtëpi

Në oborrin e shtëpive të Shahinajve, Avec rrapijt të madh, Jashari, kur ish i vogël, pati mbjellë edhe një mollë. Molla kish lidhur shumë kokrra, degët qenë mbushur dhet tani, më një thyheshin. Kokrrat skuqnin, sadoqë s'ishin pjekur. Në një degë që anonte nga veriu, midis gjetheve, dukej një kodër më e vogël se të tjerat, pak e fishkur dhe e verdhë. Po ta shihje nga afër, do të shquaje një vrimë që shkonte gjer diku, po që s'kish depërtuar gjer më zëmrën e saj. Po prapë molla qëndronte akoma e fuqishme.

Kësaj kokërr molledi ngjante dhe Nekija. Ndjehej e përmirësuar, dhe katënditë, ditën e festës së peshkatarëve, doli ngadalë, shtroi një rrugoz dhe ndenji për t'u shulluar në diell. Faqet dhe lëkurat e ftyrës i ngjanin shumë faqeve dhe lëkurës së mollës. Rinte në rrugoz dha edhe burte një corape leshi. Rezeti e diellit e ngrohni. Gruaja punonte dhe mëndjen e kish te festa. Atje do të ish dhe i biri. Ah, sikur të kish këmbë e të shkonte ta shihte si rrinte e si kërcente. U mat të shkonte, po gjene e mbajti veten, se i vjehri e kish porositur kushedi sa herë që të mos lodhej. Duke punuar, ndjeu që u hap dericka, ktheu kokën dhe pa Hekuranin. Ju lëshuan duart, u trondit dhe s'pati fuqi të ngruhej. I biri iu turr, e qafot dhe i mbeti në prehër. Nga sytë e Nekijes u rr

kullisen lotet një pas një. I zuri faqet, i pa sytë më urrejtje të madhe, pastaj nisi ta puthë me afsh e me zjarr.

* * *

Jashari ndenji mjaft në festë. Vështron te rinjtë dhe të rejat që kërcenin. Sytë i zunë dhe Selvijen, të cilën e shikonte gjatë e me vëmëndje.

— S'ka të share, — thosh duke parë vajzën që i kish vënë synë i nipi. Po kur kujtonte se ajo ish e bija e Rizajt, që i kish sjellë tërë ato fatkeqësi, mvrejtej. Afër drekës Jasharit i ra ndër mënd Nekija. Në festë ishin gjithë të shtëpisë, kurse e shokja e djalit të vrarë rrinte vetëm. Sigurisht që mërzitej. Iku nga festa që të shihte se ç'bënte ajo. Si e kish zakon, me kokën gjysmë të ulur, me bastunin prapa, plaku shkonte i qetë dhe me hap të ngadalshëm.

Kur iu afrau oborrit, pa Hekuranin që kish mbështefur kokën në gjurin e s'ëmës. U drodh i tëri dhei më kujdes u largua për të mos u prishur qetësinë. U ul në një vend të fshehtë dhe vështron te. Me të parë këtë skenë, në shpirtin e Jasharit u krijuar një gjëndje e vështirë. Nusja e djalit, që ndejeti në shtëpi dhe treti të ritë e saj në atë truall dhe i nipi që pat mbetur pa baba, qenë ndarë për shikak të tij. Plaku shkontakte Hekuramin tek po e ledhatonte e ëma dhe drithërohej. Në atë çast iu duk vetja i tepërt në botë e sikur kish shpirt prej katili, sepse ai kish ndarë nënën nga djali e djalin nga nëna.

Ashtu, këmbëkryq siç ish, Jashari vështron te më sy të zgurdulluar, me pamjen e një njeriu që e bren ndërgjegjja si krimbi lisin.

Në fund psherëtiu dhe tundi kokën:

— Do ta ndreq këtë punë! —
Zuri të dý tamthat me gishtrinjtë e mëdhenj e i shtrëngoi fort. Një zhurmë, që ardi nga oborri, e solli në vete. Hodhi sytë e pa Hekuranin që u ngrit e ndenji karshi s'ëmës. Se ç'i tha asaj e i fshiu lötët. Në atë çast u dëgjuan zëra në rrugë. Hekurani u ngrit, përqafci përsëri t'ëmën, e puthi dhe mezi u shqit prej saj. Sa u largua i nipi, Jashari doli nga vëndi ku ish fshehur dhe shkoi te Nekija.

E reja po qante. Me të parë vjehrini ajo fshiu lötët. Plaku u mallëngjye dhe, nga që s'e mbante dot veten, hyri në shtëpi me shpirt të copëtuar.

Turtujt fluturonin grumbuj grumbuj në erë, uleshin në hamullore, në mezhdat e misrave, në ndonjë pemë të lartë dhe niseshin për udhë të gjatë. Dallëndyshet rreshtoheshin në telat e telefonit, të tula-tura e dukej sikur u vinte keq për vëndin që i kish ushqyer dhe për ajrin ku kishin flutuar. Në qell shikoheshin lejlekët që shkomin drejt jugut me krahë të lodhur. Në kënetë nisi zhurma e shpendëve që dëgjohej në verë si e mbytur. Bajzat çanin ujin me gjoksin e tyre tërë pupla të ashpra e të dendura si të lyera me vaj. Rosat ngriheshin dhe kur e kur lëshonin zërin duke ndjellur rikat e vogla që sa kishin zë-në krahë. Në ara misrat ishin korruar e thyer. Dielli bënte rrugë më të shkurtër dhe dendur dukej si me drithë të vrarë.

Plepaj e kaloi verën atë vit më me qejf se vitet e tjerë. Çatitë e shtëpive, në pjesën më të madhe qenë me tjegulla, kurse katër pesë prej tyre kishin edhe muret me tulla. Dëgjohej zhurma e sqeparit

dhe të thirrurit e ustallarëve, kur fqinjët ose të afërmit e familjeve që ndërtonin, dërgonin peshqeshe.

Atë mbrëmje, drita e diellit i jepte fshatit një pamje të kulluar e të freskët. Çdo gjë shquhej, qartë e me një bukuri të rrallë. Në rrugën kryesore kish gjallëri. Qerret e mbushura me misër, tjegulla e tulla kërkëllinin, dhe zhurma e tyre përzihet me zérat e ndryshme që përhapeshin nga presja, kodrat e Shëne-Premtes, Rrapi i Shahinajve, nga fusha dhe nga thellësia e Kënetës.

Shahinajt ishin ndër familjet më të gjenuara; i madh e i vogël fluturonte nga gjëzimi e lunturia.

Më i gjuar nga të gjithë dukej Azizi. Atij i dukej sikur po lindte edhe një herë. Të nesërmen do t'i jepnin tokë të re, tokë të begatëshme dhe afër shtëpisë, tokë që s'ish punuar kurrë, gjithë plehë, tokë nga Kënetë e Zezë.

Kanali i gjerë e kishi dhënë frutin e parë. Tërbufi i Vogël ish kulluar, dhe afër dy mijë hektarë tokë ishin bërë për punë. Në listë, i pari që do të merrte tokë ishte Jashar Shahini. Atë ditë Rizaj lajmëroi në një mbledhje sihariqin e madh, sihariq që gjëzoi zemrat e fshatarëve.

Jashari ish i kënaqur. Ajo verë e pat plakur shumë. E plaku kopshti, e plaku ndarja e të nipit, por tanë dukej sikur përtërihej me ditë. Veçse në zemrën e tij ish edhe një plagë e pambyllur, dhe plagë e rëndë bile. Ai nuk ishte pajtuar akoma me të nipin, dhe s'po dinte si do ta zgjidhë këtë hall të madh.

Të nesërmen mëngjesi u gdhi i bukur. Çdo gjë u zgjua e madhërishme, e freskët, e ëmbël. Me të lindur dielli, në Këshillin e fshatit u mblohdën të gjithë Plepallarët. Aty kishin arrdhur, dhe njerëz nga Komiteti i partisë, nga pushteti e kantieri Midis styre

dallohej Shega. Katundarët, me saze përpëra, duke kërcyer e duke kënduar, morën rrugën. Nuk ecën shumë dhe ramë në një fushë. Atje dhei ishte plasa plasa, në ngjyrën e kafesë së mbyllur. Në të majtë të fushës shkonite kanali, kurse në të djathtë, përtej, dukej rruga automobilistike që vante në Sulzotaj e, më tej, dukej Shkumbini. Pranë kanalit qëndronin tre traktorë. Në njerin prej tyre hypi Rizaj i gëzuar e i qetë. Kish veshur rroba të reja e kish vënë medaljet që i zbukuronin gjoksin.

— Shokë, — nisi të flasë, — Kënetë e Zezë, që na kish zënë brinjën e djathtë, u tha: Tani radhëm e ka Tërbifi i madh. Punuan shokët tanë punëtorë. Punuan dhe po punojnë me rder. Unë dua që në emrin tuaj t'i falënderoj nga zemra dhe t'iu uroj punë të mbarë edhe pas kësaj. Unë dua të falënderoj në emër tuaj Partinë dhe shokun Enver për këtë ndihmë që na dhanë ne fshatarëve të brigjeve të Tërbufit, Rroftë partia jomë e Punës! Rrofshin punëtorët! Rroftë shoku Enver!

Brohoritje dhe duartrokutje të zjarrita shpërthyen nga të gjitha anët.

Pas fjalës së Rizajt, foli Shega, pastaj shefi i kantjerit. Në fund u lexua lista e njerëzve që do të merrnin tokë. Në radhë të parë përfituan të gjitha familjet që ishin dëmtuar nga kanali.

— Jashar Shahini, — foli një zyrtar me syzë.

Plaku që mbante në gjoksi katër dekoratat e të birit dëshmor iu afroa nëpunësve, iu dha dorën e qëndroi më buzë në gaz. Atë kohë nisën të matin tokën.

— E trashëgofsh, xha Shari, — uroi Shega, kur iu e aktua plakut toka e re.

Plaku e përqafoi në zhurmën e traktorit që nisi të hapë brazdën. Pas traktorit u turren një grumbulli

njerëz. Midis tyre ishte Azizi, që s'dinte ç'të bënte nga gëzimi. Kur shkoi traktori gjer në kufinë e tokës që do t'u jepej Shahinaive, Azizi qëndroi, u ul në bisht, mori një grusht me dhë e nisi ta vështrojë me etje të madhe.

— Zot, më jep fuqitë punoj si dua vetë! — mërmëriti dhe mori rrugën për te njerëzit që vështronin traktorin.

Duke ecur, Azizi diktoi Hekuranin që rrinte pak më përpara të tierëve, në një ledh që vinte pak më i ngritur. U rrënqeth. Deshi të vente ta qafonte, po prapë nukeshkoi. Në atë kohë e pa Hekuranin edhe Jashari. Zemra i rrahul me të forta dhe nië ndjenjë krenarie e ppushtoi. Po kur i zuri syri Rizanë, që rrinte shumë i kapardisur, sikur ja hoqi njeri me shuplakë.

«Nuk më ruajte kur më ngeci buka në grvkë! — mërmëriti dhet tundi kokën e shtrëngoi nofullat sikur t'i kërcënohej në heshtje kryetarit të këshillit.

— Ti u bëre shkak që më prishe, or Riza Drenja...»

* * *

Një maqinë udhëtonë nëpër qytet. Përpara maqinës, sipër në karroceri ishte shkruar: «Ujët e Tërbufit sot derdhet në det».

Në shtëvitetë dhe në derickat e oborreve të fshatarëve të Plépait ishin varur flamure. Te rrapi i Shahinaive, nérdegët e sipërme, qe varur një parullë: «Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë». Te Shelgu i Lumturisë po grumbulloheshin njerëz. Pranë tij qenë ngritur kodra të mëdha dheu, që sa veshin mbusheshin me fshatarë e qytetarë të ardhur nga të katërt anët e Myzeqesë. Afër drekës zunë të vinin një nga një shumë vetura. Atë ditë bëhej inaugurimi i

Emisarit, të Tërbufit. Uji i kënjetës, i mbylliur aty shekuj me radhë, atë ditë do të derdhej në det. Kanali kish shkuar gjer në buzë të kënjetës. Dy eskavatorë, që kishin ngulur lopatat në ledhin dy metra të ngushtë, që ndante ujet nga kanali, rrinin gati. Një fjongo e kuqe puqte lopatat me njera tjetrën. Në eskavatorin e krahut të djathtë rrintë Hekurani, kur se në të majtin, Besimi dhe ishin gati që të hapnin ledhin. Hekurani shikonte njerëzit me fytyra të qeshura dhe gëzohej. Syri i zuri gjithë të afërmitt. Azizin, Bulen, Nekijen, Selvijen, Rizanë dhe Jasharin që bisedonte me Shegën dhe me një oficer shpatull-gjerë. Në fillim oficerin s'e njoihu, po pastaj i qeshi buza. «Paska ardhur shoku Zan Hajdari!» — tha me vete. Desh ta shikonte më gjatë, po atë qast nga rruga, që ish rrrethuar nga të dy anët me popull, u dukën autoritetet.

I deleguari i Komitetit Qendror të Partisë dhei Këshillit të Ministrave mori një gëershërë dhe preu fjongan. Të dy eskavatoristët vunë në lëvizje motorët, ngulën lopatat, i mbushë dhe i vërvitën përtet.

Në vah nisi të rrjedhë një curril ujë. Pas pak ledhi u zhduk dhe uji i Tërbufit filloj të marrë rrugën e detit.

Jashari i pa të gjitha këto dhe shpirti po i përtërhej. Gëzonte dhe admironte çdo gjë që shihet. Kur mbaroi punë i nipi dhe u ul, ishte bërë ujë me djersë. Rrezet e diellit, që i binin në fytyrë, u jepnin pikave të djersës së ballit shkëlqim dhe dukeshin si me ruaza të arta. Ato pikat i kujtuat plakut fjalët e të gjyshit: «Tërbufi do të thahet kur t'u kullojë njerëzve djersë e artë».

— Hekur, o Hekur, — foli Zani dhe u derdh përpara.

Eskavatoristi u turr, e pushtoi fort, u puth me

të duke u ngashëryer, pastaj, ashtu i entuziazmuar, u përqafua me t'ëmën.

Jashari rrinte si i ngrirë. Kur u nda Hekurani nga e ëma, plaku, e vështroi si i hutuar, pshëretitë dhe e përqafoi me duar tëndredhura.

Pas pak, të gjithë së bashku shikuani te shëshi para Shelgut të Lumturisë. Shefi i kantjerit hapi mitingun, pastaj folën i deleguari i Partisë dhe i Qëverisë, një inxhenjer dhe një brigadier. Më në fund, u ndamë dekoratat.

Hekuranin e thirën në tribunë.

Djali shkoi me hap të sigurtë, po kur u afroa u skuq në fytyrë. I ngjitën Urdhërin e Punës në xhaketë dhe e uruan për të ardhmen. Eskavatoristi u kthye te të afërmit e tij, në kulmin e gjëzimit.

Plaku i pa dekoratën që shkëlqente, kurse Hekuranit i vanë sytë te dekoratat që mbante i gjyshi për të birin e tij dhe një ndjenjë krenarie i përshkoi trupin.

Më në fund, të gjithë së bashku, muarën udhën për në shtëpi. Te sheshi i fshatit u dëgjuan daullia dhe ja muarën valles.

Djali rrinte pranë prindërve.

Jashari dëgjonite sazet e mbushte çibukun. Atë kohë se si i vanë sytë në qill dhe shquajti dy shpenzë që viriin frotull.

— C'të jenë këto? — vriste mëndjeni Jashari dhe mbloodi grushtet si dylbi duke i vështruar më me kujdes.

— Qënkan shqiponja mal! — mërmëriti duke ndjekur fluturimin e shqiponjave e duke dredhur mustaqet.

Atë kohë plakun e zuri dikush për krahu. Jashari ktheu kokën dhe njozu Shegën.

— O xha Shari, pa eja tē shkojmë nga shtëpia, se kam një sihariq pér ju.

Plaku e vështroi në sy dhe buzëqeshi. Ajo vazhdoi:

— Pa njihuni me shokun, éshë Drejtori i bankës. Plaku i zgjati dorën dhe që tē katër, duke qenë edhe Hekurani me ta, muarën rrugën e shtëpisë.

— Po Zanin ku e ke? — pyeti plaku si bënë nja dhjetë hapa.

— Ka shkuar te Rizaj.

Jashari nuk foli. Me tē hyrë në oborr, pa tē birin e i tha:

— Aziz, nxirr rrugozin e qylymin në hie tē rravit.

I biri u ngrit nga vendi, i mori Bules rrugozin dhe, kur pa se mungonin jastëkët, shkoi e mori dhe ata.

Shega me buzë në gaz shikonte plakun dhe, si i tregoi Drejtorit tē Bankës pér familjen e Shahinajve, i tha Jasharit.

— Kam marrë vesh se je zënë me Rizanë dhe, si i thonë fjalës, qënkeni zënë pér mustaqet e Çelos. Rizaj s'ka pasur aspak faj. Kanali do tē shkonte pa tjetër te Vija e Strymit, se atje e merrte plani dhe s'kish asnjë rrugë tjetër.

— Nuk e di, moj bijë, po edhe tē Vija e Patës mund tē shkonte dhë nuk shkoi, se s'desh Rizaj, se i prisheshin bostanet.

— Nuk éshë ashtu, xha Shari. Bostanet e xha Rizajt i mori kooperativë e fshatit Mokaj, se i ka afër; dje ai ua dha vetë. Së shpejti, xha Rizaj do tē marrë tokë tē re, ashtu si more dhe ti. Je zënë kot. Pastaj, si mund tē vihet dorë te Kryetari i Këshillit, te ai kryetar që éshë zgjedhur nga populli? S'kini bë-

rë mirë. Paska qenë i urtë xha Rizaj, se pò të ish ankuar, do ta kish pësuar keq yt bir.

Jashari vështroi i turbulluar, tundi kokën dhe rënkoj.

— Ti më the se bostanët ja dhat kooperativës?

— Po, ajo i dha shpërbimin e punës që kish bërë gjer tashti dhe ai s'kundërshtoi. «Kur dashka kooperativa bostanet, le t'i marrë. Unë s'kurseva kokën për ta dhe jo të kursej tokën», — tha Rizaj.

U bë qetësi. Jashari kish rënë në mendime, kurse Azizi rrinte kokëulur.

— Nejse, xha Shari, e mira e të mirave është që ju të pajtoheni; kjo është fjala ime. Tani, shoku Drejtor i bankës ka ardhur të të japë shpërbimin e démit që t'u bë në kopësht dhe në arë. Nga këneta e Zezë more tokë dhe aty ndërtó një kopësht të ri, Ti, Aziz, mbill grurë, se do të të japë sa të duash.

Jasharit i dukej sikur ish në èndër. Herë pas here vështronte Shegën, pastaj i hidhte sytë përqark si ndonjë që do të fluturojë me krahë.

Drejtori i bankës nxori të hollat dhe i numuroi Jashari i mori me duar të dredhura.

— Zere sikur ja shite kopshtin qeverisë, — i th Shega.

Jashari mbylli sytë, tundi kokën dhe dy lot rrrukullisën në faqe.

Shega tërë ditën u bëri vizita plepallarëve; në mbrëmje u duk prapë te shtëpia e Shahinajve. Nuk hyri brenda, ndenji mbi kërcurin e vjetër dhe, duke vështruar plakun i tha:

— A shkojmë t'i bëjmë një vizitë xha Rizajt? Unë dua t'ju shoh t'i shtrëngoni dorën njeri tjetrit. S'ka hije...

Plaku s'foli një hop, pastaj brofi më këmbe;

— Shkojmë, — tha më një zë që tregonte pende.

së të thellë pér gjithë ç'kishin ndodhur dhe vendosmëri pér ta shlyer çdo njollë turpi.

Shkuan dhe të gjithë së bashku hynë në oborr të Rizajt. Xha Rizaj doli e i priti me bujari. Pér një çast të dy pleqtë u vështruan në sy, pastaj u përqafuan.

Selvija, që kish dalë në prak të derës, i pa dha u skuq u bë flakë. Në buzë i lëvrinte hia e një gëzimi të papërbajtur. Herë shikonte pleqtë, herë Hekuranin. Pér një çast vështrimet e të dy të rinxje u përpinqen. Në sytë e tyre shkëlqente ngazëllimi pér trugën e lumtur që u hapej përpara. Atë çast nga lindja u dëgjua një zhurmë. Tufa pelikanësh u ngritën në qancell dhe nisen të fluturonin rrith e qark.

— Pelikanët ndruan fole! — xha Shari tha Shega.

— Ndruan, bijë. Ata ikën nga Kéneta e Zezë e ngritën fole në Tërbuf, po edhe atje s'e kanë të gjatë.

— Po, s'do ta kenë të gjatë, — e përforcoi thënien e xha Jasharit xha Rizaj, — s'do ta kenë të gjatë, se i kanë vënë shpatullat e gjoksin punës këta, — dhe iu përgëzoi shpatullat Shegës e Hekuranit.

6

Бесхитор: Мараја Сисиријан
Редактор: Јелена: АЛН Народни
Издатник: Јован: Аћим Џами
Кооператива: Доми Гјуми

BIBLIOTEKA
SHTRIJEVSKA
32473

Sotira që i përdorim këtë libri është që
përveç që është një libri i vlerësuar, është
një libri i interesante historie së Shqipërisë.
Përmes këtij librit, mund të shihni
dëshmi e rëndësishme e zhvillimit
politik, ekonomik, kulturor, etj. të Shqipërisë.
Të dhëna që përcaktojnë
në këtë libri, janë të rëndësishme
përmes të cilave mund të
meritur një përgjigje më e
plotë për historinë e Shqipërisë.
Më poshtë, mund të
meritur një përgjigje më e
plotë për historinë e Shqipërisë.
Të dhëna që përcaktojnë
në këtë libri, janë të rëndësishme
përmes të cilave mund të
meritur një përgjigje më e
plotë për historinë e Shqipërisë.
Të dhëna që përcaktojnë
në këtë libri, janë të rëndësishme
përmes të cilave mund të
meritur një përgjigje më e
plotë për historinë e Shqipërisë.

Redaktor: Moisi Zaloshnja
Korektor letrar: Ali Hashorva
Redaktor teknik: Adem Lita
Kopertina: Dolli Gjinali

Tirazhi: 3000 Kopje Format 70X100 1/32 STASH: 2204-55

Shtyp. N.I.SH. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tiranë
168